

JANIS LILIS

# BALLKANI I DEHUR

*Parathënia nga*  
NASHO JORGAQI

- SHËNIME UDHËTIMI
- ARTIKUJ ESTETIKE
- SKICA E TREGIME

TIRANË 2012

**Botimi origjinal**

**ΓΙΑΝΝΗΣ ΛΙΑΛΗΣ**

*«Στα μεθυσμένα Βαλκάνια»*

*επαναστατικές σελίδες*

*Αθήνα 1946*

**Korrektor letrar**

Stavri Sharrëxhi

**Παναγιώτης**  
**CONFIDENTIAL**

ΕΠΙΣΤΗΜΟΝΙΚΟ ΚΕΝΤΡΟ  
ΕΡΕΥΝΑΣ ΚΑΙ ΠΡΟΣΕΚΥΨΗΣ  
ΕΠΙΣΤΗΜΟΝΙΚΟ ΚΕΝΤΡΟ  
ΕΡΕΥΝΑΣ ΚΑΙ ΠΡΟΣΕΚΥΨΗΣ

**Formulimi grafik**

Adelprint


**Kopertina**

Stefan Taçi

© Copyright

Shtypur në Shtypshkronjën “Adelprint” sh.p.k.

ISBN:



*Jani Lili në moshë të re*



# JANI LILI – SHKRIMTARI DHE PUBLICISTI QË BEFASON DHE SFIDON

*Dy fjalë nga përkthyesi dhe mbledhësi i materialit, Panajot Barka*

Kur profesor Nasho Jorgaqi, me fisnikërinë që e karakterizon, përfundoi recensën për disertacionin tim me fjalët, perkulem me respekt para trashëgimisë letrare të minoritetit grek u ndjeva më borxhli ndaj letrave dhe kulturës së minoritetit etnik grek në Shqipëri, se sa kur e nisa rrugëtimin për të sjellë në një punim doktore historinë e këtyre letrave dhe të kësaj kulture.

Midis emrave të shquar të kësaj trashëgimie të përmendura nga profesori ishte edhe Jani Lili. E vërteta është se burimet e informacionit për të tregonin të shtëruara. Në Shqipëri, për shkak të biografisë. Më tutje, për shkak të hapësirës gjeografike që lëvizti, jetoi e punoi. Ky realitet e bënte më të rendë pluhurin e dekadave mbi veprën e tij. Por ishte edhe ky, pluhur që fshihte një thesar. Kishte arritur të mbulonte thesarin, por nuk mund të pengonte fushën magnetike rezatuese të vlerave të tij. Profesor Nashua kishte të drejtë. Sot i themi me modesti se një pjesë e veprës së Jani Lilit, që më së shumti lidhet me Shqipërinë, e kemi në këtë libër të parë në gjuhën shqipe.

Libri që i ofrojmë lexuesit zotëron një tufë vlerash të spikatura dhe të rralla. Janë të natyrës së letrave, treguese të modelit të bashkëjetesës dhe të kontributit për të, të kompromisit dhe me errësirën për t'i shërbyer dritës. Rrjedhin nga veçoria e autorit Jani Lili, me origjinë greke, nga fshati Dervican i Dropullit, në rrethin e Gjirokastrës. Jetoi vetëm 47 vjet, pak për veprën që la pas.

Fati e pajisi me dhunti të papërsëritshme artistike e letrare.

Talentit i dha si dhuratë të çmuar një kulturë të gjerë, të cilën e ktheu në sistem referimi të sjelljes dhe të veprimtarisë së tij civile për të kapërcyer provincializmin, skepticizmin nacionalist dhe urrejtjen pa kufi të kohës së luftës. E vuri në shërbim të letrave për të shkruar një letërsi që e vë në avangardën letrare të kohës. Aq sa pa frikë mund të themi se letërsia e tij jo vetëm që i rezistoi kohës, por koha e letrave duket se nuk mund ta parakalojë atë.

Për asnjë moment nuk e pa vetën shpëtimtar të botës apo të njeriut. Ambicia e tij e vetme, e thjeshtë por e sinqertë, ishte shprehja e shqetësimit të tij të thellë për gjendjen e njerëzimit. Dhe e bënte këtë me shumë mënyra. Me veprime konkrete të njeriut që s'pajtohet me këtë realitet, me udhëtime që i siguronin shpëtimin e përkohshëm dhe thellimin e dhimbjes dhe të protestës njëkohësisht, duke u dhënë pas letërsisë.

Për 65 vjet qëndroi në errësirën e baltës që i hodhi koha dhe bashkëkohësit e tij. Arsyeja e vërtetë ishte distanca e pa shkurtuar që letërsia, arti dhe pretendimet e tij artistike, ruanin krahasuar me prodhimin e tyre artistik. Arsyeja e deklaruar lidhet me kompromisin e Lilit për t'u pajtuar me mekanizmin në shërbim të asaj ideologjie të cilën, në thelb, e dënonte dhe e urrente deri në asgjësim.

Libri që lexuesi ka në dorë përbën një përpjekje për rehabilitimin artistik e moral të veprës së J. Lilit, vepër e cila na tregon se sa më shumë koha kalon, aq më mirë e kuptojmë rëndësinë dhe vlerat letrare të tij.

Edhe pse grek, ai njihte shumë mirë Shqipërinë dhe shqiptarët, njihte kulturën, mentalitetin, traditën dhe aspiratën e tyre. Shkrimet e librit i dedikohen realitetit shqiptar në kohështrirjen para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Libri përbëhet nga tri pjesë:

*Pjesa e parë* na shpalos tregime udhëtimi nëpër Ballkan. "Ballkani i dehur, që përbën edhe titullin e librit U shkrua në gjuhën greke, me 1946. U përkthye në shqip, me 2011. Një letërsi e llojit të

veçantë. Është njëkohësisht roman autobiografik, reportazh letrar e filozofik, një manifest social-politik. Mënyra e kompozimit të rrëfimit e bën Lilin të qëndrojë në krah të Kazantzaqit të madhë. Letërsia që shpalos dhe parimet letrare e ideoestetike të cilave u referohet, e vendosin në bashkësinë e korifenjve të letërsisë greke të viteve 30. Rrëfyesi në vetë të parë i ngjarjeve në udhëtim, herë konfondohet me autorin dhe herë me bindjet e aspiratat e tij, herë me përvojën e jetuar e herë me përjetimet e të tjerëve. Përbën në fakt një skanim deri në indin e fundit të psikosintezës shqiptare kolektive dhe individuale të kohës. I jep rezultat përpjekja për të depërtuar me objektivin e skanerit të tij social filozofik në diakroninë shqiptare në fenomene që shënjojnë mbikohësisht shoqërinë shqiptare. Jo thjesht për të ndjekur rrugën e krijimit, të kompozimit dhe të formimit të kësaj psiko-sinteze dhe konstitucioni shpirtëror, si edhe shkaqet që e përcaktuan atë, por për t'i dhënë të drejtë vetes për analiza të vlefshme dhe për ditët tona. Në të mishërohet një letërsi ku vlerat artistike gatuhet në estetikën e shpirtit lirik të autorit, ku qëmtimet dhe vëzhgimet gazetareske përbëjnë lëndën e parë për reflektime në pasqyrat e kulturës së tij dhe të ndërgjegjes së tij. Gjithashtu ato ndihmojnë për të fiksuar e dhënë artistikisht dimensionin me të thellë të realitetit shqiptar.

Arti i fjalës së tij është përherë në funksion të qëllimit më të lartë. Herë përshkruan, herë psikologjis, herë filozofon e herë ëndërron. Rrëfimi rrjedh me thjeshtësi në ngjarje dhe situata, të cilat, shpesh, edhe pse qëndrojnë mbi detaje, na çojnë te thelbi i qëllimit të autorit. Karakteret e tij, herë të vërteta e herë plazmatike, nuk janë heronj, por dëshmitarë, nuk janë fajtorë, por viktimë në kërkim të një rruge shpëtimtare. Ai i fton në rrëfimin e tij për t'i dhënë jetë, për të dramatizuar dhe për ta bërë më tërheqëse analizën e vet politiko-shoqërore.

Gjuha e Lilit është krijuese, e përshtatur me mjeshtëri në stilin e rrëfimit të tij karakteristik. Në përdorimin e saj është i dukshëm interesimi

për të qëmtuar edhe fjalën e fundit.

Si e tillë e bënte përkthimin një art të vërtetë. Në procesin e përkthimit nuk mund të kishim parasysh vetëm materien letrare që duhej përkthyer dhe mjedisin pritës, lëxuesin shqiptar. Por edhe origjinën, mentalitetin, kulturën dhe formimin e autorit. Na u desh të njohim thellë artin letrar grek të brezit të tij. Të përvetësonim gjuhën e kësaj letërsie dhe sidomos gjuhën e shkrimtarit, e cila është bëfasisht krijuese. Lili nuk është se nderton sistemin e vet figurativ nëpërmjet gjuhës, por më shumë vë simbolikën gjuhësore në shërbim të parimeve të tij estetike e filozofike, sidomos përsa i përket raportëve të njeriut me natyrën, me traditën e tij kulturore, filozofike e shoqërore etj. Në një realitet të tillë na u desh të kapërxenim parimet e njohura përkthyesë dhe të ndiqnim në shqip gjuhën e tij letrare greke.

*Pjesa e dytë* përfshin disa nga seria e pafund e shkrimeve të tij në shtypin më në zë të kohës në Tiranë. Vepra e tij publicistike e artikullshkruese në gazetat më të mëdha të periudhës së Luftës së Dytë Botërore, ka një qëllim të lartë. Ajo synon të krijojë bazat e teorisë së letërsisë shqiptare, të japë njohuri letrare, të bëjë analiza e kritika, t'i ofrojë dhe të sistemojë terminologji dhe vetë letërsinë shqiptare. Arti për të ishte “këshilltar i pagabueshëm i jetës, prijësi shpirtëror, shtytësi drejt një lartësie jashtë materialiste”.

Në mendimet e tij për letërsinë kërkon një komunikim me traditën dhe të vendosë një ekuilibër midis asaj dhe artit modern. Pretendon me bindje një marrëdhënie të barabartë në këmbimet letrare me Evropën. Por, nuk pranon imitimim e verbër të saj, nuk qetësohet me klasicizmin e vjetër. Përqafon, me siguri, frymën e re në kulturën botërore, duke propozuar një letërsi shqiptare, që mbart vulën e popullit të vet, që qëmton mbi realitetin shqiptar dhe djepin e traditës së vet letrare të kultivuar e popullore. I sjell realitetit letrar në Shqipëri personalitete të shquara letrare e artistike nga



Greqia e Italia apo vende te tjera Evropiane, me këmbënguljen e vetme lartësimin cilësor të letërsisë shqiptare.

*Pjesa e tretë* përfshin dhjetë skica dhe tregime të shkurtra letrare të botuara gjithashtu në shtypin e kohës në periudhën 1940-1941

Në koncizitetin e tyre ai tregon se letërsinë e njej më mirë kur e shkruan se sa kur e vlerëson. Mbi fabula e subjekte të thjeshta të marra nga jeta e përditshme ai shpalos kulturën e tij të gjerë letrare, filozofike, shoqërore. E ndihmon, me sa duket, dhuntia e të qenit gazetar ku aftësia vëzhguese e detajeve përbëjnë materien për mishërimin në artin e tij letrar të kulturës së tij dhe të njohurive të veta filozofike.

Duhet thenë se në riprodhimin e shkrimeve të pjesës së dytë dhe të tretë me qëllim nuk ka një përshtatje të plotë me normën gjuhësore letrare të natyrës gjuhësore që është fiksuar në shypin e kohës. Kjo u bë me qëllimin e vetëm që lexuesi dhe studjuesi të mund të ndjekin procesin e formësimit të gjuhës në atë periudhë, sidomos përsa i përket terminologjisë dhe koncepteve letrare dhe si evoluuan ato më vonë.

\*

\*        \*

Janis Lilis, megjithatë mbetet një përfaqësues i denjë i letërsisë greke i brezit të viteve tridhjetë, periudhë që, sipas vlerësimeve të studiuesve grekë e atyre të huaj, përbën një epokë që ndryshoi gjithçka. “Një yjësi vezulluese” e karakterizon **atë Rodrig Podrik Biton**. Bëhet fjalë për një letërsi që, sipas studiuesit, italian Mario VITTI, brezat që pasuan e vunë në dyshim por nuk arritën të përmbysnin asgjë nga arritjet e saj. Dhe kjo është e vërtetë po të kemi parasysh se në të përfshihen dy nobelistë grekë, Seferis e Elitis dhe një plejadë emrash të shquar të letërsisë e të artit grek.

I brumosur në përvojën e klimës së luftës mbeti gjatë gjithë jetës një shpirt poetik dhe filozofik i shqetësuar për probleme fundamentale shoqërore, politike e estetike të kohës, për hapësirën dhe kohën, për traditën dhe të ardhmen, për natyrën dhe marrëdhëniet e njeriut me të si më substancialet. Arrin deri atje sa t’u kundërvihet mekanizmave të shoqërisë, të cilat, sipas tij, vetë njeriu i ndërtoi për të skllavëruar vetveten.

Plotësia njerëzore, sipas Lilit, arrihet në respektimin e ligjësive të natyrës. Pikërisht te kjo natyrë ai kërkon “ashpërsinë e vetë shpirtit ballkanas”, “predispozicionin nostalgjik dhe dehjen lirike të botës ballkanase”, “ndryshueshmërinë e çuditshme e shpirtit të popujve të tij”, për të arritur te konkluzioni se “pasionet këtu nuk i zbut asnjë civilizim, asnjë kulturë nuk i qetëson”.

Shpreh hapur frikën se shoqëria e lumturisë së imponuar do të tregohej më e rrezikshme, me tinëzare se barbaritë e shkuara dhe luftërat. Besoi te komunizmi dhe te internacionalizmi i predikuar prej tij se e përjetonte atë si materie shoqërore të filozofisë së Krishterimit. Por aftësia e mendimtarit, që i siguronte rolin e lajmëtarit për perspektivën e kohëve, e bindi shpejt se rreziku ishte i pashmangshëm. “Ide të reja lërojnë thellë horizontin e vet të mjegullt” paracakton të ardhmen komuniste të popullit shqiptar Jani Lili.

Në këtë këndvështrim Jani Lilit nuk i detyrohemi thjesht heqjen e baltës së rëndë të harresës dhe të denigrimit, por edhe një nderim të veçantë dhe përkushtim për t’u dëgjuar një zë ndjeshmërie humane, një penë që skanon estetikisht realitetin e kohës së vet, të cilit, me siguri, profesionalizëm dhe aftësi profetike i jep vlera estetike të mbikohëshme.

Duke i përmbyllur këto shënime dua të falënderoj përzemërsisht profesor Nasho Jorgaqin për këmbënguljen dhe përkushtimin e treguar që lëxuesi shqiptar të ketë në dorë një autor, që përbën një risi të veçantë në letrat shqipe dhe të minoritetit etnik grek; vajzën e autorit, Kostandinën

në Australinë e largët, për gadishmërinë e treguar që për të atin e vet të ketë edhe një botim në gjuhën shqipe; kolegën Kostando Baruta për ndihmesën në gjetjen e materialit në shtypin shqiptar të periudhës së Luftës; poetin Andrea Zarballa, si edhe të gjithë ata, të cilët kapërxyen çdo paragjykim të vjetër e të ri dhe sollën kontributin e tyre për këtë botim.



## JANI LILI I GJETI MË NË FUND LEXUESIT E TIJ

Shkrimtari Jani Lili i takon kategorisë së krijuesve të pafat. Është ndoshta i vetmi që përshkoi një rrugë të gjatë, 65- vjeçare, në kërkim të lexuesve të tij të vërtetë. Dhe i gjeti. Pasi kapërceu dy mure të mëdha. I pari qe murin ideologjik. Ndoshta ka qenë fati i padukshëm që i ngriti këtë mur. Ndoshta qëndrimi i caktuar i tij kundrejt epokës dhe protagonistëve. Ndoshta të dyja së bashku. Por një ditë u gjend ai në njërën anë të murit dhe në anën tjetër vendi i tij. Kërkonte një shteg për të gjetur lexuesit, por nuk e gjente. Iku i pikëlluar nga Shqipëria dhe vajti në Greqi. Iku i dekurajuar nga Greqia dhe arriti në Australinë e largët. Iku i zhgënjyer nga Australia dhe u vendos për gjithmonë në vendin e amshimit.

65 vjet ishin të mjaftueshme për të rrëzuar murin ideologjik, përderisa kishin rrëzuar mure edhe më të mëdha, si ai i Berlinit. Kjo i dha mundësinë të nis rrugëtimin në të kundërt, nga vendi i amshimit në kërkim të lexuesve. Për fat të keq u përplas pas një muri tjetër, shumë më të fortë se i pari. Ishte muri i smirës letrare. Brezi i tij alarmohej dhe vetëm nga artikulimi i emrit të Lilit.

Lëshonte hordhitë e mallkimeve, egërsohej. Bëhej e dhunshme, ligësohej. Dhe, përderisa, ligësia është motër e dinakërisë, gradonte tinëzisht anatemat mbi hallkën e tij të dobët, atë të shërbimeve ndaj ideologjisë, që vetë ai s'besonte. Në fakt godisnin mbi shtatin e tij letrar. Dhe duhej të ikte nga kjo jetë brezi i tij, që të shëmbej edhe muri i dytë.

Ideologjitë venë e vijnë, zëvendësojnë njëra- tjetrën, përftojnë ngjashmëri sa shpesh nuk mund t'i dallosh. Smira mbetet gjithmonë po ajo: primitive, e egër, e pamëshirshme. Përherë e uritur dhe e etur në kufirin e kimit moral. Nuk zbutet. Dhe ushqehet me trupa të njomë talentesh. Sa më të spikatura talentet, aq më të shijshme kafshatat.

Brezi i tij nuk e fali kurrë, sepse, në thelb, atij fati i letrave i

caktoi zbulimin e një shkalle. Në kohën që të tjerët ecnin në sipërfaqen e gjerave ose mjaftoheshin me ngjashmërinë e jashtme të sendeve, duke thurur ditirambe për një mal epik, për një kala të pamposhtur, për një datë shurdhuese ose për një kalorës pa shpatë, ai sfilitej në shkallën e tij për të arritur në shpirtin e njerëzve, në shpirtin e popujve. Dhe e gjeti. Gjithë vepra e tij e ndërtuar me fjalën e përzgjedhur meditative, filozofike dhe metaforike, nuk është gjë tjetër veçse një zbritje këmbëngulëse në botën e brendshme, për të zbuluar materien natyrore të ekzistencës dhe për të interpretuar situata, qëndrime dhe sjellje më të thella njerëzore.

Ajo që të çudit është se sa më shumë zbriste, aq më e gjerë dhe më e ndritshme bëhej bota e tij letrare. Në antitezë me të tjerët që, megjithëse rriteshin nën dritën e diellit, të zhgënjyer konstatonin se bota e tyre letrare bëhej më e vogël, më e zbehtë, më jetëshkurtër, aq sa jepte shpirt mu te këmbët e tyre.

Koha i dha të drejtë. Shkrimtari Jani Lili, pas një rrugëtimi sfilitës, i gjeti lexuesit e tij. Pas këtij momenti do të vazhdojë të bashkudhëtojë me brezat e së ardhmes. Ndërkaq, proza cilësore e minoritetit grek, pa me kënaqësi të veçantë se radhët e saj shtohen: Athanasios Ikonomidhis, Miltiadhis Ikonomidhis, Katina Papa, Janis Lilis...

**Andrea ZARBALLA**

*poet dhe përkthyes*

## PARATHËNIE

Jani Lili, një emër që më ka mbetur në mend nga leximet e shtypit shqiptar të viteve '40 të shekullit XX, kur hulumtoja për të njohur nga afër jetën letrare e kulturore të asaj kohe. Më tërhoqi fillimisht fakti që firmën e tij e mbanin disa artikuj dhe shënime për probleme letrare dhe estetike, jo aq fort të trajtuara në shtypin e ditës. Ç'është e vërteta, Jani Lili, më shumë se sa emër i vërtetë, më tingëllonte si pseudonim letrar. Dhe kështu do ta mendoja deri sa një ditë kur, në bisedë e sipër me mikun tim Spiro Xhai, nuk di se si doli emri i Jani Lilit dhe ai më tha duke buzëqeshur: “Jani është nga anët tona. Ishte nga Dervišani, pranë fshatit tim. Unë nuk e kam njohur drejtpërdrejt, por di që i takon të jetë nga të paktët intelektualë minoritarë që do të shkruante aso kohe në gjuhën shqipe e do të botonte shkrime në shtypin e Tiranës. Më vjen mirë që ti i paske lexuar dhe e vlerëson nivelin e penës së tij.”

Kaq më tha Spiroja. Më tej, ai nuk dinte për fatin e Jani Lilit. Do të duheshin të kalonin disa dekada dhe në rrethana krejt të tjera do të ndeshja rishtazi emrin e tij. Kësaj here Jani Lili ishte përfshirë në studimin “Historia e letërsisë së minoritetit grek në Shqipëri” të pedagogut Panajot Barka të Universitetit “Eqrem Çabej” të Gjirokastrës, që ai e paraqiste para jurisë, ku bëja pjesë edhe unë, për të marrë gradën e doktorit të shkencave filologjike. Sigurisht, u gëzova jo vetëm se mora të dhëna të reja për Jani Lilin, por, ç'është më e rëndësishme, për herë të parë u njoha me historinë e letërsisë së minoritetit grek në vendin tonë. Njihja, natyrisht, letërsinë e viteve të socializmit, madje kisha miq disa nga personalitetet e saj, si S. Xhai, P. Çuka, N. Kacalidha, A. Zarballa, V. Koçi, por s'dija asgjë për traditën e saj. Nuk dija që nga ky komunitet kishin dalë shkrimtarë të talentuar, të cilët kishin bërë emër me vepra letrare të botuara në gjuhën e tyre amtare në Greqi, si Katina Papa, Athanasios Ikonomidhis etj. dhe në

mes tyre dhe Jani Lili.

Pas kësaj njohje të përgjithshme që kish të bënte me vlerat shpirtërore të komunitetit tonë grek në Shqipëri interesimi im do të rritej dhe veçanërisht për figurën enigmatike të Jani Lilit. Për fat të keq burimet e njohjes qenë shumë të pakta dhe të vështira. I vetmi studiues minoritar që do të tregonte interesim dhe do t'i binte në gjurmë do të ishte Panajot Barka. Prej tij do të merrja vesh dora dorës për jetën dhe veprimtarinë e mëtejshme të Jani Lilit. Një jetë relativisht e shkurtër, që nuk i kish kapërcyer të 50-at (1918-1965), i shkolluar në gjimnazin “Zosimea” të Janinës dhe në Universitetin e Romës, që ishte kthyer në Shqipëri dhe kish punuar kryesisht si gazetar në shtypin e Tiranës e më pas në atë të Athinës në kohë të vështira. Në vitin 1948 ai kish përfunduar si emigrant në Australinë e largët dhe atje kish mbyllur sytë në kulmin e veprimtarisë së tij si gazetar e shkrimtar. Një veprimtari e pasur e me vlera, e shpërndarë në libra, revista e gazeta, që rrok një hark kohor relativisht të kufizuar, por që ka hyrë tashmë në historinë e letërsisë dhe të kulturës greke të diasporës nëpër botë e aq më tepër të minoritetit grek në Shqipëri.

Dhe është meritë e studiuesit tonë minoritar, që falë përkushtimit dhe kërkimeve ka arritur të nxjerrë në dritë deri më tani qoftë dhe majën e Ajsbergut të trashëgimisë së Jani Lilit. Ai jo vetëm i ka mbledhur shkrimet e tij, botuar në shtypin shqiptar, por ka shtënë në dorë dhe ka përkthyer librin e Lilit “Ballkani i dehur”, duke na zbuluar kështu staturën e tij si kritik letrar dhe estet, publicist e akoma më shumë si shkrimtar. Kuptohet se kontributi i çmuar i Jani Lilit i takon letërsisë dhe kulturës së minoritetit grek, por trashëgimia e tij ka të bëjë edhe me Shqipërinë, sepse një pjesë e saj është shkruar dhe në gjuhën shqipe. Nga kjo pikëpamje ai, ndoshta, është ura e parë lidhëse mes dy kulturave tona.

Duke e vështruar nga afër jetën intelektuale shqiptare të viteve ‘40, një kohë kjo tepër e trazuar që kish të bënte me pushtimin fashist,



Jani Lilin do ta shohim të pranishëm në rrethin e letrarëve dhe gazetarëve të kulturës. Ai i takonte një brezi të ri letrarësh që po debutonte në shtypin e kohës më një zë të vetin, kryesisht në prozën e shkurtër dhe në poezi. Jani Lilin e gjejmë në shoqëri me emra të njohur të kulturës shqiptare si kritikun Vangjel Koça apo shkrimtarin Ernest Koliqi, të cilët, ndonëse qenë figura të hierarkisë fashiste, nuk arritën ta komprometonin atë politikisht. Asnjë shkrim i tij nuk është i infiltruar nga ideologjia e ditës, përkundrazi, ai tregohet i distancuar, madje, siç do ta vërejmë në veprën e tij “Ballkani i dehur”, autori qëndron në pozita antifashiste. Një qëndrim i tillë s’ka si të mos i bëjë nder emrit dhe kujtimit të shkrimtarit minoritar.

Trashëgimia letrare, studimore dhe publicistike e Jani Lilit është e gjerë dhe e larmishme, e shtrirë në kohë dhe hapësira të ndryshme, e shkruar kryesisht në greqisht, me përjashtim të disa shkrimeve në gjuhën shqipe, si skica letrare, artikuj kritikë, profile krijuese, reportazhe e intervista, të botuara në shtypin shqiptar të viteve ‘40. Por do të jenë veprat që botoi në gjuhën greke, ato që përfaqësojnë dhe mishërojnë vlerat e tij si shkrimtar dhe publicist. Në qoftë se në fund të viteve ‘30 do të debutonte në shtypin grek me shkrime të ndryshme, nga mezi i viteve ‘40 Jani Lili do të paraqitej para lexuesve me libra e veta. Kështu, ai do të botonte në Korfuz përmbledhjen poetike “Brenga të mbytura” (1945), për të vijuar brenda një kohe të shkurtër me vepra të tjera serioze, të cilat i boton në Athinë. Këto do të jenë “Ballkani i dehur” (1946), “Përshkrime mbresëlënëse” (1947) dhe “Faqe nga Epiri i Veriut” (1947), vepra kryesisht letrare-dokumentare, që i takojnë, me sa duket, letërsisë së udhëpërshkrimeve.

S’ka dyshim që për lexuesin shqiptar interes të veçantë paraqet libri “Ballkani i dehur”. Është një vepër autobiografike dokumentare, që ndonëse titulli i saj rrok gadishullin ballkanik, ajo i kushtohet në radhë të parë Shqipërisë dhe shqiptarëve në kufijtë kohorë 1937-1946. Pra, është

fjala për fundin e viteve ‘30 dhe gjysma e parë e viteve ‘40, që përfshin periudhën dramatike të pragut dhe zhvillimit të Luftës së Dytë Botërore, si dhe epilogun e fitores mbi fashizmin.

Te “Ballkani i dehur” Jani Lili ka marrë përsipër të tregojë e të meditojë për gadishullin e përbashkët, të zbulojë shpirtin ballkanik, vështruar në sfondin historik, por të lidhur dhe me peizazhin fizik. Ai e quan Ballkanin trevë e kontrasteve të mëdha, vend “që thith gjakun e bijve të vet për idealin e lirisë, tokë vullkan i pasioneve dhe ndjenjave të fuqishme”, me popuj që u vlon përbrenda urrejtja, armiqësia e gatuar me kalorësinë, fisnikëria me barbarinë.”

Dhe rrëfimin e tij për Ballkanin autori e nis pikërisht nga Shqipëria, duke i quajtur shqiptarët “një popull i vogël me zemër të madhe, me mendime të virgjëra, me ndjenja të pastra.” Është një rastësi fatlume për të që, duke u vënë në rolin e shoqëruesit të kolonelit bjellogardist K. Ullugait, oficer zogist, atij i jepet mundësia të shkelë për afro 6 muaj nëpër viset e Shqipërisë së Veriut, duke filluar nga Shkodra, kryeqendra e saj, e deri në Pukë e në Kukës. Në këtë rrugëtim të gjatë e të vështirë ai do të njihet me realitetin shqiptar, të cilin do ta sodisë dhe vëzhgojë jo me syrin e një turisti, po nga pozita e një intelektualit me horizont, që përpiqet të depërtojë përtej pamjes së jashtme nga pozita sociale të përparuara. Në vështrimin e tij Shkodra paraqitet një qytet piktoresk, me një botë të veçantë krejt origjinale, plot kontraste e mistere. Duke u endur nëpër rrugët e saj, ai heton e dallon vijën ndarëse mes katolikëve dhe myslimanëve, bukurinë evropiane të të parëve dhe kënaqësinë orientale të të dytëve, ndjen dhe kap psikologjinë dhe njëmendësinë e veçantë të dy komuniteteve, liberalizmin dhe fanatizmin, por vështruar më thellë rrok dhe shpirtin e tyre të përbashkët, si një popull që i bashkon gjuha dhe historia e mbijetesës. Për të “Rozafa është akropoli ilir i Shkodrës”, ndërsa vet qyteti një bastion vlerash njerëzore, me një psikologji vetjake, me një

jetë të pasur zakonore dhe larushi etnografike. Të gjitha këto ai do t'i konstatojë nga takimet dhe kontaktet me njerëz të shtresave të ndryshme, për të cilët flet me dashuri e respekt, sado që ka rezerva e i ngjallin keqardhje kundërthëniet e thella sociale, varfëria dhe prapambetja.

Shkodra është vetëm kontakti i parë me botën shqiptare, sepse njohja e vërtetë me të do të plotësohet e realizohet kur autori, duke shoqëruar oficerin e lartë të mbretit, do të ngjitet më lart e do të shkelë në malësinë e Kukësit. Një realitet ky sa i bukur e mahnitës, aq dhe tronditës, me njerëz të pashëm e krenarë, mikpritës dhe të besës, me psikologji e zakone që të joshin e të habitin. Ai përballlet me jetën e tyre patriarkale, me ligje të rrepta dhe etike puritane. Ata malësorë trima e të virtytshëm jetojnë nën hijen dhe komandën e bajraktarit. Atij i bëjnë përshtypje jo vetëm kullat e sarajeve, po dhe atmosfera mesjetare që zotëron në mjedisin që e rrethon, varfëria e malësorëve, për të cilët nuk e fsheh simpatinë e tij.

Udhëtimi shkon më tej, kur zbret në malësinë e Pukës dhe ndeshet pak a shumë me të njëjtin peizazh, me të njëjtin mjedis, po ata burra e ato gra, pothuaj po ajo psikologji e jetë zakonore, po ato ligje të rrepta të maleve dhe po ai fanatizëm. I tërheq vëmendjen pamja e burrave për nga portreti dhe shtati, për nga natyra krenare dhe shpirti liridashës, po mbi këto mbresa bien hijet e varfërisë dhe të zakoneve të egra. Pa pritur, ai bëhet dëshmitar i një prej këtyre zakoneve, gjakmarrjes, kur gjendet para një ngjarjeje të tillë. I dhemb ajo çka sheh e përjeton, që këta njerëz krenarë e dinjitozë e pësojnë nga një zakon, që sipas tij ka ardhur nga orienti. Bile ndjehet akoma më keq kur merr vesh që vrasësi është mësuesi, bashkëfshatari i tyre. E megjithatë, në këtë çast të rëndë përsërit me vete: “Kjo tokë më ngjan shumë krenare.” E njëjta situatë shpirtërore dashamirëse zgjohet tek ai edhe kur vëren dallimet fetare mes malësorëve në myslimanë e katolikë, që i duken se janë “si dy vëllezër të ndarë miqësisht.” Meditimet e tij për këta njerëz vazhdojnë kur pohon

se “mikpritja e tyre është e shenjtë”, “se besa është nga ligjet themelore të mbijetesës” apo se zakonet e tyre janë tepër fisnike. Për të malësia dhe qyteti kontrastojnë me njëri-tjetrin, sepse e para është e pastër, kurse i dyti i molepsur. Autori shkon dhe më thellë në mendimet e tij kur, duke soditur e përjetuar realitetin e maleve shqiptare, kërkon të hasë heroizmin që Gjergj Fishta këndon te “Lahuta” në shembullin e Homerit apo lirizmin e kthjellët të E. Koliqit, por më kot. Prapambetje, varfëri, mjerim e, megjithatë, te këta malësorë, siç thotë, ai takon “Zemrën e hapur dhe ndjenjat e pastra që i ushqen kontakti i drejtpërdrejtë me natyrën që nuk di të shtiret” apo “Fisnikërinë e ngrohtë, siç ia përcjell me dhembshuri toka mëmë.”

Më tej, udhëtimi i tij zbret më poshtë, në trevat e Burrelit e të Lezhës, ku ligjet e maleve, sado ligje krenare, nuk ndryshojnë asgjë, ku katolikë e myslimanë janë të njëjtë, pavarësisht se kujt profeti i falen. Ndërsa kur arrin në zonën e Krujës ndien se mendimet e tij i kontrollon hija e Kastriotit dhe kështjella e saj i bëhet “shkëmb i patundur i krishterimit ballkanik përballë invazionit osman.”

Udhëtimi, sa i gjatë e i lodhshëm, po aq mbresëlënës dhe mësimdhënës, mbyllet me kapitullin “Tirana – kryeqytet – mbret”. Kontakti me këtë qytet është zhgënjyes, i duket “një mikrobotë e sëmure” krahasuar me malësinë e pastër dhe fisnike. Në sytë e tij Tirana është një fshat i madh, që ka marrë përsipër nxitimthi detyrat e rënda të kryeqytetit. Sipas autorit, “këtu jeton mbreti me kopenë e vet mes varfërisë së popullit dhe Lanës së molepsur, që kalon jo larg Pallatit të tij dhe shkarkon plot degëzime tinëzare.” Në këtë rast ai nuk kursen ironinë dhe sarkazmin kur përshkruan pushtetin anakronik dhe përvijon portretin e mbretit të vetëshpallur, demagog e tiran, që mban brenda vetes djallëzitë orientale me lustër perëndimore. Tabloja e Tiranës zgjerohet tek hedh dritë në jetën e përditshme të qytetarëve të saj, në peizazhin bardhezi të pazarit

oriental dhe të lagjeve me “kontraste brutale”. Realiteti i zyrtë, me të cilin ballafaqohet, nuk e pengon kurrsesi të shprehë simpati, respekt dhe ndjenja humane ndaj banorëve, veçanërisht të shtresave të varfra, të njerëzve të thjeshtë, por dhe të atyre pak intelektualëve që i jepet rasti t’i njohë nga afër. Sepse një vend të veçantë zë koha kur ai kryen shkollën e oficerëve dhe njihet e miqësohet me shokë shqiptarë. Autori nuk e fsheh, përkundrazi, e ndien veten krenar që është grek, edhe pse është nënshtetas shqiptar. E sheh jetën shqiptare me mirësi, pa kurrfarë paragjykimesh, i do dhe i respekton shqiptarët sinqerisht.

Libri i Jani Lilit merr vlera të një dëshmie historike në kapitullin kushtuar pushtimit fashist të Shqipërisë. Agresioni ndaj atdheut të tij të dytë e trondit dhe e revoltion. Një natyrë liridashëse dhe humane si ai nuk mund të pajtohet me skllavërinë e popullit shqiptar. Në këto çaste dramatike e ndien veten pasardhës të heroit ballkanas, Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Tek sheh vëllezërit shqiptarë të ngritur në këmbë në mbrojtje të atdheut ngrihet edhe ai në këmbë. Ai është shpirtërisht dhe mendërisht me ta pa asnjë mëdyshje. Merr pjesë në demonstrata bashkë me rininë dhe e quan veten me fat që do të luftojë kundër agresorit që po vjen. Dhe kjo nuk është vetëm një dëshirë, sepse shpejt e tregon veten. Është gati të vetëflijojë në emër të lirisë dhe miqësisë ballkanike kundër një armiku të përbashkët. Vrapon në front dhe vendoset në kodrat e Durrësit, në krye të togës së tij që komandon. Merr mitralozin dhe hidhet në luftë sapo armiqtë shkelin bregun shqiptar krahu ushtarëve të vet. Një ndeshje për jetë a vdekje. Ai dehet nga lufta e shenjtë dhe tok me të tjerë zmbrops sulmin e parë. Askush nuk tërhiqet. Liria kërkon gjak dhe luftëtarët e tij dinë ta mbrojnë trimërisht tokën amtare. Çaste këto madhore që autori nuk është në rolin e soditësit, por të pjesëmarrësit në betejë. Por në këtë atmosferë solemne vjen lajmi ogurzi që mbreti i ktheu kurrizin popullit dhe ia mbathi, duke lënë vendin në dorë të armiqve. E, megjithatë,

ushtarët, nën komandën e oficerëve patriotë, vijnë luftën e tok me ta edhe autori i librit të ardhshëm. “Shqipëria – mendon ai – e para në Ballkan piketon historinë e saj të re.” Ndërkaq, tradhtia ka bërë punën e vet, sepse vjen urdhri për tërheqje dhe autori bëhet dëshmitar i asaj zmbarsjeje të dhimbshme e të dëshpëruar, kur sheh lotët e ushtarëve të tij, zhgënjimin dhe revoltën kolektive.

Fillon kështu arratisja drejt kufirit, për të mos iu dorëzuar armikut. Një aventurë kjo bashkë me të tjera që kalon nëpër rrugën Elbasan – Librazhd në drejtim të hapësirave ballkanike. Takon njerëz dhe përjeton ngjarje nga më të ndryshmet. I lodhur dhe i çorientuar arrin në Jugosllavi dhe pastaj hidhet në Greqi, ku përballet me mikpritjen dhe solidaritetin ballkanik. Kudo e ndjek tragjedia e Shqipërisë, të cilën ai e ndien si tragjedinë e tij. Po ndërkaq, e mundon parandjenja se i njëjti fat i pret edhe këto vende. Në këtë situatë të vështirë vjen në Shqipëri, ku arrestohet që në kufi dhe burgoset. Nis kështu një kalvar tjetër, duke u përballur me shtrëngesa e kërcënime, me oficerë e hierarkë fashistë, të egër e djallëzorë. I vetmi njeri që i gjendet me dashurinë dhe besën e tij është Ganiu, një oficer i ushtrisë së mundur shqiptare, që e vuan disfatën e pamerituar të popullit të vet, tanimë i robëruar nga hordhitë fashiste. Të prek qëndrimi dinjitoz e kurajoz i këtyre dy oficerëve që nuk jepen para dhunës dhe demagogjisë së pushtuesve. Të bën për vete solidariteti i tyre në këto momente dramatike. Edhe kur lirohet nga burg, ai nuk çlirohet nga brenga e hidhur e pushtimit, e faktit që vendi është i robëruar tanimë, ndërsa ndien pakënaqësinë dhe rezistencën e fshehur të shqiptarëve. Ganiu bëhet zëdhënës i aspiratave liridashëse të popullit të tij. “Shqipëria nuk do të shuhet”, i thotë ai i bindur.

Më në fund, ai kthehet në vendlindje, në Dropullin e tij të dashur, pranë prindërve, i malluar dhe i dëshiruar për t’u çlodhur pas kalvarit që ka kaluar. Por ky është vetëm një interval i shkurtër qetësie iluzive, sepse

shpejt ndodh gjëma tjetër: sulmi i pabesë mbi Greqinë që përballet me rezistencën heroike greke, e cila e gëzon atë dhe miqtë shqiptarë. Fashizmi është armiku i tyre i përbashkët. Dhe këtë ai e sheh dhe e ndien kudo ku shkon në këtë kohë nëpër Shqipëri e Greqi, Kosovë e Dalmaci. Duke lëvizur nëpër këto hapësira, vë re që popujt nuk gënjehen nga demagogjia fashiste. Rinia është ngritur në këmbë, kanë dalë në male çetat partizane. Lufta sa vjen zgjerohet e organizohet dhe ai bëhet dëshmitar i ngjarjeve politike dhe i aksioneve luftarake. Ai është gjithnjë e më entuziast dhe besimplotë për luftën çlirimtare që ka shpërthyer. Kështu arrin ditën e gëzuar të kapitullimit të Italisë fashiste, por, ndërkaq, vendin e pushtojnë ushtritë naziste. I kthyer rishtazi në Dropull, ai gjendet pranë fushave të luftës që zhvillojnë partizanët kundër pushtuesve të rinj. Antifashisti i orëve të para s'ka si të mos mbështesë gjithë çka ngjarë para syve të tij, siç ndien urrejtje dhe përbuzje ndaj ballistëve, që duke qëndruar në krah të gjermanëve, masakrojnë popullin dhe djegin shtëpitë. Në këto çaste ai mendon se nga hiri i këtyre flakëve do të lindë bota e re! Dhe më këtë bindje, për arsye që nuk i thotë, largohet për në Greqi. Këtu mbyllet dhe epilogu i librit, që i përket dimrit të vitit 1946, kur ai takon në një kamp të mundurit e arratisur, ballistë e bashibozukë dhe e ndien veten krenar që është radhitur në krah të fitimtarëve të luftës antifashiste.

Libri “Ballkani i dehur” nuk është thjesht vepër dokumentare, por dhe vepër me vlera të çmuara letrare, që dëshmon për një autor të talentuar dhe me përvojë, të cilin e karakterizon sa aftësia prej vëzhguesi të hollë e të mprehtë të jetës, aq dhe ndjeshmëria e lartë ndaj njeriut dhe botës së tij shpirtërore. Ai është njeri i kulturuar dhe me horizont, psikolog dhe i vërtetë në gjithçka që rrok e përshkruan. Inteligent dhe realist, shpirt kritik dhe analist, ai depërton në thellësi të jetës, kap thelbin e fenomeneve, priret nga dialektika e proceseve njerëzore dhe shoqërore, vështron gjerë dhe larg, tregohet human dhe karakterizohet nga një filozofi optimiste

dhe pozitive. Kështu shpjegohen antifashizmi dhe antimonarkizmi i tij, aspirata për një shoqëri të lirë e të drejtë, reminishencat e ideve socialiste.

Libri “Ballkani i dehur” është një vepër tipike e letërsisë së udhëtimeve nga mënyra e konceptimit dhe e rrëfimit, nga syri gjithëpërfshirës dhe ndjeshmëria prekëse. Rrëfimi dhe meditimi gërshetohen aq bukur dhe vërtetësish, sa herë-herë të kujton librat e udhëtimeve të N. Kazanzaqisit. Udhëpërshkrimet e Jani Lilit në faqet më të mira duken sikur kanë poetikën e mjeshtrit të madh. Kanë një gjuhë figurative, ndonjëherë me metafora abstrakte. Stili është lakonik, me fjalë të kursyera, me një ritëm të brendshëm.

S’ka dyshim se “Ballkani i dehur” është një kontribut shumë i çmuar për njohjen e një periudhe të rëndësishme të historisë shqiptare, siç është ajo e luftës antifashiste, vendosur në kufijtë ballkanikë. Jani Lili shpreh ndjenja vëllazërore ndaj popullit shqiptar dhe tregohet partizan i flaktë i mirëkuptimit dhe afrimit të popujve të gadishullit, trevës më të lashtë të kulturës dhe letërsisë evropiane.

Për herë të parë dhe të fundit Jani Lili u shfaq në botën intelektuale shqiptare në fillim të viteve ‘40 si estetik dhe kritik letrar. Nga sa njohim deri më tani, veprimtaria e tij u zhvillua në një kohë tepër të shkurtër dhe me një numër të kufizuar shkrimesh. Por ajo që ia ka ruajtur peshën emrit të tij edhe pas shtatëdhjetë e ca vitesh është vlera që ai bart. Në studin e mendimit tonë estetik e letrar të asaj kohe, s’ka dyshim që artikujt e tij përbëjnë një kontribut, në radhë të parë, për nivelin e tyre jo të zakonshëm të mendimeve e gjykimeve. Është e vërtetë se sasia e tyre mezi e kalon numrin e gishtave të dorës, por nga dora e tij kanë dalë shkrime cilësore që flasin për talent në këtë fushë të vështirë, për përgatitje estetike letrare, për njohje serioze të letërsisë shqipe dhe asaj botërore.

Dhe këto vlera të Jani Lilit duken që në artikujt me karakter estetik dhe teorik-letrar, siç janë “Arti dhe shkenca”, “Mendime mbi letërsinë”,



“Arti dhe kristianizmi” dhe “Poezia dhe proza”. Kështu, brenda pak faqeve, ai bën objekt studimi dallimin në përmbajtje e në formë dhe raportet mes artit dhe shkencës, si dy fushat kryesore të krijimit dhe mendimit njerëzor. “Arti, - shkruan ai, - buron nga dielli, kurse shkenca nga errësira.” Është e vërtetë se këto dy fenomene shpirtërore, sipas filozofëve dhe estetëve, rrjedhin nga i njëjti burim, siç është jeta, por përdorimi i lëndës prej tyre është aq i ndryshëm, sa asgjë nuk i afron. Nga ana tjetër, ai jep mendime për artin kur thotë se arti është jetë, ngjallje, energji dhe se ai nuk beson “në të famshmen arti për artin.” Në këto arsyttime, Jani Lili iu referohet filozofëve të njohur nga Hegeli, Kanti, Niçja e deri te Kroçe, vështruar nën optikën e tij.

Në artikullin tjetër “Mendime mbi letërsinë” ai përpiket të zbatojë e të demonstrojë disa nga parimet letrare në terrenin e letërsisë shqipe, të cilën, me sa dëshmon, e njeh mirë. Sipas tij “ne kemi një traditë letrare”, e cila duhet të zhvillohet më tej, duke synuar “të sjellë me vete epokën në të cilën jeton”. Për të, “arti nuk është fotografi, është lartësim i lëndës që përdor”, s’është as gazetari, sepse artisti, përmes frymëzimit të sinqertë dhe intelektit krijues, bën letërsi të vërtetë. Ai është i mendimit se një vepër para se të bëhet ndërkombëtare është kombëtare, e nxjerrë nga vendi i artistit. Sepse “kozmpolitizmi nuk është qytetërim dhe se çdo ide e tension duhet të brumoset me tokën, me psikologjinë tonë”.

Interesant paraqitet artikulli “Proza dhe poezia”, dy fusha këto të letërsisë, të cilat i vështron dhe i trajton në plan historik dhe teorik. Me një njohje të gjithanshme e të thelluar të letërsisë evropiane nga antikiteti deri në kohët moderne, ai tregon ecurinë e poezisë e të prozës nëpër shekuj. Ndalet veçanërisht te poezia e antikitetit, te Homeri e Eskili, te Safo e Simonidhi. Por vlerëson dhe poetët e Mesjetës me në krye Danten dhe Shekspirin, për të ardhur në kohët e reja me Gëten dhe Vinjinë. Të njëjtën linjë ndjek për të treguar ecurinë dhe kulmet që ka arritur proza nga etërit

e saj shpirtërorë Sokrati dhe Ciceroni e deri te Volteri e Servantesi. Të njëjtën gjë bën dhe me historikun e dramaturgjisë.

Jani Lili tregon vëmendje dhe njohje serioze të letërsisë shqipe të traditës dhe asaj bashkëkohore. Sipas tij, “vërtet jemi një komb i vogël dhe i varfër, por çdo vepër fiton vlerën e vet në vendin ku krijohet”. Me këtë mendim e nis artikullin “Dy rrymat”, ku bën thirrje që të shkruhet për jetën shqiptare, që letërsia shqipe të sjellë heroin dhe psikologjinë e tij në art, që ta dallojë nga letërsitë e tjera. Mendimet filozofike dhe konceptet estetike duhen zbatuar në kushtet dhe në terrenin e letërsisë shqipe. Pra, “të kërkojmë tipin shqiptar, me thjeshtësinë e tij, me zgjuarsinë e tij, me ndjenjat e tij të larta”. Në këtë drejtim, ai sjell si shembull nga brezi i traditës Gjergj Fishtë, “poeti që më shumë nga të tjerët iu afrua psikologjisë së malësorit”. Ndërsa nga letërsia bashkëkohore dallon E. Koliqin, i cili “gjen veten në klasikët italianë në poezi, dhe në prozë në prozatorët frëngj. Por që është krijuesi i novelës shqiptare”. Kurse Lasgush Poradecin e quan “poet të harmonisë dhe të iluzionit klasik që buron prej shkollave poetike evropiane”. E, pra, janë Koliqi dhe Poradeci përfaqësues të dy rrymave, sipas tij, në letërsinë shqipe.

Nga dora e Jani Lilit kemi dhe disa përvijime profilesh letrare, siç janë “Kritiku dhe sociologu Vangjel Koça” dhe “Rreth një poetike dhe një kritike kushtuar Nexhat Hakiut”.

Për të dhënë profilin e Vangjel Koçës, i njohur me pseudonimin Vangjo Nirvana, si kritik letrar, ai merr shkas nga një intervistë e tij. Është fjala për një personalitet të letërsisë sonë të asaj kohe, që po kontribuonte me fjalën e mençur dhe gjykimet profesionale si kritik letrar, që sipas tij i mungonte letërsisë shqipe në nivelin bashkëkohor. Mendimin kritik të Vangjel Koçës, ai e sheh në kuadrin e lëvizjes letrare të atyre viteve si një nevojë e domosdoshme për të orientuar opinionin publik për ç’është krijuar e krijohet në letërsinë shqipe dhe për t’i ardhur në ndihmë vet

shkrimtarëve në punën e tyre. Gjithë sa thotë tregon se ai e njeh shumë mirë historinë dhe procesin letrar që zhvillohet në Shqipëri dhe jep gjykime serioze, që edhe sot i kanë qëndruar kohës.

Artikullin e dytë, ai ia kushton poetit Nexhat Hakiu, si një nga zërat e njohur të viteve '30-'40 në poezinë tonë. E quan poet lirik, që, sipas tij, do të thotë “një poezi që përshkruan jetën e fshatarit, të njeriut të thjeshtë, shqetësimet e tij, ndjenjat të lidhura me zakonet e vendit të tij”. Pra, një poezi lirike e bukolike, me dinamizëm të brendshëm, ngritur në art, ku poeti le të flasë heroi i tij dhe jo ai vetë. Me këtë rast Jani Lili, duke iu referuar një mendimi të B. Kroçes, thotë se për një poet “intuita është elementi më kryesor i një talenti të vërtetë dhe se stilistika është rroba e jashtme e artit dhe jo arti vetë”. Në përfundim të vlerësimit të tij, ai e përcakton poezinë e N. Hakiut “poezi të zakoneve në fazën e saj të parë”.

Por, një tablo analitike të poezisë shqipe bashkëkohore, përmes profilesh, e gjejmë në artikullin kritik për librin “Antologji- Dhjetë poetë”, që u botua në vitin 1939, me vjersha të zgjedhura të zërave të rinj poetikë më përfaqësues. Ky botim, i cili, me vonë u pasua me një antologji të dytë, përbënte një akt mospajtimi dhe refuzimi të poetëve të rinj për të bashkëpunuar me shtypin fashist. Brezit të tyre i takonte pak a shumë dhe Jani Lili, ndaj s’kish si të mos tërhiqte vëmendjen e tij. Kështu, ai do të analizonte dhe gjykonte për krijimtarinë përfaqësues të këtij brezi.

Të bën përshtypje fakti që, me gjithë dashamirësinë që ka ndaj tyre, ai tregohet tepër serioz, kërkues dhe kritik sepse, sipas tij, “poezia është ajka e mendimit njerëzor”, prandaj në gjykimin e saj “është rreptësia masa më e duhur”. Për Jani Lilin, duke qenë se në poezinë shqipe mungon tradita letrare, poetët e rinj ndjekin gjurmët e poezisë evropiane. Duke përjashtuar Gj. Fishtën, për të janë të diskutueshme vlerat poetike të Naimit, të Çajupit, të Asdrenit, që kanë krijuar në atmosferën e klasicizmit dhe të romantizmit. Brezi i ri i poetëve shqiptare, sipas tij, s’ka si t’i

ndjekë gjurmët e tyre, por ata të brezit të dytë, siç janë L. Poradeci dhe E. Koliqi, të cilët përbëjnë rrethin e parë të poezisë së pastër, të poezisë lirike. Gjithsesi, sipas tij, poetët e rinj përfaqësojnë brezin e tretë dhe për këtë, ai gjen rast, duke marrë shkas nga “Antologjia” të parashtrojë në mënyrë sintetike gjykimet dhe vlerësimet e veta nga pozita të rrepta kritike. Ndonëse herë-herë tregohet subjektiv dhe nuk jep sa duhet argumente të mjaftueshme, prapë shpaloset individualiteti i tij prej kritiku, sensi i hollë i gjykimit, kultura profesionale, përgatitja teorike-letrare, njohja e letërsisë shqipe.

Nëpër fokusin e gjykimit të tij kalon poezia e zgjedhur e dhjetë poetëve. Ai nuk niset nga krijimtaria tërësore e tyre, por vetëm nga 2-3 vjersha për të arritur në vlerësimin e secilit. Sepse te secili, ai synon të kapë atë çka është thelbësore dhe karakteristike, dritën dhe hijen. Kështu, duke iu përmbytur renditjes së Antologjisë, ai e nis me poezinë e Helenaut (Kolë Mirditës), e cila karakterizohet “nga predispozita e sinqertë, mendime jo të shtrënguara, vargu i shpenguar, fryma pesimiste, me një ëmbëlsi të varfër”, por, nga ana tjetër, konstaton mungesën e organizimit artistik, mospërsosmërinë e harmonisë poetike.

Për kritikun, poeti më i talentuar i brezit të ri është Migjeni, i cili, sapo fillon ta lexosh, ta ndryshon menjëherë botën shpirtërore. “Autori dramën e tij e bën poezi”, shkruan Lili. “Një dramë e gjerë njerëzore, që mund të ketë si fillim vobekësinë, por që më poshtë e lartëson në dramë të vërtetë shpirtërore... Fjalët e tij nuk luajnë me kuptimin... Realiteti lartësohet në art...”

Kritiku është aq i bindur në talentin e madh të Migjenit sa mendon se “shumë shpejt do të meritojë famën që meriton”. Nga ana tjetër, ai konstaton se “Migjeni nuk ngjason me asnjë dhe ngjason me poetët që janë nisur të bëhen të mëdhenj”. Madje e krahason me Poen dhe Uitmanin për nga përngjasimi që ka nga fryma e dhimbjes dhe jo e gëzimit.

Te poezia e Platonikusit (Veli Stafës) ai vë re se “nuk i mungon fryma e vërtetë.., veçse në vargjet e veta shfrytëzon melankolinë dhe pesimizmin e vdekjes. Duket më shumë poet i mendimit.” E quan poet të fisëm, me mendime të larta, por poet i vjeshtës, i ditëve të mërzitura. E kritikon që fjalori i tij herë-herë është antipoetik dhe i mungon harmonia e duhur e lirizmit.

Ashtu si për Migjenin dhe Helenaun edhe për Platonikusin ai shpreh keqardhjen e thellë për largimin shpejt nga jeta prej të cilit “pritëshin vepra të bukura poetike”.

Pas poetëve të vdekur, kritiku merret me poetët e gjallë, të cilët “ende s’ë kanë gjetur personalitetin e tyre”. Prandaj dhe gjykimi i tij bëhet më i rreptë dhe kërkesat janë më kritike. E nis me Dh. Shuteriqin, i cili “rrjedh nga shkolla bodleriane”, por, që, sipas tij, “Edhe imitimi i vetëm një poeti të madh, na bën të shpresojmë, por dhe të dyshojmë.” Duke na kujtuar rreziqet e e imitimit, ai vë re se “Shuteriqi nuk e ndien veten rob të bukurisë së Bodlerit”. Gjithsesi, Lili pohon se ai “jeton ne dritën e yllit bodlerian” dhe “rrezikohet nga verbimi i dritës së madhe”. Por shpreh besimin se ai do ta gjejë veten, madje mendon se “Është shpresa më e madhe e poezisë së sotme shqiptare.”

Në mes poetëve të tjerë, Lili çmon dhe Aleks Çaçin për ëmbëlsinë dhe mjeshtërinë e vargut, sinqeritetin, natyrën njerëzore të ndjenjave. E quan “poet të vërtetë”, siç e konsideron të tillë dhe Thanas Konomin, i cili dallohet “për vërtetësi absolute” dhe i dashuruar pas thjeshtësisë klasike të poezisë greke.

Ndryshe mendon për Vedat Kokonën, që e konsideron nxënës të poezisë erotike frënge dhe e cilëson “poet aristokrat, që kënaqet me narcizmin e ëmbël të vetëkënaqësisë”. Te vargjet e Munir Peshkopisë, Nexhat Hakiut dhe Shefqet Musarait, kritiku sheh vijimin e traditës së poezisë së Lasgushit, që përkufizohen brenda vetes së tyre dhe larg

ndikimeve të huaja.

Për Jani Lilin “Antologjia” e poetëve të rinj është një shpresë e vërtetë” për të ardhmen e poezisë shqipe dhe koha e tregoi se ai nuk ka gabuar.

Me mjaft interes paraqiten dhe mendimet e tij dhe informacioni i pasur që sjell për letërsinë e huaj, botuar në shtypin e ditës. Në radhë të parë duhet të përmendim esenë ‘Kostis Palamas, një idolarter i madh’, shkruar me rastin e ndarjes nga jeta e poetit grek. Lili tregohet sa admirues aq edhe njohës i gjithanshëm e kompetent i jetës dhe i trashëgimisë së tij. Duke përkufizuar portretin krijues të Palamasit, ai ndalet në ngjarjet kryesore të jetës dhe në vlerat e spikatura të veprës së madhe që la pas. Jo rastësisht, autori nënvizon qëndrimin e drejtë dhe konsekuent që mban poeti ndaj një problemi jetik siç është çështja e gjuhës greke. Në luftën e gjatë që u zhvillua në mes partizanëve të gjuhës aristokrate dhe asaj popullore, ai do të vihej në mbrojtje të kësaj të dytës. Dhe këtë poeti e arrin jo vetëm përmes argumenteve shkencore, por, në radhë të parë, me krijimtarinë e tij madhore artistike.

Me këtë rast, Jani Lili ia bën të njohur publikut shqiptar vlerat e këtij thesari, frymën humane dhe popullore, nivelin e lartë artistik, mesazhet universale, origjinalitetin dhe individualitetin krijues. Ai e karakterizon atë si një poet të madh lirik, që arriti kulme me lirikën e tij patriotike dhe erotike. Në mënyrë të veçante kritiku analizon poemën e famshme “Dekalogu i evgjimit”, ku shpalosen idetë liridashëse të poetit dhe jepet figura e evgjimit si simbol i njeriut të lirë. Për të, Palamasi është sa poet aq dhe filozof, ndaj dhe poezia e tij është e tillë. Dhe kjo shpjegohet me arsyetimin që “Sa më thellë ndien poeti, aq më thellë mendon.” Kjo e bën Lilin të pohojë se “Palamasi është i papërkthyeshëm”, sepse, sipas tij, ” si mund të përkthehet një poezi që bukurinë e saj e bazon më tepër në harmoninë dhe në plasticitetin e fjalës, sidomos kur është poezi lirike”.

Eseja e Lilit për largimin nga jeta të K. Palamasit ishte i vetmi homazh që iu bë poetit të madh nga opinioni publik shqiptar.

Në vitin 1940 Jani Lili ndërmerr mikrostudimin “Letërsia e re italiane” ku jep në vija të përgjithshme zhvillimet e saj në gjysmën e parë të shek. XX në lëmin e poezisë dhe të prozës. Duket qartë që e njeh mirë argumentin, ka përgatitje serioze dhe ndihet kompetenca profesionale. Sigurisht nuk e ka pasur të lehtë të përmbledhë gjithë kuadrin dhe problematikën e një letërsie në zhvillim dhe në një epokë komplekse e me ngarkesa të rënda politike. Në radhë të parë është fjala për një poezi të re, që vinte pas trashëgimisë poetike klasike italiane, të përfaqësuar nga emra të mëdhenj siç qenë Karduçi, Paskoli dhe D’ Anuncio, që kishin sjellë kontribute historike dhe që autori i njeh mirë dhe ua bën të ditur publikut shqiptar.

Kështu, në qoftë se Karduçin e ngre në shkallën e poetit kombëtar për frymën e thellë patriotike dhe për nivelin e lartë artistik, Paskolin e cilëson lirikun e ëmbël, këngëtar të dashurisë, me ritme sekrete të brendshme; ndërsa D’ Anuncio është krejt i ndryshëm, kryevepja e tij janë sensualizmi dhe fryma heroike, me një mjeshtëri të lartë gjuhësore dhe poetike.

Studiuesi vëren se, përbri tyre u shfaq brezi i poetëve të hijedritës, që përkundër lartësimit heroik, u lindi interesi për gjera më të thjeshta më të vogla të jetës. Dukuria dhe ngjarja letrare më e rëndësishme e këtij brezi është dalja në skenë e futurizmit, e njohur me manifestin e F. Marinetit që iu kundërvu gjithë traditës letrare italiane. Futuristët shpallën si kredo të tyre parullën:”Le të formojmë të shëmtuarën në letërsi”, që do të thotë një letërsi e nënshtruar prej instinkteve dhe pa sintaksë, me liri absolute, e cila, sido që pati njohje dhe përhapje në botë, sipas Lilit, artistikisht dha vepra të varfra dhe mesatare, të krijuara nga autorë të paafte. Për hir të së vërtetës, ndonëse pati ndër poetët më të mirë futuristë dhe të atillë, që

krijuan diçka me vlerë, kur u shkëputën nga kjo shkollë, prapë futurizmi mbeti një eksperiment.

Në fakt, poezia e re italiane për Lilin do të përfaqësohet nga disa individualitete poetike që, më vonë, u bënë emra të mëdhenj, ku të parin radhit Xh. Ungaretin. Duke shqyrtuar poezinë e tij, ai vë në dukje përmbajtjen dhe idetë e vështira filozofike, të shprehura me delikatesë e fisnikëri, plot harmoni, muzikë metafizike dhe lirizëm spontan, që buron një shqetësim i brendshëm artistik.

Risia dhe novatorizmi në përmbajtje dhe në ide ishin aq origjinale dhe të çuditshme sa kritik u reagoi rreptë. Por kjo nuk preku thelbin e vlerave të reja që solli në poezinë bashkëkohore italiane.

Krahas tij, ai radhit dhe emra të tjerë, të cilët në vitet e më pasme shënuan kulme si E. Montali me poezinë dramatike, S. Kuazimondo me shprehjen e përsosur metafizike. Ada Negri me lirizmin e thjeshtë por tepër sugjestiv.

Pjesa e dytë e studimit i kushtohet prozës së re italiane, të cilën Lili e konsideron me po aq vlera sa poezia, duke iu kundërvënë mendimit të Xh. Papinit, që e cilëson letërsinë italiane më shumë poetike. Ai u bashkohet atyre, që me polemikën e hapur mbrojnë mendimin se shpirtit italian nuk i mungon zotësia e rrëfimit dhe zhvillimi psikologjik. Ardhja e kryeveprave në këtë fushë, sipas tij, është çështje kohe. Këtë e dëshmon fakti i një tradite me vlera të spikatura, të trashëguara nga proza e traditës dhe në mënyrë të veçantë veprat e D'Anuncios dhe të L. Pirandelos. Në qoftë se i pari shquhet për një prozë lirike, me sensibilitet të hollë, me frymëzime të larta, plot pasion dhe atmosferë mistike, i dyti me romanin e tij solli kontribute tepër origjinale, në pasqyrimin realist të jetës, me tipa, me karaktere të fuqishëm, me analiza të thella psikologjike mbi bazën e një rrëfimi e kompozimi krejt të veçantë.

Në galerinë e prozatorëve të suksesshëm të kohës, Lili nënvizon



trininë e shkrimtarëve, S. Borgezen, A. Gattin dhe A. Moravinë. Nga ky i fundit, që është më i riu në moshë, por që premtion shumë, përmend romanin “Indiferenti”, ku autori shquhet për zotësinë psikologjike dhe mjeshtërinë e kompozimit.

Sigurisht tabloja e prozës italiane të kohës është më e gjerë dhe Lili nuk mungon të informojë publikun shqiptar me të dhëna interesante, ku bie në sy vlerësimi i romancieres G. Deledda, e cila është nderuar me çmimin Nobel.

Në trashëgiminë e Jani Lilit përfshihen dhe një tufë prozash të shkurtra, skica dhe vizatime letrare dhe ndonjë tregimth. Ato u botuan kryesisht në shtypin e ditës, nën pseudonimin letrar Jankrili. Është një prozë e shkruar në frymën e prozës shqipe të kohës. Ishte një praktikë e njohur atëherë lëvrimi i prozës së shkurtër, sidomos nga brezi i viteve ‘30 si A. Varfi, Veli e Qemal Stafa, V. Kokona etj., por mbi të gjitha nga Migjeni, i cili kish krijuar një traditë të re në këtë gjini. Jani Lili do të ecte në këtë traditë jo vetëm për sa i takon llojit letrar, por dhe nga trajtimi i temave sociale. Ai tregohet kritik dhe realist, e sheh shoqërinë nga pozita të avancuara, nuk pajtohet me padrejtësinë dhe pabarazinë sociale dhe nga kjo pikëpamje herë-herë shkrimet e tij kanë një frymëzim deri diku revolucionar. Për këtë arsye ai shpesh operon me subjekte dhe figura alegorike. Shkruan çuditërisht me një shqipe të natyrshme, të rrjedhshme, me nuanca stilistike që dëshmojnë për talentin e një prozatori të vërtetë.

Me këto proza ndërpritet veprimtaria letrare publike e Jani Lilit. Emri i tij nuk duket më në shtypin e kohës. Dallgët e ngjarjeve të luftës e të pasluftës e largojnë nga Shqipëria dhe e shkëpusin nga krijimtaria në gjuhën e atdheut të dytë. Në vitet që vijjnë, ai do të bëjë jetën e vet si shkrimtar e publicist me një varg veprash të rëndësishme në gjuhën amtare, të cilat i dhanë emër të nderuar midis bashkatdhetarëve të tij.

Por, për hir të së vërtetës, nga sa dëshmojnë veprat e tij në

gjuhën shqipe, por dhe libri “Ballkani i dehur”, shkruar mbi Shqipërinë e shqiptarët me aq dashamirësi, e bëjnë atë një figurë të cilën historiografia jonë letrare duhet ta njohë e ta vlerësojë për aq sa i takon dhe e meriton.

Për këtë, pa dyshim, do të kontribuojë në radhë të parë libri i përgatitur me aq dashuri dhe këmbëngulje, por dhe me kompetencë profesionale nga studiuesi Panajot Barka, i cili po ia jep publikut shqiptar.

Në mbyllje, nuk mund të rri pa pohuar se njohja dhe vështrimi që i bëra krijimtarisë së Jani Lilit ishte për mua një kënaqësi dhe nder, po dhe një rast i çmuar për të shprehur ndjenjat e mia vëllazërore për minoritetin grek, me të cilin jetojmë dhe krijojmë së toku në një atdhe të përbashkët.

**Prof. Nasho Jorgaqi**

*Prill 2012*

## SHËNIM BIOGRAFIK

“Kur Jani Lili arriti në Australi, në vitin 1948, me ftesë të të vëllait, Spiros, ishte një shkrimtar i sprovuar, njeri me kulturë tepër të gjerë dhe gazetar i njohur. “ Kështu shkruan Petros Petranis në librin e tij bibliografik “Epirotasit e Australisë”, botuar më 2003, kushtuar personaliteteve me të shquara greke në Australi.

U lind në fshatin Derviçan të Dropullit më 1918.

Mbaroi shkollën fillore të fshatit dhe vazhdoi shkollën fetare për mësuesi në Vella të Pogonit – Greqi deri më 1934.

Që nga viti 1934 deri më 1936 studioi në Akademinë Pedagogjike “Zosimea” të Janinës. Paralelisht me studimet shkruante në gazeta të ndryshme ditore. Që në moshë të re bashkëpunoi me gazetën “Εστία» (Vatra) dhe revistën “Letra të reja greke”. Përveç greqishtes fliste shqipen dhe italishten.

Pas përfundimit të studimeve në “Zosimea” u kthye në krahinë e tij ku vazhdoi të shkruante në gazeta të ndryshme .

Më 1938 u regjistrua në Universitetin e Romës, në Fakultetin e Filozofisë e të Letërsisë. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore u detyrua të ndërpresë studimet dhe të kthehet në Shqipëri. Jeton dhe njeh veriun e saj. Pa e kuptuar përfundon në shkollën e oficerëve në Tiranë. Me këtë staturë pret me armë në dorë ardhjen e fashizmit në Durrës.

Pason një periudhë e ngjeshur në veprimtarinë publicistike e letrare në gjuhën shqipe. Boton shkrime dhe artikuj që i përkasin letërsisë, kulturës, estetikës dhe artit. Emri i tij rreshtohet denjësisht krahas emrave më të spikatur të kohës si Vangjel Koça, Gjergj Fishta, Haki Stërmilli, Ernest Koliqi, Filip Fishta, Aleksandër Xhuvani, M. S. Frashëri, Pashko Gjeçi etj.

Shkruan në gazetatat më në zë të kohës si “Tomor”, “Shkëndija”,

“Drita” etj. Angazhimi i Lilit me letrat shqipe ishte në këtë kohë i gjithanshëm. Në shkrimet dhe artikujt e tij (studimorë, kritikë, estetikë e teoriko-letrarë) bën përpjekje jo thjesht për të trajtuar probleme të ndryshme të karakterit teoriko-letrar e estetik, por edhe për t’i krijuar artit e letërsisë shqiptare terminologjinë, konceptet dhe të gjithë bazën e teorisë së letërsisë së munguar. Kërkon të orientojë letërsinë e kohës në frymën e arritjeve letrare më të spikatura bashkëkohore, e përshtatur kjo në rrethanat e vendit tonë. Bën përpjekje për të njohur lexuesin shqiptar dhe sidomos krijuesit me figura të shquara të letërsisë e të artit botëror të kohës.

Lëvron me sukses lloje të ndryshme të publicistikës ku spikat artikulli teorik, ai problemor e polemik dhe intervista. Gazeta “Tomor” e kishte të dërguarin e saj të preferuar në Romë për të marrë intervista nga personalitete të artit italian të kohës. Nuk mjaftohet kurrsesi në aspektin e trajtimit teorik të problemeve letrare dhe artistike. Paralelisht shkruan në shtypin shqiptar letërsi, (skica dhe tregime të vogla), që në fakt përbëjnë mishërim të bindjeve të veta teoriko-letrare e ideoestetike.

Më 1944 ai largohet nga Tirana dhe rikthehet në Dropull. Pas një qëndrimi të shkurtër atje vendoset në Athinë ku ushtron mirëfilli gazetarinë.

Më 1945 botoi në Korfuz librin e tij të parë, vëllimin poetik «Πνιγμένοι Καϋμοί» (Brenga të mbytura). Më 1946 botoi në Athinë librin “Μεθυσμένα Βαλκάνια» (Ballkan i dehur) dhe më 1947 pasuan dy libra të tjerë të tij, «Περιγραφικές εντυώσεις» (Përshtypje përshkruese) dhe «Βορειοηπειρωτικές σελίδες» (Faqe nga Epiri i Veriut).

Më 1948 vendoset në Australi ku një vit më vonë, më 1949, u martua me athinioten Ana Karajani, me të cilën lindën dy fëmijë: Kostandinën dhe Theodhorin.

Për një kohë të shkurtër punoi në shoqërinë e automobilave

“General Motors”. Më pas do t’i rikthehet profesionit të tij të preferuar, gazetarisë. Filloi si drejtues i redaksisë në revistën «Οικογένεια» (Familja) që e botonte bashkatdhetari i tij Zoi Oikonomu dhe bashkëpunonte me gazetën «Αυστραλοέλληνα» (Greku i Australisë). Më vonë e zgjeroi gamën e bashkëpunimit edhe me gazetat e tjera greke të Australisë, «Εθνος» (Kombi), «Πανελλήνιο Κήρυκα» (Lajmëtari panhelen) dhe «Πυρσός» (Pishtari).

Nga Australia vazhdoi bashkëpunimin me periodikun e përmuajshëm të Janinës «Ηπειρωτική εστία» (Vatra Epirotase), ku botoi në disa vijime tregimin e njohur «Το καλαμπόκι του αγά» (Misri i agait). Bashkëpunoi gjithashtu me revistën Londineze «Κρίκος» (Hallka)

Për një periudhë kohe botoi gazetën e tij «Σήμερα» (Sot). Përveç gazetarisë u mor shumë me letërsinë kryesisht atë rrëfyese. Gjithashtu, përktheu letërsi nga gjuha shqipe në atë greke dhe anasjelltas

Mbeten të pabotuara veprat e tij : “SS Partizanka – Ξεριζωμένη γενιά» (SS Partizanka- Brezi i shkullur), «Περιγραφικές εντυπώσεις από την Αυστραλία, η άλλη όχθη της γης» (Përshtypje përshkruese nga Australia, bregu tjetër i tokës), vëllimi me tregime « Οι σκλάβοι του κάμπου» (Skllëvërit e fushës), kushtuar jetës së vështirë të bashkatdhetarëve të tij në Shqipëri, si edhe me dhjetëra poezi, tregime dhe skica.

Vdiq në Melburn në qershor të vitit 1965 në moshën 47 –vjeçare.

Konsiderohet një nga personalitetet më të spikatura të komunitetit grek në Australi ku herë pas here organizohen veprimtari në kujtim të veprës dhe të jetës së tij.



PJESA E PARË  
BALLKANI NË DEHJE

*Athinë, 1946- '46*





## NË UDHËTIM

Male gri, maja të egra me ngjyrën e hirtë shterpë mbi vete. Rrëpira të lagështa, brenda të cilave enden legjendat ballkanase, plagë të thella të tokës, që për shekuj me radhë pranuan dendurinë e ngjarjeve të gjakshme të popujve në përpjekjen e pashuar për lirinë.

Ashpërsia në këto anë gjysmë lindore, historitë heroike, që ushqejnë çdo brez, e pushtojnë lehtë njeriun e dobët me një ndjesi asgjësuese.

Duhej të ishte shumë i përlulur shpirti i këtushëm përballë krenarisë se paepur të natyrës dhe dukshëm të nënshtruara veprat e këtyre popujve përballë madhësisë së tokës që i ushqen.

Greqi, Jugosllavi, Shqipëri.

Ec....

Bri teje, një lumë i madh i pabindur, që nuk e fsheh aspak origjinën e tij barbare malore. Në breg të tij një masiv guri me pamjen e harbuar të fitimtarit rrënues, ironizon njeriun e vdekshëm...

– Këtu huazon vallë ashpërsinë e vet shpirti ballkanas?

Shtrije tani pa pengesë shikimin tënd të lodhur në fushën e Thesalisë, çlodhu në hapësirën e Myzeqesë, qetësoje ekzistencën tënde të përgjumur në valëzimin e grurit të Hercegovinës.

Pas hijeshisë së Saronikos të presin anëdetet e ngrohta dhe mikpritëse të Vlorës dhe, më tutje ,frymëmarrja e kthjellët e Dalmacisë: Ulqini, Kotorri. Pastaj, nuk do të shpërblejnë më pak Prespa, Ohri, Buna.

– Të burojë pikërisht këtu predispozicioni nostalgjik dhe dehja lirike e botës ballkanase?

Ec...

Juga të mbush me aromën e shiut të egër, pak para teje zien shtrengata vjeshtake

Dhe, më tutje, të fton bukuria e çlirët dhe qetësia e vesuar.

Duke ecur nuk të përgatit asgjë për të pritur ndryshimet që shfaqen befasishtëm para teje. Male dhe menjëherë fusha, lumenj, shkëmbinj të thepisur dhe atje, që kurrë nuk e pret, liqene e dete.

– Të gjendet vallë këtu ndryshueshmëria e çuditshme e shpirtit të popujve ballkanas?

Dridhen fushat nga këngët festive në korrije, malet krekosen të qeta në valët nostalgjike të fyellit dhe në netët e shkreta dimërore shuhet ngadalë zëri i vajtuar i qiraxhiut.

Dhe rrjedha murmuritëse e lumenjve vazhdon të shpalosë ngadalë historitë burrërore të botës ballkanase.

Kudo që ta prehesh, qoftë edhe pak, shpirtin tënd dhe do të ndiejë gëzimin e pafund të pasioneve të pafjetura. Kudo që të hedhesh shikimin e etur ëmbëlsia nostalgjike e ngjarjeve me denduri mahnitëse të kohës së shkuar do të përndezin ndjenjat e tua?

Këtu gëzimi spontan të bën skllav, atje mërziçja të brumos me përlësinë e botës së varfër.

Jeto realisht me shqetësimet e njeriut dhe, nëse mundesh, çlirohu nga ndjenjat dhe mendimet që të përçojnë.

\* \* \*

Greqi, Jugosllavi, Shqipëri.

Vende tramundanë, tokë që thithi pa pushim gjakun e bijve të vet për idealin e pavdekshëm të lirisë, tokë që akoma ka etje, tokë që vazhdon të pijë këtë lëng të kuq të përzgjedhur të popujve, që iu përvodh e drejta.

Dhe rrëpirat me hijesirë vazhdojnë mbrujtjen e legjendave të nesërme luftarake. Dhe rrjedha murmuritëse e lumenjve shpalos ngjarjet moderne, përpjekjet e përgjakshme të atyre, që në kohët tona i lanë pa gjë.

Dhe çdo përpjekje e tillë, kur arrin të ngërthejë brenda vetes idealet e një revolucioni shoqëror, jashtë ngushtësisë së interesave vetjake, fiton gjithë simpatinë e njeriut të ndërgjegjshëm të brezit tonë.

Krimi, që trazon çuditshëm shpirtat tanë dhe, që nuk i shpëtoi asnjë revolucioni shoqëror, është ai që do të ndalojë hapat tanë. Për hir të së vërtetës lëmë mënjanë çdo fanatizëm për të takuar kështu dëlirësinë e sakrificave të mëdha.

Para nesh e gjallë bota ballkanase me kundërshtitë, që potisi tradita me çka e ushqeui toka e vet.

Një tokë vullkan nga pasione dhe ndjenja të fuqishme. Popuj që u vlon përbrenda urrejtja, armiqësia e gatuar me kalorësinë, fisnikëria spontane me barbarinë më të harbuar.

Herë-herë mizëria shpirtërore, (fryt i varfërisë dhe i skllavërisë pafund) më shtyn larg tyre, por me fuqi më të madhe më nënshtron në atmosferën e vet të mjegulluar, çiltërsia e buzëqeshjes, apo e miqësisë dhe ai burimi spontan i së keqes.

Pasionet këtu nuk i zbut asnjë civilizim, asnjë kulturë nuk i qetëson. Dhe çdo brez trashëgon nga ai paraardhës të gjitha karakteristikat dalluese, për t'i përçarur me të njëjtin zjarrmi që i trashëgoi.

Vij nga Shqipëria.

Brenda meje shtyhen pamje dhe ndjenja, përshtypje dhe mendime duke kërkuar me këmbëngulje një sistemim, kristalizimin përfundimtar.

Më pushton të gjithin një mëshirë pafund për një popull dalë rruge, një urrejtje që brenda tij mungon neveria për udhëheqësit e tij shpirtvegjël të së djeshmes dhe dashuria konvencionale për fshatarin e thjeshtë që pret ata, të cilët do të drejtojnë ndjenjat e tij tek ardhmëria, te zhvillimi shoqëror.

Njëkohësisht, një ndjenjë e pa treguar shtrihet brenda vetes, që me ëmbëlsinë e saj nuk ndryshon fare nga shpëtimi. Njëfarë lehtësimi, një

prehje që magnetizon mendimin dhe e fton në sendërtimin e ngjarjeve të kaluara. Diçka, akoma, që nuk ndryshon nga nostalgjia.

E habitshme, ndoshta. Çlirohet, vërtet, shpirti nga pesha e kohëve që ka jetuar, kur përqafton ngjarjet dhe i ndien më shumë, sesa kur përpiqet të refuzojë përjetimin e tyre.

E dua njeriun, një popull, simpatizoj një shoqëri me gjithë kontrastet e saj, kur në të individit i janë bërë padrejtësi.

E dua gjithmonë njeriun larë në diell dhe akoma më shumë kur padrejtësia e ka zhytur në baltë.

Me këtë predispozicion, shpalosen në mendjen time skenat dhe pejzazhet, natyra, ngjarjet dhe njerëzit.

\* \* \*

Vij nga Shqipëria.

Brenda meje kumbon me këmbëngulje kërcitja e nxituar e arvillës italiane, zhurma e mbytur makabre e çizmes fashiste.

Pardje, jeta orientale e Ahmet Zogut, haremet e pasura dhe të virgjëra të tij dhe përballë tyre lakuriqësia dhe gjallëria e popullit shqiptar. Dje, përhapur gjithandej dorëlëshuar pamja e tej fryrë e Musolinit. Pak më vonë intimiteti politik me egërsirat flokëverdha të lisnajës gjermane dhe sot koha nervoze kryengritëse, përpjekja vigjilente e një populli për të rehabilituar vlerat e tij morale të keqkuptuara, për të ringjallur ndjenjat e tij të varrosura me forcë.

Çdo epokë është e lidhur fort me skenat e veta karakteristike, me ngjarjet e rënda që kërkon të fshehë oportuniteti i politikës bashkëkohëse, me mendimin e përciptë se mëkatet lahen më mirë kur mbulohen sesa kur burrërisht pranohen.

Gjak i ri derdhet sot në Shqipëri. Ide të reja lërojnë thellë horizontin e vet të mjegullt.

JANIS LILIS

Njeriu i djeshëm, i zhytur në mëkat, zgjohet sot dhe kundron me seriozitet të ardhmen.

Arriti ndoshta deri këtu? Por, para se gjithash, nga u nis? Dhe të gjitha këto pikëpyetje na çojnë në konkluzionin:

Cila ishte dje Shqipëria dhe cila është sot?

**Janis Lilis**

*Athinë, tetor 1945*

Disa vjet në Athinë. I shtyrë nga shqetësimet e mia të para, i fryrë me ëndrrat e majme të studentit provincial, tani po e lë me një ndjenjë dëshpërimi dhe zhgënjimi bashkë. Por, ajo shija e çuditshme mesdhetare e saj, hijeshia e kulluar greke, do të më ndjekin me këmbëngulje në jetën time.

Dje me pak grosh në bark, sot me një copë bukë të ngrohtë në xhep, që e gëlltis vjedhurazi për të shmangur atë mëshirë neveritëse të kalimtarit dhe nesër... kushedi.

Kështu kalonin ditët e mia.

Habitem akoma edhe sot se nga e huazoja atë durim dhe atë fuqi shpirtërore për të shfletuar me etje të pashuar një libër letërsie, një revistë të mirë. Ndoshta ishte mënyra për t'i shpëtuar realitetit. Frojdi nuk do të kishte kundërshtim se dobësia ime e papjekur letrare kërkonte ngushëllim në stepat mikpritëse të Gorkit dhe në fjordet e freskëta të Hamsundit. Mundet, por, për atë farë soj katandisje timen nuk e dija akoma me kë të zemërohesha, megjithëse teoritë socialiste e kishin kthyer në banesë të përhershme trurin tim.

Vërtet, nuk e dija akoma kush ma kishte fajin dhe zemra ime nuk kishte ende fuqi të urrente.

Isha i lirë dhe kjo nuk është gjë e vogël. Ishte mirë kështu. Dhe, një ditë gjithçka ndryshoi brenda një mëngjesi. Në rrugë mbinë mitraloza dhe rojet kënaqnin kapriçot e Maniadhakit<sup>1</sup>. Civilizimi i tretë i Metaksait, pasi më ndaloj të punoja, kuptohet, kur unë dëshiroja, më mohoi edhe të drejtën për të shëtitur ku të doja unë. Pastaj gjeti se isha nënsh tetas i huaj dhe pa më pyetur më dha pasaportën.

---

<sup>1</sup> K. Maniadhakis oficer në lirim i ushtrisë greke me rol të veçantë në regjimin diktatorial të 4 gushtit të Metaksait. Krijoi nënministrinë e sigurisë publike ku metodat e tij të pamëshirshme bënë epokë.

Kishte pak minuta që kishte dalë dielli dhe avujt e dendur të Pireut pakësonin suksesshëm vapën e gushtit.

Jam i papërgatitur për të përshëndetur Athinën,( të mos ketë fare haber nga poezia kjo botë) dhe megjithëse zallamahia njerëzore e portit më merr me vete në qerthullin e saj nervoz, nuk mund të më pakësojë mërzitjen.

Nisja e anijes nuk vështirëson orientimin. Pastaj sirena e tij të premtton një botë të re. Ëndrra nuk mbyllet në burg. Pak nga pak zënë vend brenda meje kënaqësitë e udhëtimit të ri.

Në rrugën e hapur më shoqëron kureshtja ime e pashëruar, më përqafton të tërin ndjenja mashtruese e ikjes dhe fillon të nxjerr kryet dyshimi me rrënjët e veta, futur thellë në kontrastet shoqërore.

Largohem.....

Humbe pas meje, Athinë, që të kthehesh e gjitha brenda meje. Në qytete të reja do të shtrihet etja ime, por ngrohtësia jote e habitshme do të më shoqërojë këmbëngulshim.





## TOKA E SHQIPONJAVE...

Të udhëtosh në një vend që nuk i di asnjë të fshehtë dhe të mos dish asnjë fjalë nga gjuha që flet populli i tij. Dendësohet kështu më shumë etja jote dhe syrit nuk i shpëton asgjë. Dija shumë herë vret origjinalitetin dhe mbi objektet precipiton si pluhur pedantizmi dhe monotonia.

Një vesë kënaqësie vërshon në shpirtin tim.

### *Shkodër, vjeshtë 1937*

Tisi i hollë i pasdites që përqafton me ledhatim qytetin nuk më pengon fare, që me predispozicionin e vizitorit fillestar, t'i gëzohem ëmbëlsisë së çuditshme lindore të tij. Atmosfera veriore ruante akoma diçka nga mesdita verore, një vapë e pakohë që nuk mund ta asimilonin shirat e para.

Shkodra. Kam pak ditë që strehohem në prehrin e saj. Një dehje e panjohur më parë derdhet në dejet e mia dhe kontrastet e panështruara, që i bashkon përpjekja e pandjeshme e ëmbëlsisë mesdhetare me ftohtësinë veriore, më falin gjendjen e palodhur të të shijuarit të kënaqësive.

Lodhja shpirtërore, që buron nga monotonia, nuk gjen vend tek unë.

Serjanis nëpër rrugë duke rruftur pa droje çdo gjë që më ofrohet pa hesap, lëpij pa u ngopur lëngun e freskët të pjeshkës së pjekur, shijoj grykshim ëmbëlsinë e dendësuar të fikut të tejjekur dhe i jam mirënjohës tokës për dhembshurinë e saj. Njëkohësisht, falënderoj duart me kallo të bujkut të tejlodhur për dhuratat e tij vjeshtake.

Pastaj, ndiej atë mpirje trupore që provokon përreth ecja çapkëne femërore. Ndjek si skllav bukurinë e fshehur të hanëmes. Më ditë tëra

hamendësoj këtë plastikë orientale, pa nënvleftësuar bukurinë e kulluar të malësorese katolike.

Nuk zura akoma miqësi me natyrën. Krenaria e saj kërkon të imponohet brenda meje.

Male të egra të vuajtura, lumenj të pabindur që nuk e njohin tërheqjen. Në krah një liqen i pafund, liqeni i Shkodrës, i ndarë midis Shqipërisë e Jugosllavisë. Qesh me kufijtë që vuri mbi tokë ngushtësia njerëzore.

– Këtej e tutje është Serbi.

I huaj në kërthizën e dy shteteve të huaja. Sa më bëjnë për vete popujt, aq më shumë me largojnë shtetet...

Nuk mund të shpëtoj nga një mëdyshje e lehtë, nga diçka si frikë që të ngjit e panjohura. Kam bindjen se më pëlqen, më tërheq me aq druajtje një gjendje e tillë.

\* \* \*

Këto rroba të çrregullta ushtarake nuk më shkojnë fare. Tall veten i zhgënjyer, pa mundur t'i imponoj ndjenjën e këmbënguljes. Nuk di një fjalë shqip dhe kur të tërë qeshin me mua, i shaj greqisht dhe kënaqem.

– Mëso shqip, kafshë, nuk di shqip!

– Më përshëndet carin tënd.

– Çfarë the?

– Nuk di, nuk të kuptoj.

Nuk i kërkoj askujt miqësinë. Aq më pak simpatinë. Dhe e mohoj me këmbëngulje, kur ai që ma ofron qëndron më lart se unë.

Por, djall, ai që më bezdis ka gusto. Oficer i përkëdhelur i carit<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Më 1925, Zogu, për organizimin e ushtrisë së tij mori oficerë rusë të carit të arratisur në Serbi.

nuk vonoi të ambientohej me shqipen. Pëlqej fleksibilitetin e tij kozak dhe nuk i fsheh admirimin tim. Më duket e çuditshme se si përvetësoi kështu shpejt fisnikërinë shqiptare... E kuptoj se është rrjedhojë e përkushtimit të pamasë në punën e tij.

Bëra gati një muaj të mësohesha me emrin e tij. Kutsiuk Ullagai. Nuk më thotë asgjë dhe habitem akoma se si nuk e ndërroi.

Përpiqemi të dy të bëhemi miq me nxitim. Nuk jam bërë akoma as ushtar i thjeshtë dhe ai është kolonel. Nuk ka rëndësi. Kishte të njëjtën gradë në Rusi, në kohën e carit. Bashkë me yjet e tij solli edhe gjithë urrejtjen kundër bolshevikëve.

U bënë shumë ditë që shëtit bashkë me mua nëpër rrugë. Më pëlqen të më shohin njerëzit krah tij. Roli i lakeut nuk mund të zërë vend në shpirtin tim. Dhe rusi krenar nuk ka asnjë kundërshtim.

Di shumë mirë frëngjisht dhe mundohet mjaft për të më treguar të fshehtat e tij. Nuk di të fsheh mërinë e tij për përbuzjen e gjimnazeve greke ndaj gjuhës frënge.

I them natën e mirë në sllavisht dhe emocionohet si fëmijë:

– *Llakou notsi kolonel!*

Qyteti ndahet në mes nga rruga që vazhdon në tokën jugosllave.

Në krahun e djathë jetojnë qytetarët shkodranë me zakonet moderne evropiane, në të majtë kafazet e lagjes myslimane pengojnë me këmbëngulje hyrjen e civilizimit të sotëm. Midis tyre fanatizmi dhe urrejtja është aq e madhe sa ç'është edhe diferenca e jetës. Mund të thuhet pa frikë se të dytët nuk i honepsin të parët, pasi kufizimi i tyre fetar i ndalon që t'i imitojnë.

Natën humbas në sokakët e errët katolikë, i ndjekur nga dëshira tinëzare rinore dhe ditën vij vërdallë rrugëve gjithë pluhur “të mëhallës” duke filozofuar...

Bukuria e zbuluar evropiane nuk më tërheq më shumë se kënaqësia

e mbuluar orientale, e premtuar nga shikimi i habitur e i zjarrtë i hanëmes, të cilin ndjen se të ndjek nga vrima e çelësit, ose nga pas kafazeve të errëta me thurje të dendura.

Ky fryt i ndaluar ngacmon me zjarrmi pjekurinë burrërore, por nuk më pëlqen fare romantizmi mesjetar dhe kërcimet e rrezikshme. Mjaftohem me krahasimet shoqërore të të dy këtyre botëve që kanë të përbashkët vetëm emrin e tyre: **Shqiptarë.**

Njëri freskon verës kurmin e vet në Rimini ose në Kotorr, dhe tjetri mbytet në djersën e shtëpisë së tij të mykur.

Në dimër, i pari argëtohet me mundin e tij mëkatar në sallonet plot dritë, i përkulur si besimtar në tavolinën jeshile duke kërkuar “asin e katërt” dhe i dyti, duke gogësitur, shtrin ëndrrat e tij deri te harqet dhe komplekset misterioze të xhamisë me dëshirën e zbutur të fanatizmit të zbehur.

Në luksin evropian mbruhet feja e re e kënaqësisë dhe në misticizmin lindor shuhet ngadalë falja te profeti, nga mosbesimi tek çuditë.

I pari arriti te besimi i ri evropian, i dyti frikohet akoma të hedh piedestalet e pluhurosur të paraardhësve.

Një është toka që i ushqen, e njëjta atmosferë i rrethon, por nga ky kryqëzim linden binjakë, që nuk ngjajnë fare midis tyre.

Vërtet gjë e habitshme. Diferenca fetare ishte e natyrshme të brumoste psiko- sinteza të ndryshme. Por nuk mund të kuptoj se si ky diferencim ishte i denjë të kultivonte dallime racore. Secili komunitet fetar i mbyllur brenda vetes, fitoi, pa e kutuar dhe identitetet racor.

Para meje dy botë të huaja. Asgjë nuk ndihmon historinë, se këtu e shtatëqind vjet ishte e njëjta racë, me të njëjta doke e zakone, me një fe, me të njëjta ideale. Të paktë janë ata që u qëndruan besnikë psaltirëve bizantinë të fanarit. Shumë prej tyre u gjuhëzuan para madhësisë mbitokësore të

Papës dhe numri më i madh ngriti brenda vetës një Mekë të re.

Shëtis me kureshtje të dukshme në rrugët e këtij qyteti të çuditshëm. Rreth meje qarkullon i njëjti popull edhe nëse ai që kalon bri meje quhet Ernest, ose ai që më parakaloi Demir. Nuk do të kishte asnjë rëndësi, nëse brenda vetes kishin ndjesinë shpirtërore të një race. I pari ngërthen në botën e tij zhurmën dhe brutalitetin materialist të civilizimit perëndimor dhe i dyti shpalos me narcizëm oriental kënaqësitë e fshehta të romantizmit muhamedan.

Në një shpirt dy botë të huaja saqë asnjë mbret nuk mund t'i bashkojë...

I afrohem një dyqanxhiu katolik me guximin e klientit të mirë. Mendja e tij nuk i shqitet traditës dhe në shikimin e butë lodron ironia dhe përvoja e pasur e tregtarit. Por miqësitë në këtë botë zihen shumë kollaj, përderisa me gjuhën tënde të përzier nuk u mbetet asnjë dyshim se je i huaj .Pastaj nga t'i presin një frymë tjetër, diçka të re që do të ëmbëlsojë sigurinë e zakonshme të një qyteti të largët provincial.

Pyetja që i bëj, nuk mund t'i shmanget atmosferës që ai vetë krijon me palëkundshmërinë e vet:

– Të njëjtën jetë vazhdoni edhe pas pushtimit austriak?

Me apatinë që shoqërova fjalinë ishte si të mos kërkoja përgjigje. Në momentin që e thosha ishte sikur nxirrja nga xhepi një shami për të fshirë hundët.

– Racën tonë e mësoi historia të orientohet pa vështirësi në çdo situatë.

Koha dhe situatat e përsëritura i imponuan popullit tonë përkulshmërinë shpirtërore. E detyruan të bëhet një shkallinë e gatshme për synimet e të huajve.

Një sinqeritet të tillë nuk e prisja.

Shikoj dyqanin e tij të pasur dhe më imponohet një mosbesim

këmbëngulës, që në një farë mënyre e përforcoi përgjigja e tij: Mund të shpëtoj ndjenja kombëtare nga tertipet satanike të kapitalizmit?

U mendova pak dhe hodha një pyetje të dytë që nuk i ndahej ironisë:

- Po Zogu? Nuk ka kundërshtime?

Qeshi në një mënyrë që tregonte bindjen absolute në mendimet e veta.

Kureshtjen nuk e kufizoj fare në formatet e fisnikërisë. Dikush mendon se diçka të rëndësishme dua të psonis.

Këto dyqanet e mëdha me luksin e tyre të ekuilibruar, më krijojnë përshtypjen se u bënë strehë e përhershme e njerëzve të tyre. Nga ana tjetër, kjo pasuri tregtare e struktur në to më pikon ndjenjën e asfiksionit.

Pak metra me tutje dyqanet e varfra i rezistojnë këmbëngulshim modernes, si vet shpirti i pronarëve të tyre myslimanë.

Një shëtitje nga parku plot hije i qytetit mendoj se do të ma zbehë lehtësisht plogësitinë e drekës. Lehtësohet kështu edhe koka e rënduar nga një ndjenjë melankolike.

I falem romantizmit me cektësinë e tij dhe kam zili etjen nostalgjike mesdhetare të Laurensit dhe gëzimin e tij të madh, kur ndodhet në një qytet të panjohur. U gëzohet të mirave të tij dhe shmang me dëshirë njeriun me kontradiktat e tij.

Panair i vërtetë tregu popullor i Shkodrës. Pasuri ngjyrash, që nuk disiplinohen në asnjë mënyrë sipas ligjësisë estetike dhe harmonisë. Kostume fshatare që tregojnë nevojën ekonomike dhe aspak qëllimin plastik dhe pretendimin për të evidentuar bukurinë trupore.

Të gjitha krahinat e Shqipërisë së Veriut parakalojnë para teje pa ndonjë sfidë të veçantë, me kundërshtitë që imponuan ndryshimet e jetesës, varfëria dhe tradita malësore.

Që pa gdhirë transportojnë djersën e ballit në qytet, duke kërkuar

vlerësuesin e mallrave të tij. Gra të ngarkuara me djepe, fëmijë të dobët që nuk njohin veç të qarat, burra shtatlartë që skamja nuk ka arritur akoma t'u thyejë krenarinë historike. Gomarë të durueshëm, (kjo kafshë e urtë është po ajo në të gjithë gjeografinë e ekzistencës së vet) që transportojnë mundimshëm ngarkesën e tyre.

Produktet e fshatarit të vuajtur shtrihen në treg me ftesën e pazëshme që shpërndajnë frytet e shëndetshëm të tokës. Pjebra, shalqinj, domate dhe të gjitha frutat e vonuara të verës me aromat dehëse. Pjeshkë të mëdha, pjekuria e të cilave të premtton një shije të freskët, dardha gjatoshme me aromën e lëngshme të llojit të vet. Dhe fiq, fiq të shumtë që kanë kaq shqetësime për mbledhjen e tyre në mëngjes herët. Dhe mbi to qëndron i emocionuar dhe me seriozitetin e mbrojtësit fshatari i largët. U nis mahmur nga kasollja e vetmuar për të blerë kripën e shtëpisë, pak copë të trashë për këmishë.

Jeta e tij është e thjeshtë, larg pretendimeve. Opingat me lëkurë derri i qep vetë. Poturet, të vogla e të ngushta sa s'ka më, i end në vegje me leshin e vitit gruaja e tij skllave. Pak dele dhe pak dhi është gjithë pasuria e tij.

I plotëson vet nevojat. Rasti i vetëm që vë në dyshim filantropinë e allahut, është që nuk bëri kripën frut për ta mbjellë në arë. Nuk i zileps asgjë qytetit dhe për të treguar përkushtimin te toka e paraardhësve mban me vete fyellin prej bronci të gjyshit të ngjeshur te silahu i tij i vjetër.

I do njerëzit dhe sillet me ta me barazinë që e edukoi natyra për krijesat e veta. Por, i imponohet çuditshëm rregullsia e uniformës ushtarake me padhembshurinë e vet të disiplinuar. Nga ana tjetër ka gjithë gatishmërinë e pashtirur për të të shërbyer.

– Urdhno vlla!

Të ofron menjëherë ndonjë frutë dhe gjesti i tij nuk ka asnjë lidhje me dinakërinë e tregtarit, që bën çmos të të fitoj si klient.

Blatoj për një kohë të gjatë një pyetje.

– Nga vjen vlla?

– Pasha Zotin bre burrë prej shumë larg. Nga Malsi e Madhe...

Në lëvizjet dhe në ngjyrosjen e zërit kërkoj origjinalitetin e sinqeritetit të tij. Nuk mund ta vë në dyshim.

– Si të kanë shku punët?

– Për at' allah, jo mirë. Më ngordhën shumë bagëti simjet. Pastaj nuk do me rra shi. Misrat u thanë. Dhe taksat nuk ndalojnë, nuk dun me u paksue. Ai i madhi nuk ka dhimb për na.

– Kush asht i madhi?

– Mreti në kasabanë e madhe. Asht i madh dhe ban gjynah që mirret me na.

E beson me fanatizëm këtë, se kështu ia thanë. Bajraktari i tij kur zë në gojë emrin e mbretit bie në gjunjë përkushtueshëm. Ai e viziton mbretin atje në kasaba për te marrë urdhrat e tij.

– Asht bir i allahut, plotëson fshatari.

Nuk mund të përcaktoj akoma ato që ndieja në ato momente për këtë njëri dhe gjithë racën e tij. Simpatinë e madhe që shkonte të vërshonte vrullshëm, e mbyste ngadalë mëshira dhe një dëshirë e brendshme për të qeshur, që s'kishte të bënte me sarkazmin apo dashakeqësinë.

E përshëndeta miqësisht me një bindje të çuditshme brenda vetes, se nëse do ta takoja pas shumë vitesh, ai nuk do të ndryshonte më asgjë, me përjashtim të mjekrës, e cila duke ndjekur rrugën e jetës, do të zbardhej dhe aforizmave fataliste privilegj i pleqve, nga filozofia orientale.

Asnjë lloj fanatizmi nationalist nuk me pengonte të ndaja ndjenjat e mia me një popull të panjohur. Prej vitesh popujt nuk më krijonin brenda vetes simpati të veçantë dhe i vlerësoja në bazë të nivelit kulturor.

Para meje kam sot një botë të gjallë kurrfarë të njëjtë, që më dhuron pa paragjykim kozmosin e tij, siç shpaloset në veprimet e tij,



natyrshëm dhe pa pengesa. Fiton kështu dashurinë time, një ndjenjë e beftë, që dyshimi nuk e mënjanoi nga brenda tij akoma.

Folëm për një kohë të gjatë dhe, kur kuptoi dëshirën time për t'u larguar, zgjati dorën e tij të gjerë gjithë kallo për ta shtrenguar me të dorën time. Diçka me ngroh brenda vetës se duhet të jem krenar për miqësinë e çiltër që më ofron.

– Tungjatjeta vlla. Udh' e mbarë burr i dheut!

Të çuditshme edhe frazat e tij. Të ngrohta, krenare, siç është dhe vetë natyra malësore që e ushqen.

Një popull i vogël me zemër të madhe, me mendime të virgjra, me ndjenja të pastra.

Koloneli rus është i entuziazmuar me përparimin tim gjuhësor. Më dëgjon tek flas shqip dhe është gati të qeshë, duke pritur gabimin e radhës.

Diskutimet tona nuk kishin lënë asgjë pa prekur, por dje më befasoi pyetja e tij:

– Ke marrëdhënie të mira me atë, Marksini? Dhe më atë fshatarin, Leninin, si ja çon?

Shqiptoi emrat e tyre sikur të bëhej fjalë për njerëz që jetonin diku afër nesh, sikur u kishte borxh diçka dhe kërkonte rastin t'ua kthente.

– Kam dëgjuar dikur emrat e tyre.

Me këtë mënyrë doja të shmangja vazhdimin. Nuk mund të shfaqja tek ky oficer bjellorus simpatitë e mia për rrymat e reja shoqërore, as respektin që ushqej për një njëri të madh, pavarësisht dobësive të tij dhe kritikave që i bëhen.

Në dejet e tij ruse rridhte i paplakur dinamizmi i racës së tij, ku nuk mund të justifikojta urrejtjen kundër figurave revolucionare.

- Kafshët! Përmbysën simbolet e shenjta të njerëzimit.

Më këtë konstatim të cekët nxitonte të lante duart me ata njerëz që i hoqën luksin e salloneve cariste dhe e syrgjynosen në pleqëri.

I mbeti vetëm një kalë i lartë i dëgjuar, për të kujtuar bëmat e tij rinore. Shtathedhur, i hollë, me shkathtësinë sllave, shkonte mrekullisht me të zotin.

Hapësira fushore e Shkodrës, mashtronte sytë e kaltra të rusit, i cili nuk mund të fshihte nostalgjinë e stepës. Ditë të tëra humbiste me “Vanjën” në pluhurin e dendur që ngrinte troku i tij.

Kur kthehej nga ndonjë fshat përmbliidhte me nxitim përshtypjet e tij:

- Muzhikë të plotë këta shqiptarët e Veriut.

Nuk ushqente asnjë simpati për këta njerëz të prapambetur e të varfër dhe besonte se të tillë njerëz ishin lindur për të vuajtur.

Nuk flisja. Kisha shumë dyshime dhe kundërshtime për një popull që akoma nuk e njihja.

Orë të tëra e shikoja në sy me habi: Mund të jetë kaq i thatë shpirti i tij, mund të ketë kaq ranishte në mendjen e tij?

Shumë herë arrinte në zyrë me një fytyrë të lodhur dhe aspak nuk ishte lehtë të hamendësoje shkakun. Megjithatë, zotëronte një gjallëri të pajustificuar për moshën.

Kishte marrëdhënie shumë të mira me familjet e pasura të qytetit. Pavarësisht nga mosha e tij pesëdhjetë e pesë vjeçare, në sallonet e mbajtura katolike ishte vallëzuesi më i kërkuar. Dinte të sillej me delikates aristokratike me një zonjë të bukur. Ndërsa një zonjushe të sapodalë e skllavëronte me rrëfimet e pasura.

– Do të ikësh këto ditë, - më tha së fundmi. - Si çdo vit hapet kursi për oficerë rezervistë në Tiranë dhe të takon një yll. Do të interesohem të marrësh shpejt një emërim definitiv dhe po të duash rri me mua.

Me interesimin e tij po i hyja një peripecie të re. Ishte vështirë të shpëtoja nga emocionet e mia pasojë e këtij interesimi.

I shtrëngova dorën, i shpreha në heshtje mirënjohjen time dhe u largova nga zyra e tij me trazimin e brendshëm që të dhuron ideja e një udhëtimit të ri.

Shpirtin ma zotëronte akoma hija e pamjes së tij. Njeri i çuditshëm. Plot ndjenja, patos dhe me një humanizëm të brendshëm që dinte ta fshihte mjeshtërisht, se shfaqjen e tij e konsideronte prozaike dhe dobësi.

Filloja të besoja se veprimet e tij s'kishin asgjë të përbashkët me shpirtin e tij të gjerë rus...

Padashur në mendjen time nis bilancin për gjashtë muaj që jetova në Shqipërinë e Veriut. Një botë e re me pret dhe kjo që më pas kërkon në ndërgjegjen time vendin e vet.

Në qytet, zërat fëmijërorë, matrapazllëqet satanike tregtare, fanatizmat dhe dobësitë e pafundme njerëzore që i ushqejnë interesat dhe rivaliteti.

Në fshatra fizionomia e respektuar e pleqve, që zbut ashpërsinë veriore të tokës, dhitë që kacavirren me lehtësinë e një dykëmbëshi nëpër pemë, blegërima e largët e qengjit dhe pranë arës bujku i djersitur që me parmendën e tij stërgjyshore, plotëson dëlirësinë e atmosferës fshatare. Skamje, mundime të pafundme, varfëri deri në gju.

Në Nikaj, fshat mbi Shkodrën, nuk munda të përmbaja kureshtjen time. Bashkëbiseduesi është vendas, një burrë i vërtetë malësie, që, pa frikë, mund të thuash se gjeje tek ai të gjitha karakteristikat e mundshme të racës së tij:

- Sigurisht ky vit nuk do të ketë shkuar edhe aq mbarë.

Fjala e pyetjes sime, e matur aq sa munda, përbënte esencën e përshtypjeve të mia, fryt i rezervuar i realitetit.

Nuk vonoi për ta kuptuar këtë dhe më dha qetësisht përgjigjen:

– Të vjelat ishin shumë të mira. Nuk presim më mirë. Zemërgjerësia e Allahut është e madhe.

Ndaloi pak mendueshëm dhe plotësoi:

– E besoj. Ju në qytet jeni ndryshe. Ne këtu nuk njohim jetë më të mirë se kjo që shikoni.

Nuk kisha asgjë për të thënë. I thoshte me një mënyrë të tillë që neutralizonte çdo kundërshtim. Ky predispozicion fatalist kishte rrënjë të forta brenda tij dhe jam i sigurt se e trashëgoi për ta mbjellë edhe ai te brezi i ardhshëm.

Rezervoj edhe unë mendime të kundërta për veten time. Po të dua lë të mos besoj se mbreti rri mirë në kurrizin e tyre.

Më mundon akoma një skenë e çuditshme në Kukës. Para do kohe, ndalova këtu duke shoqëruar kolonelin në misionin e tij ushtarak. Një fshat i madh geg me shtëpi të vogla primitive të futura sporadikisht në gëmusha, ose të stisura njësoj të thjeshta në cepat ndarës të malit me fushën.

Bajraktari i madh i zonës, me sarajin e tij të ndërtuar në majë të kodrës më të lartë, sapo e mori vesh ardhjen e zabitit të madh, zbriti vet për ta pritur dhe t'i lutej për të nderuar konakun e tij.

– Gjithë shtëpia ime, efendi, është në dispozicionin tuaj.

Koloneli rus e dinte mirë sa do t'i kushtonte të madhit të krahinës mohimi i ftesës.

Dhe bajraktari shtoi me ngut në gjuhën e tij:

– Të tan robt e mi jan shërbëtorë të tu...

Vështrimi miqësor i plakut krenar të maleve mbi kolonelin ngjante sikur i kërkonte shpjegime prej kolonelit. Rusi e kuptoi dhe shtoi me përzemërsi:

– Nuk do të veçosh me asgjë djalin. Është i imi, njeri i ditur dhe i shërben me besnikëri mbretit.

Fytyra e bajraktarit mori menjëherë pamjen e respektit të thellë dhe përsëriti me përlulje të gjitha shprehjet e mirëseardhjes të sapo thëna komandantit tim.

Një e përpjetë e lehtë na nxori te kulla e bajraktarit. Mandra e shtëpisë së vjetër ruante akoma gjithë strukturën luftarake. Disa të çara vertikale, frëngji të njohura të kohës së Turqisë, i jepnin sarajit pamjen e ngrysur të një kulle mesjetare. Muret e nxira nga shiu i dhuronin diçka nga misteri.

Në oborrin e shtruar me rasa guri, dy-tre derra futin turirin në papastërti të ndryshme të shtëpisë primitive dhe një qen stani, i lidhur fort në një qoshe, paralajmëron me mënyrën e tij të egër ardhjen e të huajve.

Një erë e rendë thartie dhe frutash të kalbura depërton me ngulm në hundët tona dhe, në momentin që hapet porta e shtëpisë kullë luftarake, era e mykut na godet në fytyrë.

– Konaku ynë i varfër e ka për nder të madh t’ju presë bujarisht.

Ishte “mirëseardhja” fisnike e salloneve të pasura të një qyteti.

Një grua e re na ndihmoi të nxjerrim këpucët dhe u ulëm këmbëkryq në krye të minderit. Dhoma e madhe “e pritjes” ishte shtruar me qilima të rendë prej leshi, me plot ngjyra, velenxa çlodhëse, të bëra në avlëmendin e konakut.

Deri këtu nuk hapa gojën për asnjë fjalë. Diçka si frikë zuri vend brenda meje dhe drita e pakët, që kalonte me shtrëngim nga dritaret e vogla, ngacmonte më shumë fantazinë për komplekse misterioze. Nga ana tjetër, psiko- sinteza ime e krishterë nuk i pret miqësisht ato shenjat arabe lart në mure.

U errësua dhe rakinë nuk po na e merrnin nga përpara. Bajraktari kthente me qejf festiv gotat njëra pas tjetrës, por dhe oficeri rus, që, me

sa duket, ishte ambientuar lehtësisht me këtë pije të egër shqiptare, pa kundërshtim zëvendësoi me të vodkën e vendit të tij.

Midis tyre këta dy burra kishin shumë gjera për të thënë. Allahu dhe Muhameti i bashkon shpirtërisht këta njerëz, të cilët i ndante kaq shumë distanca tokësore me ndryshimet e pamasë.

Midis tyre isha totalisht i huaj. Brenda meje, Krishti i sëmurë nuk kishte fuqi t'i kundërshtonte. I kruspullosur në një qoshe kisha një pamje të vuajtur, që nuk më pëlqente fare.

Vonë natën erdhi darka. U shtrua në mes një sofër e madhe dhe rreth tij afro njëzet kokë dhe dyfish duar, të përulura me devotshmëri, prisnin të jepej shenja e darkës së vonuar.

Dy tepsi të mëdha me nga një qengj të pjekur secila u vendosën para bajraktarit, i cili filloi me shpejtësi t'i copëtonte. Pastaj i hodhi secilit nga një copë të madhe mishi dhe kështu filloi me përkushtim të heshtur darka. Duart, duke mbajtur kockën, lëviznin si fizarmonikë në gojë. Pastaj erdhi një pilaf i trashë dhe në fund feta të mëdha karpuzi e pjepri vulosnin darkën orientale.

Buka e freskët e grurit kundërmonte në mënyrë provokuese dhe gjalpi, i sapo nxjerrë, ngacmonte akoma stomakun e stërmbushur.

Kjo skenë patriarkale me ngjyrat e saj të zbehta ngjallte brenda meje një botë të tërë dhe unë mundohesha të saktësoja origjinën e saj. Atmosfera e dehur, që mbinte në mendjen time nga vargjet e pashlyeshme të Homerit, kërkonte këtu të drejtat e saj autentike.

Shikoj këta burra të lartë me kujdes të përqendruar. Si nëpër mjegull me kujtojnë diçka, sikur prej vitesh janë të njohurit e mi. Mustaqe të kthyera, të dredhura lart, sy të zgjuar e plot zjarr, kryelartë, që të kujton pa vështirësi atë krenari të paafreshme shqiponje. Gjeste zemërgjerësie, aspak të shtirura. Në përgjithësi një ansambël i dalë nga faqet e "Iliadës".

Kthehem te vetja. Një krahasim të beftë dhe çuditërisht, provoj

një ndjenjë nënvleftësimi.

Më në fund darka mbaroi. Lamë duart në një enë që na e solli vajza më e vogël e bajraktarit dhe u tërhoqëm tek minderet për kafën.

Rusi i njihte mirë traditat e malësorëve dhe më orientonte herë pas here duke më folur ngadalë në frëngjisht.

– Kujdes, - më thotë, - tani mos keqkupto atë që do të shohësh. Kështu e do zakoni.

Prisja me kureshtje të tendosur. Shikoja bajraktarin me pamjen e njeriut që pret diçka të pazakontë. I bëri me shenjë vajzës që të afrohej. Ajo pa kundërshtim iu ul te këmbët. I ati e përqafoi dhe diçka i tha duke buzëqeshur. Për një moment vajza ktheu sytë provokuese duke parë një herë kolonelin dhe një herë mua.

Ishte e bukur. E pjekur e me një fytyrë gjithë dritë. Të ngacmonte shpejt dëshirën e trembur.

– Trimosh zabiti ynë, me gjithë moshën e tij, usta në këto punë. Si po thua nuk do të të pëlqente këtë natë?

Nuk munda të fshihja turpin tim nga sa tha papritur i ati i saj dhe ula kokën për të mos parë të tjerët kaq lakuriqe habinë time. Bajraktari u kthye me shpejtësi nga unë:

– Pas kësaj nuk mund të kesh ankesa nga trimi. Trupi jot i etur nuk do të vonojë të shkrihet në krahët e tij të forta.

Vajza nguli sytë mbi mua që të bënte ngurrimin tim të përkryer.

Vazhdoi për shumë kohë kjo histori. Nuk vonoi për të dalë edhe unë nga situata surprizuese e momentit të parë. Për të thënë të vërtetën prisja me padurim vazhdimin.

Natën vonë ramë për të fjetur. Do të vrisja mendjen për një kohë të gjatë duke kërkuar një shpjegim për të gjitha këto, po të mos ndërhynte me kujdesin e tij lakonik komandanti im:

– Ishte dikur realitet. Ndoshta do të mbetet akoma edhe për vitet

në vijim. Miku nuk fitonte vetëm të drejtën mbi gratë, por vet shtëpia e konsideronte nder të madh që ai të flinte me to. Kundërshtimi krijonte madje edhe armiqësi. Por, nga të gjitha këto, këtu mbeti ana formale. Zilia mënjanoi pak nga pak thelbin.

E dëgjoja me vëmendje, ndërsa brenda vetes uroja fatin e mikut të atëhershëm.

Edhe një ligj akoma që fshihte brenda vetes një gjendje natyrore. Fjeta i përkujdesur nga malësorja e bukur dhe ndonëse mbyllja i shtirur sytë, ndiqja kurmin e së resë që jepte e merrte dehëse bri meje. Gjumi do të linte dëshirat e mia të paplotësuara.

Në mëngjes mezi u ndamë nga i pari i Kukësit.

– Konaku im, - na thoshte herë pas here, - mërzzitet shumë për ndarjen kaq të shpejtë. Rrini edhe pak ditë, nuk ju nxiton kush.

Në fund na përshëndeti me ngrohtësi të madhe.

– Mirë se të na urdhëroni sërish. Ndonëse do të takohemi shumë shpejt, - tha ai dhe pastaj iu drejtua me zë të ulët kolonelit:

– Do të vij të marr rrogën.

Kishte të drejtë. Ishin të gjithë oficerë titullarë të Zogut me një rrogë të majme.

Bajraktarët në Shqipërinë e Veriut e mbanin fort në fron.

Iknim dhe herë pas here ktheja kokën pas. Një natë e vetme më lindi kaq kërshëri, më ushqeu kaq mendime, më qëndisi kaq ndjenja.

Por edhe këtu te vetmia e rrugës nuk dal i humbur.

Para nesh një fushë pjellore hap zemrën e vet për të pritur të mbjellat. Lart nesh mbajnë suksesshëm ekuilibër zogj të mëdhenj. Të tjerë peshohen për një çast në një copë qielli të kaltër dhe të tjerë akoma depërtojnë në mënyrë mitike në mjegullën e mëngjesit që fshihte malin e ashpër kockor. Huta të bardha, shqiponja që s'begenisnin kënd, i jepnin atmosferës një ngjyrë të çuditshme epike.



Fshatari, skllav i varfërisë, një mekanizëm i verbër i ligjësive feudale, lëron tokën me pesimizëm stërgjyshor. Pa fushën të mbushur nga bereqeti, por pozicioni i tij nuk ndryshoi kurrfarë. Çdo vit mbush hambarët e vjetër të bajraktarit, ndjek gostitë e tij grykëse dhe kthehet ankueshëm në kasollen e varfër për të gjetur me vështirësi koromanen e tij.

Kushedi, të ketë arritur vallë dyshimi i shenjtë të ngjallë mungesën e besimit ndaj ligjësive patriarkale? Të ketë lindur në mendjen e tij mosbesimi që do ta çojë në kryengritje shpirtërore?

Një simpati e pafund përhapet brenda meje dhe mendjen ma rokanis frikshëm anarkia. Kam një dëshirë të papërcaktuar, të marr nga dora këtë muzhik verior, ta shkund fort, t'i tregoj rrugën e tij. Vështroj për një moment oficerin rus, që u shërben verbërisht interesave të agallarëve të huaj, sjell në mendje pamjen autarkike të mbretit dhe mbys brenda vetes padrejtësinë shoqërore që më torturon.

Jam një frikacak, një hiç dhe nuk vonoj të mëshiroj veten time të vockël.

Fshatrat e rralla ngjajnë midis tyre si një monotoni e padurueshme.

– Do të kalojmë nga Puka dhe do të kthehemi shpejt në qytet, - më thotë për një moment koloneli.

Shurdhëria e bezdiste dhe kërkonte të hapte ndonjë bisedë. Më tha edhe një herë të njëjtën frazë dhe u gjenda ngushtë se m'u desh t'i ktheja të njëjtën përgjigje. Nuk hapa fare gojën dhe e pashë në sy me pamjen e njeriut që pret vazhdimin. Dhe kisha të drejtë. Më vështroi më shikimin atëror dhe vazhdoi:

– Duhet të ikësh në Tiranë.

Sëmundja për të qenë origjinal më është ngjitur akoma edhe në bisedën e thjeshtë. Nuk kisha prapë përgjigje dhe ndërrova bisedë.

– Nuk ju çudisin ato që pamë, zoti komandant?

– Kur i shikon mbi dy herë nuk të bëjnë më përshtypje. Janë ligjet

e malit, vullneti i trashëguar brezash. Nëse je më fat do të dëgjojmë edhe të tjera në vijim.

Ky i huaj nga Rusia nuk ka asnjë afinitet me shpirtin ballkanas. Pastaj, dyzet e ca vjet në vendin e tij dhe vetëm rreth dhjetë në këto ashpërsi malore. E kam të vështirë ta kuptoj se si mendja e tij e hapur ia doli kaq shpejt të paqësohet me zyrtësinë e këtushme. Vallë interesi të ndryshojë me kaq nxitim atdheun?

Nuk i bëjnë përshtypje. Sikur t'i ketë jetuar që në vogëli, sikur të mos qe një traditë tjetër që e ushqeu. Fantazia ime e vendos, (të më falësh zoti kolonel që nuk të pyeta), në sallonet e rënda të Petërburgut dhe të Moskës, të komplimentojë, me suksesin e sigurt të oficerit të pashëm e me grada të kohës së tij, baroneshën Orlov, markezen Kalinski. Pastaj me plot rrudha e vendos të ulur këmbëkryq te minderet e bajraktarit. E habitshme vërtet. Dhe të shikoj ëmbëlsisht fshataren trashaluge me shallvare. Më vjen keq për llogarinë tende, z. kolonel Ullagaj.

Po sikur të kishte mundësinë të kuptonte çfarë mendoja për personalitetin e tij....

Dyshimi me detyron të korrigjoj pamjen e fajtorit që më mori fytyra. Madje më vjen t'i kërkoj ndjesë.

Rrallëherë në rrugën e ngushtë takojmë ndonjë fshatar. Na përshëndet vëllazërisht dhe humbasim serish të vetmuar në këmbët e kodrave. Komentojmë për pak për njeriun e varfër dhe vazhdojmë me të njëjtën heshtje. Kuajt tanë më argëtojnë shpesh me zgjuarsinë që tregojnë. Zgjedhin me delikatesë rrugën, kapërcejnë me përkujdesje kanalet dhe gropat dhe herë-herë të vështrojnë me shikim njeriu mu në sy. Lodh mendjen time me lëvizjet e tyre dhe pranoj emocionin e qetë që më dhuron urtësia e tyre.

Largësia e madhe nga Puka nuk më tremb.

Së fundi arritëm. Më zotëron bindja se nuk duhet të pres gjëra

të reja. Shtëpitë, janë po ato të Shqipërisë së Veriut, kështu që, edhe nëse ndryshon pjerrësia e malit apo ka pak pemë më shumë, asgjë nuk ka aftësinë të argëtojnë mendjen time. I shikoj me simpatinë që shfaqim për sendet e vogla të pafat.

Në qendër të Pukës lëvizje e pazakontë. Rusi u hodh me shkathësi nga “Vanja” dhe përshëndeti me temena lindore dy-tri pleqtë flokëbardhë që erdhën për të na pritur. E imitova në të gjitha hollësitë, duke kërcyer nga kali, ndoqa shoqërinë e tyre të ndërruar. Ndjeva një ëmbëlsi të butë që me kënaqte me thjeshtësinë e saj.

Dritaret e vogla të pakta të shtëpive, shëmbëllim të arkitekturës turke, më ngjan se më shikojnë miqësisht. Rrugët e ngushta sikur të më kujtojnë diçka dhe njerëzit me buzëqeshjen spontane të malësorit komunikojnë shpejt me botën time të brendshme.

Jeni pa fat sot, zabiti ynë. Nuk ka rëndësi, por nuk jeni aq me fat. Janë gjëra që ndodhin shpesh në anët tona.

Koloneli vështroi me interes intim plakun, që fliste dhe pyeti pa u shtirur.

- Çfarë ka ndodhur prapë?
- Gjaku sërish vlla...

Plaku tundi kokën dhe heshti. Mund të shtonte edhe gjëra të tjera, por me heshtjen donte të tregonte se ato ishin punët e fatit.

- Gjakmarrja, plotësoi për të saktësuar tjetri në krah.

E vështrova edhe këtë me vëmendje. Më dukej e çuditshme. Këta burra të fuqishëm truplidhur a mund të fshihnin një disfatizëm lindor kaq të madh brenda vetes. Pleq dhe vitet nuk mundën t’u heqin nga trupi elasticitetin burrëror. Raca e tyre ilire nuk ka të bëjë në asgjë me grumbujt amorfë e të përgjumur të stepave lindore. Por edhe kurani u ndryshoi krejtësisht shpirtin. Besoj tani absolutisht se kjo fe nuk i shkon aq përshtat popujve evropian.

Gjaku, hakmarrja. Një plagë që për shekuj me radhë nuk ka gjasa të mbyllet. Hyja pa dashur në dramën e papërfunduar të malësorëve. Në këto vende të larta e krenare, ku banon një popull kryelartë, gegët, është vështirë të gjesh një shtëpi që çdo çast të mos i trembet kërcënueshëm vdekjes së dhunshme.

Kështu është. Paraardhësi vrau patriotin e vet, se fyeu nderin e burrit me një fjalë të nxituar, në zemërimin mesdhetar, ndoshta, e shau. Dhe pasardhësi i të vrarit detyrohet me ligj t'i marrë gjakun. Të vrasë dikë nga shtëpia e vrasësit, nëse nuk do të mund vrasë vet vrasësin. Kjo vlen edhe për vrasësin e ri.

Për breza të tërë do të përsëritet kjo zyrtësi derisa të shuhet përfundimisht njëra nga të dy farat. Dhe kur në një nga familjet sosen burrat detyrën e vazhdojnë gratë.

Nëse dikush vendos të heshtë, nuk do të respektojë ligjin e malit, nuk është burrë, nuk e pranon vendi i tij krenar. Burrat e përçmojnë dhe fëmijët e tallin në rrugë. Nuk ka rrugë tjetër. Ose të vrasë që të lajë turpin e shtëpisë, ose të vetëvritet që të vazhdojë shtëpia e tij të jetojë në përçmim.

Flisja heshturazi me veten për një kohë të gjatë dhe do të vazhdoja të mbetesha kështu i hutuar, nëse nuk do të më ngacmonte kureshtjen një shprehje e re e plakut:

– Na shani ju nga kasabaja, na thoni se jetojmë prapa dynjasë. Nëse do, besojë vlla, por vrasja edhe këtë herë u kry nga një njeri i qytetit. Mësues, burrë i kulturuar dhe i zgjuar, erdhi pardje për të marrë gjakun e vëllait.

– Dhe kush është ky, - pyeti me nxitim koloneli rus.

– Idriz Jaho, djali i Isufit.

Komandanti u kthye vrik nga mua dhe më shikoi.

– Duhet ta njohësh, është mësues në gjimnazin e Shkodrës.

Pas pak vazhdoi sikur t'i fliste vetes:

– Nuk do ta besoja kurrë. Një djalë i shkolluar dhe i kulturuar fort mirë, një njeri përparimtar. Duhet të ishte në dilemë shumë të fortë derisa mori këtë vendim.

Nuk m'u desh shumë për ta kujtuar. Bile para pak kohësh i lexova edhe një artikull të gjatë për “gjakmarrjen” në një revistë serioze të Shkodrës. Me sa mbaj mend, me argumente të forta psikologjike përkrahte idenë se vetëm civilizimi në këto anë do të arrijë të shuajë këtë traditë, “që u kthye në nënndërgjegje”. Dhe tani vetë ai nuk arriti ta mbysë, ta zbusë. Me studimin e tij me siguri kërkonte t'i lehtësonte barën vetes.

I gjori Idriz! Nuk shpëtove nga dënimi i shoqërisë dhe u përpoqe t'i prisje prapësinë. Je nga viktimat e para të saj dhe brezat e ardhshëm të civilizuar nuk duhet të të harrojnë. Ishte i tmerrshëm poshtërimi që duhet të ndieje brenda vetes nga përçmimi i mjedisit, se përpiqeshe të harroje detyrën karshi vëllait të vrarë. I ati të vështronte sikur gjente te ti vrasësin e djalit të tij, (ndoshta mallkonte orën që u përzje për të lindur një njeri të tillë). Nëna skuqej nga turpi dhe shokët, kur ti hyje në shoqërinë e tyre, largoheshin një nga një duke murmuritur. Më duket akoma sikur u dëgjon zërin:

– Pa shiko ç'burrë! Frikohet të marrë gjakun e vëllait...

Do të kesh parë akoma edhe të vdekurin në gjumë. Të shikonte me ankim, se “nuk e pranonin në botën tjetër, po të mos i merrje gjakun”. Dhe rrëmbeve armën ditën me diell dhe tërhoqe atë këmbëzën e frikshme për të zgjuar veten.

– Dhe djali ç'u bë pas vrasjes? – pyeti pas pak kozaku, për të venë një pikë në këtë çështje, që mësa dukej po e lodhte kjo histori e gjatë.

– U dorëzua bashkë me pushkën e tij në xhandarmëri. Njerëzit e shikonin aprovueshëm dhe i tregonin rrugën për në mal, për të shpëtuar nga drejtësia, por ai u drejtua për te stacioni i xhandarmërisë.

– Unë jam vrasësi, - tha. - Më vrisni, më varni, më bëni çfarë të doni.

Kështu e donte shoqëria jonë. U bënë ditë që përpëlitesha por nuk munda të shpëtoja.

E njihja njeriun dhe simpatia për të sa shkonte e rritej. Pastaj, sa më shumë e zboja, më kthehej në mendje me mani më të madhe, si mizë behari, ajo fjala, **shoqëria**. Një mekanizëm i çuditshëm që ndërron me dinakëri ngjyrat si kameleon dhe nuk ngopet me viktima. Ngul akoma hunj dhe ndërton barrikada në rrugën e natyrës, kërkon ta disiplinojë me ligjet e veta. Ndërtoi xhami e kisha, për ta mashtruar blatoi përralla pafund, e mbylli në dogma dhe fe. Dhe vuri atje aktorë tragjikë, shenjtorë dhe profetë, për të trembur masat. Dhe ato ulën në gju për t'u falur... Dhe ti, njeri i ndërgjegjshëm, të përpiqesh për popullin dhe të vdesësh nga duart e tij. Çfarë shpërblim tragjik për kënaqësi morale!

Dhe kjo tragjedi e pafundme vazhdon...

Në mëngjes jemi sërish për rrugë. Rusi këmbëngul të kthehemi nga i njëjti monopati për të arritur sa më shpejt në qytet. Por nuk ma prish qejfin. Nuk ndiej asnjë kënaqësi që iu bind vullnetit tim. Më vjen shumë keq, por është e papranueshme, kur mendoj se do të kapërcejmë të njëjtët lumenj, do të përballemi me të njëjtën monotoni lodhëse të fushës, që do të kalojmë nga i njëjti mal.

Shpirti im e kërkon befasuesen, më tërheq e panjohura, megjithëse nuk më interesojnë fare njohuritë gjeografike shterpe. Nuk pyeta kurrë sa banorë ka qyteti që ndeshim përpara, ç' prodhon fshati që përshkojmë. Futem nëpër sokakë, lëshoj paturpësisht shikimin në dyert gjysmë të mbyllura, në oborret e lagështa të shtëpive të varfra. Kureshtja ime kërkon njeriun.

Sot ndiej veten time të lidhur fort me tokën që shkel. Jam një farë autentike i ndryshimeve të vrullshme ballkanike. Nga ana tjetër, asnjë

preferencë provinciale nuk më pengon t'u gëzohem bukurive tokësore, kudo që të ndodhem.

Argëtohem tani me pikat e dendura të shiut, që kërkon të na dëshpërojë me këmbënguljen e zemërimit të tij të pa zbutur.

Përpiqem të fsheh të qeshurën që më mbyl, shkaktuar nga shtrembërimi i fytyrës së kozakut. Qëndrojmë me mëdyshje te bregu i Drinit të Zi që rrjedh i trashë në shtratin e tij të vuajtur. Provon në mendjen e tij ndonjë plan strategjik dhe murmurit:

- Dhe tani ç' të bëjmë, kësaj here ky solli gjithë ujin e Ohrit.
- Kjo është prova, kolonel Ullagai, - them me vete.

Më zotëroi një indiferentizëm aspak natyror. Kisha qëndrimin dhe apatinë e një fëmije, që nuk mban asnjë përgjegjësi në momente kritike. Kam lëshuar veten time nën kujdesin e kozakut dhe tani argëtohem me agoninë e tij, sikur të mos ndodhemi nën kërcënimin e të njëjtit rrezik.

Diçka i murmurit allahut dhe pastaj i bie kalit.

Uji i turbullt dimëror mbuloi barkun e “Vanjës” së tij. Më vjen turp për indiferentizmin tim dhe lidh fatin pas tij. Për një çast më duket e çuditshme. Tani e ndiej më shumë se ky njëri nuk është i huaj për mua. Le të jetë ai nga Rusia, le të jem unë grek, le të jetojmë të dy në natyrën kërcënuese të një vendi të huaj. Jemi pjella të tokës që s'ka kufi, jemi gati të sakrifkohemi njëri për tjetrin.

Kaluam. Në mes të lumit më shikonte miqësisht për të më dhënë kurajë.

Shkundëm nga vetja pakënaqësinë dhe, duke shkelur mbi tokën e sigurt të një are djerrë, kthyer kokën, fitimtarë mbi egërsirën që shkumëzonte.

E kuptoj se nga ky moment dëshiron të më flasë më miqësisht. Që këtej e tutje e ndiej të nevojshme të shemb atë pseudo-fisnikëri që rri mes nesh si pjellë e diferencimit të madh klasor.

Vë re fytyrën e tij fisnike dhe habitem më shumë se përse iku nga Rusia e Re. Vërtitem akoma në oborrin e mosbesimit. Historia u krijua sipas qejfit dhe interesave të njeriut. Legjendat mund të fshehin më shumë sinqeritet, por as ato nuk u shpëtojnë ndryshimeve oportune kur rrëshqasin nga dëlirësia provinciale dhe bien në penën e intelektualit të djeshëm. Por kjo tokë më ngjan shumë krenare.

Ecim. Nuk mungoi në rrugën tonë hija e një zogu të madh, që humbet herë pas here në atmosferën e zemëruar dimërore. Ngado që të kthehem na ndjek pamja e ashpër e një mali dhe nëse kalojmë një lumë një tjetër do të na presë rrugën pak me tutje.

Shpirti vazhdon të mbetet i ngrysur. Gjendet në mbrojtje të pafund.

Në një mjedis të tillë gatuhet bota malore ballkanase.

Hymë në krahinën e Burrelit, të Milotit, të Lezhës dhe të një vargu të rralluar fshatrash të shtrirë tej mase.

Në rrugën tonë, një kishë e vetmuar, një kryq i harruar, më shkaktojnë një intimitet të veçantë me këtë tokë. Tmerri u zbraps totalisht nga brenda vetes.

I afrohem i fshatit të parë. Të njëjtat shtëpi, të njëjtët njerëz me myslimanët. Dhe ligjet e maleve nuk ndryshojnë në asgjë.

Natën fjetëm në shtëpinë e të parit të vendit. Akoma edhe diskutimi këtu nuk do të kishte asnjë ndryshim nëse këtu Muhameti nuk do t'ia lëshonte paqësisht vendin Krishtit.

Më ngjasojnë tani si dy vëllezër, që ndanë popujt, që ndanë miqësisht interesat e tyre ideologjike. Më vonë kjo forcë metafizike jashtë interesave, u kthye në ndërmarrje materialiste, së cilës i vjelin frytet stërnipërit e tyre, të mëdhenjtë e botës...

Atje komplekset arabe, këtu një “i kryqëzuar”, i varur në murin e zhveshur të shtëpisë së thjeshtë, ndjek me apati gjithë hollësitë e jetës familjare.



E çuditshme, mendoj. Malësorët, katolikë ose myslimanë, janë të njëjtë. Nuk u fali asgjë dalluese profeti i tyre. Sikur ata dje të ishin myslimanë dhe u pagëzuan pak më përpara katolikë, sikur të ishin këta katolikë dhe u gdhinë në mëngjes me Muhametin në mendjen e tyre.

Ndjek me etje të pashuar të gjitha shfaqjet e jetës fshatare.

Sapo ra agu i ëmbël, e reja e shtëpisë vajti për të parë kuajt, që ishin të lidhur në oborr. Hoqi ca kallamishte nga mullari dhe u hodhi për të ngrenë. Janë dhe kafshët tona mike të shtëpisë dhe nuk duhet t'u mungojë kujdesi.

E njëjta grua nxori më vonë dhitë për kullotë. Delet i mori i vëllai dhe iku. Qetë do t'i vërë përpara për në arë i ati. Nga pas tij do të shkojë edhe ajo për ta ndihmuar.

Plaku erdhi pranë nesh për muhabet. E kuptoj, për hatrin tonë, do të vonojë të zbres në fushë. Një natë e vetme pranë tyre dhe zumë miqësi të mirë.

Duke kaluar me kaq nxitim nga fshatrat e tyre, dyshoj nëse mundem, kështu shpejt, t'i njoh mirë. Përpiqem që çfarë nuk shoh, ta fitoj nëpërmjet bisedës.

- Dhe si ia çoni or mik me myslimanët?
- Hëm, nuk kemi asgjë për të ndarë. Ata punën e tyre ne tonën.
- Por, kur futet në mes djalli?

Plaku më shikoi dhe buzëqeshi aprovueshëm:

A, po, atëherë në të gjitha këto vende që kaloni, nuk flasim ne. Fjalën e ka pushka.

Vonova të heq sytë nga sipër tij. Fliste për armë, për vrasje dhe krime që ndodhin në krahinën e tij qetësisht, siç mund të tregohet një histori e zakonshme. Zëri i tij kishte një forcë bindëse që prapësonte dyshimet.

- Por më e bukura është kjo. Mos të të duket fare çudi.

Ndaloi për të venë re nëse e ndjek me interes. U përgatita

shpirtërisht të pres sa më i qetë rrëfimin. Kur vuri re shqetësimin tim, përdrodi mustaqet, për t'i dhënë ndoshta seriozitet më të madh fjalës së tij dhe vijoi:

Kështu ndodhi. Dhe nuk kaloi një muaj që atëherë. Do të kesh dëgjuar ndonjëherë për “besën” e vendit tonë, Të më fali Zoti i madh, nëse mendoj me dinakëri, por nuk mund të mos dish se në këto anë nderojnë shumë të huajin. Është diçka e shenjtë për malësorët i huaji. Që thua ti, kjo ndodhi këtu e para një muaji. Në fshatin fqinj, një orë rrugë që këtu. Zotëria tende je nga anët e jugut. Kështu me dukesh. Pra, iu afrua këtij fshati një i huaj nga anët tuaja. Në rrugë gjeti dy vëllezër. Djalli e solli të zihen të tre midis tyre. Njerëzia thotë për çështje parash. Të them të vërtetën një Zot e di. Por e keqja ndodhi. I huaji nxori koburen dhe vrau njërin. Vëllai tjetër nuk mund t'i bënte gjë se s'kishte armë me vete. Ra nata dhe i huaji mori rrugën për te fshati më i afërt. Kohë dimri, që thua ti dhe binte shi.

Plaku ndaloi prapë dhe vështrimi i tij kërkonte aprovimin tim. E kuptoi shpejt se zelli po më binte dhe vazhdoi tregimin duke u përpjekur të më bënte për vete.

– Nuk e humbas kohën me përralla. Jo! Të më dënojë Zoti në gënjej.

E, pra, i huaji hyri në shtëpinë e parë që i doli para. Hëngri dhe u mbështet që të çlodhej. Pas pak sollën mbi degë vëllain e vrarë. Ishte shtëpia e tij. Por, siç ju thashë, i huaji, cilido qoftë, për ne është një gjë e shenjtë. Gratë ndaluan të qarat dhe u morën me mysafirin. I vëllai i të vdekurit që e njohu, nuk tha gjysmë fjale. I huaji e gdhiu me sytë hapur. Nuk e zinte gjumi nga frika. Në mëngjes i vëllai i të vdekurit, u zgjua, hodhi në krah armën dhe doli për të përcjellë “mikun”. Kur arritën në kufijtë e fshatit e ndaloi:

– Dje, - i tha, - brenda në shtëpinë time ishe i huaji. Sot, jashtë fshatit tim, je vrasësi i vëllait tim. Përgatitu, nxirr armët e tua dhe të mundemi.

I huaji e humbi. Iu kujtua se dje, në kohën kur hyri në fshat kishte

hedhur koburen, se e dinte që miku fyen shtëpinë nëse hyn në shtëpinë mikpritëse me dyshimin se është i armatosur.

– Më vra, - i tha, - unë nuk kam armë me vete. Jam vrasësi i vëllait tënd. Mund të më vrasësh.

I vëllai i të vrarit e pa një copë herë i mundur, se nuk mund të merrte gjakun e të vetit dhe i tha me përçmim:

– Shko, ne këtu në malet tona nuk mundemi me gra.

I dha dorën për t'u liruar nga një barë dhe vijoi:

– Nëse vrave padrejtësisht, nga tjetër kush do ta gjesh. Nëse vrave në të drejtën tende, Zoti do të të falë.

Plaku bëri të çohej dhe plotësoi:

– Kështu e kemi ne nga anët tona.

Ligje të çuditshme, mendoi me vete. Gjykimi nuk kishte akoma fuqinë për të çmuar vlerën e tyre, por admirimi im jepej i pasur pas këtyre zakoneve krenare.

Nuk binte shi dhe rusi porositi të na sillnin kuajt. Ishte koha për të ikur.

Në rrugë shfaqja pa dashje përshtypjet e mia. Në mendjen time nxirrnin shpesh kryet skenat që përjetova me nxitim në këtë botë të pa eksploruar. Sa më shumë kalonte koha, aq më shumë urreja njerëzit e qytetit, shpirtrat pa shpirt, të cilët nuk i dehu asnjë mendim, asnjë dëshirë e madhe. Nuk mundesha akoma të kuptoja se si këta burra krenarë mali, poshtëronin veten duke bashkuar frymëmarrjen e tyre të pastër me intrigat e pista të tregtarëve të qytetit.

Po u afroheshim shtëpive të para të Shkodrës qejf prishur. Pallate të mëdha e të bukura, shtëpi të përkujdesura, që mbyllnin brenda mureve të tyre mizërinë e njerëzve pa vlera. Nga çatitë e kuqe më ngjan sikur pikon akoma djersa e fshatarit dhe lulet e bukura të kopshtit ndiej se thithin gjakun e bujkut të palodhur, i cili, nga agu i mëngjesit deri natën vonë, përgatit, pa

dysshimin më të vogël, jetën e pasur të afendikonjve.

Qyteti lëpihet para nesh i përlur, mbërthyer nga mendimet dinake dhe planet mëkatore të së nesërme.

Më pushton një zemërim i madh, që nuk di akoma se ku duhet ta konsumoj.

Kthej edhe një herë sytë nga qyteti. E shikoj me një ndjenjë mërzie dhe mëshire, madje me revoltë, pa munguar nga brenda vetes, bindja e hidhur e pandryshueshmërisë së gjërave. Më fali, pa asnjë kompromis gratë e tij të bukura, më hapi fisnikërisht sallonet e veta. Megjithatë nuk ndjej asnjë detyrim për ta falënderuar.

Mbyll brenda vetes përshtypje të përziera dhe largohem.

Ngurova shumë gjersa mora vendimin për të përshëndetur kolonelin kozak. E kuptoi menjëherë situatën time dhe u çua vetë:

– Hajde, rrugë të mbarë....

Futi midis duarve të tij dorën time dhe më përcolli deri te dera e zyrës së vet.

– Do të të shkruaj, - më thotë se largu.

Të të ketë mirë preëndia jote nëse rron, Kutsiuk Ullagai. Nëse ikën përgjithmonë, le të të falë mëkatet e tua. Në botën tjetër (nëse diku na pret) nuk ka dallime dhe interesa. Shpirti yt nuk do të vonojë t'i dojë njerëzit që urreve...

Makina ka pak që është nisur. Gjithsesi nuk mundem të lehtësoj mendjen nga atmosfera e habitshme e qytetit verior.

Më pushton të tërin një mëshirë pafund për një popull aspak të zakonitë, pa koherencë, i dorëzuar tek ato çka lë prapa, te ngjarjet e historisë, pa asnjë predispozicion mbrojtjeje, pa asnjë ideal që t'u përkasë të gjithëve. Nga ana tjetër, një popull që nuk u zgjua akoma për të kërkuar rrugën e tij.

Tregtari pret verën për të freskuar në det trupin e majmë. Në dimër mbyllet në luksin familjar. Myslimani i qytetit vazhdon të përulet i

përgjumur në xhami dhe fshatari pret të bëhen të mbjellat dhe të piquen frutat për t'i shitur në qytet.

Rozafa, akropoli ilir i Shkodrës, e patundur dhe ironike, e zhbërë nga rrënimi, vështron me apati rrjedhën e kohës dhe natyrën barbare që e rrethon. Kaluan shekuj tanimë që ka humbur tërësisht destinacionin heroik dhe natyra e saj mbrojtëse u kthye, thuajse në armiqësi për brezat e fundit të shqiptarëve. Kodra mbi të cilën është ndërtuar kështjella, duket sikur e lartëson vazhdimisht, e ngre larg tokës, mbi pëllëmbën e një dore çeliku, jashtë nga mëkatet tradhtare të kohëve.

Maja të thepisura përreth nesh, të ngrëna nga shirat dhe stuhitë. Para nesh i turbullt dhe kërcënues Drini i Zi, lumi më i madh i Shqipërisë.

Rripa të ngushtë fushe nuk mund të zbutin ashpërsinë e mjedisit. Kërcejtë e gjatë të misrit, trungjet gjithë nyje të pemëve në anë të arave, të ndihmuar nga vërshimet e lumit, fshehin brenda vetes barbarinë e orgazmës primitive.

Në një kthesë të rrugës një burrë shtatlartë i pret rrugën makinës:

– Ndal, bre ti !

Shoferi ndaloi. Vështroi me vëmendje malësorin, që qëndronte kërcënueshëm para nesh me një pushkë të shkurtër krahëve dhe me një kobure me dorezë të fildishtë në brez. Mustaqet e zeza e të dredhura në egërsinë e vështrimit i jepnin pamje imponuese dhe vendosmërie, që paralizonte çdo kundërshtim.

Shoferi përpiquej të zbuste pamjen e tij me buzëqeshje dhe nënshtrim. I njihte shumë mirë këta njerëz që llogarisin jetën e viktimit aq sa prerja e një pjepri.

E pohoj se u gjenda menjëherë në pozitë të vështirë. Pa e kuptuar pesha e kobures në brezin ushtarak më kujtonte detyrën dhe dyshimi i dukshëm më shtynte dorën për vetëmbrojtje. Prisja me apati të shtirur rezultatin.

– Ku shkon ky?

Me këtë papërcaktueshmëri, duke treguar makinën, dukej sikur i jepte asaj vetëpërsosje, sikur i falte shpirt.

– Në Tiranë, vlla, - i përgjigjet me ëmbëlsi shoferi.

– E ky ç’asht? - Thotë pas pak me dhelpëri gega, duke më treguar mua në thellësi të mjetit.

Është i imi, mos ki frikë, - përgjigjet shpejt shoferi, për t’i paraprirë ndoshta ndonjë zhvillimi të paparashikuar, pasi ishte i sigurt për mendimet e patriotit të vet.

U hodh në parafango me një lehtësi dhe siguri sikur kishte vite që e bënte atë punë. Bëri shenjë që të niseshim.

Shoferi nuk mund të kishte kundërshtim. Dy tregtarët që udhëtonin për punë në kryeqytet nuk hapën gojën fare. Jam i sigurt se kapnin me dorë portofolet e tyre dhe të strukur, siç qenë, me hidhnin herë-herë vështrime me premtime miqësore.

Argëtohesha qetësisht me kënaqësinë e tyre qesharake, ndërsa thellë brenda vetës më sëmbonte ideja se në momentin e duhur duhet të tregohesha burrë. Dhe të them të drejtën për asnjë çast nuk hoqa syrin nga burri i padëshiruar.

Pasi kaloi shumë kohë, në një kthesë të fortë, i armatosuri bëri shenjë se donte të zbriste.

– Mos jipni gjëkund shenjë për mu. Dhe kur keni me u kthi, nuk ka me ju prek kurrkush. Kto male i shkel me siguri kamba ime.

I kishte të pakta fjalët dhe fraza e fundit s’kishte fare ujë. Humbi me shkathësi në pyllin e dendur që fillonte në këmbët e malit dy metra larg nesh.

Një lëshim fryme kolektive, sado e përmbajtur, dëshmonte çlirimin tonë shpirtëror. Por, një frikë fluide u ul këmbëkryq brenda nesh dhe, duke iu bindur asaj, gjuha rrinte e lidhur. Duhej të largoheshim shumë nga pylli

për të filluar hamendësimet e ndrojtura.

- Hajdut, me siguri nuk është.
- Dhe tjetri:
- Diçka kërkon të bëjë.

Dhe një i tretë plotësoi me bindje se presupozonte përvojë të gjatë:

- Dikë ka vrarë.

Prapë një vrasje, nga të zakonshmet e malit. Gjaku i pafund, kjo gjakmarrje...

Rikthehej brenda meje, gjithnjë edhe më e gjallë drama e kësaj race me të drejtën e vet të nëpërkëmbur. Vedeta, asgjësimi që imponohet nga ligji primitiv burror i Lek Dukagjinit, kriminelit që bën profesion vrasjen.

Kërkoj heroizmin që himnizoi Fishta te imitimi homerik “Lahuta e Malsis”.

Lirizmi i kthjellët i Koliqit, zhvishet lakuriq para meje, më skalitet në mendje si një reliev i frymëzuar nga pasionet e papërmbajtura njerëzore. Duke rikujtuar episodet historike të maleve dhe të fushës, që u mbrujtën me kaq nxitim për të formuar historinë shqiptare, më rizgjohet gjithë dyshime një shprehje e neveritshme, zbulim dhe varrosje njëkohësisht e botës së vjetër politike, që zhyti popujt në errësirë dhe vetmi:

Forca shpirtërore e këtij populli të lashtë morri rrugën e krimit, në një kohë që i ka të gjitha mundësitë t’i kushtojë e papërmbajtur përparimit shoqëror. Dhe u himnizua kështu në vargje krimi dhe u shkrua më germa të arta në histori.

Shkruaj sa vëllime të duash Jokli, për këtë vend të përzgjedhur për ty. Shkenca jote bëhet miope kur harron totalisht pandërgjegjshmërinë e udhëheqësve politikë të kohës së shkuar dhe, padashur, bëhesh psalti tragjik i krimeve të tyre. Gëzohem në këto momente për patosin tënd dhe duke studiuar këtë popull ballkanas të kam para sysh.

Shkeli këmba ime malet e virgjëra të Mali të Zi shqiptar dhe

brenda vetes provova ndjenjën e përlësisë para madhësisë së natyrës së dëlirë. U ktheva pas për të parë njeriun. Dhe e pashë. E pashë jo me dehjen romantike që e mburjtë at Fishta, por lakuriq e të zbathur, të përlur me përkushtim mbi parmendën primitive të ngrënë nga krimbi, skllav të verbër të afendikonjve të vet.

Te malësori shtatlartë i Pukës, takova zëmrën e hapur dhe ndjenjat e pastra, që i ushqen kontakti i përditshëm me natyrën që nuk di të shtret. Te çobani gjoksgjerë në Kukës gjeta fisnikërinë e ngrohtë, siç e përcjell me dhembshuri toka mëmë.

Përshkoj tani këtë tokë me larmi pamjesh, me ndryshime të menjëhershme gjeografike. Vë përbri historinë për të ngjallur të kaluarën. Ushqej te vetja gjithë dëshirën e mirë për të falur dobësitë e kohëve të shkuara. Por, nuk i ndahem për asnjë moment mosbesimit të udhëtarit me përvojë.

Në përshtypjet e mia nuk më shtyn asnjë politikë oportune. Urrej pa masë cektësinë gazetareske, që kërkon ngjyrimë mashtruese, shumë larg psikologjisë së popullit.

Drini i Zi dhe Mati. Që të dy lumenj të mëdhenj, të cilët, pavarësisht nga shtrirja e qetë, nuk pakësojnë aspak ashpërsinë e mjedisit, trishtimin e shkëmbinjve.

– Shqipëria,- i them vetes- një vend kaq i vogël të sundohet nga male kaq të larta, të përshkohet nga lumenj kaq të mëdhenj. Shqipëria, një vend i vogël, të banohet nga njerëz me pasione amorfe, me ëndrra të ndryshme dhe interesa kontradiktore. Është raca që pranoi jo pak shartime, pa mundur të ruajë kohezionin e qëndrueshëm, që karakterizon një komb të pastër.

Ky është fati i botës ballkanase, që ndër shekuj nuk arriti të vendosë vetë për fatin e vet.

Makina ecën pa ndaluar dhe unë ndjek alternimin e pamjeve. Gjithkund male, maja pafund sup më sup, aq sa thua se diku do të ndërpresin



kalimin. Më duket sikur nën peshën e tyre ndiej psherëtimën e fushave të varfra.

Arrijmë në zonë e Krujës dhe hija e Kastriotit kontrollon mendimet tona.

Ky shkëmb i patundur i krishterimit ballkanik, ky luftëtar i çeliktë antiturk. I famshmi Skënderbe, u bë heroi i madh shqiptar. Koka e dhisë së përkrenares së tij stolis stemën e Zogut dhe bashkë me deformimet e tjera, ky hero është i detyruar të marrë pjesë në intrigat e oborrit të sotëm shqiptar. Vërtet i çuditshëm roli që i caktuan. Ai, që për vite pengoi valët osmane të ndotin tokën e vendit të tij, sot kthehet në mbrojtës të tyre. Skënderbeu luftoi dhe theu vullnetin e sulltanit. Gojës së myslimanit të sotëm i bën shoqëri emri i allahut...

Kalojmë bri vendlindjes së tij, Krujës, vendndodhja e selisë së shtabit të tij. Një qytet i krishterë në lulëzimin e parë të tij dhe tani plot xhami dhe minare.

A mund të përcaktojë kush sa ironi zbret nga malet e larta që ai luftoi, nga shkëmbej që shkeli këmba e tij fluturuese...



## TIRANA- KRYEQYTET - MBRET

Të tri këto fjalë kumbuese me pushtojnë të tërin dhe përfaqësojnë dëshirat e njeriut, që viziton për herë të parë një qytet, një botë të panjohur, që do të njoh një mbret për të cilin, zhurma botërore teproi me shumicë.

Përpëlitem në të njëjtën ëmbëlsi që më vërshon kur përgatitem të shoh një qytet të panjohur.

Pa e kuptuar dora më shkon në qafë për të rregulluar kravatën, por përmendem menjëherë. Jam ushtar. Pakënaqësia e vjetër zgjohet serish brenda meje. Nuk kam asgjë për të rregulluar te vetja.

## MBRETI DHE KOPEJA E TIJ

*-Drejt dimrit të vitit 1937-*

Errësohej dhe dyqanet e varfra popullore bëhen gati për dry. Zakoni i thjeshtë i punonjësit me mëditje në qytet përsëritej me saktësi kërcënuese.

I hedh vetes një vështrim nga koka te këmbët dhe deziluzionhem shpejt. Një ushtar i thjeshtë. Një subjekt hiç, që s'e ka në mendje askush. Nuk më pëlqen fare.

Fus dorën në xhep dhe nxjerr një letër të kolonelit rus. Është një rekomandim i ngrohtë për komandantin e “Shkollës së Oficerëve Rezervistë”. Më jep kurajë dhe marr vendimin. Nxitoj. Fluturoj në hotel, hap valixhen dhe vesh me zjarrmi rrobat civile.

U lehtësova. Më ndryshoi totalisht psikoza. Kjo mendja ime ruan akoma optimizëm të madh. Shikohem në pasqyrë. Korrigjoj totalisht qëndrimin për veten.

Nuk e di sa ishte ora kur u ktheva për të fjetur. Megjithatë jam i shtrirë në krevat dhe tendosem me dembellëk.

Kam oreks të grindem me veten. “Bre, pa dale or mik, ku ishe mbrëmë gjithë natën?” E pamundur të kujtoj hollësi.

Po, kështu më duket. Një rrugicë e ngushtë me baltë. Një kabare dhe dy-tri tiranase, që kërcenin mu para meje, shishe me birra në tavolinë, premtime të ndezura, pastaj...pastaj nuk mbaj mend asgjë.

E anulova disiplinën ushtarake për tri ditë. Po të sosen këto ka perëndia. Le të jetë mirë miku im kozaku.

Ndihem mirë. Qyteti më duket i hutuar. Nuk do të vonoj të futem në sekretet e saj orientale.

Shirat e para e zbrazën zemërimin e tyre dhe koha i ngjan atmosferës së ëmbël verore. Një vapë e piksur nderet mbi sipërfaqen e tokës. Nga çatitë e kuqe e të ulëta pikon në shpirt ndjenja shterpë e lodhjes. Janë të varfra mendimet që burojnë nga një ambient i rëndomtë.

Për të mënjeluar mpirjen e brendshme vë veten në lëvizje.

Minaret përhidhen pa kuptim aty këtu nëpër lagje, grisin me tundim atmosferën e lagësht dhe me pamjen e zbehtë theksojnë më shumë ndjenjën e monotonisë së sëmurë.

Qyteti i lodhur u shtri, thuj përmbys, në fushën e përzishme dhe fsheh fytyrën nga mëkatet e shkuara. Pastaj njerëzia që të kalon mu përpara hundës, të jep përshtypjen se nuk ka ndërruar kurrë sjelljen e vet. Njerëz të ngathët, që jeta i detyron të hedhin këmbët, të lëvizin duart, se nuk mësuani diçka tjetër më të mirë.

Lë të jenë. Jam i vendosur për të ndjekur rrugën e përshtypjes.

Ruaj akoma pezmin e gjendjes shpirtërore të veriut. Vij vërdallë nëpër rrugë me ngrefosjen e njeriut që nuk përfill askënd. Eci me kureshtje pakufi dhe nuk vonoj të kënaq veten me përshtypjen që lë rrotull.

Duhet të dukem i huaj dhe të them të drejtën më pëlqen. Ndjek

sokakët e ngushtë dhe humbas nëpër degëzimet tinëzare. Nuk e di ku shkoj dhe as dua ta di.

Shtëpiza të vjetra, të ulëta me ato çati të kohës së Turqisë që tendoset si strehë kapeleje jashtë murit. Fëmijët nuk mungojnë kurrë nga rruga. Luajnë z bathur, munden, shahen, zgërlaqen në baltën e pakët që u formua nga uji me finjë, që u derdh nga kazani i rrobave të porsalara. Fytyra të palara, të përthara, këmbë e duar të pista ku dejet e imta jeshile të ngjallin dhembshuri. Të fut në kaq mendime kjo mikrobotë e sëmurë.

Era e sapunit të lirë, kundërmimi që del nga shtëpitë e varfra, nuk më pengojnë fare të vazhdoj rrugën, të dalë ku të dalë.

Një derë u hap papritur dhe vë në pah gjithë lakuriqësinë e shtëpisë. Një grua që u shfaq e ndrojtur, nxiton të fshihet përsëri në errësirën e shtëpisë. Në verdhësinë e fytyrës është e lehtë të dallosh dramën e shurdhër, që luhet çdo ditë për një copë bukë misri.

– Duhet të jetë shumë i pasur ky mbret, - them me mendjen time. - Nuk pashë një njëri të shëndoshë deri tani në këtë lagje.

Një vogëlush këmbëngul në të qarat e tij për të shkëputur nga nëna pak bukë.

– Dhe kushedi, - them me vete, - nëse do të punojë edhe nesër.

Një botë që i pari i vendit nënshkroi për t'ia dorëzuar vdekjes.

Shtëpitë e jevgjve zënë një zonë të madhe të qytetit. Më të shumtat janë ndërtuar në të dy anët e lumit të pistë e gjysmë të tharë, që përshkon pjesën jugore të këtij fshati të madh, i cili mori përsipër, kështu nxitimthi, detyrat e rënda të kryeqytetit.

Kaloj bri njërit breg të Lanës. Vë një shami në hundë me bindjen se do të kalojnë sa më pak mikrobe në mushkëri.

Është e padurueshme. Kundërmime të pafundme, të papërcaktuara, nga këpucë të kalbura, lecka të mykura; një thartirë mbytëse nga kuti dhe teneqe të ndryshme, nga të gjitha ato teprica të shtëpive të varfra. E

përmbi to sundon era mbyhtëse e kërmës.

Kafshë të ngordhura të zhytura në baltë, barqe të fryra në diell, sy të shqyer që ironizojnë jetën. Mace, qen, minj, pula dhe të gjithë ato kafshë të vogla që nuk mund të durojnë shirat e rrëmbyeshëm të vjeshtës.

Këtu pranë janë të ngritura barangat e ciganëve. Të zotët e tyre, banorët e përhershëm të kryeqytetit shqiptar, rrinë shtrirë e thahen në ngrohtësinë e diellit. Vite me radhë, u lodhën së bredhuri në Ballkan dhe kërkuan, si e drejtë njerëzore, qetësinë.

Mbreti nuk ka kundërshtim për këtë larmi të vendit të tij. Pastaj rritej edhe buxheti i shtetit të tij, shtoheshin taksat, rritej rroga e tij.

Duhej, vërtet, durim i madh për të kaluar nga këto shtëpi. Shpërblimi nuk ishte i vogël pavarësisht se durova gjithë ato pamje lakuriqësie dhe erërat e ndyta që më rrethonin në çdo hap.

Zëri i plakës nuk më çudit fare:

– Efendi të të them fatin. Të do një bukuroshe, do të jetosh i pasur, do të udhëtosh...

E dëgjova me mirëkuptim. Kjo shtrigë këmbështrembër me fytyrë të shëmtuar të ngrënë nga koha, e kuptoi shpejt përçmimin që u jepja profecive të saj, ashtu siç kuptoi se nuk e nuhata qëllimin e saj të fshehtë, ndaj më orientoi me dinakërinë karakteristike të racës së vet:

– Të kam një mall efendi, të lëpish buzët. Gjashtëmbëdhjetë vjeç, për herë të parë del. Mos të duken shumë një natë e terë është.

– Të ngjan, plakë?

– Jo, mor djalë. Është farë nga e juaja. Nëna e saj një shtojzovalle cigane, ndodhet prej vitesh në prehrin e plakut Krosi. I huaj dukesh, herë e parë kalon zotëria tende në këtë qytet. Të më vras allahu, mos nxirr llaflaf se më hoqën qafe.

E marrtë djalli. Në ato çaste e kisha të vështirë të zgjoja dëshirat mashkullore. Por, ajo plakë mbarte mbi vete kërsërinë lindore të racës së

vet. Sjellja e saj premtonte originalitet në kësi kënaqësish.

Dhe për të zhdukur edhe gjurmën e fundit të tundimit tim përsëriti me fshehtësi tërheqëse.

– Gjashtëmbëdhjetë vjeç cigane, fendëm...

Kujtova shpejt se nuk më rëndonte asnjë kufizim moral, se rruga ime është shumë larg qëllimit të misionarit të shenjtë.

... Le të të bekojë zoti tat, vajzë e ciganes, farë e dehjes trupore. Më duket se duhet të të kem borxh një mirënjohje.

Dhe nëse akoma njihja të gjitha rrugët dhe rrugicat e ngushta të Tiranës, do të mbeste gjithmonë diçka e re, do të më priste ndonjë skenë në ndonjë qoshe të errët për të plotësuar përshtypjet e mia.

Këtu para meje, dy metra larg lumit të qelbur dhe po aq larg nga kasollet e jevgjve, është ndërtuar pallati princëror, haremi mashkullor i motrave të Zogut. Thjeshtësia e jashtme e pallatit nuk ka asnjë ngjashmëri me pasurinë së brendshmi.

Të katër motrat e mbretit (njëra më e keqe se tjetra), të habitura edhe vet ato nga titujt e lartë, nga stolitë e shumta dhe kujdesi mbretëror që iu siguroi figura e çuditshme monarkike e vëllait të tyre, provojnë tani edhe recetën e fundit të kozmetikës kimike, për të zbutur shëmtinë e fytyrës së tyre. Nxënëse të vonuara të salloneve franceze, nxitojnë të thithin vlagën e fundit të trupit të tyre të shtrydhur.

Kaloj bri pallatit me gatishmërinë e fantazisë për të sendërtuar jetën e zonjave të tij. Një ironi e hidhur struket brenda meje dhe kërkon të shndërrohet në të qeshur. Vështrimi i rojës, më pret gjithë humorin. Një gegë i bukur, shtatlartë, me seriozitetin e duhur për misionin e vet, qëndron i pa lëvizur në oborrin e pallatit.

Komedia, që luhet rreth meje, u bë një zakon i bukur për njerëzit që e jetojnë përditë. Ndërsa për ata që venë në dyshim këto kontraste të çrregullta, shndërrohet në dramë, që luhet tek zverku i botës së varfër.

Fëmijë me rrecka në shpinën kockëdalë kalojnë para pallatit, plaka të vuajtura, që zgjatin me droje dorën te çdo njëri i veshur bukur, gra të reja limon të verdha, që të ndrojtura kthejnë sytë nga pallati princëror. Admirojnë luksin mbretëror, pa keqdashjen më të vogël. Nuk guxojnë as të mendojnë zilinë. Por edhe urrejtjen s'kanë të drejtë ta shfaqin. Ky popull nuk ka arritur akoma në fazën e parë të zhvillimit shoqëror, që të hap mendjen për të dalluar të paktën kundërvëniet më të dukshme.

Lavdi profetit të tyre, që u fali një mbret me katër princesha...

– Dhe e di, -më thotë miku im, - janë shumë të dhembshura. Shpirtmëdha.

Sigurisht sepse mallëngjehen shumë duke parë varfërinë e madhe dhe ikin nga vendi i tyre në udhëtime të largëta. Pardje, u kthyen befas nga Suedia me kavalierët e tyre oficerë. Sollën me vete modën suedeze dhe për të kënaqur .... kureshtjen estetike të kalorësve të tyre vijnë vërdallë hipur në kuajt e tyre të famshëm.

Më e shkathta prej tyre ka gradën e togerit. Por nëse i teket së madhes nuk vonon të bëhet kolonele.

I pranoj këto kontraste kaq të theksuara me hidhërim të pashëruar. Një pehlivan, djalë i një bajraktari nga Mati, pasi u zgërlaq me edukatën e salloneve të Evropës Perëndimore, mbajti brenda vetës gjithë djallëzitë orientale të Turqisë së vjetër, të ushqyera në haremet e saj ku studioi vitet e para. Dhe një ditë të bukur kërceu me shkathtësi dhe paturpësisht në skenën politike. Më 1925 rrëmbeu në duart e veta fatin e popullit shqiptar dhe, pasi e përkëdheli me patriotizëm të fryrë, u ul në kurrizin e tij.

– Në dejet e mi,- tha para botës, - rrjedh gjak mbretëror. Jam pasardhës i mirëfilltë i Gjergj Kastriotit”.

Dhe interesat e huaja e besuan dhe nxituan t'i garantojnë fronin. E para tregoi vullnet të mirë dhe futi hundët Italia. Dhe që atëherë fillon drama e re e popullit shqiptar.



Djersa e fshatarit të largët u ngurtësua dhe, me të fshehtat e fakirit oriental, u bë flori. Mundi i punëtorit, që kalonte ditët me një copë bukë të thatë, u kthye në pallate mbretërore, u bë vila.

Kaloj nga ky luks mëkatar dhe ndiej të pikojë nga çatitë e tyre gjaku i një populli të shtrydhur.

Zbres te sheshi i qytetit. Këtu afër meje, në një gjysmërreth të rregullt lartësohen të rënda godinat e ministrive. Stili romak hijerëndë i tyre të zë frymën, të imponon disiplinën. Të zotët nuk turpërohen fare për marrëdhëniet mëkatore të ofruara në barangat e trembura që mezi qëndrojnë në këmbë.

– Kjo është Ministria e Brendshme, - më thotë i riu që pyes, në çastin që hyn në godinë.

– Paniku i popullit, - plotësoj me vete, - tremb akoma shpirtin tim pamja e egër e Musa Jukës, e këtij ministri primitiv të Punëve të Brendshme të Shqipërisë. Një burrë i pagdhundur, i cili përpiqet të fitojë vlera nëpërmjet djallëzisë. Vegël e verbër i mbretit të tij.

Dorë për dore të lidhura ministritë e tjera. Këtu Krosi, me tutje një tjetër si ai, ose pak me ndryshe se ky. Shpirtra të errëta që gdhihen mbi plane dinake, për t'u pasuruar sa më shpejt.

Qëndroj për pak te Ministria e Luftës. Psherëtimë akoma shkallaret e saj nga pesha mëkatore e gjeneral Xhemal Aranitasit. Qesh me vete. Kjo bandë e madhe, këta udhëheqës mendjengushtë, nuk i mohojnë fare fijet, që i lidhin me kapitalin e huaj. Nafta e Kuçovës iu shit Italisë, fabrikat e pakta janë edhe ato ndërmarrje të huaja dhe në një kohë kur populli ka muaj që vë pak mish në gojë, anijet u lodhën së ngarkuari djersën shqiptare.

Tani besoj se do të liroj mendjen time nga kjo atmosferë e tmerrshme, që e ushqejnë kontrastet brutale.

Kërkoj bukurinë që të çlodhëm.

Pak më tutje më provokojnë me dorë shtëpitë e mënjanuara të qytetit të ri.

Oborre të freskëta, vila të ndërtuara bukur, rrugë të qeta, të mbyllura ankueshëm në shkretinë e tyre. Dhe e pashpirta fiton shpirt me qetësinë pikëluese të saj. Më vret dhimbja ngado që vjen.

Por, dreq, më ndjek edhe këtu dyshimi i pangopur. “Pakar -i” që rrëshqiti pa zhurmë bri meje ka përpara tabelën e një ministrie. Ndaloi i mënjeluar në vilën më të afërt. I afrohem një vile tjetër dhe lexoj mbishkrimin. Është e kryetarit të bashkisë. Pak më tutje e filan sekretari të përgjithshëm. Ajo tjetra, në krah të saj, është e një tregtari të madh.

Nuk gjej as këtu qetësi. Këto shtëpiza të qeta janë pjellë e selive ministrore. Mundi i njeriut të ndërgjegjshëm nuk arrin kurrë në këtë luks. Nuk bëhet kurrë strehë fëmijërore, vendshlodhje për trupin e lodhur.

Diku gjetskë do të kërkoj kënaqësinë shpirtërore. Sigurisht atje ku mungon bukuria e jashtme. Luksi është tregues i pa përgënjeshtuar mëkatit.

– Jetoje jetën siç të vjen. - Mundohem ta justifikoj këtë mendim të cekët fatalist. Ah, jo ! Më pështiroset pranimi i tij.

Me një shpresë të vakët tërheq zvarrë këmbët e lodhura tek tregu i vjetër.

Dyqane të ulëta me produkte të varfra vendase. Qepë të varura, fasule në thasë të grisur dhe në një minder tregtari vendas pret me durim të pasosur klientin e vet. Pak më tutje enë prej teneqeje të bëra vetë dhe në muret e zhveshura, “qeleshet” e bardha turke përpiqen pa shpresë t’i rezistojnë fundit të tyre. I tremb sëmundja e madhe e evropianizimit.

I afrohem dyqanit. Pronari del te dera duke reklamuar gatishmërinë për shërbimin që kryen. Shikon kapelën time dhe nuk e fsheh armiqtësinë për formën perfekte evropiane.

– Kështu jemi ne shqiptarët. Harruam fare se çfarë vishte babai ynë.

Pamja e tij ironike nuk më pëlqen fare, por për t'i fituar simpatinë bie dakord me mendimin e tij.

– Kjo është e vërtetë....

E kuptova se e kishte të domosdoshëm mirëkuptimin tim se e pashë që e priti me dëshirë për të vazhduar:

– Nuk them për mallin tim, zotëri. Por mos t'ju vijë keq. Ejani brenda. Provoni një nga kapelet e mia më të mira. Shikoni ju shkon mrekullisht. Gëzohet kush ju shikon me këtë pamje burrërore. Mund t'jua fal, zotëri, nëse e doni. Gëzohem që ju shoh kështu.

Më vuri në pozitë të vështirë. Të vë qeleshen. Qesh edhe për faktin e vetëm, se më shkoj ndërmend një gjë e tillë. Nuk më pengon asnjë fanatizëm, por më duket kaq e çuditshme.

E përsëhendes dhe ik pa menduar se do t'i mbetet hatri. Bota, sado që të vonojë, i them vetes, nuk mund të pengohet në rrugën e vet. Tregtari vendas ndoshta pret ndonjë mysliman të bërë pishman, por djali i tij nuk do të vonojë që një ditë ta braktisë këtë punë pa shije dhe të futet në fabrikë, të trazohet me njeriun e kohës. Dhe atëherë vetëm në muze do të mbetet ndonjë qeleshe e varur.

Njerëzit vazhdojnë t'i luten të kaluarës, nuk mund të besojnë vdekjen e botës së vjetër dhe le të kalojnë përditë para tyre kortezhi i saj i përmortshëm.

Precipitoi brenda meje me neveri një ditë e tërë me gjithë peshën e skenave të çrregullta. Provoj gëzimin për botën që shuhet ngadalë, por shpejt e zëvendëson mërziçtja e madhe për botën e sëmurë që po lind.

Ia dedikoj lehtësimin qetësisë së natës. Vetia e saj njëdimensionale zbut kontrastet e ditës. Nuk do të vonojë të çlodh mendjen time.

Djali i pronarit të hotelit pranon të më hapë rrugën. Është një djalë i ri, që nuk beson në traditën e paraardhësve.

Më shikon me dhelpëri, pa ndjerë nevojën për të thënë arsyen.

Rrëmben heshtur dëshirën time dhe e bën tonën. Veshi pallton, çoi jakët dhe iku. Më këtë kuptova se distanca deri në destinacion nuk mund të jetë e vogël.

Siguria e tij është shumë premtuese për qëllimin tonë. E ndiej se peripecia e nisur fsheh në vetvete një ëmbëlsi të çuditshme.

Kapërcejmë sokakët e pafund, në të cilat errësira dimërore me pengon të dallojë hollësi. Pastaj, të them të vërtetën, nuk vija re asgjë. Kishte përparësi ajo shpresa burrërore, që, në këto orë tinëzare ushqehet pa hesap tek instinkti njerëzor.

Muzika e vendit me klarinetë dhe dajret e tepërta na tregon rrugën për te streha e asaj nate.

Mikut tim të ri nuk i shpëton asgjë. Hap derën e kësaj qendre të çuditshme. Qëndrova dhe e pashë me mëdyshjen e varur në sytë e mi. Më tërheq me shpejtësi dhe mbyll derën. Sjellja dhe pamja e tij kishin shkathësinë dhe dinakërinë e një veprimi të ndaluar, por që sapo fillon.

Nuk qe frika ajo që ndaloi këmbët e mia. Diçka tjetër prisja dhe fantazoja me zjarrmi, që më ndizte gjakun dhe gati sa s' më shpërthente tëmthat.

U mundova të qetësohem.

Zumë vend në një tavolinë të veçuar. Shoqëruesi im i foli garsonit, që me një servilizëm oriental na erdhi pranë.

– Birra! Birra dhe foli Nazes.

Salla e veshur, në të cilën strukeshin mbyttës tymi dhe frymëmarrjet e shumta, ruante një igrasi të djallëzuar. Mjaftonte era e rakisë, e verës dhe e birrës që të deheshe.

Kontrolloj me nxitim ambientin. Tavolinat janë të gjitha plot. Gota dhe shishe thyhen orë e çast mbi dyshtemenë prej guri. Zërat e ngjirur kërkojnë të lehtësojnë krijesat e tyre të vuajtura. Dëshira të pafundme njerëzore. Në çdo shoqëri një apo dy gra, nga ato bukuroshe

të dalldisura, produkt i kryqëzimit të paligjshëm të racës cigane me atë të bardhë, ujdysin qejfin mashkullor sipas dëshirës së secilit. Vështrime të flakta, fytyra të ndezura, pëshpëritje me zë të ulët që përcjellin premtime të shpejta.

Në mesin e kësaj kabareje vendase, të “Kafe Santan” ose “Kafe Aman”, siç i thonë, dy–tri cigane kërcejnë me atë përkulshmërinë mahnitëse të racës së tyre.

Muzika orientale, ashtu siç e zbuti shpirti ballkanas që përzien mrekullisht fatalitetin me dinamizmin evropian, më qetëson nervat. Rigjej veten ashtu siç e lashë të vogël këtu e vite më parë, për të ndjekur kënaqësinë e kulluar evropiane në qytetet e mëdha e të disiplinuar. Këtu dehja e brendshme qeraset me papërmbajtje dhe përqafon njeriun nga koka tek këmbët.

Më duket se miku kishte të drejtë.

Nazja erdhi dhe u ul midis nesh. Zgjati këmbët e vogla në karriget tona. Njërën ia fali mikut tim dhe tjetrën mua. Të njëjtën gjë bëri edhe me duart delikate borë të bardha. Më vuri në dispozicion gjithë dëshirë të djathtën. Vështirësia natyrore e ndalon të bëjë të njëjtën gjë edhe me sytë e saj të qetë e të turpshme. Mërzitet sepse nuk di nga të kthehet më parë.

Vogëlushe e gjorë! Duhet të jetë shumë katil ai që do të guxojë të të bëjë keq. Por, e para nëna jote, që të dërgoi të argëtosh botën.

Më këshilluan të mos shes moral në situata të tilla. E përmbaj vetën me shumë vështirësi.

Vajza ngrihet vrik edhe ikën. I vjen shumë keq, na thotë, por e kërkon në shoqërinë e tij një i madh. Një ministër. E do gjithë natën në shtëpinë e tij.

I shpreh habinë mikut.

– Paratë, i dashur. Sa të dojë vogëlushja.

Po, them me vete. Nuk është kambanë që dëgjohet për herë të

parë. Puno, punëtor i varfër, përmbysu gjithë ditën mbi parmendë bujk i rreckosur, për të argëtuar natën afendikonjtë e tu.

U zëmërova për një moment për katandinë tonë dhe i fola me të fortë mikut tim, sikur të ishte ai fajtori.

– Si thua, po të paguajmë ne më shumë nga ky ministër matuf? Nuk mund ta shpëtojmë? Të shkoj te nëna e saj, të qetësohet në fund të fundit vajza.

– Mbahu se do të na qash. Nuk është vetëm një natë kjo punë. Nga ana tjetër harron se është ministër dhe të dërgon në djall kur t’i teket.

Nuk e nxori më aq zemërimin e tij të disiplinuar dhe vazhdoi:

– Është ora e të mëdhenjve kjo. Nuk i shikon barkmëdhenjtë që hyjnë e dalin? Rrëmbejnë vajzat në makina dhe ikin. Nuk mjafton trimëria jonë vetëm....

I dhashë të drejtë.

Na mbetet gjumi, i cili nuk është akoma i ndaluar. Dhe ëndrrat nuk mund t’i urdhëroj asnjë i madh, nuk mund t’i burgosë asnjë urdhër mbretëror....

## PRANVERË 1938

Kam disa muaj në shkollën e oficerëve. Nuk dua t'i numëroj se trembem të mësoj sa më mbeten akoma.

Zura edhe miq të tjerë. Vetëm këta oficerë nuk mund t'i honeps. Sidomos ai nënkoloneli italian e vret shumë lart. Por edhe kursantët shqiptarë e shikojnë shtrembër dhe me armiqësi. Kanë një arsye më shumë se unë.

Janë të gjithë djem të mirë dhe nuk vonon t'i duash. Të bëjnë për vete me miqësinë burrërore.

Këto ditë martohet mbreti. Në shkollën tonë bëhen përgatitje të mëdha për festën. Miqtë e mi, i kuptoj, kanë pretendimin të mallëngjehem bashkë me ta. Këtu më kanë kundër. Nuk e kuptoj përse duhet të më interesojë.

Dasma e mbretit u bë. Nga mëngjesi oshtinin topat dhe njerëzit gjithë ditën argëtoheshin nëpër sheshe. Ndiej një shkreti rreth meje.

Pasdite parakaluam para tij. Edhe këtë nuk mund ta kuptoj. Nuk e di ç' emër t'i vë këtij pretendimi.

Miqtë e mi janë të entuziazmuar. Panë mbretin e tyre, panë mbretëreshën e tyre. Shihja të parin me këmbëngulje të çuditshme. Burrë i athët. Nuk mund të përcaktoja se ku gjendej aftësia e madhe për të udhëhequr një popull. Por, pse lodhem kot. Mos vrasja e ndërjegjegjes është avantazhi bazë për një diktator.

Kthej sytë te mbretëresha. Është e bukur, është e lartë dhe i takojnë madhështitë. Pelë e vërtetë hungareze. Kolegët bri meje rrokjezojnë në mënyrë të përsëritur emrin e saj: Geraldina! Është e vështirë, por jam i sigurt se duan të kundërshtojnë. Nëse guxojnë le të thonë mendimin e tyre. Kam përshtypjen se janë gati të bëjnë edhe kollotumba, mjaft të qeshi mbreti i tyre.

Në krah të mbretëreshës pozonte si star kinemaje me uniformën zyrtare fashiste, ministri i Jashtëm italian, konti Çiano. Ishte kumbari i Zogut, nuni i Italisë dhe Shqipërisë.

Populli, që nuk ka faj për asgjë, nuk u bë kurrë krijuesi i fatit të vet. Shikonte skenën, pa mundur të marrë me mend se ekzistojnë dhe prapaskena.

Kalon koha.

Sot na viziton koloneli Asimakopoulos. Është atasheu ushtarak në ambasadën greke në Tiranë. Përpiqem të fsheh emocionin tim.

Koloneli kaloi para nesh duke buzëqeshur. Pas pak hymë në sallë. Erdhi edhe këtu të ndjekë përparimin tonë ushtarak. Nuk njihte gjuhën vendase dhe duhej të ngrihej një kursant, që dinte “disi” greqisht. Kur ai shfaqti këtë interesim oficerë e kursantë u kthyen dhe më shikonin me simpati.

U çova dhe qëndrova gatitu. “U paraqita” në gjuhë të qartë ushtarake dhe prisja pyetjet e tij. Më shikonte duke buzëqeshur me kënaqësi:

- Je grek, mor djalë?
- Patjetër, zoti kolonel.

Në vijim kërkoi t’i shpjegoja shkaqet e luftës. Parashtrova pa mundim mendimet e mia. I përforcova me argumente nga fenomenet sociologjike dhe kontradiktat shoqërore me baza ekonomike. Iu referova pikëpamjeve socialiste të kohës ... dhe, siç e nisa, nuk kisha për të përfunduar kurrë.

Më shikonte me krenari, sikur donte t’u tregonte oficerëve shqiptarë epërsinë kulturore të racës greke. Unë kisha mendim tjetër, megjithatë nuk mund t’i shmangesha kësaj krenarie të cekët.

Koloneli më shtrëngoi me takt dorën, më komplimentoi shumë tek oficerët e mi dhe u largua.



Sot jam tjetër njeri. Më duan të gjithë dhe më pushton e njëjta ndjenjë për të gjithë.

Shkolla jonë i mbylli dyert. Na ngjiten në uniformë nga një yll dhe do të na nisin nëpër njësi.

Më mbajtën brenda në Tiranë, në një zyrë. Nuk bëj për oficer. U jap guxim të tepruar ushtarëve dhe nuk kam ide për disiplinën. Kjo është karakteristika zyrtare për mua i Ministrisë së Luftës. U jam mirënjohës për mirësinë e treguar.

Jeta në kryeqytet, pavarësisht larmisë, nuk ndryshon fare. Melankolia që pushton njerëzit, nuk përbën thjesht farën e monotonisë, por më shumë tregon mjerimin ekonomik.

Vesh shumë herë rrobat civile dhe dal nëpër qytet. Përpiqem t'i jap shije jetës me njohje të ndryshme. Nuk kam ankesa. Populli, njerëzit e thjeshtë të çdo race janë zemërmirë.

Shoh veten me uniformën ushtarake dhe qesh. Nuk mundem akoma të kuptoj, se përse njeriu kur vesh këtë uniformë, vrenjtet në fytyrë dhe drejton trupin. Pa lë pastaj po të ketë edhe një yll akoma.

Nuk ndiej asnjë emocion.



## LUFTA

### *Tiranë 1939*

Evropa ka prapë etje për gjak.

Gjermania nuk mund të fshehë më qëllimet e saj. Në krah të saj Italia ëndërron ringritjen e Perandorisë Romake. I rikthehen historisë për një nënshtrim të ri të popujve të vegjël.

“Austria ishte gjermane. Gdanski nuk është i Polonisë.”

“Shqipëria ishte çiflig i vjetër i Italisë, Greqia ishte dikur koloni e saj.”

Janë këto parullat e para të pafajshme të luftës së re.

Shtypi botëror zien nga reagimet. Çambërleni shkon në Munih, i drejtohet Romës duke shkallmuar dhe kolonën e fundit të kalbur të paqes. Hitleri parashtron me Musolinin planet pushtuese. Radiot zalisin atmosferën me fjalime të zjarrta:

- Popull gjerman, ty të takon të drejtosh fatin e botës!
- Popull trim i Italisë, mos harro origjinën tënde romake.

Dhe përpos tyre e vërteta lakuriqe ironizonte serishmi fatin e të pafatëve:

– Popuj, nuk është as kjo sakrifica juaj e fundit për lirinë e përhershme.

Këto ditë mora një ftesë nga Ministria e Luftës për t’u paraqitur pa asnjë vonesë në njësinë time. Ftesa ishte lakonike. Hartuesit e saj, njerëz të thatë, huazuan diçka nga poezia për të na mallëngjyer.

“ Italia kërkon të robërojë atdheun tonë të vogël, por trim. Pasardhës të denjë të Skënderbeut nuk duhet të turpërojmë kujtimin e tij....”

Jam vërtet pasardhës i këtij heroi ballkanas dhe le të mos më ketë

ushqyer kjo tokë dhe le të qe Skënderbeu aleat i ngushtë i Venedikasve.

Arsyeja ia linte serish vendin emocionit. Tundimi i fundit i shpirtit humbi në entuziazmin e papërmbajtur popullor.

Zhvillimet e fundit tragjike nuk arritën akoma në veshët e botës.

Në vendstrehimet e fshehta gjysmë të ndriçuara të pallatit zogist, për dy ditë me radhë kryqëzohen hije tinëzare, përhapen pëshpërime dinake, hyjnë e dalin figura të reja.

Sot u njoftua zyrtarisht nga mbreti se prej afro një jave italianët kërkojnë të pushtojnë vendin e tij.

Qeveria e “Shkëlqesisë së Tij...” hodhi poshtë kushtet e Musolinit dhe fton popullin në krah të saj.

Me lajmet e para “për zbarkimin italian” pallati mbretëror, me hije haremi, merr në sytë e kalimtarit një pamje melankolike, fiton një rëndesë të gabuar historike.

Oborrtarët ngatërrohen nëpër korridore të nervozuar.

“Liri a vdekje... Të gjithë për atdheun”.

Zogu, që deri dje pipiliste me ëmbëlsi emrin e bamirësit të tij, sot i shpall luftë. Shtypi, që mbushte faqe të tëra me propagandë pro italiane, fton sot popullin kundër Italisë. Botime të jashtëzakonshme, mesazhe rreziku drejt gjithë botës. “Populli heroik shqiptar përpohet nga përbindëshi italian! Popuj të qytetëruar shpëtoni vendin tonë!”.

Radiograme të panumërta përpiqen të prekin sedrën e popujve të lirë, dashuri të vonuara ballkanase, të varrosura nga mizëria politike, fillojnë sot të gjejnë rrugën e tyre natyrore.

Populli nuk njeh akoma se kush është fashizmi. Po, ky popull shumë pak ka dëgjuar për demokraci të lira dhe kurrë nuk e lejuan as të shqiptojë fjalën komunizëm. Atdheu kërkon gjakun e tij. Kaq mjafton.

Pasditja pranverore me të ftohtin brisk është e padurueshme. Dajti nuk arriti të shpëtojë nga bora e prillit. Tirana nuk do të flejë sonte.

Masa e njerëzve kryqëzohet nervoze nëpër rrugë. A thua se diçka kërkon. Mendimin e thjeshtë popullor vetëm një frazë e mundon:

- Italia. Vjen Italia të na skllavërojë...

Duhet bërë diçka. Nuk mundet që një shtet i madh të pushtojë një popull të vogël, se kështu i pëlqen.

Nxënësit e gjimnazit, ky brez i ri krenar i Shqipërisë, gjendet në vijën e parë të popullit që vërshoi sot në të gjithë kryeqytetin. Zëri i dredhur e tepër i lartë gërvisht kupën e qiellit. Fjalët e artikuluar prej tyre tronditin atmosferën:

- Poshtë Italia!...

Më në fund. Këtë shprehje të thjeshtë priste me kohë populli. Mjaftonte aq për të dehur në mënyrë të habitshme njeriun, për ta ngritur në këmbë të gatshëm për vetëflijimin sublim.

- Poshtë Italia!...

Kjo jehonë e pafund, e ardhur prej dehjes popullore ngjallte fushën e vdekur dhe qytetit të rëndomtë, i falte një madhështi primitive.

Njerëzit bashkoheshin, shtoheshin pa pushim. Një lum i pamat njerëzor, i verbër në ndjenjë.

Në këto çaste nuk ka vend për asnjë mendim. Tundimi më i vogël mbetet pa shpirt dhe varroset te burimi i errët nga u nis.

Ndiej veten të lidhur me masën dhe me trondit çrregullisht i njëjti patos. Është larg atdheu im, por është më afër njeriu, dhimbja e tij pa kufi. Edhe po të ishin lëkurëzinj këta njerëz rreth meje, e kuptoj se ndjenjat e mia do të kishin të njëjtin hov. Zëmra nuk di të bëjë dallime racash.

Kaluam nga pallati mbretëror. Në çdo moment tjetër hija e tij shtypte mendimin tim dhe pamja më ngjallte armiqësi. Por tani oshtima jonë para tij arrin madhësinë tragjike:

- Liri a vdekje!...
- Luftë, luftë!...

Dallimet shoqërore u harruan, armiq në gjirin e popullit nuk ekzistojnë.

Hymë në rrugën e ambasadave. Një popull i vogël kërkon ndihmën e botës së lirë:

- Rroftë Amerika!...
- Rroftë Anglia!...

Ambasadorët përshëndesin miqësisht popullin nga ballkoni. Në ambasadën greke dhe serbe emocioni kulmohet. Populli i shtirë nga një fuqi e errët provon një ndjenjë të çuditshme, që e gozhdon në vend. Këtu zëri i thellë popullor nuk ka asnjë lidhje me lutjen. Është kërkesë. Lidhjet e ngushta me Ballkanin i përqafojnë shpirtin e dhe i shterojnë gjithë fuqinë:

- Greqi, Greqi!
- Serbi, Serbi!

Populli. Fjalë e shenjtë, që nuk njeh tjetër gjë veç krijimit, nuk njeh planet që kurdisin të mëdhenjtë me fqinjët e tij, por farefisninë me ta e ka në deje. Madje, e bën që të vrasë edhe vëllain e vet, por dënoje po munde, në këto momente sinqeriteti. Këto orë i përkasin totalisht atij, se politika, mbuluar nga mëkatet, dha dorëheqjen.

Natën vonë, qyteti i lodhur u mbështoll në shqetësimet e veta. Errësira shoqëronte gjumin, që përpiquej të qetësonte ankthin e tmerrshëm të njeriut.

Vonë u tërhoqa për të fjetur.

Emocioni u ul këmbëkryq përgjithmonë brenda meje, duke dhënë, madje, edhe te sendet e vogla një pamje melankolike plot dhembshuri.

Qyteti fitonte sot një simpati të thellë.

Rrugët janë krenare me gjithë shkretinë e tyre. Pranoj me kënaqësi zhurmën e hapave të mia. Jam shumë i kënaqur me veten dhe çfarëdo që i takon trupit tim e admiroj me egoizëm. Por edhe sendet e huaja, që më ofrojnë kaq miqësisht pamjen e tyre.

Nuk njoh asnjë privim në këto momente dhe jam gati të përballoj me kokën lart dhe burrisht vdekjen. Përjetoj momentin e rrallë të vetëflijimit.

U veshja prapë oficer. Është hera e parë që gëzohem për uniformën dhe ylli me papeshën e tij rëndon lehtë supin tim.

Sot që në mëngjes përshkoj krenar qytetin. Qetësia e kudondodhur më freskon fytyrën. Kërkoj dashurinë e njerëzve të thjeshtë dhe jam gati t'u shpalos vendimin tim të madh:

– Më shikon, o njeri? Trupi im të është falur ty, tokës tende dhe le të jem i huaj për të.

Por është e tepërt. E ndien vetë ai dhe dalloj dëshirën për të më përqaftuar. Veshët e mi thithin me grykësi fjalët e tij mallëngjyese:

– Djemtë tanë... Janë djemtë tanë. Me trima të tillë i huaji nuk do të shkel shtëpitë tona.

Tek po eci, më shoqërojnë sy plot simpati. Është ora që edhe ushtari i thjeshtë rifiton nderin e humbur.

Një emocion i heshtur përqafton gjithë qytetin që nga mëngjesi. Një qetësi asimetrike përhapet në botë, fryt i pashpjeguar i shqetësimit.

U errësua dhe populli rivërshoi nëpër rrugë. Dhembja njerëzore shpërthen sot më e rrëmbyeshme, e çliruar krejt nga pretekste mashtruese:

– Duam armë ë ë ....! Të lirë ose të vvarë!...

Ditën tjetër oshtima arrin dëshpërimin. Pasditën, (ishte e Enjtja e Zezë) diku rreth pesëdhjetë aeroplanë italianë çanin atmosferën e shqetësuar si përbindësia të padisiplinuar. Gjëmimi i tyre metalik i kallte popullit dridhmat e para të robërisë. Nuk mbeste më asnjë dyshim. Italianet vijnë.

Natën zumë vend në kodrat e Durrësit. Dy togat e mia më rrethojnë që të marrin udhëzimet e fundit.

Përqaftoja mitralozin, përkëdhelja njerëzisht tytën e tij të ftohtë

dhe ngulja sytë në det.

Urdhri i komandantit tim më jep liri të plot veprimi:

“Vrisni sa italianë të mundni. I hidhni në det dhe e gjithë bota e lirë është me ne.”

E lexoj shumë herë dhe gjaku im kërkon rrugëdalje nga trupi. Zëri fitoi një dridhje të thellë nga emocioni i papërmbajtur.

Oficeri në krahun tim me përkushtim të turpshëm kërkon me ngulm t’i lë mitralozin:

– Zoti komandant, duhet të shkoni pas nesh. Plumbi i parë nuk duhet t’ju zërë juve. Jeni oficeri ynë dhe atdheu ka nevojë më shumë për ju.

Më mallëngjen dashuria e tij, por zemërimi im vështirë se përmbahet:

– Bedri, detyra jonë është e njëjtë. Gradat nuk i krijoi natyra. Shko mbrapa dhe ki kujdes djemtë..

Dritat e largëta, që reflektoheshin fillimisht zbehtë në sipërfaqen e pafund të detit, na afroheshin për herë e më shumë. Kolegu në krah vjen gjithë shkulum me urdhrat e fundit të komandantit:

– Stefan! Stefan po vijnë! Qëlloni në mish.

I shtrëngoj dorën pafolur dhe humbet shpejt në errësirë. Dridhem i tëri. Nuk jam njeri në këto momente.

Për herë të parë në jetën time ndiej të zgjohet brenda vetes bisha e parë, që më lindi. Kam etje për gjak.

Një gjakftohtësi e trazuar qetëson befasisht mendimin tim. Ballafaqoj pa kuptuar veten. Nga shpirti njerëzor, mendoj, kaluan kulturat e kaq epokave, por nuk arritën të zbusin instinktët e errëta të shtazës, që kanë origjinën tek vegimi i parë i njeriut, në çastin që dezertoj nga xhungla, duke fshehur dobësinë e tij trupore nëpër shpella.

Qetësia tinëzare, që zuri vend mes nesh bashkë me errësirën, me



kot kërkonte të zbuste pasionet njerëzore.

Anijet mbushur me drita farfuritnin ngadalë në ujë, duke iu afruar vjedhurazi bregut. Këngët italiane përpiqeshin të hidhnin spirancat e para miqësore në shpirtin tonë të zemëruar. Diçka kërkon të më heq dorën nga këmbëza e mitralozit. Shkund nga vetja ndjesitë paqësore që tentonin të mpinin vullnetin tim dhe ngul sytë me keqdashje tek masivet e ftohta që ankoronin në port.

Mitralozi më provokon. Pres zbarkimin e parë. Barkat mbushur me ushtarë arrijnë në stere. Papritmas, plumbat e mitralozit pranë copëtojnë shqetësimin tonë. Errësira, toka mbarë, pranonte me krenari protestën e fuqishme të popullit të vet.

– Djall! - Shaj veten, se dikush ma kaloi.

Nuk e di sa kohë kaloi që zbraz pareshtur shirita me fishekë.

– Fishekë, sillni shpejt fishekë!...

Është mesnatë? U gdhi? Nuk më intereson. Shikoj barka të plagosura që krahëmarrin anijet në kërkim të mbrojtjes.

Përpjekja e dytë e italianëve na gjen më të rrëmbyer. Shpirti ynë i dehur nga shenjat e para të fitores, jepet e papërmbajtur në luftë.

Predhat e mëdha të topave të marinës së tyre vërshëlajnë të demonizuara me dhjetëra metra mbi kokat tona.

Ushtarët tanë nuk përmbahen:

– Shënoni më lartë dhe do të na gjeni!...

Aeroplanët gjëmojnë ulët duke kërkuar pozicionet tona. Mitralozat e tyre krehin me pezëm kodrën e qytetit. Topat tani na gjuanin paprerë.

Errësira shkrihej nga agu i ditës dhe dalloj vdekjen lakuriqe. Një ushtar bri meje i shtrirë në shpinë shikonte me sy të zgurdulluar qiellin bosh.

Korrieri më sjell urdhrin e fundit të komandantit. “Më ndiqni

prapa qytetit. Kthehemi në Tiranë. Mbreti urdhëron ta ndjekim në male. Lufta sapo filloi”

E besonte edhe vetë ai. Do të zëmë malet. Fillojnë të shquhen të gjallë në mendjen time legjendat heroike. U deha i tëri.

Në orët e para të ditës u shpërndamë në lartësitë përreth kryeqytetit. Dhe në momentet, që entuziazmi i papërmbajtur i djemve të thjeshtë mënjanonte frikën njerëzore të vdekjes, mbreti me bandën e tij boshatiste arkat, përgatiste valixhet për udhëtimin tradhtar. Balerina hungareze Geraldinë mbështillte me përkujdesje aristokratike foshnjën e saj, të sapolindurin Skënder. Pas Vidit, princit mendjehetë, falsifikohet për herë të dytë emri i heroit të madh Skënderbe. Historia dënonte tradhtarët me përçmim dhe heshtje.

Veturat luksoze të mbretit dhe të ministrave të tij, ngarkuar me flori, humbitnin pak e nga pak nga sytë tanë. Të turpëruara. Që nga ky moment ndahej fati lakuriq i njerëzve të thjeshtë, nga roli shekullor i udhëheqësve të tij.

Shikoj ushtarët me gëzim të trazuar. Kërkoj me etje në sytë e tyre pesimizmin, kryeneçësinë, urrejtjen që do t’i orientojë shpejt në rrugën e duhur.

Shqipëria, e para në Ballkan, piketonte historinë e saj të re. Populli shqiptar lidhte fort fatin e tij me atë të fqinjëve. Këtu pengohet nga mëkati që i hedhin nëpër këmbë udhëheqësit e tij të rinj. Më tutje, po ata e shtyjnë në krim. Nuk ka histori të tijën.

Zgjimi final do të vonojë të vijë. Peripecitë e reja do ta çojnë akoma më poshtë, për t’i dhënë shtysën finale drejt së përpjetës së madhe të lirisë së vërtetë.

## VJEN ITALIA

7 Prill 1939

Pavarësisht nga shkëlqimi natyror kjo është një ditë e errët për të gjithë botën ballkanase.

Natyra, indiferente ndaj ankthit njerëzor, ndjek logjikën e saj. Dielli puthte ironikisht çatitë e shtëpive, kur ushtarët italianë hynin në kryeqytet me kujdes, të dehur nga një fitore e paqenë. Helmetat e hekurta të lyera rishtazi, shkëlqenin në diellin e prillit dhe armatimet e shumta, stoli të çuditshme, më kot kërkonin misionin e tyre.

Qyteti është i shkretë. Aty- këtu nxjerr kryet në dritare ndonjë njeri me shqetësim të dukshëm. E gjallë kureshtja e përzier me frikën.

Jemi akoma nëpër kodra. Pushka në duart tona qëndron e turpëruar. Pikëllimi i skajshëm, që na rëndon në shpirt, na zë frymën, pa mundur akoma të na zbusë urrejtjen.

Komandanti me mundim mbante lotët:

– Djem! Mbreti me qeverinë na tradhtoi. Zgjidhni rrugën tuaj. Është fillimi i një lufte të madhe. Shkoni në shtëpitë tuaja dhe atdheu do të kërkojë përsëri gjakun tuaj. Të urojmë që kjo të jetë hera e fundit. Qëndroni si burrat!...”

Nxitonte të mbaronte. Kishte frikë mos e mundte mallëngjimi. Hipën me adjutantit në kuaj dhe humbën në tatëpjetën e malit.

– Po ne?

Më rrethuan ushtarët e mi që t’u zbusja ankthin.

– Në qytet. Italianët janë njerëz shumë të mirë. Nuk do të na prekin.

Pashë me pështirosje oficerin katolik që nxitonte të fitonte simpatinë italiane.

Gjaku më hipi në kokë. Kërkonte shpërblim:

– Nuk e bëj pis dorën...

E përmbajta veten dhe vazhdova:

– Vëllezër! Janë dy rrugë. E shkurtra të çon për një orë në qytet. Atje, e dini ç’ju pret. Rruga e gjatë ka shumë mundime, por, nëse preferoni nderin, zgjidheni.

Morën me miqtë e mi nga një kalë hungarez, të braktisura nga oficerët eprorë dhe ikëm me trok të djallëzuar. Edhe kuajt fatkeqë jetonin me gjendjen tonë shpirtërore.

– Stefan! Ku vemi kështu?

– Ku ka tokë në liri.

Vraponim. Vraponim të demonizuar. Rruga plot me qere, fishekë të hedhur nga frika, topa që nuk arritën t’u dëgjohet zëri luftarak.

Nuk ishim njerëz, ishim legjendë. Nuk na ndiqte frika, por na dehte, na përqafonte të gjithëve zemërimi i pazbrazur në mërinë e betejës.

Në rrugë fshatarët duan diçka të mësojnë:

– Ç’ bëhet, bre djem? Ku shkoni kështu?

– Në male, në gërxhe, që nuk arrijnë makinat e tyre të mallkuara.

Atje i presim.

– Vijnë?

– Hynë në qytet.

Kaluam Elbasanin dhe ndaluam për pak në Librazhd.

Mbeta prapë vetëm.

Komunari, që ndaluam të hamë, vuri një radio të vogël me bateri, të cilën e mbante me vete në male për të komunikuar me botën dhe pas pak dëgjuam stacionin e kryeqytetit. Spikeri i vjetër vazhdonte tani propagandën e re, duke përsëritur me një stil dramatik të njëjtat fraza:

– Shqiptarë heroikë! Djem të Skënderbeut. Mikja e madhe e vendit tuaj, Italia, vjen sot t’ju çlirojë nga sundimi i errët i Zogut. Vëllezër! Shkoni të qetë në shtëpitë tuaja dhe për pak ditë do të gjeni tek ne

lumturinë e humbur. Vendi juaj në krah të Italisë së madhe do të lulëzojë, parajsë e vërtetë. Ushqime dhe rroba vijnë me bollëk pas nesh, që t'ju japin gëzimin e jetës. Ushtarë heroikë të Shqipërisë së pavdekshme! Mos vrisni vëllezërit tuaj që erdhën për t'ju çliruar. Hidhni armët dhe kthehuni të qetë në shtëpitë tuaja. Duçja i madh mendon për ju. Rroftë fashizmi! Rroftë mbreti i Italisë dhe i Shqipërisë, perandor i Etiopisë”.

Në mirëbesim, miqtë e mi pranonin me gëzim të përmbajtur këto premtime të pasura. Kishin kaq muaj të shkonin në shtëpitë e tyre. Pas pak u hipën kuajve dhe humbën në pafundësinë e rrugës.

Mbeta prapë vetëm. Që nga ky moment, fati im merrte rrugën e vet. E ndiej veten kaq të huaj në këtë vend. Sa e çuditshme! Akoma dhe malet e egra, pemët e plakura dhe këto shtëpi primitive malore më shikojnë me kaq armiqësi...

Nuk gjeja asgjëkund qetësi. Vura përpara diçka për të ngrënë dhe e lashë me përtesë. Orë e çast dilja te dera dhe kthehesha me pesimizëm të shtuar. Kërkoja një mendim të huaj për të përforcuar vendimin tim, kërkoja rrugëdaljen e madhe.

– Të iki. Duhet të ik. - Ky ishte mendimi i vetëm që kishte zënë gjithë hapësirën e trurit, pa mundur ta mposhte asnjë forcë.

Kryekomunari, më shikonte me simpati. Nuk ishte e vështirë të kuptonte agoninë time:

– Një kafe zoti oficer! Keni nevojë për qetësi.

Pranova ofertën me mungesën e dëshirës që i shkon përshtat një fëmije të vogël.

Ndërkohë erdhi dhe u ul pranë meje një burrë i shkathët i veshur mirë, që deri tani s'e kishte hapur gojën. Dëgjonte mendueshëm radion dhe ndiqte përshtypjen që skiconte në fytyrat tona situata e re. Më ndiqte me kujdes kaq kohë pa i vënë re fare qëllimet e tija. U ktheva nga ai me pamje miqësore. I jepja kështu shansin të gjente rrugëdalje në mendimet

e veta, që e mërznin dhe e mbyllnin në vetvete. Në momente kaq kritike heshtja është helmi më i përshtatshëm.

– Si i shikoni gjërat, zoti oficer? Po ktheheni nga fronti. Po ju shikoj.

Në përgjigjen që po i jepja ndieja zemërimin të më lehtësohej:

– Një robëri e zezë që fillon me fisnikëri të madhe.

Më pa mirë në sy.

– Po e ndieni shumë këtë që thoni.

– E njoha mirë fashizmin dy vjet në atdheun e tij, u përgjigja me të njëjtin nxitim të zemëruar.

Fjalët e mia të prera nuk linin vend për dyshime. Dhe ai donte të vazhdonim akoma. Diçka murmuriti, pastaj më bëri me nxitim një pyetje të re, që binte si gur i kobshëm brenda meje:

– Si ju duket ky Musolini?

Nuk kisha asnjë dyshim për ndjenjat e tij, por nuk e di si më erdhi që e lash të dëgjoja fillimisht mendimin e tij:

– Ju çfarë besoni?

– Është një kriminel i madh.

Fliste me patos, me një kënaqësi të pafund. Ndaloj për pak përmes një frymëmarrjeje të thellë dhe vazhdoi me një ton të qetë rrëfimin:

– I njoh mirë ata këmishëzinjtë. Më lejoni, zoti nëntoger, nëse nuk mërzniteni të më dëgjoni. Jam komandant batalioni artilerie. Kam veçse pak ditë që u ktheva nga fronti spanjoll. Isha vullnetar në ushtrinë e kuqe. Erdha edhe këtu në atdheun tim për këto sorra të zeza, po vazhdimin e patë vetë. Nuk arrita ta shkrepja as edhe një herë.

Zëri i tij nuk kishte fare ngjyrën e pesimizmit tim të thellë. Deshi të lehtësohej

me frazën e fundit:

– Jeni të rinj, mos bëni kështu. Kjo luftë nuk mbaron këtu. Liria

kërkon sakrifica të mëdha se armiku ka vite që përgatitet. Dhe e kërkon sakrificën nga ju të rinjtë, se e ardhmja ju përket juve. Në krahun tuaj jemi të pandarë dhe ne të moshuarit.

U drodh menjëherë dhe më zuri dorën:

– Çohu! Mund të vinë nga çasti në çast të na zënë. Kemi tri orë rrugë akoma deri në kufi.

Dolëm jashtë dhe më tregoi drejtimin:

– E shikon atë majë me borë. Pak metra më brenda është posta e parë serbe.

Serbia është e lirë. Pastaj, kushedi? Greqia, Turqia dhe me tutje akoma.

Kuajt e çlodhur ngjitnin me lehtësi të përpjetën.

Pas pak kohe ngroheshim në zjarrin e pasur të rojës serbe.

- Kakosi dobro.
- Zdravo dobro nogo.
- Albania. Italia u albanski!

Pesë a gjashtë ushtarë serbë na rrethuan duke kërkuar me ankth të mësonin të rehat, që ishte aq e vështirë të arrinin në malet e tyre të larta. Në sytë e tyre diktohej një dhembshuri pa kufi dhe një varg të pasosur pyetjesh rreth vendit tonë.

- Çfarë njerëzish janë ata italianë? Çfarë kërkojnë në Shqipëri?

Dhe sa të tjera që gjuha jonë nuk mund t'ua shpjegonte.

Me komandantin e batalionit mbetem pak kohë në Serbi. Njerëzit zemërmirë përpiqen, me mënyrën spontane të veriorit, të na pakësojnë dhimbjen. Na përqafojnë pa u shtirur dhe na çojnë nga shtëpia në shtëpi ku na ofrojnë mikpritje. Nuk mund të fshehësh lehtë mallëngjimin që të ofron pa kursim ky popull i sinqertë. Por edhe ai e ka të vështirë të përmbajë shqetësimin tij nga jehona e ngjarjeve shqiptare.

Nga Shkupi i qetë, (na shoqëron simpatia e ngrohtë e banorëve të

tij) arritëm me tren natën tjetër në Manastir. Njerëzit mblidhen rreth nesh me të njëjtën miqësi.

Jemi të rraskapitur. Nuk ndjej asnjë lodhje në trup, por shpirti lodron pa pushim në emocionin pa fund që ngjall çiltërsia e ndjenjave. I përjetoj këto momente të shenjta pa asnjë rezervë. Përkushtohem i tëri tek emocionet e brendshme të ndezura nga dashuria e njerëzve të thjeshtë.

– Populli, - më thotë herë pas here komandanti i batalionit, - jashtë popullit nuk do të gjesh asgjëkund dashurinë pa paragjykime. Dhe i lumtur është ai që di t'i pranojë ndjenja të tilla. Dhe lumturia dyfishohet kur lidh fatin tënd me to. Se populli nuk është asnjëherë dorështrënguar në mirënjohje.

– Liri! Duam shpejt Liri!

Na përshëndet qyteti në mëngjes me një mijë urime të tilla.

– Liri! Shpejt Liri!

– Përshëndetje vëllezër!

Vonë natën kapërcyem kufirin grek

– Ndal!

– Refugjatë politikë.

Nxitova t'i përgjigjem rojës, me një mënyrë që parathoshte miqësi të vjetër, larg nga ankthi karakteristik i njeriut që hyn në tokën e një vendi të huaj. Zëri im kishte diçka nga kërkesa dhe ankesa së bashku.

Hymë me shpejtësi në vendroje. Para uniformës time ushtarake ushtarët e pakët u çuan në këmbë për të përshëndetur. Ndieja qasjen e një intimitet të veçantë. Kureshtja greke nuk vonoi të shpaloset në pyetjet pa fund:

– Janë shumë? Ç' njerëz janë këta italianë? Ç' duan në vendin tuaj?

Përgjigjesha me thjeshtësi, duke mos lejuar të na ngjitej pamja e heroit, që ata krijonin me sjelljen e tyre ndaj nesh.

– Po, janë shumë, janë të armatosur dhe Shqipëria e vogël, nuk



mundi t'u bënte ballë me asgjë.

– Të poshtrit, palo edepsëzët! mërmërisnin orë e çast duke shoqëruar dhimbjen tonë.

Për dy ditë arritëm në Athinë. Komandanti i batalionit iku shpejt për në Turqi dhe unë do të zbrisja në Janinë.

– Nëse e gjej pisk në Ankara, afër është Rusia.

Shpresa të tilla i jepte vetes kur u ndamë. Nuk ishte nevoja të kalonte shumë kohë për t'u bërë miq të mirë. Fati i njëjtë i njeriut mënjanon pengesat e gënjeshtërtat dhe zemrat nuk llogarisin vitet.

Po, Athina. Kthehem serish adhurues i bukurisë sate të trazuar. Ngjyrimet lozonjare, mbrëmjet me të kaltrën e mbyllur, luhaten akoma në horizontin e saj të pafund. Dhe ato mëngjese të kthjellëta me dehjen e diellit mashtrojnë me dinakëri mendjen e varfër. Në shpirtin e athiniotit jeton romantizmi klasik. Të kundrosh, kështu i papërgatitur, Parthenonën nuk e di nëse mundesh lehtësisht të shpëtosh nga një iluzion. Për atë Zot, besova shumë herë se jam bashkëkohës i Praksitelit, qytetar dhe përkrahës i Perikliut. Ndoshta këtu duhet kërkuar sa pa baza ishte besimi te “Romios<sup>3</sup>”. Ndoshta këtu duhet kërkuar mungesa e orientimit dhe kërkesave për një kulturë të re.

Çdo mëngjes i jam mirënjohës zuzarit, që mbulon bukurinë e vdekur klasike të monumenteve me lakuriqësinë e gjallë njerëzore.

---

<sup>3</sup> Sinonim i emrit “grek”. Emri “Romios-Romioi (–shumës) nënkuptonte gjithë qytetarët e lirë në Perandorinë Romake, aq më tepër që Konstandinopoja fillimisht u quajt Roma e Re. Gjatë periudhës së pushtimit turk emri “Romios” humbi këtë kuptim dhe u përdor me kuptimin e njeriut të shkathët, të zgjuar, të aftë. Ideologjia iluministe e revolucionit grek i kërkoi rrënjët e lavdisë greke tek antikiteti i lashtë grek dhe grekët e kohës pasardhës të drejtpërdrejtë të kësaj lavdie. Kjo risi anashkaloi si Romën ashtu deh Bizantin, me pasojë dhe nënvleftësimin e emrit “Romios/oi”

Falënderoj, madje, edhe Metaksanë, që s'i përshtatet fare Perikliut. Njëri skaliste bukurinë në piedestale dhe tjetri lartëson mure për të mbyllur atje shqetësimet e shenja që frymëzojnë zhvillim.

Je një qytet i madh Athinë dhe le të mos kesh asnjë ngjashmëri me qytetet e tjera të mëdha. Je kaq e bukur me gjithë shëmtitë e tua.

Do të të lë gjithmonë prapa me të njëjtën ndjenjë mërzie.

Shëtis në qytet pa busull. E njoh mirë Janinën, por midis njerëzve zemërhapur të saj ndihem kaq i huaj. Njerëzit, që mbesin përherë në një vend, blatojnë çdo ditë të njëjtat mendime, të njëjtat emocione dhe, besoj, akoma se pa kuptuar përtypin të njëjtat fjalë.

Ndryshimet dhe shpirti im kryengritës me çuan shumë larg njerëzve të qetë. Në fytyrat e tyre nuk gjej askund pak nga vetja ime. Jam ende i veshur oficer i huaj. Jam refugjat dhe nuk kam rroba të tjera për t'u ndërruar.

Pas shpinës sime ndjej të më përçmojnë shikimet e njerëzve. Kureshtja, me kalimin e kohës, u bë simpati pavlerë dhe kjo u lodh e u shndërrua në mëshirë. Edhe mëshira nga ana e saj, nuk të jep aspak të drejtën të zemërohesh për t'u lehtësuar.

Kaluan dy muaj, por brenda meje nuk ndryshoi asgjë. Ambienti nuk më ndihmon fare për të harruar ngjarjet e befta luftarake. Nuk më munguan minaret edhe këtu në Janinë dhe, rrugicat e ngushta dhe sheshet e vogla i kërkojnë me ngulm kujtesës sime krahasimin.

Më ndjekin nga pas të gjalla skenat e frontit të varfër, (një veprim që mbeti në mes, një ndjenjë që nuk e lanë të vërshojë, do të tentojë përherë të realizohet dhe do të ngjallë përherë pikëllim në kujtesën time), kontrastet që i zbuloi tërësisht pangishmëria e politikës dhe bri saj ndjenja e pastër e popullit, dashuria e tij për lirinë, para se cilës nuk llogarit kurrë sakrificën.

Lë të lira shqetësimet e mia të pazbutura të bredhin nëpër dyqanet

e varfra popullore të qytetit dhe mundohem të zbus melankolinë time në hapësirën metalike të Pamvotidhës. Hija e lagësht e kështjellës lehtëson zjarrminë e ballit tim dhe valëzimet e buta të liqenit freskojnë përtesën time verore.

Me orë të tëra, nën pamjen e ashpër të kështjellës, robëronte dhe poshtëronte shpirtin tim fizionomia e demonizuar e Ali pashës. Rendonte brenda meje gjithë koha e tij. Në ëmbëlsinë e butë të fytyrës së tij shndrisnin dy sy të zjarrtë dhe ndërsa në të gjithë trupin e tij kishte folenë moskokëçarja orientale, brenda tij kryqëzohej dinamizmi i Pirros dhe Aleksandrit të madh. Të birin e Hankos e ushqeu zyrtësia e shkëmbinjve, e përkëdhelën legjendat modeste të fshatit të tij për t'i falur në fund Muhameti gjithë ëndrrat e tij dinake.

Meka nuk arriti kurrë ta shkulë nga balta e egër dhe e ligisht ballkanase. Bashkëkohës i Bonapartit. Nëse i mungonin diplomat e betejave të mëdha, shtati i Aliut nuk qëndron më poshtë se gjeniu francez. Trembi Perandorinë Osmane kur Napoleoni i kërkonte aleancë.

Para meje krenohet ishulli i vogël i Pamvotidhës, që historia e favorizoi të pranojë në prehrin e vet modest këtë personalitet ballkanas. Njëri vdiq te Shën Elena, i ngarkuar me përçmim. Tjetri jepte shpirt në një ishull tjetër, ngarkuar me lavdi e duke luftuar.

– E quanin Ali, - më thotë aty pranë profesori im i vjetër. - Nuk ka rendësi, mund të quhej edhe Petro, Konstandin, Aleksandër. Fetë nuk ndryshojnë gjakun.

Është e vërtetë. Fetë, nëse transformojnë pasionet, nuk e ndryshojnë gjakun.

Nuk e di nëse rron akoma brenda meje romantizmi i rrënuar i paraardhësve, por e takoj tani të lodhur në perëndim të diellit, në ngjyrat e tij të purpurta.

Në pak kohë u strukën në mendjen time kaq përshtypje.

Në Shqipëri jetova dramën tinëzare të një populli që tensionet e mprehta politike dhe interesat e verbra e ushqyen me urrejtjen dhe i transfuzuan pasionin e krimit, oportunitetin pamoral të feve, varfërinë e pa treguar që e çon njeriun në vdekje shpirtërore. Dhe në çastin e rrallë dhe të madh, kur një popull ftohet për të dhënë edhe pikën e fundit të gjakut, që i ka mbetur, të gjitha këto pengesa të helmatisura shfarosen që të shpaloset shpirti i pastër i njerëzve të thjeshtë, në gjithë madhësinë e saj të delirë.

Historia këtë herë ftoi popullin shqiptar për të krijuar me sakrificat e tij, 1821-shin e vet. Por udhëheqësit e tij ia hoqën sërishmi këtë krenari. Luftëtari shqiptar mbeti përsëri mercenar.

U ktheva në Greqi për të mbështetur shpirtin tim të dobët te buzëqeshja miqësore e bujkut, në frymëmarrjen e ngrohtë të punëtorit. Zbavit agoninë time në dinamizmin mesdhetar të Romiosit dhe në zemrën e tij të hapur rigjej mikpritjen shpirtërore që të ofrohet pa paragjykim nga njeriu i thjeshtë. Në gojën e tij varet në dy fjalë të vetme e gjithë bota e tij e brendshme.

– Shqipëria e gjorë...! Të poshtrit këta italianë!

Dhe askush nuk mund të mendonte se pak më vonë këto fjalë do të përbënin një realitet sublim. Ky popull i vuajtur do të sakrifikonte veten në malet e Shqipërisë, me krenarinë legjitime që të çlironte vendin fqinj nga pushtuesi i errësirës.

Shëtis me nostalgji mendimet e mia në atmosferën gjysmë lindore të qytetit epirotas. Humbas nëpër ngushticat e tij dhe ka momente që besoj se futem fshehtas në ndonjë mëhallë të Shkodrës, në sokakët mbytëse të Tiranës. Sa ngjan Kurabasi me kopshtin e vogël që shëtita për pak orë në Shkup. Dhe kjo rrugë që kam përpara tani, nuk mund të jetë tjetër veç ajo që më përcolli në shtëpitë e para të ulëta të Manastirit.

Ngjasojnë kaq shumë midis tyre qytetet provinciale ballkanase!

JANIS LILIS

Kërkoj kontrastet shpirtërore, ndryshimet e mëdha që i ndan këta popuj në shtete të veçanta, duke mbjellë brenda tyre urrejtjen dhe krimin.



## DASHURI E HERSHME FASHISTE

Do ta lija serish Greqinë një mbasdite gushti me shpirt të ndrydhur nga frika dhe dëshpërimi. Brenda meje nuk ishte fashitur ende zemërimi dhe neveritja. Megjithatë jam i detyruar të kthehem në Shqipëri. Në mendjen time fillon që tani të jehojë kërcitja e thatë e hekurit. Pushkë, mitraloza, topa, tanke dhe gjithë të tjerat hekura të ftohtë. Pastaj disiplinë ushtarake, gjuhë e huaj, imponim.

Truri im i lodhur bluan pa dashur skenat e nesërme. Nxiton të më përgatis gjendjen shpirtërore. Kërkon ta orientojë. Më kot. Më mbysin që tani kontradiktat shpirtërore.

Apatia e përgjumur orientale, vështrimi fatalist i ngjarjeve nuk i shkojnë fare shpirtit tim.

Helmetat, çizmet, mamuzet.

– Jo, nuk shkoj!

Njeriu im më shikon me zhgënjim të fshehur dhe përpiqet ende të thyejë këmbënguljen time:

– Do të shkosh. Prindërit pleq kalben në burg për shkakun tënd. Je shumë egoist.

Rri pak i mendueshëm dhe kuptoj si zien brenda tij. I zëmëruar me veten që nuk mund të zgjedh frazat që i duhen, ndërkohë që di të zgjedhë me kaq siguri një pjepër të bërë mirë.

Pavendosmëria e tij nuk dallon shumë nga droja. Shikimi i tij më përqafton me atë dashuri të sëmurë, të mpirë nga dhimbja, që pikon frikshëm në momentet më të vështira të njeriut. Erdhi të më inkurajojë dhe më mërzit më shumë për hesap të tij. Më duket sikur bëhet gati të më ngushëllojë thellësisht për një njeriun tim, që vdiq. Shikimi i tij fsheh akoma diçka që i ngjan pendimit.

I njeh mirë sakrificat që më duhet të bëj ashtu si nuk harron peripeçitë që më ofron bujarisht ky udhëtim.

Shpirti i tij u zbut tërësisht. Pamja e thatë pikon qetësi të vuajtur. Kërkon të thotë diçka akoma dhe vështirësohet shumë për ta filluar:

– Harron Stefan, se atdheu yt është Greqia? Kaq mërzitje të madhe se u pushtua Shqipëria? Ne skllever dhe të huaj jemi për të dyja.

E tha me aq mallëngjim. Dhe ishte një e vërtetë e madhe. Nga ana tjetër, gënjeshtria kurrë nuk mund të zëvendësojë çiltërsinë e spontanitetit. Dhe ishin të thjeshta dhe të paqëmtuara fjalët e tij. Në një popull të robëruar shprehjet e stolisura, jo vetëm janë të tepërta, por pakësojnë përshtypjen dhe zbehin krejt dhimbjen.

Për një moment mallëngjimi i tij më la pa rrugëdalje, por vetë ajo dhimbje me rrënjët e saj stërgjyshore, më afronte më shumë me realitetin e tanishëm:

– Kështu është. Dhe ne sklleverit ndjejmë sinqerisht ankthin e një popullit tjetër, që fillon tani të robërohet. Brenda nesh akoma lëvrin i njëjti gjak me atë popull, sado që ustallarët u përpoqën ta ndërrojnë me kontradikta që sajuan kohë pas kohe. Sigurisht, beu, agai. Të drejtë ke. Por ç' faj ka njeriu i varfër që është i zbathur më shumë se ti? Është hamalli, shërbëtori i tyre ashtu si edhe ti. Nga ana tjetër, agallarët nuk robërohen. Mos ki dert për ta. Nuk do të paguajnë as kësaj here me gjakun e tyre gjakun e kaq brezave tanë.

Më kërkoi një vendim duke më treguar sahatin e tij:

– Fillove prapë me të vjetrat. Dhe, ndoshta, mund të kesh të drejtë, por prindërit e tu vdesin, e kupton vdesin për shkakun tënd.... Dhe mos harro se shoferit nuk i intereson asgjë nga këto.

U çova i mërziur. Shkoja pas tij, fitimtar i nënshtruar.

Nuk gjej forcë për të mundur zhgënjimin. Jam viktimë e rrezikut dhe nuk mund t'i gëzohem asgjëje nga natyra. S'do të thotë asgjë fakti



që është kaq i bukur liqeni i qetë i Zharavinës. Më duket pa shije në momentin që kaloj bri tij, i pakuptimtë.

Hymë në baltërat bërë pis të Kakavijës. Shpirti im u mbyll totalisht i përndjekur madje edhe nga natyra.

Një mbasdite e neveritshme, që me kot mundohej ta ëmbëlsonte hapësira ankuese e Dropullit me ngjyrimet të argjendta. Qielli i tij i kaltër, i ngrohtë, lodrat rrëshqitëse të Drinos.

Është e vërtet, pra. Për ta ndjerë natyrën, ajo kërkon bukurinë tonë të brendshme. Dhe unë fsheh aq shëmti brenda vetes në këto momente.

Makina ndaloi në postën greke të Kakavijës. Morëm vulat dhe u nisëm drejt rojës shqiptare. Treguam dokumentet.

– Brenda tek oficeri.

– Roja bën pa emocion detyrën. Nga ana tjetër nuk harron fare ashpërsinë që i imponon ligji për momente të tilla. Është roja e kufirit të shtetit të tij dhe duhet t'i japë të huajit të kuptojë se raca shqiptare, që ai përfaqëson me egërsinë e tij, është e tëra si ai, dhe po të duan le të guxojnë ta nënshtrajnë....Një turizëm amorf midis të tjerash.

I gjithë luksu i një zyre u mblodh te të dy oficerët e tij. rada të arta, dekorata shumëngjyreshe dhe një uniformë që edhe një qime ka droje t'i ngjitet. Muret e thatë, kanë turp të strehojnë bukuri të tilla. Njëri duket nxënës fillestar në fisnikëri dhe tjetri, me ironinë hiperbolike të tij, e ka tejkaluar. Në rrudhat e ballit nuk vonon të përcaktosh origjinën ballkanase të njërit dhe në ëmbëlsinë e tepruar të tjetrit nuk e ke të vështirë të dallosh feminitetin e racës italiane. Nuk e di në çfarë mund të ketë faj Mesdheu me rrymat e tij të ngrohta.

Më ka mpirë të tërin një indiferencë e pakuptimtë. Dhe kam një predispozicion të djallosur, të tallem me botën.

Në fytyrë ndiej një dregëz të fortë dhe pamja ime përbuz krejtësisht vështirësitë që më rrethojnë. Heroizëm ndoshta? Budallallëqe.

Është pandjeshmëria e pandreqshme që më zgjati frika. Ndoshta edhe pashmangësia e asaj që është e shkruar. Orientalizma dhe asgjë më shumë.

Oficeri shqiptar pranoi të më japë pak rëndësi. Mori në dorë pasaportën time provizore . E kontrolloi me .... dyshim profesional dhe rrokjezoi me vete:

– Stefan.... Stefan.... A! Po. Ti je.

I sigurt për vlerën e tij, ktheu sytë me përbuzje drejt meje:

– Më njeh mua? Nuk të kujtohem?

– Nuk të njoh. Domethënë të di por nuk të njoh.

Zgjuarsia e tij e lejoj të kuptojë ironinë time. Ndoshta u gëzua në vend që të prekej. I jepja mundësinë që të mos merrte parasysh miqësinë tonë, për të respektuar detyrën, që i siguronte kaq shkëlqim.

– E di që ndiqesh. Dhe duhet të dish akoma se çfarë të pret. Dezertor, tradhtar i vendit tënd.

Indiferenca ime nuk kishte të bënte asgjë me gjakftohtësinë. Brenda vetes po vërshonte një ndjenjë që nuk llogariste pasojat.

– Tradhtar unë? E di fort mirë kush nga ne të dy...

– Lidheni!

Urdhëroi me shpejtësi rojën dhe u tërhoq mënjanë me kolegun italian. I zgjata duart e mia prangave duke kthyer sytë nga muret. Fytyra e dhjamur dhe e fryrë e Musolinit dukej se më buzëqeshte me kënaqësi. Mund të ishte i bindur për nënshttrimin shqiptar.

Lazri, miku im i vjetër, oficer shkodran, dha urdhrat e fundit dhe u kthye serish tek unë i egërsuar:

– Palogrek! Ju njohim të gjithëve ju.

Ndoshta mund të mos qetësohej gjithë natën, pa më thënë fjalinë e fundit.

I falënderoj, që për kaq orë më dhanë të drejtën të mendoj në dëm të tyre. Dhe kur flasim me vete, ndiejmë një lehtësim dhe lë të mos

shfryjmë siç duhet.

U err dhe do të vonohemi shumë akoma të arrijmë në Gjirokastrë. Kushëriri im iku shpejt me makinë për në fshat.

Për orë të tëra ecim me rojën në rrugën e lodhur të fushës. Më shikon që vuaj kështu me duar të prangosur dhe e kuptoj që mendja e tij e thjeshtë nuk mund të arrij deri te planet e të mëdhenjve.

Është hera e tretë që iu luta të nxirrte paketën nga xhepi im dhe të më vinte në gojë një cigare. Qëndron, e ndez, ndez edhe të tijën dhe ecim duke biseduar. Pas shumë kohe vendosi të më pyesë :

– Domethënë nuk je vrasës? Unë vetëm ata i mbaj me pranga.

Nxori çelësin dhe i shkyçi. E kuptoi edhe vetë se foli kështu befasisht, por donte të shpëtonte vetën nga një peshë që e shtypte dhe e turpëronte para meje.

Nuk di shumë gjera për të biseduar, por di se jam njeri dhe Zoti nuk i dha duart që të t'i lidhin.

Dy hapa larg nesh fshatrat e Dropullit flenë shtrirë në radhë rrëzë malit. Jergucati, Grapshi...Dhuviani, Vanista, Goranxia, Derviçani. Kërcej një derë. Lopa kërkon fëmijën e vet, qengji blegërin për nënën e tij. Ndiej brenda vetes frymën e trupit të vuajtur, që u shtri për të fjetur. Më mbyst nostalgjia dhe mallëngjimi.

Diku këtu rrinë zgjuar të mitë me ankthin për fatin që më pret.

Jam dërmuar nga lodhja. Sonte nuk i mbylla për asnjë çast sytë. Gjumi përkëdhelte fshehurazi trupin tim, por e dëbonin me ngulm insektet e burgut, që cilësohen si torturat e përhershme për të burgosurit. Pleshtat kërcejnë të demonizuar dhe morrat zvarriten të etur në të gjithë trupin. Nuk arrita akoma të mësohem me këtë ndotësi dhe neveri të gjithanshme, që shkakton prekje mpirëse e tyre në lëkurën time. Dhe zemërimi, që lind binjak në këto momente, nuk mund të gjeja rrugëdalje te grushti apo tek sharjet.

Nënë dhe babanë i flakën me shkelma nga burgu. Nuk deshën të iknin. Erdhën në mëngjes te frëngjia e qelisë sime dhe qanin. Kushëriri im qëndronte i turpëruar dhe i penduar para tyre.

– Kush të tha ta sillje këtu? Pleq jemi dhe vdekjen presim. Dhe një vdekje e tillë për prindërit është më e ëmbla.

Kërkonin të plotësonin jetën e tyre me sakrificën. Për djalin e tyre. Mallëngjimi, sado që më kënaq, nuk më jep guximin, që më duhet. Por, shumë shpejt vendin e tij e zë ndjenja e vetëflijimit. Madje dhe egoizmi i varfër për dashurinë, që tregojnë njerëzit e tu. Jeta ia vlen vetëm për këto çaste të rralla.

Në ditën e tretë më sollën në Sarandë. Më prangosen prapë duart dhe me flakën në një makinë luksoze. Shoferi është shqiptar dhe më informon me frikë:

– Ki mendjen, ai që të shoqëron flet greqisht.

Erdhi dhe u ul pranë meje një marshall i karabinierisë. Pas pak makina rrëshqiste e qeshur nëpër rrugën e pluhurosur. Italiani me ëmbëlsi dhe përkujdesje të sforcuar më vë në gojë një cigare. Më pyet në gjuhën e tij. Flet pa pushim duke lëvizur duart, por nuk merr asnjë përgjigje. Unë ngre supet me indiferencë teatrale. Ai vë edhe shoferin të më bëjë muhabet me greqishten e tij të varfër. Nuk përgjigjem dhe shqiptari përpiqet të fshehtë gëzimin e tij. Por, në dreq, më lodhi ky njeri me këmbënguljen e tij policore.

– I thuaj zotërisë të më lërë rehat.

Italiani u tradhtua shpejt. Para se të përkthente fjalët e mia shoferi shqiptar, marshalli u zëmërua dhe nuk mundi të përmbante egërsinë e tij. Qesha fitimtar:

– Domethënë nuk ditkeni greqisht. Ha! Ha!

E kuptoja që më shante në gjuhën e tij.

Në drekë zbresim në Delvinë. Duhet të hamë diçka. Dhe kam

një oreks të pajustificuar. Përpos, ndiej nevojën e paepur të demonstroj prangat. Duke hyrë në një kuzhinë të ulët, të tymosur, i kthehem italianit:

– Do të më lironi duart apo keni qejf të më ushqeni?

Nuk më përgjigjet. Hap prangat duke buzëqeshur i kënaqur. Pozicioni im i jep të drejtën të gëzohet. Ka jetën e një njeriu në dorën e tij. Kjo përbën një krenari të madhe për një shpirtvogël.

Kisha kaq ditë i mbyllur në burg. Tani barku im është i ngrohtë dhe me dehje të pashuar sodis bukuritë e natyrës.

Për pak hapësira modeste e detit më zbut ashpërsinë shpirtërore. Ndodhet bri nesh në çastet kur hymë në qytetin e vogël.

Historia respektoi emrin e saj Ajioi Saranda <sup>4</sup>. Zogu tentoi t'i dhuronte vetës pavdekësi dhe e pagëzoi Zogaj. Besoi se kështu do të ndërronte edhe origjinën e saj. Tani, Musolini, i sigurt për jetëgjatësinë e fitores së tij, lajkatonte të bijën, Edda. Porto Edda. Dhe ngjyrat e pastra greke të qytetit ironizojnë me prezencën e tyre të pashuar cektësinë e njerëzve të huaj.

Sot fjeta prapë keq. Qelitë e burgut ngjajnë të tëra midis tyre, kudo që ndodhen. Dhe morrat nuk kanë atdhe. Hyjnë gjithandej pa pasaportë.

Jam i pandreqshëm. Nuk më intereson asgjë dhe vetëm grindem, që nuk më lënë t'i gëzohem detit. Nxituan të më fusin në burg dhe nuk më lejuan të kënaq kureshtjen. Ndjej një boshllëk brenda vetes. Si është qyteti? Ku janë njerëzit e tij?

Koloneli, para të cilit më sollën pasditen për hetim, mban rroba të bardha, të bukura me shirita të artë. Qetësia e bardhë e uniformës së tij zbut ankthet e mia. Vë bast me veten që ky njeri me të bardha është shumë i mirë. Në krah të tij qëndron një admiral. Kështu e cilësoi përkthyesi. Ky mbart mbi vete ashpërsinë e furtunës. Pamja e tij shpalos përvojën e padiskutueshme në det. E stoliste me peripecitë oqeanike. Mundohet të

---

<sup>4</sup> Dyzet shenjtorë

mos e kundërshtojë këtë arsytim me dekoratat që i ngjiten mbi gjoks.

Për një moment diçka i pëshpëritin dragomanit, që kthehet me gatishmëri të shtirë nga mua:

– Si të quajnë?

– Stefan....

– Je oficer i ushtrisë shqiptare. Por, këto letra këtu të akuzojnë për agjent grek. Je tradhtar i atdheut tënd.

– Gënjeshtër. Atdheu im është këtu pranë, një fshat i vogël. Nuk e di se si mund të tradhtoj një fshat të vogël. Aviacionin e tij, marinën e tij apo planet e mëdha pushtuese....

Përkthyesi me greqishten e tij të pastër, ngrefoset me tri gradat e tij të ngjitura mjeshtërisht ulët në mëngët e uniformës dhe vazhdon me zemërim:

– Të gjitha këto fshatra flasin greqisht. Je edhe ti grek?

– Përderisa të gjithë ata janë grekë, nuk e di se si mund të jem unë shqiptar?

Fytyra e ëmbël zeshkane e togerit përkthyes bëhet komike kur përpiqet të zëmërohet. Te bukuroshët me sjellje gruaje serioziteti venitet krejtësisht. E bezdis përgjigja ime dhe vjen rrotull, duke kërkuar pyetjen e përshtatshme. E ndien se turpëron një perandori të tërë. Goxha toger nuk mund t'i mbyllë gojën një fshatari nga një atdhe që nuk shënohet as në hartë.

– Dhe duhet të jem grek nga Dodekaniso, për të folur greqisht?

– Është e drejta tënde ta mohosh....

Koloneli me admiralin, duke parë përkthyesin të nevrifikoset, ndiejnë nevojën të ndihmojnë zemërimin e tij. E kuptoj, më shajnë në gjuhën e tyre dhe sjellja ime i bezdis akoma më shumë.

Argëtoj veten heshturazi me kontaktin e parë zyrtar me racën italiane. Më hipën në kokë ndjenja e ironisë dhe një dëshirë për të

filozofuar. Është një mënyrë e mirë për të qetësuar ankthin tim.

Shikoj këta njerëz. Sa i pasur luksi i jashtëm i tyre, aq zhvlerësues i botës së tyre shpirtërore. Sollën në këtë cep të varfër të gjitha stolitë e tyre dhe kundrojnë tani botën me ndjenja poshtëruese. I shikoj me mëshirë, pa mundur të kuptoj nevojën e gjithë këtij zyrtarizmi. Në pamjen e tyre varet një mendim gjynahqar dhe nevoja për ta shprehur është një kotësi:

– Njëri i varfër!...

Dhe përderisa për kaç kohë kënaqën kureshtjet e tyre të rëndomta, u kujtuan për misionin e tyre. Pyetjet e tyre pa nerv dhe të lodhura. Me injektojnë moskokëçarjen. Me mënyrën e tyre më shkaktojnë pakënaqësi dhe më heqin të drejtën e zemërimit.

– Ishe në Greqi....

– Po.

– Nga vjen tani?

– Nga Janina.

Përkthyesi pyet e shkruan vazhdimisht. Nuk më shikon fare dhe kështu tregon se i di përgjigjet para se t'i dëgjojë.

Kalove nga Selaniku, shkove në Vollo, qëndrove disa ditë në Athinë, çfarë kuptove në gjithë këtë udhëtim? Domethënë si t'u dukën këto vende?

Përmbaj me shumë vështirësi të qeshurën që më mbyt në fyt.

– E kuptova, doni përshtypjet e mia. Sigurisht i bukur Selaniku, e mahnitshme Volloja, me gjithë vapën e saj dhe, për sa i përket Athinës, do t'ua tregonte më mirë enciklopedia dhe botimet turistike....

Kisha kaç oreks për të vazhduar, por më ndërpreu i inatosur.

– Shumë budalla po na tregohesh.

U kapërdi dhe kërceu i shtirur duke përplasur grushtin e tij delikat në tavolinë. Desha t'i shprehja keqardhje, që për shkakun tim tani vuan nga dhimbja, por nuk guxova t'i ndërpres frymëzimin.

- Nuk duam këtë, budalla!

Koloneli u çua menjëherë në këmbë dhe u kthye nga unë, sikur të kishte harruar se nuk e kuptoja:

- Il popolo... Il morale di popolo...

Togeri imiton komandantin e tij

- Morali... Morali i popullit si është... Këtë duam.

Nuk e kuptoj dhe aq qëllimin e tyre. Interesohen për moralin e popullit grek.

Dhe duhet të skërmitin dhëmbët? Do të mund të më mallëngjenin për interesin e tyre, po të mos zemëroheshin.

- Njerëzit si i pe njerëzit, çfarë po bëjnë?
- Rrojnë, gëzojnë, qeshin, hedhin valle. Çfarë bën gjithë bota.
- Bre, a ka moral?
- Të shkëlqyer, zoti toger. Moral të madh.

Koloneli bie në karrigen e tij i menduar. Nuk e priste këtë përgjigje.

U err dhe hetimi akoma nuk kishte mbaruar. Oficeri me rrobat e bardha vazhdon të mendohet duke murmuritur. Admirali nuk pranon t'i nënshtrohet zyrtësisë dhe mbrohet me fytyrën e tij të egërsuar. Togeri e ka shumë të vështirë të stabilizojë pamjen e tij. Ende më pyesin nëse pash rrugës që kaloja fortifikime dhe nëse e dija rolin që mund të luante lumi Kallamas. Isha i sigurt se do të kishin pretendimin t'iu përcaktoja thellësinë dhe centimetrat e gjerësisë së tij.

Dritarja e hapur e zyrës zë një pjesë të madhe deti. Ndjej freskinë e tij të papërcaktuar brenda vetes. Në hapësirën e paimagjinueshme të detit luajnë kukafshehthi dritat e Korfuzit. E ndiej veten adhures të tij. Një ndjenjë e sëmure romantike më shtyn larg realitetit. Mbes skllav i ndjenjës patriotike dhe nis të krenohem për qëndrimin tim. I shikoj të huaj këta njerëz në këtë mjedis, që nuk proteston. Njëkohësisht ata me



ndejnë aq të huaj në rrethin e tyre të livanisur. E kuptoj, pamja ime plot shpërfillje, shëmton atmosferën e tyre dhe koloneli nuk vonon të shpëtojë nga kjo bezdisje:

– Vatene!...

Dhe togeri, duke zbatuar me bindje rolin pashpirt të papagallit dhe duke shtrembëruar fytyrën me përbuzje, vulos në mendjen time tradhtinë e tij:

– Shko!...

Fjala e thjeshtë nuk ka asnjë afri etimologjike me “gremisu!” apo “thyej qafën!”, por në veshët e mi ishte sikur dëgjoja të dytat dhe jo të parën.

Jashtë më priste karabinieri shoqërues. Hyri brenda mori udhëzimet e duhura dhe më shtrëngoi serish prangat në duart.

Përsëhendes me shikim të mallëngjyer fshatrat e mi dhe ik për në Tiranë. Nuk e dija akoma nëse ato jetonin brenda meje, apo brenda tyre unë lija shpirtin tim.

Në rrugë bri nesh forconte qetësinë time Drinoja me ujërat e tij të kaltra. Më tutje malet e Tepelenës përpiqeshin të më vishnin lakuriqësinë e tyre. Ullinj të e Vlorës, në kodrat e ulëta, piqeshin me durimin e të vuajturit. Dhe makina nxitonte për të arritur në Tiranë.

Kam pak ditë në burg. Kam etje të shijoj qytetin dhe sa më shumë dëgjoj zërat jashtë burgut, aq më shumë ndjej vetminë. Qelitë janë bosh. Lodh vetën duke menduar. Është e tmerrshme të ndiejë dikush kaq bosh mendjen e tij. Por sot përgatitem për gjyqin e nesërm. Ma njoftoi gardiani i natës se në mëngjes do të kaloj në gjyqin ushtarak. Ushqim i bollshëm për mendjen time. Dhe nuk mund të rruhem lehtë nga frika, e cila kërkon të më zotërojë.

Kryetarin e fantazoj, ndonjë gjatuaat të madh që munxuros fytyrën time me sharje dhe merr vendimin e tmerrshëm. Agjent grek. Pastaj ajo

shprehja e kolonelit italian në Sarandë: “ Ki mendjen! Kudo që të shkosh do të shoqërojnë dokumentet e mia...” Kushedi se çfarë më kurdiste kur shkruante mendueshëm. Dhe mbante një uniformë të pafajshme.

Nuk ishte asgjë. Një muaj burg dhe humbas të drejtat ushtarake. Kryetari ishte një nënkolonel shqiptar, që fshehurazi gëzohej për qëndrimin dhe përgjigjet e mia. Nuk e di si ta përgëzoj për sjelljen e tij burrërore. Në momentin që artikulonte me seriozitet të shtirur vendimin, i mëshoi zërit në frazën finale:

- Dënohet me humbjen e të drejtave të tij ushtarake.

Një dëshirë e menjëhershme më sjell duart nëpër xhepa dhe kërkoj me vrull të gjej yjet dhe t’ua fal. Mbeta i pakënaqur.

Ganiu, miku im i vjetër, vjen rregullisht në burg dhe me viziton. Bashkë me dhuratat e tij më sjell edhe të rejat e qytetit. Gjen belanë me hollësitë që i kërkoj.

- Ouf vëlla, - më thotë në fund. - Bari mbetet ende jeshil dhe pemët nuk pushojnë se lulëzuari. Gratë nuk harrojnë të lindin dhe ajo që do të mbetet nga të gjitha këto, është se vdekja nuk harron kurrë rolin e vet.

I gëzohem indiferentizmit të tij oriental, megjithëse shpirti im nuk pranon të huazojë mentalitetin e tij.

- Dëgjoj çekiçë dhe hekura të vringëllijnë këtu rrotull meje.
- Ah, sigurisht, rezidenca, rrugë të reja, dyqanet, që nuk i nxënë mallrat. Kanë ndërmend të rrinë gjatë matufët, por siç e shikoj nuk do vonojnë shumë të mbushin burgjet. Njerëzit ngopen me bukë por, sido që të jetë, me këto nuk mund të ushqehet shpirti.

Nuk kam arsye të kundërshtoj.

Sot mora letër nga komandanti im i vjetër, Kutsiuk Ullagai. Më këshillon të rri urtë, ndërsa për të tjerat do të interesohet sa të jetë e mundur. Nuk i erdhi mirë që humba të drejtat ushtarake. Nuk e kuptoj.

Është një dezertor rus dhe e kam të vështirë se çfarë duhet t'i shkruaj.

Ç' pretendim që kanë. Dihet që barku tret grurin dhe makaronat pavarësisht se nga vijnë: nga Kanadaja, nga Australia ose nga Japonia. Në trup shkon lehtësisht çdo basmë e veshje pavarësisht nga etiketa e huaj. Por të duash të mbjellësh shpirtin tënd te një popull tjetër, kjo më duket shumë e çuditshme.

Kam ca kohë që munxosa burgun. Për orë të tëra sorollatem nëpër rrugë. Tregtari bëri skonton e parë në patriotizmin e tij. Hoqi tabelën e vjetër dhe për të renë, kërkoi ndihmën e fjalorit italo-shqiptar. Në krah të “Darkore”- restorant- u shtua fjala “Trattoria”. Hoteli “London” u bë “Imperial” dhe rrugët u mbushën me shenjat fashiste të Littorio-s

Atmosfera e qetë melankolike e qytetit u dend nga aromat e oficerëve dhe ushtarëve të perandorisë së zgërlaqur. Muret dhe ajri i lagësht i kryeqytetit mirëpresin me ndjenjën e përkohshmërisë gjuhën italiane.

Dhe qyteti shtrihet pa protestuar. Rezidenca, shkolla, hotele, kazerma, vila. Automobila pa fund, vetura që mbartin edhe ato mbi vete feminitetin e racës italiane. Qeveri shqiptare, ministra me bollëk që nën hijen e tyre fshihet edhe ndonjë specialist i Duçes. Vittorio Emanuele fitoi stemën e Skënderbeut. Italia nxiton të kolonizojë Shqipërinë.

Edhe në portin e Durrësit, ditë e natë shkarkohen mallra të reja. Musolini mjel popullin e tij për të ngopur urinë shekullore të Shqipërisë. Shtrin aftësinë retorike për të mallëngjyer njerëzit e thjeshtë: “Shqipëria është në zemrën time”. Dhe për të mbetur besnik i parimeve të tij feudale, te bejlerët shpërndan djersën e kripur dhe në popull lirizmin e artë.

U mbush kryeqyteti nga dembelët e provincës. Jeta këtu është e lehtë dhe të ofron pa pretendime ëmbëlsi të ndaluara. Të gjithë ata, që u rëndet kazma ose çekani, lajkatojnë pa vështirësi burokratike trupin e varfër tek uniforma e bukur ushtarake. Krijohen batalione vullnetare

fashiste. Ngjiten me inflacion grada, jepen tituj, shpërndahen shkallë hierarkie. Dhe në të gjitha këto e ndjen pamjen e ankueshme të gjoksit shqiptar. Është lakuriq dhe nuk ka asnjë medalje. Italianët për pak do të kenë edhe nëpër këmbë. Është e lehtë të besosh se të parët presin me padurim rastin të shpëtojnë nga ky inferioritet i madh.

Miku im avokat u bë ministër. Nuk e fsheh krenarinë e tij. Në fillim i vjen turp të dalë me uniformën e madhe fashiste. Nuk i beson vetes. Do të mësohet.

Nuk më hap asnjë bisedë për fashizmin dhe kur e ngacmoj shmanget të përgjigjet. Është i ndërgjegjshëm për gafën e bërë, por nuk mund të kundërshtojë egoizmin e vet. Për çdo gjë që frikohet, ta thotë me gojë, e shoh në sytë e tij. Madje edhe heshtja e tij më ndihmon që të plotësojë mendimin tim. “Thuaj se u pagëzua gjysma e Shqipërisë. Nëse të gjithë ata janë kriminelë, le të jem midis tyre”. E çuditshme. Gabimi i të parit jep guxim për ta përsëritur dhe i dyti, i treti...

Nuk ndodh e njëjta gjë më zotin profesor. Iu rend katedra e mësimeve dhe tani kolltuku i thellë i ministrit i siguron të gjitha lehtësitë ekonomike për të fituar kohën e humbur pa bereqet. Nga ana tjetër, për këto momente të shenjta... ka vite që punon. Përktheu nga italishtja kaq libra. Me kaq mundime zbuloi në histori marrëdhëniet e gjakut (!) të racës italiane dhe shqiptare dhe së fundi po përgatit rininë shqiptare “të ndiej brenda vetes epërsinë e frymës fashiste”. Edhe kur flet për problemet botërore, për fatin e luftës së sotme, të gjitha ua beson pa vuajtje Duçes dhe Hitlerit, me reptësinë profetike të Moisiut:

– E di unë çfarë po ju them. Italianët dhe gjermanët, janë popuj të mëdhenj. Nuk lejohet ta vëmë fare në dyshim fitoren e tyre.

Miku im i dashur, Ganiu, mërzitet shumë kohët e fundit. Ndjek me vëmendje përhapjen e sëmundjes fashiste. Çdo ditë diçka të re do të zbulojë, që e bën më të shqetësuar.

– Kam frikë, - më thoshte dje. - Vajzat tona, miku im, ato që skuqeshin dje kur të shikonin, që nuk kapërcenin pragun e derës. Është e tmerrshme, më beso. Shikojnë ëmbël këta të poshtrit. Pëshpërима, randevu nëpër sokakë të errët. Ndiej turp. Pastaj, fëmijët tanë të vegjël të shkollës. Mësuan italishtes më mirë edhe se ne, që mundoheshim me Danten dhe Papinin. Lë pastaj ato organizatat e djallit, ato këngë të pështira.

Mendoj pak dhe plotësoi:

– Ah, jo, nuk jemi italianë ne.

E njihja mirë. Ngatërrohej atëherë, kur nuk e prisje. Së fundi, policia fashiste përpiquej të ndiqte çdo lëvizje të tij.

Dhe kur me gjente serish, më tregonte me kënaqësi të çlirët përshtypjet e tij:

– I dashur, merr frymë tjetërsoj me këta njerëz. Djemtë e gjimnazit, mësues dhe punëtorë nuk e honepsin Italinë. Më beso nuk duan t'i shohin këta këlyshë...

Afrohej te veshi im në mënyrë që dukej se donte të më tregonte ndonjë të fshehtë të madhe:

– Shqipëria nuk do të shuhet, jo!...

E përjetonte çdo ditë dramën e popullit të vet. Vendi i tij, i cili shpëtoi për pak vite nga peripecitë e pafundme, ku interesat e huaja e zhysnin në përplasje tragjike të brendshme, sapo filloi të fitojë ndërgjegjen patriotike deri dje endacake, pengohet sërishmi në robërinë praruese të etjes skllavëruese fashiste. Zogu, pasardhës shtatanik i urisë dhe i verbërisë intelektuale, në periudhën e errësirës së mbretërisë së tij, në mënyrë të njëanshme dhe për llogari personale pretendonte të kultivonte ndërgjegjen kombëtare me kut feudalit.

Kur Shqipëria pastronte brenda vetes mbeturinat të huaja barbare, për të zbuluar shpirtin e vet të zhytur në errësirë, fqinjët e vet, të pajisur me koncepte të reja humane, me shqetësimin që mbante zgjuar ndërgjegjen

e kombit, me sakrifica të reja, kapërcenin shterpësinë e nacionalizmit fanatik dhe lëronin suksesshëm Evropën, shkonin përpara për fitoren e përhershme të civilizimit të keqkuptuar.

Në Greqi Metaksai me oligarkinë mëkatore të kapitalit, i shqetësuar, përpiqet të kufizojë burgjet dhe në ishujt pa jetë ankthet e njeriut të ri. Në Serbi përhapen valët e para të ngrohta të ideologjisë së Ruisë së Re.

Shqipëria, sillet akoma vërdallë, duke kërkuar vetveten.

# NJË DIELL PRANVEROR NE NETËT DIMËRORE EVROPIANE.

*Vjeshtë 1940*

Flatrat e ftohta të luftës po i mpinin sërish kockat e lodhura të botës ballkanase. Në shpinën ujore të Adriatikut, rrëshqasin të zemëruara anijet italiane, thua se nxitojnë të shkarkojnë tek autoritetet shqiptare, bashkë me hekurin e pafund edhe ëndrrat romake të bojatisura rishtazi.

Luftë...

Në Shqipëri atmosferës iu morën mendtë nga etja e nxituar pushtuese “dei figli romani” (populli shqiptar nuk ka fuqi morale të vë në dyshim fitoren fashiste). Në Jugosllavi hezitojnë akoma për vendimet e mëdha. Politika turke vazhdon me ngurrimet e veta të psikikës lindore dhe Bullgaria lëpin që tani me kënaqësi të pafund kockat greke, që i premtojnë kanibalët e pasur.

Polonia jep shpirt, barkshqyer nga çizmjja gjermane. Mazino-ja shpirtërore e popullit francez, e këtyre ushtarëve të përhershëm të lirisë, u thye. Shtati krenar i Evropës përulej i poshtëruar.

Ditë të zeza, ku shpresat nuk guxojnë të nxjerrin kokën. Duhej një forcë e madhe e brendshme shpirtërore që fantazia të guxonte të pranonte kaq shpejt humbjen fashiste.

Në këtë kohë frike zbrisja nga Tirana, si të isha në agoni. Do të rrija në Korçë disa ditë, do të kaloja nga Vlora dhe do të pushoja ca në Dropull. Zbutet disi mërziçja kur e ndan me njerëzit e tu.

Toka më e lehtë këtu, buzëqesh me bukuritë e veta. Makina ecën dhe gënjej shqetësimet e mia duke u dalldisur pas alternimit të beftë të peizazheve. U shuajt zymtësia nga majat e maleve dhe pemët e dendura por të parritura, ëmbëlsojnë me butësinë e gjelbër ashpërsinë ballkanase.

Pas pak çlodhja sytë e mi në hapësirën e butë e të tejdukshme të Ohrit. Bri meje u dëgjua llokoçitja e përgjumur e lopatës dhe mbushi veshët e mi zëri i drejtpërdrejtë i të zotit të barkës, me gjeste të gjera të krahëve që çanin ajrin si vet lopatat. Pogradeci, qytet i vogël, i qetë me emrin sllav, pasqyrohej me pekulie mbi ujërat e qeta të liqenit, thuajse i mbyllur në një prehje stërgjyshore.

Ik, pa ditur akoma nëse duhet t'i uroj këta njerëz për qetësinë e tyre.

U fikën ngjyrat e buta të pasdites dhe errësira fshiu distancat. E megjithatë Korça nuk duket ende gjëkund.

Zotëria i shëndoshë që rri në krahun tim, ta paguash nuk do të guxojë të pushojë së foluri. I vjen keq që i përgjigjem shumë shkurt dhe me siguri që po çuditet se si unë një njeri i thjeshtë, nuk e quaj për nder që bisedoj me surratin e tij të veshur mirë.

– Zotëri, - më thotë në fund, - mirë të gjitha po ne jemi të tjerë njerëz. Këtej e tutje bota është e kulturuar, fryn tjetër erë. Greqia, e sheh, që është kaq afër nesh, pastaj kurbeti në vende të civilizuar....

Priti për të vlerësuar përshtypjen që më bënë fjalët e tij, të cilat i konsideronte aq të mençura dhe vazhdoi i sigurt për epërsinë e tij:

- Ju, zotëri, pa lë të dinit dhe greqisht.
- Nuk kam ide.
- Sigurisht, përderisa nuk dini... Jemi tjetër botë ne këtu poshtë.

Nuk ishte e vështirë për të kuptuar se ku donte të dilte. E trembnin vetë ndjenjat e tij.

Dritat e qytetit zgjuan indiferencën tonë. Brenda meje u krijua një ngrohtësi, edhe pse Korça ishte kaq larg. Në shkretëtirën e pafund fushore ndienin pranë frymëmarrjen e qytetit. Është shumë vonë dhe disiplinoj kureshtjen për ditën tjetër.

I zoti me greqishten e tij më uroi i gëzuar natën e mirë, se do të



shkonte të shtrihej në krah të trupit të ngrohtë të gruas së tij të re. Çfarë pretendimi... Dhe mua të më presë një krevat i ftohtë në hotel, siç priti dje dikë tjetër, ashtu siç do të pres nesër një të tretë.

– Më quajnë Petro, - më thotë zotëria i ushqyer mirë, - nesër kam emrin, të pres me gruan time në shtëpi. Rruga “Grameno”, nr. 4 ... Të vish.

I vuri kështu vulë kulturës së tij.

Të zgjohesh në mëngjes në një qytet të panjohur. Verbim i vërtetë sapo hap dritaren. Dhe të jetë kaq i ëmbël dielli vjeshtak. Afrohem që të bindem edhe unë se ky qytet ka një shpirt të veçantë plot lëvizje.

Flas si poet sot.

Futem nëpër sokakë. Falënderoj vashëzën e bukur që më fali shikimin nga dritarja gjysmë e hapur, gruan e pjekur që harroi të hapura gjokset e pabindura. Një çarçaf tejet i pastër lëshoi deri poshtë djersë femërore. Diçka nga dehja trupore, poshtë sqetullës së femrës. I jam mirënjohës akoma edhe çunakut që vazhdon lojën e tij të djeshme, aty në rrugë pa dyshuar për asgjë.

E harrova totalisht luftën, njoftimet e fryra të Romës, pushtimet e Hitlerit. Sa e pakuptimtë edhe kjo gjakderdhja e re. Është kaq e ëmbël jeta....

U gjenda te dera e zotit Petro. Nuk munda të kuptoj si ia dola, përderisa nuk i kërkova askujt të më drejtojë.

Një sallon i hijshëm, një shtëpi e bukur dhe një grua, bukuria e secilës e stolis akoma më shumë. Ka të drejtë ky zotëria të gëzohet.

Flasin për shumë kohë me vizitorët e tyre dhe mua më harruan fare. Ndiej siklet në këtë situatë dhe provoj të ik. Në një moment zonja e bukur e ktheu bisedën rreth politikës. Atëherë e kuptoi se kishte pranë një të panjohur. Më hodhi një shikim të dyshimtë e të frikësuar dhe vazhdoi bisedën greqisht:

- Italia do t'i shpallë luftë Greqisë.
- Është e tmerrshme, - iu përgjigj mikja e saj
- Kush e thotë, - plotëson Petroja. - Grekët do të luftojnë Dhe do t'i mundin italianët.

Ky mendim ishte akoma shumë i hershëm. Më vjen shumë keq që zotin Petro nuk e marrin seriozisht. Diskutimi ndizej. Kërkonin edhe mendim tjetër për të kënaqur secila palë bindjet e veta. Zonja kthehet nga unë:

- Ju besoni se do të mundet Greqia?
- Nuk e di, por grekët luftojnë, nuk i nënshtrohen robërisë.

Zonja më shikonte sikur të kishte përpara një kafshë të çuditshme. Mendimi im, jam i sigurt, nuk i bëri asnjë përshtypje. Por ajo greqishtja ime e kulluar nuk besonte se doli nga goja ime. Zotëria i shëndoshë u hutua krejt. Lëvizën karriget dhe u kthyen të gjithë nga unë.

Pas një heshtjeje të shkurtër zonja e bukur huazonte shqetësimin e shoqërisë së saj për ta shprehur vetë në mënyrë disi të menjëhershme:

- Jeni grek?

Qesha vetëm pa u përgjigjur. Nuk e di çfarë rëndësie kishte nëse isha turk. Dhe përderisa kujtoi se më mungonte kuraja, vazhdoi :

- Vini për herë të parë në Korçë? E dini ne këtu jemi.... Nuk them, sigurisht, jo të gjithë. Njerëzit u kthyen, shikon. Të rinjtë sidomos. Kaluan kaq vjet që jemi... në Shqipëri.

U dhashë me maturi përgjigje kureshtjeve të shoqërisë së tyre dhe u largova.

- Do të gëzohemi shumë po të mos harrosh shtëpinë tonë. Je toni...

Dëgjoja me emocion të varfër fjalët e fundit të zonjës së bukur, pa mundur të shpëtoja nga mendimet dinake burrërore që më nxiti plastika e trupit të saj.

Për të gjitha të tjerat do të dëshiroja të mos lëkundesha në

kundërshtimet! Por nuk ishte edhe kaq e lehtë. Në shumë shtëpi dëgjova të pastër gjuhën greke dhe jashtë rrallë më përvodhi veshi ndonjë fjalë greqisht. Natën ndiqja i robëruar serenata në gjuhën greke dhe ditën i dëgjova të përkthyer në shqip. Të besoja se natën qyteti është grek dhe ditën shqiptar? Nuk e di. Por kjo pamje e tij nuk më duket e panjohur. Qytetet nuk kanë mbi vete etninë, por siç shoh shtëpitë, rrugët, njerëzit madje edhe të Korçës, më duken kaq të njohura. Ka kaq shumë ngjyra të bukura, më shumë se të gjitha qyteteve ballkanase provinciale, mbi të cilat ndikimi grek është evident.

U largova nga Korça, por “jelekun që ti vesh” të kandatorit mbrëmësor e dëgjoj akoma brenda vetes. Pastaj ai ankthi i njerëzve që njoha, për fatin e Greqisë...

– Jemi shqiptarë, - ma plotëson mendimin miku im historiani Pepo, por për Greqinë jam gati të derdh edhe gjakun tim. Është atdheu ynë i dytë.

Nuk ishte pa të drejtë. Pirroja ishte mbret i përbashkët i të dy popujve të sotëm dhe Gjergj Kastrioti i la të bashkuar që t’i ndajë më vonë Muhameti. U bën çifligje, hynë në mes fanatizmat dhe interesat. Populli i vetëm u bë dy dhe fara e gërnjës që kultivojnë midis tyre të mëdhenjtë, mbin e bollshme deri në ditët tona. Megjithatë Greqia nuk pushoi së ushqyeri shpirtërisht Shqipërinë. Dhe gjuha greke flitet akoma edhe në sallonet turke, ashtu siç flet frëngjisht Kollonaqi...



## FUND TETORI 1940

U vrenjtën prapë sytë e mi. Brenda tyre mbeti pikturë e përjetshme hijesira e zymtë e maleve të Këlcyrës, lakuriqësia shterpe e Tepelenës. Me sa freski pasuroi etjen e shpirtit tim uji i zbritur nga malet në Vjosë, damari i kaltër i Drinos. Në fund zalli i bardhë, i lëpirë, gurë të mëdhenj që pranojnë përkëdheljen e palodhur të shkumës. Paqja pikonte fshehurazi brenda meje dhe le të kalonin kaq afër topat për frontin e ri.

Lë të mbeste, o natyrë, njeriu një nxënës i mirë i mrekullisë tende paqësore... U zbut krejtësisht shpirti im nga fusha e ngushtë e Gjirokastrës dhe pas pak përrulte shqetësimet e mia përhapja e qetë e fshatrave të Dropullit.

U zhgënjeva shpejt. Këta njerëz në shekuj të robëruar, dinin mirë të fshihnin ndjenjat e tyre. Filloi edhe këtu të nxihet rruga nga makinat dhe ushtarët. Ankthi vuri në vështirësi frymëmarrjen njerëzore. Italianët nga çasti në çast do të hyjnë në Greqi. Dhe le të jenë dhe këta këtu grekë. Në këtë rast fati u dha grekëve të këtushëm të drejtën që vetëm të shqetësohen për atdheun.

Nga Korça deri në Himarë topat italianë të armatosur presin me padurim dhe dora e ushtarit përkëdhel me një dridhje të papërcaktuar këmbëzën e pushkës.

Fshatrat greke, këto net pa shije, nuk mund të flenë. Njerëzit dalin në dritare dhe ndjekin përgatitjen e pafund luftarake, ngjallin brenda vetës stuhinë që do të shpërthejë në atdheun e tyre.

Sot erdhi Jakomoni në Gjirokastrë. Mbajti fjalim për të ngritur në këmbë njerëzit, të shkojnë për të luftuar vullnetarë. Njerëzit e thjeshtë admirojnë stolitë e tij të shumta dhe agallarët urojnë për fatin e tyre. Duartrokasin të dehur udhëheqësin e tyre të madh dhe përpiqen të nxisin

tek populli sedrën e paraardhësve.

Kishin çifligje të mëdha në Epir dhe shpresojnë tani t'i rimarrin. Disa vrapojnë vetë për në front. Të tjerë paguajnë djemtë e varfër të popullit që t'i zëvendësojnë.

– Do të të vë mbikëqyrës në çifligun tim në Janinë, i bërtiste një bej një njeriu të thjeshtë të zbathur, të cilin nuk e prekte kollaj ... tërbimi patriotik i latifondistit të etur.

Dhe vraponin njerëzit e varfër për në front, për pak para. Pastaj, truri i tyre i përgjumur nuk mund të besonte se një njëri me kaq stoli të ishte i aftë për gënjeshtër... Sa për again e tyre e dinë se ishte njëri zemërdhembshur....

Italia i premtonte Shqipërisë Janinën dhe Prevezën, derdh flori, djersë shqiptare, për të nxitur popullin në një krim të madh racor. Nuk ka nevojë për pesë shqiptarët e uritur, porse edhe në momentin e fundit i trembet zgjimit të gjakut të njëjtë nder popujt e Ballkanit ndaj dhe kërkon t'i ndajë me urrejtjen dy popujt vëllezër. Dhe ia doli. Një pjesë të popullit shqiptar e plogështoi me madhësinë e hijes së saj. Tregtarëve u mbylli gojën me para dhe tani një pjesë të vogël e hedh në luftë.

Shikoj njerëzit që më shpërblejnë me një neveri të thellë plot mjerim dhe përbuzje të paepur. Populli shqiptar me sy të verbuar, pret akoma i mpirë udhëheqësit e tij për t'i treguar rrugën.

U bënë pesëmbëdhjetë ditë tani, që topat italiane vjellin mëkatet e errëta të fashizmit mbi Epirin.

Një popull i vogël, harruar në një qoshe të Evropës, ndjek i vetmuar rrugën e lirisë së të parëve. Rrëmbente pas vetes, si furtunë e vërtetë, dobësitë njerëzore. Mbyste shpirtvogëlsinë politike dhe ngurrimet aristokratike të udhëheqësve të tij dhe shtyhej përpara, i dehur nga ndjenja për të përballuar i zbathur frontin e çeliktë. Në kohën kur e gjithë Evropa heshte e turpëruar, ose i lutej me tmerr pushtuesit.

Italianët e plagosur mbushën spitalet dhe ai Kalibaki i djallosur nuk ka ndërmend të bjerë. Vajtën kaq ditë dhe Kallamas ia kaloi shumë këtë vit Misisipit.

Të shkelin kështjellën e shpirtit grek. Nuk kërkojnë shumë. Vetëm që do t'u kushtojë shumë bindja se nuk lufton hekuri, por shpirti krenar.

Në Korçë hyri dje ushtria greke. Ora e Gjirokastrës është e afërt. Ky popull i vogël shpërndan shpresat e para në Evropën e përgjumur.

Sot në mëngjes zbrita me diellin bashkë në fushë. Vërshëllej një melodi luftarake, që ma imponon në mënyrë të jashtëzakonshme atmosfera, që krijoi me kaq thjeshtësi ushtari grek. Duhet të jem i gëzuar. Një ngrohtësi e lehtë kërkon fole brenda meje.

Për një moment sytë e mi takuan një grumbull pa fund njerëzish, që me zyrtësinë e tyre bënin pis pamjen e qeshur të rrugës. Bej tutje me devocion të shtirur dhe ndjek lëvizjet e padisiplinuara të ushtarëve italianë. Suret të parruar, që i shteroi frika e vdekjes, sy të nënshtruar në mërzinë e thellë, duar e këmbë të robëruar nga dridhja e rrezikut. Pushkët të thyera në shpinën e përlulur, mitraloza bosh, që i mban pa oreks një dorë e huaj. Vë bast se pak me tutje do të platiten në tokë.

Për orë të tëra vështroj këtë botë pa shpirt, pa pasur fuqinë të gëzohem për këtë katandi njerëzore.

Krahina jonë ka disa ditë që është çliruar. Fshatrat tona priten me mirënjohje të thellë fytyra të djegura e të thara në diell të vëllezërve tanë. Njerëzit rrethojnë fituesit me ngurrim të justifikuar. Janë këta njerëz të pakët që bëjnë kaq çudira në aq pak ditë?

Krenohem sot me admirimin e shqiptarëve. Rrethojnë ushtarët grek dhe i kundrojnë si fenomene jashtëtokësor. Përkëdhelin pushkët e tyre dhe përpiqen të dëbojnë nga vetja edhe ngurrimet e fundit.

Të mëdhenjtë e tyre u fshehën nga mërzitja në shtëpi. Nuk është gjë e thjeshtë të ngresh kaq ëndrra dhe tani të dridhesh se mos të marrin

edhe çifligjet e fundit që të mbeten, trashëgimi private e allahut...

Por shqiptari i zbathur, pa vënë në dyshim farefisninë që e lidh me ushtarin grek, nuk ka asnjë lidhje me ndjenjat nacionaliste monolite të beut, të cilat kurrë nuk mund t'i ndajë nga interesat e privileguara të paligjshme.

– T'u pish dollinë, më thoshte dje Nuredini me pamjen e zakonshme të dinakërisë labe. Djem me zëmër të madhe . Pa le sjellja e tyre ... T'u lutesh, miku im. Kalojnë vajzat tona bri tyre dhe ata mblidhen, se mos prekin fustanin e tyre . Për atë Allah, punë e madhe.

E shikoja me dyshim për të vërtetuar sinqeritetin e tij.

Admironte ushtrinë greke me inferioritetin e fajtorit.



## ZMERT FASHIZMA<sup>5</sup>

*Pranverë 1943*

Liri. Fjalë e thjeshtë, por sa gjak duhet që të arrish në limeret e saj të pashkelura. Dhe bota ballkanase e pagoi tepër shtrenjtë në histori, pa arritur kurrë përqaftimin e saj. Në momentet e fundit ia rrëmbenin nga duart e saj të plagosura të mëdhenjtë dhe përpiqeshin t'ia zëvendësonin me shtrigën binjake, robërinë. Por ky popull nuk dallohet fare për fisnikëri të tilla. Fle me pushkën nën jastek. Është parmenda e tij e dytë. Një dorë e ka për fushën, tjetrën për malin. Sa për rrugën ia mësoi i ati. Për trashëgimi i la vetëm një amanet:

– Do të marrësh çdo mëngjes rrugën për në arë. Nëse ta bëjnë jetën të vështirë afendikonjtë e mallkuar, merr rrugën tjetër, atë për në limer.

Nuk e di në shtoi diçka tjetër kur vdiq Gjergj Kastrioti, Kollokotroni, ose Karageorgji.

Brenda meje jepte shpirt edhe ngurrimi i fundit. Të rrish me duar të kryqëzuara, në kohën kur u zgjua gjithë bota, duhet të mos kesh fare shpirt, për të mos ndierë poshtërimin që të ofron pasiviteti yt.

Mbeta për pak ditë në Tiranë. Qyteti e mori totalisht veten. Njerëzit fituan një seriozitet të çuditshëm. Një fytyrë e ndritshme dhe e gëzuar është bosh në mendime dhe ndjenja. Një fytyrë e rrudhosur me vetulla të bashkuara fsheh një gjallëri produktive dhe mbart mbi vete gjithë peshën e epokës së tij.

Ganiu e pushkatuan vjet italianët. Herën e parë e zunë tek organizonte një grup, i cili do të vepronte në prapavijën e italianëve, kur këta u dislokuan në Tepelenë. E burgosën vetëm për një vit. Të dytën nuk shpëtoi. Me dy miq të tij transportonte pushkë për partizanët jashtë qytetit.

---

<sup>5</sup> Vdekje fashizmit, parulla e partizanëve Jugosllavë.

Më duket e pabesueshme. Ky njeri që mbarte një mentalitet kaq lindor, arriti të lehtësohet nga mpirja e tij dhe të fitojë kaq dinamizëm.

Kujtoj akoma fjalët e tij:

– Kështu siç e nisëm nuk do të vonojnë burgjet të mbushen me patriotë.

Muajin e kaluar në qendrën e qytetit u bë betejë e vertetë. Rreth njëzet karabinierë u ndeshen me tre komunistë shkodranë. Komunistët vranë me bombë dore katër italianë, të cilët kur e panë pisk u futën nëpër sokaëe. Arritën edhe karabinierë të tjerë dhe rrethuan gjithë lagjen. Një tank hapte rrugën dhe ata kontrollonin shtëpitë. Partizanët u hodhën jashtë. Njëri u fut brenda tankut, vrau shoferin dhe në momentin që shokët e tij binin të vrarë, ai vetë u bë copë nga një granatë.

Populli i qau, siç u takon, të tre djemt e tij, ndërsa qeveria fashiste shqiptare nënshkruante me zemër të lehtë dhe dënime të reja ndaj luftëtarëve të tjerë.

Dje, prapë në rrugën më kryesore një partizan vrau në sy të turmës së njerëzve të së dielës një fashist shqiptar me gradën e kolonelit. Populli në mënyrë të heshtur fshehu brenda vetes patirotin e guximshëm dhe policia, nëse nuk do të binte Italia, do të kërkonte ende për ta zbuluar.

Mikroemocionet e qytetarit të qetë u mënjanuan përfundimisht nga dehja kryengritëse e brezit të ri. Nëpunësi numëron orët në zyrë i trembur se mos humbet rehatinë e thjeshtë familjare; buzëqeshjen e gruas; mikroegoizmin e krijuesit të zakonshëm sa herë shikon fëmijën e vet. Tregtari, nga ana tjetër, do të vdesë nëse ndahet nga kënaqësia që i jep arka e fryrë. Ndjek me tmerr veprimet e rrezikshme të rinisë dhe nuk mund ta honepsë, se si mund të martohet me luftën pa interes.

Malet u stolisën sërishmi me hijen krenare të komiteve të reja të partizanëve. Pushka rëndon në shpinën e tyre në misionin e madh të çlirimtarit. Pushtuesi ndien kudo rrezikun e pranisë së tij të pagjumë.

Rrëpirat ballkanase mbarsin brenda vetes oshëtimën e kryengritësit. Pllajat dhe fushat, së bashku me këngët, mirëpresin me prestigj harmoninë e pa fre të betejave për liri.

Përshendesja atë pasdite vere Shkodrën me shpirt të penduar. Sokakët e varfër nën hijen e majme të tregtarit provokonin udhëtarin e vjetër të ndërronte mendim. Këtu u vra një luftëtar, pak me tutje u var një tjetër. Brenda tyre mbanin një krenari të heshur, diçka akoma, që nuk ndryshonte nga shenjtëria.

Sa ka ndryshuar qyteti dhe le të ketë të njëjtat shtëpi, të njëjtat rrugë. Brezi i ri shplante mëkatet e vjetra dhe Shkodra fitonte freskinë e ëndrrës së re.

Jam kalimtar dhe udhëtimi i gjatë nuk më jep të drejtën të çlodh mendimet e mia në kujtimet e vjetra. Kërkojnë dhe kujtimet të drejtat e tyre, megjithëse ashpërsia e kryengritësit përpiqet t'i zbojë.

Kosova është e pafund. Këtu male të murmë, atje fusha pjellore pa mbarim. Dhe një popull që vuan nga mëkati i politikës së paqëndrueshme. Grua gjokszbuluar me trup të gërvishtur, dorëzuar në pasione të lira, me kënaqësi të çoroditura, që nuk kërkojnë djersë. Leshrat e saj varen të trazuara në trupin lakuriq, sytë të skuqur nga pagjumësia. Sapo u çua nga krevati i paligjshëm.

Kur hyri Italia përqafoi popullin, i fali puthjen e diplomacisë së errët dhe i turpëroi dorën me shpatën vrastare. E frymëzoi me entuziazmin e lirë të premtimeve të mëdha dhe e nxiti të vrasë jugosllavin zinxhirlidhur. Dhe gjakun që u derdh nuk e lan hakmarrja njerëzore.

Po gdhinte kështu një mëngjes me nënshtetesi shqiptaroitaliane, ngarkuar me përgëzime fashiste.

Para meje Kosova. Ndihehesh i përlurur nga kjo shkreti tinzare. Shoferi nxiton të arrijmë pa u errur në Prizren.

– Nuk e di se ç'mund të të gjejë në këtë vend të panjohur, murmurit

për të justifikuar kthesat e menjëhershme.

Ka të drejtë. Serbët, ata që shpëtuan, morën malet. Dhe shqiptarët kosovarë me praninë e ligjshme të italianëve, i ndjekin që t'i zhdukun. Vrasësi mbart pas shpine hijen e hakmarrjes.

Dielli i sëmurë humbiste pas nesh kur po hynim në qytet. Siluetat e lodhura të pemëve të plakura, që lëshonin të dembelosura degët e tyre jashtë oborreve të varfra, pikonin brenda nesh raskapitjen dhe shpërndanin në atmosferë pamjen e tyre të ankueshme. Këtu- atje plepi dhe qiparizi bashkë me pamjen e pasigurt e të dobët të minareve plotësonin ndjenjën e shkretisë.

Një moskokëçarje e rrezikshme përpiqej të rrënjosej brenda meje. Nuk kisha fuqinë për asnjë vendim. Shoferi, që fitova pa u rrëfyer miqësinë e tij, kërkoi të më çlironte nga kjo ndjenjë:

- Diku do ta kalojmë sonte.

Dhe ec përpara me vendosmërinë e njeriut që shkon të kryejë një premtim. Shtëpitë nuk shpëtojnë nga misticizmi lindor i të zotit fanatik. Sokakët kopjuan me besnikëri tinzerinë e rrugëve të ngushta të Mekës dhe ato pak godina moderne tregonin gjithë dobësinë e civilizimit evropian para këmbunguljes orientale.

Hymë dhëlpërisht në një bar.

- Këtu do të të mbushet shpirti me krenari, - murmuriste shoferi në drejtimin tim. - Nuk janë popull i vogël jugosllavët...

Kur po hynte në barin e vetmuar shoferi im më dukej tjetër njeri. Këtu brenda fitonte vetveten

Një vajzë bionde, sapo pa shoferin, erdhi e gëzuar pranë nesh. E mori nga dora dhe na tërhoqi në një tavolinë të mënjanuar. Më dha me besim dorën e saj të djathtë:

- Më quajnë Bazilika.

I thashë emrin tim dhe heshta. U kthye nga miku im dhe diçka i

tha në gjuhën e saj. Pastaj u kthye e gjitha nga mua gjithë qejf:

- Bravo, tavarish. Vdekje fashizmit!
- Liria e popullit!

Ndieja një emocion të çuditshëm nga vetë fjalët e mia. Për pak nuk do të njihja veten.

Në anët tona të keni besim, - më thotë pas pak sikur të ishte e detyruar të hapte bisedë me mua. - Titoja, me gjithë popullin tonë na mbështetin.

Admiroja të renë me atë besim të patundur të kryengritëses. Eshtë e detyruar të punojë dhe argëton njerëzit me zërin e saj. Por nuk harron për asnjë çast atdheun e pushtuar.

– Sonte nuk duhet të flini në hotel. Askush nuk e di se ç'mund t'ju ndodhë. Jemi akoma të skllavëruar. Do të shkoni në shtëpitë e tanëve. Këto anë janë plot me spiunë. Fshih me mjeshtri ndjenjat e tua, shok. Por duhet të punojmë që të shkurtohet durimi ynë.

Qetësoi disi veten dhe mori për nga orkestra. E kërkonin të vazhdonte punën.

- Do të kthehem shpejt- na thotë me nxitim sikur kërkonte të falur. E shoqëruan sytë tanë gjithë admirim.

– Atdheu ynë do t'i ketë shumë borxhe kësaj vajze të thjeshtë,- shton miku im për të shmangur ndoshta kureshtjen time.

Bari gjysmë i fshehtë u mbush me njerëz. Bazilika, me një freski të habitshme, këndonte me qejf të pasosur. Këngët e saj popullore tërhiqnin nga dora shpirtin tim në vallëzimin e tyre nostalgjik. Vajza, edhe pse e dehnin duartrokitjet e shumta, nuk na harroi për asnjë çast me vështrimet e saj.

Ndaloi dhe na erdhi në tavolinë.

– Çohuni, - na thotë. - Do të kërcëjmë sonte. Të gjithë këta që shikoni janë djem tanë. Popujt midis tyre janë vëllezër. Dhe në jeni nga

vend tjetër, nuk jeni i huaj në atdheun tonë.

Na zuri nga dora. Miku im nuk kundërshtoi. Unë këmbëngula. Nuk i ndahesha karriges time.

– Mos më turpëro, Bazilika. Nuk ua kam idenë këtyre valleve.

– Do valle shqiptare, shovinist, - më thotë për të më çarmatosur edhe nga justifikimi i vetëm që më mbetej.

Buzëqeshja në këto momente më takonte e tëra mua. Edhe këtë herë luftëtarja tërhiqej në dinakërinë e gruas së pjekur.

– Ato i di më pak.

Sytë e vajzës kërkonin një shpjegim.

– Është e vërtetë, nuk gënjen. Miku im nuk është nga Shqipëria. Nëse di greqisht të kërcesh me të, do ta kënaqësh shumë sonte, - plotësoi shoferi im.

– Je grek? – murmuriti me kureshtje e reja.

Më shikonte me habi të pazakontë. Duart e saj u lëshuan dhe sytë me lëvizjen e tyre energjike dhe çapkëne njëkohësisht u ngulën mbi mua. Dhe përseriti me të njëjtën habi.

– Grek!...

Shikimi i saj më përkëdhelte të gjithin. Të them të vërtetën u turpërova. Nuk e dija ç'qëndrim të mbaja që të mos e humbisja seriozitetin e burrit. U bëra pishman për të gjithë këtë potere që shkaktoi emri i dëgjuar i atdheut tim. E ndieja veten shumë të vogël për ta përfaqësuar denjësisht. Isha i sigurt që fytyra m'u skuq.

– Je i pari djalë që shoh nga ai vend. Nuk di shumë gjëra, por po të isha greke, e kuptoj se do të isha krenare.

U përpoqa të zbusja atmosferën legjendare që krijonte admirimi i pamatë i saj. Madje dhe për fisnikëri. Por si mund të fshihja vlerësimin e thellë për popullin që kisha përpara ?

– Njerëz janë edhe ata, - i them. - Shumë njerëz të thjeshtë. Luftuan,

vërtet, sa edhe vetë nuk e prisnin, sa di të luftojë ky popull në të gjithë historinë e vet. Tejkaloan edhe veten, do të thoshja. Dhe këtë herë luftuan për gjithë botën. Por edhe ju, nuk është gjë e pakët kjo që bëni sot.

– Po, është e vogël se luftojmë vetëm për Jugosllavinë. Në kohën që derdhte gjakun populli juaj, popujt e tjerë të Ballkanit hodhën armët të përlurur, të tradhtuar nga afendikonjtë e tyre. Dhe Greqia ata i mundi. Dhe Greqia në këto momente vazhdon të njëjtën luftë. Jemi të turpëruar para saj. Më beso, ne jugosllavët zilepsim krenarinë që stolis popullin tuaj. Është nder për Ballkanin të na konsideroni vëllezër.

Ziente e tëra. Kjo vajzë e varfër kishte kaq pasuri brenda vetës. Privimet dhe puna modeste nuk kanë zbehur aspak krenarinë e saj malore.

Përpiqem me takt të ndërroj bisedën. Nuk më shkon një prestigj kaq i madh.

– Dëgjuat ndonjë të re sot ?

– Kurajë, shok, të gjitha shkojnë mirë. Aleatët u hodhën në Itali. Populli rus i vuri para gjermanët. Në malet dhe qytetet tuaja betejat janë pa mbarim. Mos më kërko hollësi se nuk di as edhe një fjalë greqisht.

– Po andartët tuaj?

– Dhe ne diçka po bëjmë. Vetë Titoja është jashtë Fiumës<sup>6</sup>. Forca të tjera nga tonat spastrojnë gjithë Dalmacinë. Është edhe ai Mihailloviçi. Sapo iu sosën lirat angleze, filloi me miqësitë gjermane.

Nuk mbaj mend ç’thoshim tjetër konkretisht të ulur në tavolinë. Ishte shumë vonë dhe i bëra me shenjë mikut për t’u larguar.

– Mos u nxitoni. Rrini edhe pak akoma dhe do të ikim së bashku. Nëse nuk ke kundërshtim miku im, sonte do të fleg në shtëpinë time, -shtoi vajza.

U çua me nxitim për të mbaruar numrin e saj. Tavolinat kthyen kokën për të parë shtatin e saj të derdhur. Përveç pamjes tërheqëse të

---

<sup>6</sup>Rjeka e sotme

njëzet viteve, ruante një gjallëri që i dhuronte një bukuri, që s'kishte të bënte fare me linjat e lodhura klasike të harmonisë.

- Këngën e lirisë, Bazilika, këngën e lirisë!

Njërëzit bërtisnin me ngulm duke duartrokitur. Një heshtje e rrezikshme u përhap mbi krerët tona. E reja lëkundej në ngurrimin e saj. Ishte shumë e tepërt ajo që i kërkonin. Dhe njerëzit këmbëngulnin për ta bindur:

- Lirinë! Lirinë!

Vajza shikonte përreth e trembur. Me një vështrim mori pëlqimin e të zotit të dyqanit dhe me një mallëngjim të dridhshëm filloi këngën e ndaluar.

Ishte sakrileg të dëgjohej gjë tjetër nga zëri i saj.

Dhe njerëzia e dëgjonte, e ndiente, e thithte me devocion.

***Liri, robëria na shtoi mallin,  
Barbarët na shkelën shpirtin;  
Netët me beteja i mbushim,  
Me gjak robërinë do mundim...***

Gruaja humbiste krejt nga sytë tanë. Në zërin e saj të thellë, që na rrethonte me patos të papërmbajtur, ndieja shpirtin e një populli të tërë. Dobësitë njerëzore në këto momente tërhiqeshin të turpëruara.

Zëri i Bazilikës u ndërpre papritur. Tri të shtëna pistolete e shtrinë në dërrasat e pluhurosura. Kthyem kokën për të parë. Një spiun i policisë italiane sapo nxori suratin te porta, humbi me nxitim në errësirën e natës. Një grup i madh njerëzish u sulën pas tij. Brenda gjëmonin zërat e njerëzve nga mania e shenjtë e hakmarrjes. Përqaftuan vajzën dhe u nisën për në shtëpinë e saj.

- Nuk do t'ia hedhë qeni, - më tha miku im i skuqur i tëri.



Shpirti m'u mbush sot më pamjen e vajzës së vvarë.

Do ta varrosnin pasdite. Në mëngjes u çova i tronditur. Qortova veten që për pak desh e harrova.

Duhet të ikim shpejt për në Pejë. Të na falësh Bazilika. Të takonin kaq pak lule nga një njeri, që përfaqëson aq varfërisht një popull, që admirove me çiltërsinë e shpirtit tend.

Spiunin e zhdukën po atë natë. Lëkura e tij e lirë, sigurisht që nuk mund të shpaguajë vrasjen e një luftëtari.

– Kanë borxhe edhe të tjerë, - më thotë shoferi me zëmërimin e djeshëm. -Djemtë e popullit dinë mirë t'i lajnë hesapet. Atdheu i ka aq borxhe kësaj vajze të thjeshtë.

Qyteti, tani që po e lemë pas, nuk ka asnjë shije. Rruga e shkretë përpara duket se na priste prej kohësh. Të tremb kjo heshtje e ashpër.

Aty- këtu ndonjë fshat fshihet i trembur nëpër pllajrat dhe shtëpitë duket sikur duan t'i shmangen ashpërsisë veriore nën pëmët e plakura. Malet me gjithë mbulesën e blertë të tyre nuk humbasin asgjë nga zymtësia primitive. Dhe të jetë kaq larg stacioni yt dhe të jesh i detyruar me një mërzitje të tillë të pranosh gjithë peshën e natyrës së ashpër.

Vonë natën arrijmë në Pejë. Një karabinier italian na pret hovin.

- Dokumentet.
  - Miku im i jep lejën e tij dhe unë një shënim provizor të një firme tregtare.
  - Çfarë do të bëni ju në qytet, - më pyet me qëllim verifikimi.
  - Do të blej.
  - Dhe çfarë ka Peja?
  - Borë, - i thotë shoferi me seriozitet të rrezikshëm.
  - Italiani qeshi me ironinë e guximshme dhe na la të iknim.
  - Pulë deti, - më thotë miku im i kënaqur.
- Një qytet nuk i mohon asgjë të huajit në orët e natës, por ramë

dakort që edhe sot të mos largojmë nga mendja jonë Bazilikën.

Fjeta shpejt. Në mëngjes kemi prapë rrugë.

U lodh syri im nga ferexhetë. Qyteti është i vogël dhe nuk më tërheqin fare të fshehtat e tij. Fanatizmi mysliman, nga ana tjetër, zbraps mendimet dinake para se ato të lindin.

Do të kthehem në Shkodër.

Udhëtoj më shqetësime të reja për në Dalmaci. Është vështirë t'i shmangesh ndikimit të namit që të imponon tradita. Brigjet dalmate kanë fituar vendin e ëndrrës brenda meje. Nëse, sigurisht, isha një nga dembelët pa kripë, të cilët fisnikëria shoqërore i strehon në fjalën turistë, do të vilja me moskokëçarjen aristokratike, (aromë e panjohur kjo në dëshirat e mia bredharake), të gjitha njohuritë gjeografike dhe kështu nuk do të më mbeste asgjë për të kundruar.

Vazhdoj prapë rrugën time i zhytur në padituri. Makina ngjitet me vështirësi në Tarabosh, mal i Shkodrës, që ndan Shqipërinë nga Jugosllavia. Ndiej të më ëmbëlsojë një egoizëm teksa po kaloja me kaq lehtësi kufijtë, me të cilët njeriu ndoti barazinë e natyrës. Më duket sikur hakmerrem për këtë shpirtvogëlsi pa kuptim.

Mali nuk ka asnjë shenjë dalluese kombësie. Lakuriq, siç është, irinozon mjerimin njerëzor.

Zotërinë që rri pranë meje, me tri - katër valixhe, të lidhura mbi autobus, duket se e shqetëson shumë heshtja.

– Më falni, zotëri, nuk ju pyeta, telegrafuat t'ju mbajnë vend në hotel?

Se, e dini, është shumë vështirë të gjeni në këtë kohë.

– A, jo, jo akoma, - iu përgjigja, pa ditur se çfarë duhej të thoshja.

– Ku do rrini?

– Nuk e mendova.

Më pa me mëshirë. Isha një njeri që nuk telegrafoi për hotel. Dhe

nuk mund ta honepste. Përpiqej të krijonte një ide sa më të qartë për mua. Por, këtë të drejtë nuk ia lejoja dhe kështu ofronte për mua mëshirën. Gjëja më e thjeshtë për raste të tilla, se varet provizore në buzët e çdo të ushqyeri mirë.

Nën këmbët tona liqeni i Shkodrës. Në palëvizshmërinë e vet, e humbet krejt pamjen e bishës së lëngët të zemëruar. Një zbulurim i thjeshtë prej qelqi i natyrës, që e nënshtron në kapriçot e veta Taraboshi krenar.

Ndiej përpjekjen e heshtur për mbijetesën e elementeve të natyrës. Më duket kaq qesharak roli metafizik, që përpriqet të marrë njeriu si ngushëllim për dobësinë e tij përballë tyre.

Një zog i rëndë nate rrëshqiti bri nesh dhe në pëllëmbët e mia ndiej butësinë e freskuar të puplave të barkut të tij.

Tani e kam radhën unë të mëshiroj apatinë e zotërisë në krahun tim, të cilin as që e mundon fare prania e kaq shpirttrave jashtë egoizmit të vet.

Doli në rrugë ajri i rëndë i detit të na takojë. Dhe është kaq larg hapësira e tij nga sytë tanë.

Ulqini. Asnjë verbim, asnjë zbulim. Një fshat shumë i madh me shtëpi të varfëra e të ngjeshura njëri pas tjetrit. Dhe shtrirja kurnace e detit para tij, ngushton në mënyrë të pakëndshme shpirtin e etur. Dy shkëmbinj të thepisur, si dy krahë prej çeliku, ndajnë me dysh dhe me zili bukurinë e qytetit.

Pluhuri i dendur i rrugës dhe vapa e gushtit, që u ul këmbëkryq mbi çati, gërvisht pafundësisht në mendjen tënde vlerën e një gotë uji të freskët.

Djemtë e zbathur në rrugë argëtojnë urinë me lodra. Jam i sigurt se zotëria i trashë nuk mund të kuptojë... këto liri shoqërore, të cilat nuk kufizojnë një shëmtirë kaq të madhe turistike. Në këtë pamje mallëngjyese

tharton pa kuptim suratin e vet. Ndërkohë është e pamundur t'i zbusë oreksin për gjellën, që përgatitet prej orësh për barkun e dhjamur të tij.

“Ko-op”-i, një vepër e hijshme arkitektonike arti, është mbërthyer mrekullisht në shkallaret e shkëmbit të majtë. Të jep kështu përshtypjen e një bukurie që rri pezull ëmbëlsisht. Dhe thonë turistët, që kam pranë, se është një nga hotelet më të mira të Ballkanit. Kënaqem me ç'shoh, perderisa mosdija më ndalon krahasimet skolastike.

Me dritaren e mëngjesit hapet edhe shpirti im te kaltersia e zbehtë e sipërfaqes së detit. Dhomën time nuk e prisja kurrë më të mirë. Është e varfër mendja ime për të patur përshtypje luksoze. Dal në taracën e vogël dhe provoj rezistencën time në ndjesinë e humnerës, që më tremb posht këmbëve.

Në drekë ose pasdite harrohem në prehërin e detit. Krahasoj veten lakuriq me trupin e deformuar të zotërisë trashalug. Nëse nuk do ta tallte njerëzia, nuk do të hiqte asnjëherë nga trupi kostumin e tij më të mirë, as sahatin me zinxhirin e floringjtë.

Hapet rruga prapë para meje. Nuk kërkoj asnjë informacion për Kotorrin. Le të më gjejë të papërgatitur qyteti i radhës, lë ta gjej nul për nga tradita.

Kur ikja nga hoteli në Ulqin, kamarierja jugosllave kënaqte kureshtjet e mia të fundit për atdheun e saj.

– Eshtë e vërtetë, - më thotë. - Vështirë është të gjesh në qytete dhe në fshatra burra të rinj. Shumë janë të internuar në Gjermani, të tjerë vëshken nga marazi nëpër burgje dhe më të shumtit morën malet.

Ndaloi për pak, aq sa e lejoi një frymëmarrje e thellë dhe vazhdoi me një hidhërim, që s'kishte të bënte asgjë me pesimizmin.

– Vëllai im nuk e di nëse do të kthehet nga Gjermania. I fejuari im është lart me Titon. Vajtën dy vjet tani që nuk e shoh as atë. Anët tona i mban Mihailloviçi dhe është e rrezikshme po të hyjë në qytet.

- Dhe ti?
- Uroj më të mirën për atdheun.

Sado që të përpiqet, nuk mund të fshehë veten. I jap dorën dhe murmuris, aq sa duhet për ta dëgjuar.

- Zmert fashizma, tavarisha.
- Slloboda Naroda, tavarish

Përgjigja e saj dukej se rrinte e gatshme, por e mbrojtur në gjuhën e saj. Ndiej se nga prapa më ndjekin me simpati sytë e saj.

Përzieja brenda vetes kontrastet e stërpjekura të botës së vjetër. Të kenë kaq këmbëngulje të mbahen në këmbë, me gjithë sëmundjen e pashërueshme të tyre... E mistershme. Nga ana tjetër, të jetë kaq e shndritshme bota e re që po vjen. Të mos duan akoma njerëzit ta ndiejnë.

Makina çan me paturpësi qetësinë verore të drekës. Përbri nesh, Dalmacia provokon shikimin me tantellat e saj të kaltra. Sa barbare m'u duk zëri i andartit, që preu rrugën tonë me paraqitjen e tij të kërrusur:

- Alt !

Pushka e tij e rëndë i imponon shpirtit tonë paqësor një heshtje metalike. E ndjekim pa folur.

- Eshtë i Mihailloviçit, - pëshpëriti shoferi pranë meje.

Marrim të përpjetën e një kodre dhe ndaluam para një shtëpie të vjetër e të vetmuar.

- Këtu brenda, - na thotë menjëherë andarti.

Roja u mënjanua nga dera dhe ne u ngjitëm në një shkallë të qelbur. Pritëm pak dhe na futën në zyrën provizore të komandantit. Një oficer pa musteqe diçka i pëshpëriti eprorit. Mjekra e dendur e gjeneralit të shëndoshë buzëqeshte me dinakëri së bashku me sytë e vegjël e të errët të tij.

U çua dhe na dha dorën e dhjamur.

- Zmert fashizma, tavarish.

Shikoja bashkudhëtarin tim me ankth. Kisha frikë se mos goja e tij nxitonte në momentin e fundit. Shoferi gjeti rastin gjatë rrugës dhe na mësoi hiletë e tyre.

– Kini kujdes, do të tentojnë të na mashtrojnë.

Gjenerali nuk merr asnjë përgjigje. Na kërkon së fundmi pasaportat.

– Je grek? – më pyeti, duke u kthyer nga unë me simpati të arnuar dhe pa pritur përgjigje vazhdoi:

– Ç'bëhet në atdheun tend ? Gjetet belanë dhe ju me atë ELLAS-in?

– Nuk ngatërrohem me ata komandant. Nuk kam ide.

– Mos u mërzitni... nuk do të shpëtojnë miqtë tanë.

Kur po zbritnim bregut na shoqëron një lehtësim i madh. Fitonim sërishmi lirinë tonë të kursyer.

Rrëshqitja nga kjo peripeci e rrezikshme, pa rezervuar asgjë në memorien time me përjashtim të yjeve të gjeneralit dhe apatinë e praruar lindore. Për shumë ditë kisha ndiesinë se në dorën time të djathtë kishte mbetur dora e tij e majme.

Pardje u riktheva në Tiranë. Me kot përpqeshin bukuritë e Kotorrit të mashtronin sytë e mi. Kontrastet shoqërore forconin më shumë dehjen kryengritëse, që përqafoi në këtë kohë gjithë Ballkanin. Nga ana tjetër, si të harrosh vilën e mbretit të Anglisë? Hapet dhjetë ditë në vit për të çlodhur të zotin e saj të përzgjedhur. Një tjetër në rivierën franceze, një tjetër ndoshta në Kapri, në brigjet spanjolle. Luajnë të tëra rolin e njëjtë aristokratik. Në një kohë që njeriu përpiqet për vite me radhë për të ndërtuar një kasolle.

Partizanët e rrethuan fort kryeqytetin e Shqipërisë. Ndiën kaq afër frymëmarrjen e tyre. Në male lufta fitoi natyrën e vjetër legjendare.

Italia ra e lodhur nga mëkatet që mbarte për vite në kurriz. Pak

ushtarë të shpërndarë në qytet, çarmatosin mekanikisht mbeturinat e perandorisë italiane. Bënin rezil aleatët e vjetër në sytë e botës. Ruaj akoma pamjen ankuese të kolonelit plak alpin, të cilit mu te sheshi i shqyente gradat një ushtar gjerman.

Mercenarët shqiptarë pranonin përkëdheljet e pushtuesit të ri. Por qyteti ndjen më afër praninë burrërore të partizanëve. Betejat në male po dendësohen çdo ditë.





## DROPULL

*Janar 1944*

Kam pak ditë në fshatrat tanë. Gjermanet vizitojnë rregullisht fushën tonë. I mallëngjejnë se tepërmi delet e varfra, që kullosin qetësisht në jeshillëkun e saj. Zgjedhin do qengja, i hedhin në makina dhe largohen me pafajësinë e njeriut të sapodalë nga kisha i sigurt për lehtësimin nga mëkatet .

Dje binte pa pushim shi. Pikat e dendura ujitnin shpirtin me një qëndrueshmëri melankolike. Në momente të tilla njeriu ngurron të dalë jashtë vetes. Por gjermanët tregojnë një përçmim të pazakontë ndaj natyrës. Hynë në shtëpitë tona, vunë përpara gomarët, për t'i shitur gjetkë për një qind dhrahmi. Kafshët fatkeqe shikonin të prekura njeriun në sy. Nënshtroheshin të trembura në barbarinë gjermane. Sikur të ndienin edhe ato epërsinë e tyre racore...

Niçja mund të jetë krenar që krijoi “mbinjeriun”

Jemi në zemër të dimrit dhe shirat vazhdojnë të na rëndojnë akoma me monotoninë e tyre të pakorrigjuar. Natyra e nxirosur pikon e gjitha brenda nesh. Asnjë shpresë për të kundruar pak kaltërsi dhe dielli besojmë se humbi përgjithmonë rrugëtimin në trajektoren e tij të zakonshme. Nuk është e pakët për andartin, që bëri strehë të përherëshme malin dhe qoshet e veçuara të kodrave tona.

E varfër toka, njësh e tëra si e vërteta pa çati. Dhe po të shikosh fushën e ulët të Dropullit një liqen-det i vërtet, nuk i shpëton dot dëshpërimet Pastaj bora që mbulonte majat si kapë e leshtë e bardhë, të përçonte nga larg ndjenjën e të ftohtit.

Ishte e padrueshme. Partizanët të rrekosur drithëroheshin nga igrasia dhe ushqimet ishte shumë e vështirë të arrinin nga fshatrat lart në gërxhe. Kishim kaq kohë që nuk hanim gjellë të ngrohtë.

Shikoja pak më vonë fshatarët të ngjiteshin përpjetë ngarkuar me ushqime. Duhet të të shtyjë një besim i madh në një luftë, për të nënçmuar me ndërgjegje edhe natyrën akoma. Mallëngjehesh si fëmijë me këta njerëz të plakur.

Nga komanda na erdhi urdhri të nxjerrim nja dhjetë burra dhe t'i dërgojmë në zonën e armikut. Që nga dje gjermanët zunë Gjirokastrën dhe mësuam se së bashku me ballistët kanë për qëllim të na vizitojnë. Është e nevojshme të hyjmë në radhët e tyre për të mësuar forcën që disponojnë.

- Sonte rroje të dyfishta.
- Sonte, rroje të dyfishta, - përsëritet e mirëpritur shprehja e qetë e komandantit tonë. Djemtë fërkonin duart nga një emocion në të gjithë trupin, përzier me të ftohtin.

...Ballistët, të bashkuar me bishat e pazakontë të nazizmit gjerman, marrin fshatrat e pambrojtura me radhë. Korrieri i guximshëm partizan, që u shpëtoi nga duart, na sjell lajmet më të fundit.

- Janë shumë dhe të armatosur rëndë. Në krye të tyre gjithmonë të njëjtët.

Ismail Golemi që, së bashku me Merkez Alinë dhe Shefqet Alinë, drejton krahun e majtë. Në krahun e djathtë që ka edhe më shumë gjermanë drejton çami Nuri Dino dhe Elmaz Runa.

Njësitë tona zunë pozicione në lartësitë dhe prisnin urdhrin e ri. Pas pak gjithë fusha shkëlqente tragjikisht dhe në maja ngjitej i trashë tymi i shtëpive të djegura. Gjermano-ballistët nxitonin të zhduknin përfundimisht fshatrat tona. Nuk kishte marrë mirë akoma zjarr Suha, kur filluan të duken gjuhët e kuqe të shkatërrimit nëpër dritaret dhe çatitë e Stegopulit dhe Saraqinishtës. Në të njëjtën kohë Labovën e Kryqit dhe Qestoratin i përqaftuan flakët mbytëse. Shtëpi dhe katandi, që u krijuan me mundin e pafund të kurbetllit, u bënë hi e pluhur në pak çaste.

Ajri u nxi nga tymnaja dhe era e leshit të djegur na vështirësonte frymëmarrjen. Qelbej atmosfera nga mishi gjysmë i djegur. Pleq që nuk mundën të iknin, kafshë që nuk mund të besonin egërsinë njerëzore.

Zemërimi ynë është i papërmbajtshëm. Sakrificat e fshatarit na përndezin gjakun. Qëndruam në shtëpitë e epërme të Qestoratit. Gjermano-ballistët, me fuqi të trefishtë se ne, hynë në fshat. Beteja fillon. Pas pak kohe shkrehnim edhe fishekun tonë të fundit.

– Dhe tani? – ulërijnë të pakënaqur partizanët tanë.

– Me dhembë ! Do t’i hamë me dhëmbë....- i përgjigjen vetes duke gjetur rrugëdalje te gjëja ende të pakonsumuar, - zemërimin luftarak.

Armiku, duke rralluar zjarrin, ka qëndruar në oborrin e kishës. Dy partizanë zbresin nga ana e pasme dhe u rrëmbejnë dy mushka të ngarkuara me armatime. Kjo nuk është sakrificë, është marrëzi.

Derdhemi mbi ta dhe i shpartallojmë jashtë fshatit. Të turpëruar nisen për në Gjirokastrë që të mbledhin forca të reja. Natën vonë e rirrethojnë Qestoratin nga të gjitha anët. Pozita jonë është tepër e vështirë. Rrethimi shtrëngohet për vdekje.

– Djem, të gjithë në zjarr!

Parulla u përhap e nervozuar duke vaditur shpirtin partizan me një dehje primitive. Çajmë rrethimin në disa vende. U dalim nga prapa, të papërmbajtur dhe duke shkelur mbi kufomat e tyre të freskët. Marrim të përpjetën të boshatisur nga fishekët. Nga prapa na ndjekin fshatarët e entuziazmuar.

Lamë tetë vëllezër të vdekur. Kufomat e armikut nuk mundem t’i numërojmë.

Pas pak flakët e ripushtuan Qestoratin.

Plakat, që nuk mundën të vinin me ne, shikonin të mermerta kërcitjen e çative dhe, pak me vonë, shikonin me apati hirin.

Llambro Papa, një plak me trup të lartë e të lidhur, që nuk arriti

të largohet, qëndron stoik para shtëpisë së tij. I afrohet një ballist dhe i kërkon një lirë, për të mos i marrë gomarin.

– Merre, - i thotë plaku. - Merre i pari ti për të mos pësuar të njëjtën gjë me miqtë e tu.

– Do të të djeg shtëpinë, - i përgjigjet i nxehur mercenari.

– Dhe akoma rri?

Zjarri nuk vonoi të nxjerrë kryet nga të çarat dhe dritaret, duke lëpirë me nxitim muret e shtëpisë së plakut Llambro.

Ky, me emocion të ngrirë, nxori nga xhepi kutinë e duhanit dhe ia dha ballistit që i dogji shtëpinë. Mercenari ogurzi drodhi me sarkazëm duhanin dhe e vuri në gojë.

– Zjarr, zjarr, ta ndez! - i thotë

– Prit! – i përgjigjet plaku. - Prit të bjeri flaka e shtëpisë dhe do ta ndezim.

Pas pak mori një dru të ndezur dhe ia ofroi ballistit. I fyer nga apatia e plakut, ballisti e pyeti me ironi.

– Bre, nuk të vjen keq që pe të të digjet shtëpia?

– Sot të mërzitem, që priset bota?! Këtu vriten djemtë tanë, gërmadhat do të shikojmë?!

Kur ikën gjermano- ballistët, gratë u kthyen nga mali për të përgatitur diçka për të ngrënë. Zbritën atë pak miell, që kishin marrë me vete, e gatuan shpejt e shpejt dhe e poqën kulaç në prushin e shtëpive të djegura.

Një keç i vogël blegërinte gjysmë i djegur në një qoshe dhe një viçi i kishte marrë zjarri njëren këmbë.

Fusha e Dropullit dhe ajo e Gjirokastrës shkëlqenin tani më shumë. Flaka që shtrirë në të gjitha fshatrat e rrëzës. Në shpirtin tonë fitonte terren një simbolikë e gjallë, bota e vjetër që po digjej:

– Mbi të, nga hiri do të ndërtojmë botën e re, - murmurisnin të

prekur nga mallëngjimi luftëtarët e lirisë. Dhe kjo botë do të ketë brenda gjithë shpirtin e njeriut të dhembur.

Këngët e Dropullit, këngët e hijshme greke të skllavërisë së pafund të vendit, zbutnin në mënyrë të çuditshme pikëllimin e paraardhësve të popullit tonë të robëruar.

Djemtë tanë vulosnin me gjakun e tyre ëndrrën e kaq shekujve:

**Lirinë.**



## ATHINË

*Dimër 1946*

Mendja ime e varfër me kot përpiket të pajtojë për llogari të vet kontrastet e pas luftës në Greqi. Kishte etje të madhe të çlodhej, e ngrohur nga frytet e sakrificave pa fund të popullit.

... Dje mora rrugën për te burgu i Haxhikostës. Miku im i mirë më njoftoi se këto ditë erdhën refugjatë serbo-shqiptarë. Njihte mirë peripecitë e mia të fundit në vendet e tyre.

– Shko – më thotë në fund- të mirëpresësh pak “në patridha”

Pranova pa kundërshtim ironinë e tij dhe mora rrugën për t'i takuar. Sido që të jetë, diçka do të mësoja dhe nëse na ndajnë pikëpamjet dhe kufijtë, më sjell pranë tyre dhimbja njerëzore. Dhimbja nuk njeh raca dhe atdhe.

Një shqetësim i trazuar mundonte shpirtin tim. Më mpinte mendjen nostalgjia e kohës së vjetër. Kotorr, Beograd, Prizren, Tiranë. Pastaj ajo Shkodra me atë dehje lindore.

Një i tillë njeri isha tek ngjisja shkallët.

Ecja përmes sallës së madhe. Të paraburgosurit ndërprisnin njëri pas tjetrit bisedën dhe të frikësuar hapnin rrugën të kaloja.

Vështrimi im ishte i qetë. Nuk tregonte asnjë zyrtarizëm. Trupa të lartë, sy të lodhur, fytyra të shtrydhura nga vështirësitë. Huazoj pa mundim nga truri im gjuhën e tyre dhe u jap fjalëve ngjyrimet e theksuara lokale.

– Përshëndetje burra! Si keni qen!

Përgjigja, e vonuar disi nga befasia, vjen nga dhjetëra gojë, si jehon:

– Për atë Zot, mirë jena fendëm.

Përpiqem të mos qesh. Prapë mirë që nuk më thanë bajraktar.

- Ç'ne keteja?

Kuptohet, nuk prisja të më thoshin se erdhën për të admiruar Parthenonën.

- Kështu deshi Titoja....

Sytë e tyre premtajnë në mënyrë të pacaktuar hakmarrjen. Ruanin akoma habinë, që si ishte e mundur të dëgjonin krejt njësoj gjuhën e tyre, kaq larg vendit të tyre.

Një vajzë e re, fshehur pas një burri, përpiqet të mos zbusë monotoninë mashkullore me praninë e saj të dobët.

- Dhe ju zonjushë?
- Partizane në mal me burrin tim.

Një i ri para meje me lëvizje fëmijërore në fytyrë, përpiqet herë pas here të më flas. Akoma nuk vendos. E shikoj dhe qesh përbrenda me ngurrimet e tij të trembura. Nuk më gënjejnë sytë. Është miku im oficer në Shkodër.

- Bre, Riza, ti je?
- Stefan!

Ka dëshirë të më përqafojë, por e vlerëson shumë të guximshëm këtë gjest. Më tërheq prej krahu mënjanë.

E pyes shumë kohë për atdheun e tij. Tregon me ngulm jetën tonë në Shkodër. Është i sigurt se më përgatit mallëngjim. Një emër gjysmë i fshirë më mbetet akoma në mendje. Kujtesa përpiqet të shpëtoj nga kjo pasiguri:

- Dhe komandanti ynë?

Thua për kozakun, Kutsiuk Ullagaj? Vdiq refugjat në Serbi. Që nga koha kur hyri Italia, iku. E kërkoi edhe gjermania të shërbente si gjeneral, kundër atdheut të tij. Nuk e pranoi shpirti i tij tradhtinë.

Njeri i çuditshëm. Shpirti i tij në botën tjetër, (nëse diku na pret) nuk do të vonojë të duhet me njerëzit që nxitoi t'i urrente...



Kaloi ora. Kërkoj shprehjen e fundit që do të më lejojë të ik i lehtësuar.

– Dhe tani çfarë do të bëni?

E kishte gati përgjigjen për interesimin tim.

– Greqia është shpresa jonë e vetme. Jemi shumë serbë dhe shqiptarë që luftuam kundër partizanëve. Atdheu yt do të na ndihmojë të rrëzojmë komunizmin në Ballkan. Sa për Anglinë, nuk kemi asnjë dyshim. Në fuqinë e saj mbretërit tanë mbështesin fronin e tyre. Pastaj le të mos zhgënjehemi. Lufta e re është shumë pranë.

– Dhe nga vini?

– Nga malet e Kosovës dhe të Serbisë. Ne jemi të Muharrem Bajraktarit. Pak janë të Denisit dhe të Mihailoviçit. Ata janë jugosllavë.

Fliste me entuziazmin e njeriut që kryente një akt madhor. Ishte i sigurt se e admiroja.

E përshëndeta gati për të ikur. Vuri dorën horizontalisht në kraharor dhe mori qëndrim gatitu. Ishte përshëndetja e Zogut. Nuk munda të përmbahesha:

– I madhi tënd ku gjendet?

– Në Angli.

– Mësova se bleu toka dhe lopë. I shkon shumë përshtat profesioni i paraardhësve. I shkrove të të marrë lopçar. Dhe mos harro zanatin e ri tre yjet...

Tundi kokën me zhgënjim të paarrirë.

– Ky është Ballkani....

**FUND**



*Me gruan, Anën, ditën e martesës*

# PJESA E DYTË

*Artikuj estetikë botuar në shtypin e Tiranës në periudhën 1939-'40*



## ARTI DHE SHKENCA

Në është se arti qëndroi në dyshimin e mendësive njerëzore, këshilltar i pagabueshëm i jetës, prijësi shpirtëror, shtytësi drejt një lartësie jashtë- materialiste, shkenca përbri, megjithëse vonë, por, me siguri, e drejtonte absolutisht dyshimin njerëzor me të vërtetën, i lehtësonte, me mjetet e saja materiale, zotimet tona materiale, e mënjanonte mjegullën duke treguar thjeshtësinë, sinqeritetin e objektit. Ajo është radhitja e të dy degëve, pa pasur ndonjë lidhje në këtë rast me ndjenjat shpirtërore. Dhe cila është radha e tyre kronologjike?

Burimi i artit fillon nga dukja e njeriut, nga çasti në të cilin ai filloi të ndiejë; dhe ai i shkencës nga çasti në të cilin ai filloi të mendojë e të dyshojë. Dhe kur arti përparonte me hapa të sigurta në krijimin e vet, shkenca nuk gjente rrugën e vet në errësirë.

Arti buroi nga dielli, kurse shkenca nga errësira. Shkencëtarët, filozofët i dhanë përcaktimet për këto të dy fenomene shpirtërore, nga Anaksagora te Platoni, nga Aristoteli te Kanti, duke u ujdisur ose jo, kurse konflikti i tyre nuk pengonte aspak zhvillimin e mendimit njerëzor.

Cili është ndryshimi i të dy fenomeneve, ose më mirë ku gjendet lidhja e tyre?

Megjithëse rrjedhin që të dyja po nga një burim, nga jeta, përdorimi i lëndës është kaq i ndryshëm sa që asgjë nuk i afron.

Arti shquhet nga gjithë shfaqjet e tjera mendore të njeriut, pikturë ose muzikë, është skulpturë ose letërsi. Nuk qëndron paralelisht në shkencë si degë e veçantë e krijimit mendor e njerëzor. Përkundrazi, është një shfaqje supermendal që mbulon çdo lloj mendimi nën kompetencën e saj superiore. Në një marrëdhënie tjetër, me shkencën, takojnë në

qëllimin. Sepse nuk besoj në të famshmen “Arti për artin” që është diçka e përfytyruar *qui absurdum*.

Gjithashtu nuk mund të besoj se arti është i thjeshtë. Ky fenomen nuk mundi të zbrisë nga metafizika e përfytyruar, në realizimin praktik. Arti bëhet prej njeriut dhe drejtohet tek ai midis tij. Pa qenë mençuria ai gjendet brenda në mendjen e njeriut. Diturin e njomë e ka monopolizuar kryekëput shkenca që nuk ka asnjë marrëdhënie organike me letërsinë.

Por cili është qëllimi i letërsisë -prozës- kurse fati i saj është, përherë, të shkelë vendet e shkencës – ose të fiziologjisë, sociologjisë, moralit, historisë, drejtësisë, metereologjisë e tjera e tjera?

E atëherë çfarë shton letërsia në rëndësinë e ballit të lartpërmendur të shkencave përkatëse, kurse dituria e patundshme është dhuratë e panjohur e shkencës?

Ka diçka për të shtuar, gjë të cilën shkenca s’mundet ta marrë hua, në qoftë se, dëshiron të gjendet brenda kushteve të saj: “JETËN”. Ja çfarë është arti: Dituria (science) e mbytur në dritën e jetës. Ose, më mirë, arti është ngjallja e jetës.

Fazat psikologjike i përshkruajnë me kaq hollësi Frojdi dhe Adleri në veprat e tyre të famshme. Ato faqe janë të përsosura sipas mendimit të sotshëm, për psikologjinë. Vërtet arti këtu mungon, por ato qëndrojnë në ekstremet e shkencës. Mandej vjen Dostojevski, ose Andrejev Bourget, ose Rolandi dhe përshkruajnë ose deliriume ose epilepsinë pa qenë psikiatër (doktor të shpirtit). Po nuk mjafton ajo, po krijojnë art. Sepse në vërejtjen shkencore të Çarko shtojnë atë që mungonte: Jetën. Dhe kështu nënkuptohet se vepra që nuk dobëson, nuk dërsin jetën nga të gjitha porët e saja, nuk qëndron kurrë si vepër arti. Mund të jetë vepër shkencore e shkëlqyeshme. Tjetër për tjetër.

Dhe ajo filozofi edhe si shkencë brenda në përfytyrimin e vet nuk mund të futet tek arti veçse përmes inspirimit të gjallë të një artizani. Duke

përshkruar mendime të thella me radhë, do të thotë se shkruan studime filozofike, pa bërë art me atë. Sepse arti është jetë- lëvizje, energji, që ngjall fenomene të vdekura.

Pra, midis prozës letrare dhe veprës shkencor, përhapet kaosi i tmerrshëm! Dhe ai kaos quhet jetë.

Nuk mundemi kurrë të paditim një vepër arti për inondatën e spiritualizmës së vet; përkundrazi, proza e sotme, përpiqet të japë në veprat e saja, përmbajtjen pneumatike me të fortë bazuar në psikologjinë apo filozofinë. Por, shkrimtarët, duke ditur fshehtësinë e artit, kalojnë fuqinë e tyre mendore nga filtri i jetës duke e veshur me fytyra, me ngjarje, me vepra e me energji. Përdorni lëndën sipas letërsisë.

Në qoftë se ndonjë prozator paditet se shkruan vepra enqefalike -pa realitet-dhe pa jetë, ajo nuk do të thotë se spiritualizma e prozatorit është element kundër letërsisë. Dhe sigurisht jo. Kjo do të thotë se ai prozator, pa pasur në dispozicion fuqinë letrare, jep të pagdhendur artistikisht fuqinë pneumatike. I hedh pa art, në kartë si një shkencëtar vërejtjet e tij qofshin edhe shumë të thella.

Me fjalë të tjera, një studim nuk është edhe romancë; s'ka të bëjë në qoftë se pajimet letrare të shkëlqyeshme te përshkrimi, por jo te kombinimi. I tillë paditet se nuk është letrar, nuk mund ta mohojnë se me të vërtetë nuk është filozof, dijetar ose shkencëtar.

Kujtoni se Niçja, Hegeli ose Kanti mund të shkruani romanca? Sigurisht jo. Me këtë nuk do të thotë se nuk janë kolosë, Gjithsecili atje ku është dedikuar.

Por është edhe shumë e vështirë që të kuptojë njeriu pikërisht se ku është dedikuar. Dhe kështu, njerëz me prirje mendore të shkëlqyeshme, marrin rrugë kundë natyrës së tyre, në dem të madh të të dy rrugëve. Por fenomeni është psikologjik: se cili ka dobësime edhe në dobësimet e tij.

Që të kufizohemi në letërsinë tonë duhej të kishim edhe lëndën

përkatëse. Prozatorët tanë nuk prekin akoma problemet shoqërore, po as nuk marrin hua prej lëndës shkencore. Kufizohen në konditat e ngushta të hithografisë), në rrethanat e përbashkëta. Edhe poezia jonë nuk mundi të shpëtojë prej lirizmit të pashijshëm, që të përqafojë ndjenja më të larta, dhe të na afrojë me popullin.

Qoftë në gjykimet e mia të kem gabim dhe diçka të më shpëtojë. Më gëzim do të vazhdojmë po këtë temë në qoftë se do më shtynin kompetentët. Veç asaj, *errare humanum est* .



## MENDIME MBI LETËRSINË

### *“Arti duhet të ndjek epokën e tij”*

#### CROCE

Në kundërshtim me atë që shënova në artikullin e parë, se jemi ngjitur në traditën tonë në një mënyrë të rrezikshme, ngjan kjo: imitimi ose, më mirë, kopjimi i letërsisë së huaj dhe jo i teknikës së saj.

Të pasur e të vobektë, sipas nesh, kemi një traditë letrare. Dhe mungesa e këtij është të mos dimë të respektojmë përmbajtjen atë që më tepër mban interesimin e artit, kurse e imitojmë teknikën veshjen d.m.th që ndryshohet- dhe që duhet të ndryshohet- sipas epokave. Arti duhet të sjellë me vete epokën në të cilën jeton, dhe vetëm atëherë realizohet qëllimi i tij.

Lë të mos harrojmë, se sa xhevahire ka për të treguar letërsia jonë e vjetër dhe e re janë pemët e atmosferës në të cilën rron dhe lëviz, janë rrethanat shqiptare.

Letrarët tanë, ata që kanë dhënë veprën e tyre dhe ata që janë në krijim e sipër, kur shkruajnë, kur prekin objektet e frymëzimit të tyre, nuk veshin dorëza, por ndiejnë drejtpërdrejt prekjen lakuriqe me jetën. Nuk dua të them me këtë se janë njerëz të vërtetë, të gjallë dhe sidomos njerëz të tokës.

Nga një anë tjetër, kur kërkojmë nga artisti sinqeritet në shkrimet e tij, nuk kuptojmë se prodhimi i një letrari nuk duhet të ndryshojë prej shkresave statistike, ose prej dokumenteve gjyqësore; aspak. Dhe na jepet prapë rasti të përsëritim: arti nuk është fotografi, është lartësim i lëndës që përdor, është përshkrimi i saj me anën e paradispozitës dhe sipas

frymës së artistit. Dhe në qoftë se pranojmë mendimin e parë, mendimin e realistëve që dëshirojnë artin organ të qëllimit dhe që përjashtojnë frymëzimet me erën e tyre lirike, atëherë në ç' gjë ndryshon letërsia prej gazetarisë statistike? Lënda dhe objektet e tyre mund të jenë imagjinuese, por frymëzimi duhet të jetë i sinqertë dhe vetëm atëherë na bind, na thotë se gjendemi në një atmosferë të ekzistuar. Jeta, pra, kalon nëpërmes instinktit të artistit dhe pasqyrohet sipas pamjes që i paraqitet atij. Nga kjo pikëpamje, nga artisti, kërkojmë të justifikojmë veprat dhe lëvizjet e tij, të jenë këto frytet, bijtë e ambientit, e atmosferës që i rrethojnë. Vjen vetvetiu, pra, gjer ku kërkojmë të jetë artisti i sinqertë.

Le të mos gënjehemi, le të mos harrojmë se një vepër, përpara se të bëhet vepër ndërkombëtare është kombëtare, e nxjerrë prej vendit, prej rrethanave të artistit. Çdo vepër e madhe është më përpara vepër e zakoneve dhe atëherë vetëm mund të quhet vepër arti, atëherë vetëm e ndien lexuesi. Çdo vepër, pra, çfarëdo lloj arti që të jetë, ka atdheun' e saj, atdheun e shkrimtarit të saj.

- Dhe ne a mundemi të kundërshtojmë jetën tonë?  
Dhe atëherë ç' kërkojmë prej shkrimtarit shqiptar?

Më falni për banalitetin. Babai ynë ka akoma brekë historikë, por, artisti shqiptar u vesh me pantallona evropian. Flet për kalin, për lopën e tij, dhe shkrimtari, i biri i tij, në gojën e tij vë fjalët e *Spinozës*. Nuk them se ngjan pikërisht kjo, dhe as kam parasysh një filan shkrimtar.

S'kemi sallone dhe ballo, rendigota dhe vajza me krejon. Heronjtë tanë duhet të kenë këpucët me baltën e arës, kur atmosfera e shkrimtarit që përshkruan është ajo e fshatit, erën e rëndë të çobanit, vesën e mëngjesit, kasolle dhe jo pallate, qetë që kthehen me bujkun e lodhur në perëndimin e diellit. Ky është ushqimi i shkrimtarit tonë, kjo duhet të jetë lënda e tij, këtu gjendet sinqeriteti që kërkojmë. E kundërta thuhet kozmopolitizëm gënjeshtare dhe me tjetrën fjalë, kjo quhet ikje

nga vendi i ynë, kundërshtim i jetës shqiptare, tradhti...

Këta janë objektet e domosdoshme të prozës sonë dhe të një lloji poezie që e urrejmë, të poezisë së zakoneve, të poezisë popullore lirike. Them prapë se në qoftë se gjenden vargje bukolike në nja dy poetë tanë të sotshme, ky përjashtim, nuk sjell dobisë e duhura dhe, fatkeqësisht këta s'kanë gjetur akoma imituesit e tyre në llojin e poezisë bukolike. Sa për poezinë individuale, atje kemi faza psikologjike të brendshme dhe jo njoftime, karakteristike dhe përshkrime të jashtme.

Një tension i tillë- i mospranimit të rrethanave tona- dallohet këtu-atje në shkrimet e të rinjve tanë. Do të jetë më mirë sikur të thyejnë pendën që tashti dhe ta lënë letërsinë të qetë.

Kozmopolitizmi nuk është qytetërim, dhe nuk kërkojmë Shqipërinë ta bëjmë krahinë evropiane. Çdo ide, çdo tension, duhet të brumoset me jetën, me tokën, me psikologjinë tonë.

Na mungon edukata letrare. Baza e lexuesit tonë të së nesërme, por edhe vatra artistike e së ardhmes, gjendet në shkollë, dhe si çdo gjë në epokën e kaluar, edhe shkolla ishte braktisur në fatin e vet. Nën rrethanat e shkollës sonë të vjetër përgatiteshin më tepër kriminelë se sa njerëz me ndjenja artistike me ndërgjegje njerëzore. Dhe ai sistem pedagogjik nuk mundte kurrë të ndiqte zhvillimin e sotshëm, se kjo ishte kundër interesave personale...

Dhe në qoftë se kemi sot artistë, i kemi për hir të disa-pak-mësuesve të shkollës së mesme që me heroizmin e tyre i kanë çelur rrugën e duhur, i a kanë zgjuar nxënësit vetitë e tij natyrale. Dhe ja një fakt i madh i mungesës sonë pedagogjike në kohën e kaluar: kush është nga letrarët tonë që nuk ka vazhduar studimet e tija jashtë Shtetit?

Iku prej atdheut të tij me ndjenja dhe mendime të pacaktuara dhe u kthye artist.

*E diel, 28 janar 1940, faqe 8*

## **Shënime kritike**

### **TË DY RRYMAT**

*(Fillimi i një studimi)*

A nuk kemi dhe ne të drejtë të flasim për rryma letrare? Jemi vërtet një komb i vogël dhe i varfër në shfaqje shpirtërore. Por vlefata e një veprë nuk peshohet nuk kritikohet absolutisht pa ndonjë lidhje me objektin që përshkon. Çdo vepër fiton vlerën e saj në vendin ku krijohet. Një vepër ka vlerë dhe sinqeritet kur përmbajtja e saj buron nga jeta e shkrimtarit të tij. Është vepër e vërtetë, kur shkrimtari i ka jetuar vetë ato çaste, kur çdo faqe vaditet nga shpirti i autorit. Na frikëson shumë herë hipoteza e veprës që krijojmë dhe përpiqemi ta nxjerrim nga interesimi lokal. Është mashtrim më i madh që pësojmë. Kujtojmë se një vepër merr famë kur shfaq jetën e qytetëruar jo të një vendi, por të njeriut përgjithësisht. Por, njeriu është lidhur me tokën, me rrethanat që jeton, dhe çdo shfaqje e tij psikologjike, justifikohet vetëm pas atmosferës që merr frymë. Flasim për njerëz normalë. Kur përpiqemi t'u japim heronjve ngjyrën e psikologjisë së përbotshme, biem në gabimin e mos-sinqeritetit, të gënjimit.

Nuk akuzojmë kurrë një shkrimtar pse imiton këtë ose atë autor të huaj. Mjafton që shkrimet e tij, që psikologjia e përmbajtur të jenë të sinqerta, të kenë vulën e personalitetit të tij, të vendit të tij-Vagabondi i Hamsunit është vetë shkrimtari, ekziston, jeton, por vetëm në vendin e tij, në Norvegji. Dhe kur përpiqemi ta imitojmë psikologjinë e tij, biem pa tjetër në gabimin e mosekzistencës së një heroi të tillë. Nuk dëshirojmë të transmetojmë një hero të një shkrimtari të huaj në tokën tonë; është njëllë me mbjelljen e bananes në Polin e Veriut. Njeriu sjell me veten të gjitha karakteristikat e rrethanave që jeton. Nuk është gjuha ajo që na ndan; është psikologjia.

Kur zotësia e autorit kufizohet në talentin e tij duke kërkuar prekjet e vërteta, vetëm atëherë gjen arti vlerën e tij dhe rrethanat lidhen pandarë me çdo ndryshim psikologjik. Çdo vepër që sjell me vete vulën e artit, është kurdoherë vepër e përshkruar prej sinqeritetit. Ka përsipër vulën e vendit të shkrimtarit. Është vepra e zakoneve.

Natyra nuk kuptohet pa njeriun dhe njeriu pa natyrën. Janë dy elemente të pa-ndarë.

Sa e shkretë, sa e shëmtuar, sa i egër do të ishte deti pa një barkë brenda, pa një shpirt. Dhe kush do të sodiste një perëndim poetik në qoftë se mungonte njeriu? Sa e shëmtuar është një panoramë, sa i vdekur është një livadh pa bukurinë origjinale të vet?

Natyra lot rolin e gruas te njeriu. Rrojmë nënë imponimin e saj, dhe kurdoherë sjellim me vete njoftimet e saja. Për vendin tonë ku jemi lindur, ku kemi rrojtur mbajmë nostalgjinë, për vendin e huaj kemi dëshirën.

Nuk do të dëshironim, pra, tipin e një heroi të Ibsenit, se këtu në tokën tonë s'ka fjarde, s'ka ato gjendje atmosferike. Një tip i tillë nuk rron ndër ne, nuk ekziston.

Nuk do të donim tipin e Verterit se, ndër ne një i tillë nuk gjendet. Nuk duam tipin dostojevskan, ose të Gorkit se nuk ekziston në tokën tonë. Kërkojmë tipin shqiptar, me thjeshtësinë e tij, me zgjuarsinë e tij, me ndjenjat e tij të larta.

Gjer në ç'pikë mundemi të gjejmë tepin e këtyre në veprat e shkrimtarëve tanë, me këtë do të merremi tjetër herë.

Qëndruan të zotët shkrimtarët tanë të formojnë shkollë letrare?

Ja një temë që kujtoj se erdhi çasti për të biseduar.

Në qoftë se mund të bëjmë fjalë për letërsinë shqiptare, nuk duhet pa tjetër të harrojmë shkrimtarët e brezit të kaluar. Dhe ai që meriton më shumë nga këta është pa dyshim at Gjergj Fishta: Është poeti që më shumë

se të tjerët iu -afrua psikologjisë së malësorit dhe me një fuqi të duhur e harmonike me temën, mund të përvijojë tipet psikologjike malësore. Personaliteti i tij, një personalitet aq i veçantë, gjer sot nuk gjeti asnjë imitim.

Koliqi gjen veten te klasikët italianë në poezi, edhe në prozë te prozatorët frëngj.

Lasgushi, poet i harmonisë dhe i lirizmit klasik buron prej shkollave poetike evropiane dhe më shumë prej Emineskut.

Mbetet të shohim brezin e tyre; Koliqi do të përmendet më tepër si prozator dhe Lasgushi si poet.

Koliqi si novelist kujtohet i vetmi, dhe krijuesi i këtij lloji.

A krijuan shkollë rreth tyre dhe cilët janë imituesit?

Ja tema me të cilën do të merremi në studimin që do të pasojë.

*12 Shkurt 1940*

## **Shënime kritike**

### POEZIA DHE PROZA.

Tema me horizonte aq të hapura nuk dobësohen, as që shpjegohen problemet e tyre të shumëllojta në një artikull të kufizuar.

Shumë herë më ka ardhur rasti të shfaq shkurtimisht rrugën reale të një letrari dhe këtu po përmbledh këtë pikë, duke zgjatur horizontet, gjithmonë mbi letërsinë.

Për orientimin ekzakt të lexuesit do të bëjmë një hyrje me lidhje historike.

\*

\*

\*

Poezi-prozë ose prozë-poezi.

Po pse zhvillimi i sotshëm i Artit e trazon pa dashje. Janë fragmente të “Ringjalljes” së Tolstoit që kalojnë lirizmin e Shilerit ose të Gëtes. “Sallomi” i Vildi-t ka një prozë, e cila nuk kapërcehet në bukuri prej atyre të Valerit. Ende lirismi tronditës që përfaqëson rruzullimin, është shfaqur në rrymë prozatore, kurse të parat e tij me metër u shuan para se të vdiste shkrimtari i tyre.

Pra të dy këto lloje paralele u ndoqën në universin...para se të lindi Ajnshtajni.

Ç’ është poezia? Fillimisht, pa dyshim, ajo është art. Por...

Kur u shfaq ky lloj? Sipas vërtetimit të përgjithshëm, u lind me dukjen e njeriut të parë:

... Dielli i dyshimtë buzëqeshte në njomësinë e gjithësisë, butësia

e horizontit sa po që vizatohesh në ngjallnin e tejpamjes dhe zogjve u ziesh fyti në provën e parë të këngës së tyre, frymorët rrëshqisnin në oborrin e freskuar me kënaqësi të pa ngopur dhe natyra pa ngopur e pa moshë përdridhte ligjet e saj mbi të parashikuarin fat të njeriut. Toka gjendej në përkëdheljet e para me dellin, që kthente me ëmbëlsi fytyrën e saj në puthjen e nxehtë të tij. Dhe të paanët në kryqëzimin e tyre prodhonin në gjirin e tokës filizat e së ardhmes.

Trazuar me frymorët, që shurdhonin atmosferën me zyrat e tyre primitive, më dija e të vetëquajturit njeri, vendosi të parin tonë, njeriun e parë midis tyre. Gëzimi i atyre transformohet në dyshim për këtë, që edhe ajo kafshë midis tyre, para çudisë që hapet rreth saj, mbetet me gojë hapur në ëmbëlsinë e dyshimit që ajo do të zhvillojë në shfaqjen e ndjenjave që të arrijnë më vonë në duart e forta të plakut Homerit.

Këto kemi parasysh kur vjen t'i forcojë mendimet tona eksploratori i Norvegjisë, profesori Knut Rasmusen, me librin e tij të famshëm “Eskimo” që tronditi atmosferën shpirtërore më 1824, kur doli në dritë. Rrojti me atë fis të egër, protogone 24 vjet, me të vetmin qëllim të merrte doket e tyre. Midis faqeve të librit të tij shquhen gjallërisht dhe këngët popullore të fisit të egër. Pa frikë, pra, bëjmë një paralel midis gjendjes së këtyre njerëzve me atë të stërgjyshërve tanë.

\*

\*            \*

Pamja e parë e poezisë është me metër pesëmbëdhjetë rrokësh, pamja e Iliadës dhe e Odisesë së Homerit. Tema e saj: dashuri, heroizëm, atdhetarizëm, përshkrim.

Shquhet me vonë poezia lirike dhe poezia tragjike dramatike, Babai i tragjedisë, Eskili, i poezisë thjesht lirike Arkilohi, i liriko-epikes



Pindari.

Mbin më vonë poezia satirike, komedia, me përfaqësues Aristofanin, ajo erotiko-lirike me Safon e së fundi shquhet lloji i epigramit që arrin kulmin e tij me Simonidin.

Gjer tashti proza është e panjohur, përveç mitologjisë dhe përrallave që trashëgoreshin me gojëdhanë.

Në vitin 300 para Krishtit një shkrimtar nga Sicilia, i quajtur Harron, bëhet pa dashjen e tij “Kaliopi” në gjuhën atike.

Nuk do të qëndrojmë këtu më shumë, pse kritika e tyre lyp kohë dhe vend pune që e kanë krijuar kritikë të ndryshëm, kompetentë të botës. Sa për ne, hë për hë, vlen gramatologjia.

\*

\*

\*

Ndërhyrja e krishterimit këput rrugën e artit për të dhënë objekte e drejtime të reja dhe, sa për klasicizmin, jo të mira.

Krijohet retorizmi, element i pavlefshëm për artin, por i domosdoshëm për politikën. Mesjeta qëndron varr i zhvillimit spiritual e shkencor. Është faza e parë e fanatizmit. Fyti i tij është Dante Aligeri; merr hua atmosferën mbytëse të Mesjetës dhe komunikon me të vjetrit e mëdhenj, me grekët e latinët.

Por i pari përdorues i pastër i prozës është Bokaçio me të famshmin “Dekameron”. Prej këtij proza fillon historinë e saj të vërtetë. Këtu shfaqet edhe kritika, ky lloj parazit i letërsisë.

Kur horizonti kullohej prej fanatizmit kristian, sy të virgjër e artizanë mundën të shohin bukurinë e natyrës. Mblodhi fuqinë spirituale të stërgjyshërve, duke derdhur lëndën e mendimit njerëzor të kristalizuar

në kallëpe të reja.

Shfaqja dinamike e Rilindjes stolisi më vonë vetveten me karakterizimin e madh “shekulli i artë i turbullimit paskristian”.

Ringjallja e fryteve spirituale të stërgjyshërve, rivizatim i personaliteteve të vlefshme letrare. Njeriu kthehet prapë në veten e tij, rinjeh fuqinë e natyrës invisibël, por pushon së përfytyruari. Njeh mirë veten e tij gjysmëkristiane dhe shkund prej kurrizit të tij asketik paditurinë që është stolia e sygënjimit kristian. Respekton etërit e tij spiritualë, Sokratin, Platonin, Virgjilin dhe Ciceronin dhe ka shqetësimin e pafjetur të trashëgojë të nipërit fuqinë e tij analoge spirituale. Krijohet rreptësia (vepër me të vërtetë e skolastikëve filozofë aleksandrinë) e vetvetes, autokritike, ndërgjegjja. Etërit anonimë intelektualë të periudhës pas ringjalljes paragatuan gjenitë e Perëndimit.

Vinji themelon poezinë e re lirike në Francë, kurse Elisabetianët në Angli përgatiten të pranojnë Shekspirin, gërmojnë gjuhën e tyre për të pranuar gjenin e poezisë dramatike. Gjermania, Spanja dhe Italia pranojnë pa kundërshtim filologjinë latine dhe greke për të brumosur, me ndihmën e tyre të parë.

Me vonë, por me siguri, degë të reja filologjike arrijnë një përsosmëri. Drama gjen kulmin e saj, merr hua skeletin dhe përmbushjen e tragjedisë së vjetër dhe zhvillohet në harmoninë e kryeveprave të artistit anglez.<sup>7</sup>

.....

Është e dokumentuar se çdo epokë kërkon, lyp, pikturimin e saj prej gjenisë shkrimtare që ushqen brenda saj. Dhe në qoftë se nuk ekziston, e lind e ushqen dhe e lartëson epoka e tij. Klasicizmi helenik bëhet shembull i artit dhe jo rrallë njomësia mbush boshllëqet e vlefshme filologjike. Komiko-tragjiku i madh në Francë pranon rolin e Zhunelit,

---

<sup>7</sup> Fjala është për Shekspirin

Molierit. Satirë e thellë, hipokrizi e hollë, sarkazëm e njomë diku, po vërtet është tragjik i madh që zgjodhi komedinë për gjeninë e tij dinamike. Satirizon pse ndjen dhembje për botën.

Nënqeshja melankolike qëndron e pa shuar në buzët e tij. Në veprat përshkruhen gjallërisht tipet që krijoi epoka e re, neopasuria, gënjeshtria, e me në fund, rrokullisja psikologjike e romantizmit. Dhe vazhdon Volteri, i mbushur me lirizëm, dituri, por gjithkund satirik. Por paralelisht nuk do të harrojë kurrë njerëzia Servantesin. Spanjollit paradoksal rron gjerësisht ippetismin e feudalizmit dhe bëhet i vetmi sarkastik i tij; kundërshtues themelor i tij. “Don Kishoti” është pikturimi mbarë i epokës së tij ippetike. Por gjenia e tij paragaton Kalderonin, në periudhën e ringjalljes spanjolle.

Pak si vonë -sa vonon të shfaqen gjenitë- në Gjermani na lëshohet Gëte, Olimpi, i shqetësuar, gjithmonë i ri filozof por edhe lirik, i thellë në dramë, i thjeshtë në poezinë lirike. Do të arrinte “Fausti” për të siguruar famën e tij, por e lartësuan jo dhe pak prozat e tij, baladat dhe sonetet.

Por edhe ai, Niçja? Ç’ kërkonte në qetësin e epokës së tij? Gjenia e tij e përnjëhershme shpejt mashtroi. “... Do të afrojo o diell, do të afrojo dhe le ta di që drita e jote do të me përvëlojë”. Kështu shfaqej përpara vërtetësisë. Profetizoi fundin e vet. U bë i marrë dhe nuk vonoi të vdiste duke dhuruar filozofo-lirizmin e tij të pavdekshëm.

– I pranuar me gjithë dobësitë e tij....

## KOSTIS PALLAMAS NJË IDOLOLATËR<sup>8</sup> I MADH

Muajin e kaluar vdiq në qelinë e tij një skulptor i madh i fjalës, një skalitës i shquar i shfaqjeve shpirtërore, poeti madh ballkanas i ditëve tona, Kostis Pallamas. Vdiq në moshën 84 vjeç. Një njeri, që filloi të shkruajë kur ishte djalosh pesëmbëdhjetë vjeç, për shtatëdhjetë vjet të tëra thithte pluhurin e librave, për kaq vite gërmonte sekretet e shpirtit njerëzor dhe për aq kohë akoma shkruante dhe shuante vargje mbi vargje, fraza mbi fraza, gjersa të arrinte në formën më të përsosur të artit. Dhe pas kaq pune dikush do të kujtonte se këtij njeriu s’i kishte mbetur gjë për të përshkruar, nuk i mbeti ëndërr e pashprehur. Pothuaj pesëdhjetë volume, poezi dhe prozë, sidomos poezi, studime dhe kritika.

Kostis Pallamas u lind në Patra më 1859. Prindërit e tij ishin nga Mesolongji, ku pas pak kohe vajti dhe ai vetë, sepse shumë shpejt mbeti jetim dhe kërkoi strehë në shtëpinë e xhaxhait të tij. Një hidhërim dhe një ankim ky që do të sillte edhe më vonë vulën e melankolisë, të një pesimizmi të thellë dhe poetik.

*Shtatë vjeç djalosh dhe varka ime qe coptuar. Vdekja më rrëmbeu mëmën dhe babën dhe më mbylli shtëpinë. Nga vendi ku më gjeti e keqja më morën një natë dhe ma kaluan në vendin fqinj ku më prisnin. Me një mënyrë të tillë përshkruan poeti moshën e tij të njomë.*

Në Mesolongji, që aq bukur i këndoi në poezinë e tij *Ankimet e Liqerdetit*, Pallamasi kaloi vitet e djalërisë. Pak më vonë do ta gjenim në Athinë ku ndoqi për një vit leksionet për Drejtësinë. Por shumë shpejt

---

<sup>8</sup> Idhujtar, njeri që nderon idhujt.

do ta braktiste shkencën për hir të poezisë. Dhe në Ballkan është diçka e madhe kjo. Është një përbuzje kundër jetës, e cila nuk kuptohet dhe nuk përballohet kollaj pa pasur një armatim të mirë si shkencëtar, avokat, tregtar. Por kurrë si poet, kurrë si artist.

Poeti gjendej në përpjekjet e tij të para. Mori vendimin e madh, duke dëgjuar tingujt e zemrës së tij: do të ndiqte rrugën plot gjemba të artit. Rreth vetes shikonte luftën e madhe që bënte intelektualit për të fituar bukën e përditshme. Por ishte i ri dhe vuajtjet nuk e frikësonin. Brenda tij ndiente një zjarr të madh që do ta digjte gjersa të gjente mënyrën më të përsosur të shfaqjes. Afshi i brendshëm nuk e linte të qetë: duhej ta nxirrte jashtë, por si? Shkruan me qejf dhe këto frytet e para i dërgon në një konkurs poetik, por... poezitë e tij u hodhën në shportën e heshtjes.

Poeti nuk e humbi aspak guximin. Edhe nga kjo kish për të fituar diçka. Bëhet më i kujdesshëm dhe ndiente tani më shumë nevojën e studimit. Dhe më parë nga të gjitha duhej të merrte një vendim tjetër; brenda vetes duhej të pastronte një gjë të madhe: botën skolastike të vjetër, atë të profesorit dhe të gjuhës *neobizantine*. Do të merrte edhe ai pjesë na luftën e madhe gjuhësore. Duhej të mundej gjuha e mykur e shkresave dhe e gramatikës, duhej të fitonte gjuha e popullit.

Dhe për të kuptuar rëndësinë e kësaj lufte, kontributin e Pallamasit në të, si dhe në botën e atëhershme të letërsisë neogreke, do ta lëmë për pak poetin dhe do të përshkruajmë në mënyrë përmbledhëse atmosferën e kësaj periudhe *propallamiane*.

Dyzet vjet përpara lindjes së Pallamasit, poeti kombëtar *Dhionisios Sollomos*, me frymën e tij të lartë nxirrte në dritë bukurinë e dendur të gjuhës popullore, duke përbuzur krejtësisht gjuhën e pastër të zyrave, gjuhën bombastike dhe pa shpirt të oratorisë. Por që të shkruajë poeti më i madh i një vendi në gjuhën e pëlqimit të tij, nuk do të thotë

se u mund gjuha kundërshtare. Me këtë përpjekje filloi një luftë që s'ka mbaruar edhe. Miqtë dhe mbrojtësit e gjuhës popullore shtohen dita me ditë, poetët më të mirë e zgjedhin si organin e shprehjes së tyre, por nuk mjafton. Kundërshtarët janë akoma shumë të fortë. Profesorët e Universitetit, pjesëtarët e Akademisë më vonë, shkencëtarët, glotologët më të mirë.

Nga ana tjetër, poeti *Aristotelis Vallaoritis* (1814-1879) i dha gjuhës popullore një freski të re; kritikë dhe prozatori më i madh i asaj kohe, *Emanuil Roidhis*, i hapi luftë ballë për ballë gjuhës së salloneve, megjithëqë ai vetë shprehet po në këtë gjuhë. Po është kjo pikërisht që ka rëndësi më të madhe. Vetë shkrimtari që shkruan në gjuhën zyrtare profetizon vdekjen e saj.

“Më pëlqen shumë gjuha popullore, por, mjerisht, nuk e di ta shkruaj”, shkruan ai më 1879 në *Idolet*<sup>9</sup> e tij.

Historiani i madh *Kostandinos Papparigopulos* dhe djali i tij *Dhimitros*, poet nga më të mirët e kohës së tij, shkruanin në gjuhën zyrtare. Poeti i ri *Joannis Papadhjamandopulos*, një talent i fortë, vjershat e tij të para në gjuhën greke i shkruan në gjuhën zyrtare; pak më vonë ai shkon në Paris ku vazhdon karrierën e vet poetike në gjuhën frënge me pseudonimin *Zhan Moreas*.

Dhe, mbas pak, kjo luftë e madhe gjuhësore do të arrijë në kulm me botimin e *Udhëtimit* të *Jani Psiharit*. Këtë herë ky hov erdhi nga Parisi.

Në këtë atmosferë gjendet Pallamasi kur filloi të shkruajë.

Ç’ duhej të bënte? Cila ishte gjuha që do të shprehej? Ja çfarë shkruan vetë ai më vonë:

“Ato ditë Roidhi merrte përsëri në duart e tij dhe e sillte prapë në mes çështjen e rëndësishme. Cila është gjuha që i ka hije poezisë së

---

<sup>9</sup> Idhujt.

re greke? Vetëm gjuha popullore mund të transmetojë prekjën e lartë dhe të ringjallë fantazmat në vepra fantazie. Me gjuhën e pastër nuk krijohen vjersha... Një ide e tillë atëherë, e shfaqur bile nga goja e një Roidhi, që diçka e re, e papritur dhe kryengritëse, e cila tundte dhe i hapte mendjes qiej të rinj.”

Pra, është e dukshme se ç’gjuhë do të pëlqejë poeti i ri, Pallamasi.

\* \* \*

Nxitohet të dalë përpara publikut. Ka shumë gjera për të thënë, ka shumë për t’i dhuruar popullit. Më 1885 pret relacionet e tij me gjuhën e pastër. Dhe më 1886 qarkullojnë *Këngët e atdheut tim*. Janë të gjitha në gjuhën e thjeshtë, në gjuhën e këngëve popullore. Edhe motivet e tyre akoma nuk largohen shumë nga format e vjershave të popullit. Këtu nuk është Pallamasi i mëvonshëm, katarakti i ndjenjave, burimi i mendjeve të larta. Temat, më tepër, janë ajo patriotike, e dashurisë, por që kanë një rëndësi të madhe gjuhësore. Gjuha fitoi edhe një poet tjetër, Pallamasin e nesërm, i cili do t’i japë një ngrohtësi dhe një gjallëri harmonike.

Edhe në vjershat e dyta, që mblidhen me titullin *Himni i Athinës*, nuk do të gjejmë poetin e madh. Këto na kujtojnë më tepër *Vjershat e vjetra* të Lekomte de Lisle. Në *Sytë e shpirtit tim* do të gjejmë ngrohtësinë e parë lirike, që do të karakterizojë tërë veprën e mëvonshme të poetit. Këtu frymëzohet nga mbeturit e kryeveprave klasike që shpërndaheshin në çdo hap të Athinës së atëhershme. Në disa vjersha të tjera frymëzohet nga historia dhe nga shkenca. Është një periudhë që influencohet nga parnasionët francezë dhe sidomos nga Sili Prudom (Sully Prudhomme).

Në hyrjen e këtyre vjershave do të gjejmë edhe kredon e poetit, atë që do të qëndrojë edhe si një shpjegim i madh i poezisë së tij.

“Poeti nuk pason. Ecën përpara. Është shkëndija, siç tha dikush, që ndez drutë e thata... Takon ndonjë herë që fjala e poetit të mos kuptohet. Përse? Sepse nuk janë lindur akoma ata njerëz të cilëve u drejtohet fjala e tij; do të vijnë edhe ata shpejt ose vonë. Nuk do ta shohin poetin, po do ta dëgjojnë t’u flasë nga thellësitë e vargjeve të tij shekullore.

Dhe, kur akuzohet si errët, shkruan: Sa më thellë ndien poeti, aq më thellë mendon.

Vjershat që do të lartësojnë menjëherë poetin dhe do t’i japin Pallamasit vendin e tij në poezinë greke janë *Jambët dhe Anapestët* dhe sidomos *Varri* më 1893. Të parat, të botuara në një librezë, i sjellin poezisë greke një tingull të çuditshëm. Diçka si e egër dhe kryelartë, disa vargje të qeta plot eksperiencë dhe hov lirik. Të gjitha këto janë strofa të vogla më një frymë mesjetare, këtu plot temjan<sup>10</sup>, atje plot pasion erotik; dhe të gjitha në toni e lartë të Himnit:

*Të dua o ty, si këngën  
heroike të Epirit...  
Ti kurrë nuk u dehe  
nga vera e ëndrrës..*

Poeti dashuron realitetin e shëndoshë, atë që nuk duhet nga ëndrra dhe nga fantazia.

Më poshtë do ta gjejmë melankolik, është një melankoli kjo që s’ka të bëjë aspak me pesimizmin.

---

<sup>10</sup> Një lloj rëshire që përdoret nëpër ceremoni fetare. Ajo lëshon një erë të mirë kur digjet.



*Fantazmë më quajnë njerëzit  
dhe largohen me frikë,  
i huaj gjendem gjithmonë  
në rrugën e shkretisë.*

I pëlqen të vuajë. Në vetminë e tij nuk qan, këndon dhimbjen me krenari dhe kënaqet. Në strofat e vogla gjejmë farën e të gjithë poezisë së mëvonshme pallamiane. Gjetkë do ta gjejmë më të pasur, më të dendur, por që këtej niset fryma e vërtetë e poetit. Këtu Pallamasi gjeti rrugën e tij. Këtu është shpirti i tij lakuriq me ngjyra bodleriane, do të thosha. *Për mua, shkruante Moreasi, kjo librezë është një kryevepër që bashkon ndjenjën patetike me atë të zakonshme: arti i poetit këtu di se ç'kërkon, është i prerë dhe i këndshëm.*

*Varri*, që doli pak më vonë, kur vdiq djali i tij i dashur, Alqis, është një elegji e pasur, një vaj i thellë që buron nga vajet popullore, duke kaluar tërë shkallën e dhimbjes. Poeti nga dashuria e madhe kërkon t'i krijojë djalit një statujë brenda tij, që të mos ta harrojë kurrë. Por nuk gjen lëndë që t'i përshtatet bukurisë së të vdekurit të vogël:

*As me pllak' mermeri,  
as me deg' floriri,  
as edhe me ngjyrat,  
që formojnë piktorët*

.....

Asnjë lëndë nuk mund t'i japë djalit bukurinë e tij të njomë. E qan në fillim me një vaj që i mund pasionet e thella njerëzore. Këto nuk

e pengojnë poetin ta bëjë dhimbjen e madhe një kryevepër të vërtetë. Dhe gjersa babai-poet kërkon t'i gjejë stolitë më të bukura, pa dashur i krijon kështu statujën më të përsosur me anën e harmonisë, me triumfin e lirezmit; në një strofë tjetër duket se bukuria e djalit për babën nuk mund të kapërcehet me anën e lëndës së vdekur.

*E preve vet mermerin  
për statujën tënde të dashur  
nga maja  
e bukuris s'ate virgjine...*

Djali, me bukurinë dhe dashurinë e tij, krijoi vetë statujën e vet, që është statuja e çdo djali, mirësia dhe shpirti i tij i pasur. Dhe ja një ditë:

*Por sa më tepër hapesh  
syri yt i pajfjetur,  
statujën që vizatohesh  
nga copa e njomë,  
kaq e shtrëngoje ëmbël,  
sikur deshe të ngrehje  
altarin me përqaftimin  
dhe brenda ta vendosje.  
Shtrëngimi yt i fortë,  
A! Sikur e treti.  
Iku... si shkumë mermeri  
dhe si ëndërr statuja...*

Djali krijonte vetë statujën e tij dhe një ditë e mori me vete. Vdiq, iku përgjithmonë. Më poshtë, babai-poet i lutet që të mos e harrojë babanë

e tij që aq e dashuroi. Më së fundi i jep vetes guxim, ngushëllohet se edhe ai, së shpejti, do ta pasojë. Pallamasi boton vjersha të tjera dhe, ndoshta, tani gjendet në epokën e tij më prodhuese, më të lartë. Për popullin do të mbetet *Poeti i Varrit*.

Kështu e thërrasin më tepër atë, se sa në emrin e tij.

Vazhdojnë më vonë *Jeta e palëvizshme*, më 1897. Këtu do të gjejmë një pasuri të madhe lirike, megjithëqë poeti bëhet i errët dhe më filozof. Një nga vjershat më të bukura të këtij vëllimi është *I vdekuri*. Në këtë vjershë poeti frymëzohet nga realiteti, të cilin e lartëson në kryevepër arti. Ishte koha kur banonte në shtëpinë e xhaxhait të tij, të cilit i vdiq djali i vetëm. Tërë shtëpia e qan ditë e natë, vite me radhë. Njerëzit në atë shtëpi rronin për të vdekurin dhe kurrgjë tjetër nuk mendonin:

*“Brenda këtu shpirtin e një të vdekuri marr frymë  
ku është i vdekuri djalosh i bukur dhe pa mjekrë?  
dhe në shtëpi diçka si dritë lëvizet or’ e çast,  
largohen ditët, çastet, po shuhen vitet dhe epokat...”  
Por si e dashuron, sa më shumë e do  
djaloshin e vdekur, trupin hije-bukur  
shtëpia e tij e vdekur, shtëpia hije-rëndë!  
Dhe duke dashur gjithmonë ta mbajë  
për gjithnjë të pandryshuar djalin e dashur,  
me kohë u ndryshua, dhe kjo nga shtëpia u bë varr!”*

Në një tjetër seri vjershash, në *Kthimin* do të gjejmë një Pallamas më të përsosur në formë dhe më të lartë në frymë. Këtu bukurinë e këndon me një pasion akoma më idolatrik. Këndon gruan e bukur, fshataren e thjeshtë dhe të shëndoshë. Nuk ulet toni i tij filozofik, por brumoset aq bukur me një lirizëm të thjeshtë:

*Akoma po lëkundet shelgu dhe lulëzon dafina  
dhe plepat tërë argjend dhe qitrot plot flori.*

Poeti mbetet akoma melankolik, por jo me kuptimin patetik.

*Mallëngjimin tënd këtu mos e braktis  
Me një kujdesje mëmëtare udhëto-e...*

Me *Dekalogun e jevgut* Pallamasi hyn në historinë dhe peripecitë e racës së tij, këndon vuajtjet dhe triumfet e saj. Është një vepër poetike e gjatë që, ndoshta, e lodh lexuesin me mendimet e grumbulluara, por së bashku me *Fyellin e mbretit* qëndron si kryevepra sintetike e poetit. Në të dy këto vjersha flet gojëdhëna epike dhe mendimi lirik. Kemi të bëjmë me një vjershë të vështirë. Jevgu është simbol i njeriut të lirë, i krijesit dhe i shkatërruesit së bashku. Në këtë Pallamasi përhapet në ikona dhe në simbole të gjata me një stoli të dendur lirike:

*Jevgat kanë ardhur të veshura  
me fustane feste plot ngjyra,  
jevgat kanë ardhur dhe mbajnë  
jordane të shkëlqyera, të trasha,  
me veshje të kuqe erdhën  
dhe me shamia të gjata dhe të verdha...  
Dhe erdhën të kurorëzuara  
me tërë lulet e majit  
dhe të stolisura me lule, mbanin  
në duar defe dhe çapraze...*

Duke mbyllur faqet e këtyre vjershave të rënda, kthehemi me dashuri në disa vargje të skalitura të poetit, vjersha që do të mbeten të pavdekshme për freskinë e tyre lirike:

*Kënga janinjote, smirinjote, stambollite,  
kënga me frymë të gjatë anadollake  
të mallëngjyera,  
se sa tërhiqni shpirtin tim!*

Por ç'mund të shpëtojë nga kjo kryevepër, në një përkthim në prozë? Pallamasi s'mund të përkthehet kurrë. She si mund të përkthehet një poezi që bukurinë e saj e bazon më tepër në harmoninë dhe në plasticitetin e fjalës, kur, sidomos, është poezi lirike?

*Me tin idhate, dhjavàtes qe peràtes,  
ti jinéka mu, tin agapitiqà mu?  
(Mos e takuat, ju kalues dhe udhëtarë,  
dashurin time, të dashurën shoqe time?)*

Dhe si mund të përkthehet ky simbolizëm idolatrik? Katër fjalë janë, por një botë e tërë:

*aqérja  
ta kalloqèrja  
ména llullùdhi  
(të gjitha verërat  
me një lule.)*

Poeti kaloi një rreth të gjatë krijimi dhe, kur arrin i lodhur në fundin

e jetës, bërtet i dëshpëruar, i penduar, ndoshta, për një jetë të thatë që kaloi.

*Libra, zyra, shtëpia ime,  
kënga, turp për mua,  
këmbët e mi të mitura  
kjo botë e palëvizur.  
Lot, llaftare, këmbënguljet,  
sëmundja ime dhe dridhja,  
të gjitha, një rrugë e huaj.  
për mua, rrugë e drejtë  
është ajo që do më çonte  
në jevgjit e pafrikshëm,  
që rrojnë të lirë në erë  
të lirë nga perëndit dhe njerëzit...*

U plak poeti, por nuk pushoi duke shkruar, shpirti i tij mbetet kurdoherë i njomë, djaloshar. Dhe tërë ky rreth i pafund krijimi- vjersha të rënda dhe të lehta lirike, synime të rënda poetike, novela plot gjallëri dhe përmbajtje shoqërore, drama- merr fund me vjershat e tij filozofike *Netët e fimjut*.

Dhe në një nga ditët e marsit mbylli sytë e tij jetën e tij që e kaloi të tërë në një qeli të mbyllur. Nuk udhëtoi kurrë, kurrë nuk doli jashtë Greqisë, shijoi botën, këndoi bukuritë e përbotshme përmes poezisë, përmes ëndrrës së artë. Dhe i la kësaj bote një vepër të gjatë, ku mbyllet një shpirt i gjerë, i pafund:

*aqërja  
Ta kalloqërja  
Mena llullùdhi  
(të gjitha verëra  
Me një lule.)*

*E diel, 14 janar 1940, faqe 3*

## **Shënime kritike**

### RRETH NJË POETI E NJË KRITIKE

Malseni ka pasur mirësinë, të merret me shënimet e mia kritike të shkruara disa kohë më parë.

Vërtet çështja është pakëz e vjetër, por nuk ka humbur aspak aktualitetin e vetë.

Kritika, kur bëhet pa ndonjë paramendim të keq, nuk shkakton pengesa për zhvillimin e një problemi por fillimin e një bisedimi në mënyrë që çdo kundërshtim të jetë i pranueshëm për të arritur, sa është e mundur, kufijtë e realitetit.

Në këtë lloj letërsie – kujtojmë kritikën dhe marrim si krijim-duhet gjithmonë që pika e fundit të mungojë krejtësisht: s'ka kufizim, se edhe problemet letrare janë poliedrike.

E ndajmë artin në shkolla: proklasike, klasike, aleksandrine, bizantine, romantike, parnasiane, neoklasike, realiste, surrealistike, futuriste etj.

Të gjitha këto kanë lidhje, kanë kuptimin e tyre. Por, mbi të gjitha, nuk gjendet veç se arti.

Dhe duke ardhur në problemin letrar, përfundojmë në këto: shkolla idealiste dhe shkolla realiste. Objekti kryesor i së parës është bukuria në thjeshtësinë e saj më të kulluar. E dyta nuk përjashton bukurinë, por nuk bëhet edhe skllavi i saj.

Janë çështje estetike dhe nëse kanë zhvillime të ndryshme, vlera e çdo shkolle varet te fuqia dhe vlera e shkrimtarit, e artistit.

Përmenda estetikën! Do të shtoj edhe diçka tjetër, meqë vlera e

artit nuk kritikohet veç se pikëpamja estetike.

Thamë se objekti i përgjithshëm i artit është bukuria. Por a është kjo absolute? Sigurisht, jo. Ndahet edhe kjo sipas teorisë së fundit të estetikës në: esthëtique- e bukur në kulmin e saj –inethëtique – e shëmtuar –anesthëtique – i painteresuar ose pa asnjë karakter estetik.

Këto janë bazat që lejojnë caktimin e gradës së vlerës së një vepre.

\*       \*  
\*  
\*

Dhe tashti, sa që “hekuri është i nxehtë”, lè të rrahim temën tonë.

Fillojmë me parullën që hedh Malseni:

“Rruga që ka ndjek në shkrimet e deritanishme N. H. Mahmudi, a asht rruga e drejtë dhe e saktë, rruga e këshillueme për shkrimtarë e poetët tanë të ri...?”

*Po përgjigjem:* Në se lloji i poezisë së N. Hakiut duhet të jetë i preferueshëm, kjo është një gjë që nuk i imponohet artit dhe sidomos në poezinë. Poeti duhet të ndjekë rrugën që i caktoi natyra dhe jo atë që dëshirojmë ne. Kritika kufizohet të përshkruajë realitete. Vetëm artisti duhet të këtë tre elementë ndërmend: logjikën, objektin dhe estetikën. Me këta elementë dhe me teknikën e poetit merret kritika. E udhëheq artistin në realitetin që duhet të korrespondojë me talentin e tij. Në kritikë ndjekim metodën përshkruese: ajo që është dhe jo ajo që duhet të jetë. Është metoda më e saktë kur problemi nuk i a ka arritur qëllimit të Artit të Lartë.

Vijmë në llojin e poezisë që unë, në shënimet e mia kritike, e karakterizova poezi zakonesh, poezinë e Nexhat Hakiut.

Ç’kuptojmë me fjalën poezi zakonesh dhe a e ekziston një lloj i tillë?



Malseni çuditet dhe, si duket, është e para herë që e dëgjon këtë lloj. Këtë lloj të poezisë e përul ose, më mirë, nuk e pranon aspak. Harron një “alamet” Homer, një Teofrast, një Virgjil dhe nga shekujt e fundit një Pushkin, krijimet e të cilëve nuk janë tjetër gjë veç se poezi zakonesh. Dhe ja, me pak fjalë, përcaktimi i këtij lloji: Është poezi që përshkuan jetën e fshatarit, të njeriut të thjeshtë, shqetësimet e tij, ndjenjat, në lidhje me zakonet e vendit të tij.

Por këta që përmenda janë poetë të mëdhenj. Po! Meqenëse janë poliedrikë nuk kufizohen vetëm në shfaqjen e jetës së thjeshtë, por janë të armatosur me lirizmin e bukolizmin. Dhe me dinamizmin e tyre poetik arrijnë Artin e Lartë- gjëninë.

Dhe me këtë idë, Malseni, nuk do të pranojë se poezia e N. Hakiut është poezi e zakoneve. Ja dhe shembulli ynë i marrë në fat:

*Eja, shoqe, tok me mua  
Eja shkojmë për në krua,  
Se kam frikë vetëm filli,  
Më vjen turp o... nga bandilli!*

.....  
Tjetër:

*Lërmë babë sa të rritem,  
Un' me kukulla po zbavitem.*

.....  
Nuk them se këto strofa, nuk janë të vërteta, nuk janë të mira. Në strofën e parë duket haptazi se heroina jeton në fshat. Dhe në të dytën, gjithashtu, kuptohet që vajza është një fshatare, gjë që duket më shumë në vazhdimin e vjershës.

Tjetër:

*Afër darkës në të ngrysur  
Rinte nusja të mullari ,  
Nuse, nuse moj shtatzëna  
Pse qëndrimin ta ka ënda!*

Ja edhe një nga strofat që Malseni i pranon si të ... përsosura:

*Nëno shpirti, nëno xhani  
M'u zvogëlua xhamadani....*

Të bukura në thjeshtësinë e tyre, në përshkrimin e jetës dhe shqetësimeve të popullit të thjeshtë të zakoneve të tij. Dhe më shumë akoma është poezi zakonesh, gjersa poeti lë të flasë tjetër, fshatarin, dhe jo poeti vetë për të. Më duket se nuk është nevojë të shtojmë edhe më për këtë çështje.

\*

\*      \*

“Intuitë e së vërtetës poetike” (η ποιητική διαίσθησις) si ka thënë dhe Aristoteli.

“Një vepër, thotë Kroçe, ka për detyrë të shfaqë jo një teknikë, jo një ndjenjë a një prekje, po intuitën e pandarë të një personaliteti”.

Guyau-i thotë: “Intuita është një ide e hollë, që buron prej lëndës. Është diçka që çdo njeri nuk e kap dhe vetëm artisti e kap dhe shfaq”

Është sekreti i një skenë, i një objekti që në pamjen e tyre të jashtme nuk paraqesin asgjë për çdo njeri të thjeshtë, por që artisti, talenti i tij, zhvillimi i tij i brendshëm e kap dhe, me anën e mjeteve gjuhësore,

mendore teknike, paraqet në sytë e popullit si një gjë që ekziston, që rron.

A ka njeri, qoftë dhe i thjeshtë, që vargjet e sipërme të mos i kuptojë dhe të mos i analizojë? Kurse intuita nuk analizohet me masa mendore me anën e prozës, me anën e fjalëve të thjeshta. Dhe kur përpiqemi për një gjë të tillë, ikën kallaji që e zbukuron, që i jep shpirt poezisë.

Intuita është elementi më kryesor i një talenti të vërtetë.

Malseni përmend retorizmin dhe stilistikën si elementë kryesorë të poezisë:

Përsosmëria stilistike=bukuria e vërtetë.

Ose duhet të mos e dijë kuptimin e këtyre fjalëve, ose nuk e di se ku e gjeti këtë teori! Është poezi konferenca? Sepse në konferencën dhe në fjalimet politike gjendet retorizmi.

Stilistika është rroba e jashtme e artit dhe jo arti vetë.

Dhe tashti mund të pyesë njeri:

- S'ka asnjë vlerë poezia e N. Hakiut?

Përgjigjem:

Diçka është e mirë, e vërtetë- por jo dhe e bukur, në kuptimin estetik një vepër arti, kur korrespondon me funksionimet shpirtërore dhe shoqërore, kur përshkruan jetën, kur shfaq mendimet e artistit. Dhe kjo thuhet vlerë e rregullt: vlera poetike e N. Hakiut. Vlera e rregullt është jeta, të cilën artisti përpiqet ta paraqitë me veshje arti pa sfumaturat e artit të vërtetë. Është poezia e zakoneve në fazën e saj të parë.

**Shkrimtarët e mëdhenj**

KNUT HAMSUN

*Shëtitësi i Norvegjisë dhe shkrimtari i madh.*

Më i panjohur nga të gjithë shkrimtarët e botës në letërsinë tonë, ta them edhe në popullin tonë, është mjerisht klasiku i madh, stilist i pa kalueshëm Knut Hamsun.

Duke ditur etjen e djalërisë sonë kulturore, prej sot e tutje do të fillojmë biografinë e shkrimtarëve më të mëdhenj duke nisur sot me Knut Hamsunin.

Evropa spirituale me bindjen e saj gjendet në gradën më të mirë të kulturës, e vaditur me klasicizmin e letërsisë paraluftarake, me sentimentalizmin e poezisë së pasur të Francës, me filologjinë e rëndë të gjermanëve dhe, më në fund, me dijeninë e shkrimtarëve të Anglitarëve pas shekspiriane. Suedia skandinave, aq larg nga rrymat spirituale të Evropës, në këtë kohë ka treguar lulëzimin më të mirë të historisë letrare të saj. Ibseni me frymën e tij të pa plakur, gjendet në mesin e qiellit të botës letrare me dijeninë e tij teatrale, me frymën e tij poetike të pa vdekur, trondit themelet e botës, nuk merr aspak parasysh aksionit e gjer tashme mbi artin e veprave teatrale duke krijuar sistemin e ri të vet që shkakton rutinën e që bazohet në ndryshimet e njëhershme të ndjenjave. Bjornsoni në këtë epokë krijon dhe formon kufijtë e romancës, që me emrin e tij shton katalogun e shkrimtarëve të mëdhenj të botës. Me fuqinë e tij poetike pasuron filologjinë evropiane dhe shtyn bashkatdhetarët e tij për një epokë të re letërsie.

Norvegjia, vendi Verior i Evropës, me ndriçimin e saj qiellor "Aurora Borealis", me buzëdetet e çuditshme të famshme "fjorde", gjer

sot i ka dhuruar plakës Evropës veprat më të thjeshta të letërsisë në stil e më shumë në lëndën e tyre.

Në një nga këto vende, në një fshat të vogël u lind në 1864 Knut Peterson, i emëruar me vonë Hamsun.

I varfër që ditën e parë që hapi sytë, fillon hapat e para, si këpuçar që të provojë më vonë të gjithë zanatet. E panjohur është nëse e ka mbaruar dhe shkollën fillore. Por diplomat në karakterin e tij janë të pavlefshme. Nuk asht nevoja materiale që ndryshon zanatet e tij, ashtu siç ndryshon i pasuri këmishën dita-ditës. Shtypet nga zemra e tij e çuditshme, nga ndjenjat e tij të pasura që përqafon me fuqinë të njëjlojshme si botën e atdheut të tij edhe atë... të Amerikës.

Në këmbët e tij toka s'qëndron aspak e sytë e tij shikojnë larg, vendet që nuk duken, ëndet që shpirti i tij i dëshiron dhe sytë e tij kullosin mbi hapësirën e botës...

Është rrugaçi i madh para se të bëhet shkrimtari i madh.

Në gjithë jetën e tij është nxënës dhe kurrë mësues.

Në moshën më të mirë, në moshën kur njeriu i qetë dhe i mirë studion, ngulet mbi bankat e shkollave, dhe në pushimin e tij dëfrehet me ëmbëlsirat e ndryshme të jetës, ai rrëshqet si hije në jetë, nga hapësira e tokës në ëmbëlsinë e yjve me një koronë në xhep vetëm për bukë. Por s'kërkon edhe më shumë. Është krijuesi i fatit të vet. I zoti për të gjitha e lë veten e tij mbi ëmbëlsinë e pa paramendimit dhe s'bën tjetër veçse mbledh përshtypjet e jetës me një kujdes të çuditshëm, dhe unë e tij paragatoj shkrimtarin e nesërm.

Universiteti më i madh i botës, jeta, e fut në sekretet e saj që në moshë më të njomë, kthehet nëpër rrugët e Stokholm-it pa qëllim, i trullosur nga hidhërimet e varfërisë. Por fati i ardhshëm i tij tall jetën mbi fytyrën e Knutit.

Ditën qarkullon duke vërejtur dhe natën kthehet në sofitën e tij

që me dritën e sparmacetës fillon krijimin e parë të tij, hapat e para më letërsinë me “Urinë”. Ditën ndjen mizorin e jetës së tij dhe natën e vizaton atë. Në moshën 21 vjeç qarkullon librin e parë “Uria”. I hodhi mendimet e tij të njoma, kundër fytyrës së jetës, por të pjekura edhe s’ka pritur pikën e kritikës.

Në atë kohë i lë kufijtë e ngutshme të Evropës dhe shkon si marinar në tokën e Rë. Zhvillimi i makinës e tërheq dhe etja e tij për studimin e jetës së rë e shtyn në zanate të reja. Bëhet tramvajer dhe, më vonë, mekanik i trenit.

Por nuk ndien akoma ndonjë kënaqësi. Kërkon jetën e thjeshtë, jetën e fshatit që nuk ngopet kurrë. Shkon me shokët e tij në fermat në fushën e pafundme t’ Amerikës dhe jeton jetën e fshatarit. Hëna, hapësira e pakufizuar, dielli i fortë dhe më në fund toka e pambuluar me çimento, me lulet e saj, janë elementë që e mbajnë skllave zemrën e tij. Ja toka e Norvegjisë, as ajo e Evropës akoma, por toka ku do që të jetë. Gëte më përpara kërkonte dritën, dhe i thjeshti Hamsun, ky njeri pa redingotë kërkon tokën, realitetin se edhe ky ka poezinë e vet. Ri shtrirë dhe dëgjon dridhjet e dheut me ëmbëlsinë primitive.

Kthehet prapë në vendlindje, i biri i pasosur, mëkatar. Por tashti është burrë 28 vjeç. Rikrijon librin e parë me tjetër formë dhe me stilin e thjeshtë, atë stil, që më vonë do të imitojnë shkrimtarët më të mirë të Evropës.

“Uria” e rë ishte me të vërtetë një kryengritje madhështore në botën e filologjisë. Ç’ishte ajo? Mos vallë vjershë á la hygojane, dramë á la shekspiriane, apo filozofia paradoksale niçejane? Jo njërën nga ato, por i kishte të gjitha së bashku. Poezia e çuditshme e Hamsunit, drama me të vërtetë e njeriut që s’ka bukë, filozofia e jetës e së thjeshtë por tronditëse, e shkundi romantizmin e Evropës që me aq zell luftonte Sainte Beuve. Meqë ribotim i këtij libri i siguroi një jetë të pasur shkrimtarit, për shumë

vjet nuk e ndërroi natyrisht aspak jetën e vjetër. Përshkon Suedinë krejt dhe Norvegjinë dhe fillon një jetë të rë pa asnjë vështirësi. Mban fjalimet për filologjinë në çdo qytet që shkon dhe kujtimet e tij i përmbledh në librin “Përshtypje udhëtimesh”. Vazhdon me “Rrugaçi”-n, një kryevepër e rë që e përshkoi fuqinë e librit të parë. Janë kujtimet e njoma të jetës së tij. Por “Benon” dhe “Roza”, që boton pas pak kohe, nuk mbeten prapa. Njëra më e mirë se tjetra. Në zhvillimin e tij s’bën tjetër përveç të përmirësojë stilin e tij dhe të pasojë çdo faqe me ide të thella dhe të zhvilluara. Në këtë kohë radha e volumeve të tij pasurohet me një tjetër kryevepër, “Viktoria”, një lartësim i ri i dijenisë së tij letrare.

Por më e mira nga të gjitha qarkullon ”Frytet e dheut”. Dëshira e tij që të qëndrojë në një vend, që etja e mëparshme e ka lodhur shumë. Është vepra që do të shtrëngojë akademinë kritike të Nobelit të japë çmimin e madh të njohjes së përbotshme. Dhe pa asnjë diplomë e thërrisin në universitete të ndryshme për të dhënë mësim filologjike, qoftë edhe një orë.

Dhe kur vajti për të marrë çmimin nga mbreti i Norvegjisë, ky me një ton të thjeshtë i tha:

– O shkrimtar i madh! Merr nga duart e mia të ulëta këtë çmim të varfër!

– Ju, një mbret, silleni aq thjesht përpara meje, përpara një njeriu të varfër dhe të ulët!

– Ne mbretërojmë në botën e jashtme të njeriut, kurse, në të vërtetë, ju jeni mbretër, prijësit e udhëheqësit e botës së brendshme njerëzore.

Mbreti i madh i Norvegjisë e pushtoi me thjeshtësinë e tij shkrimtarin e madh.

Që sot e tutje emri i tij përmendet më ëmbëlsi nga e gjithë bota kulturore, dhe me agoni presim çdo libër të tij për ta lexuar. Nuk

mbetet asnjë libër i pa përkthyer në të gjitha gjuhët e botës. Rrugëçi i palodhur bëhet shkrimtari i pandarë i çdo njeriu që ka kuptuar qëllimin e tij njerëzor, i çdo njeriu që ka besuar se jetë nuk domethënë vetëm gra të bukura dhe fruta të ëmbla. Dëfrimet, kënaqësitë shpirtërore e morale, janë të pavdekshme, të pangopura, kurse njeriu vjen rasti të lodhet nga jeta materiale.



## PIKTORI ITALIAN, XHINO ALBIERI (Nga bashkëpunëtori ynë në Romë, Jani Lili)

Arti i sotëm italian paraqit interes të madh. Stërnipat e gjenive të Rilindjes do të vazhdojnë, me të drejtë të tërheqin gjithnjë vërejtjen e mendimit të përbotshëm artistik.

Si çdo lloj arti, edhe piktura-sidomos në epokën tonë pësoi shumë ndryshime, rëndësinë e të cilave s' duhet ta harrojmë kurrë. Në të gjitha llojet e artit, formimi i epokës sonë solli ndryshime dhe çdo njeri s' mund të dijë arësyet e tyre edhe shumë kollaj artin e epokës s'onë e karakterizon si dekadencë.

Nga arti i sotëm mungon shpesh elementi poetik, nuanca lirike, që i jep frymë artit klasik. Elementi më kryesor i artit mungon. Dhe ç'element është ai që e mban në këmbë, pasi nuk mundet kurrë t'i zërë vendin? Arti i sotëm, më tepër nga të gjitha piktura, sjell me vete njohjen e lindjes së tij. Domethënë, bëhet art i zakoneve. Sot në pikturë nuk kemi art; nuk e kritikojmë kurrë absolutisht. Na caktuan rrugë, na dhanë fonde estetike. Shkolla, cilat do qofshin, vazhdojnë me dekalogun e tyre të justifikojnë dobësitë artistike. Megjithëkëtë, nuk duam të themi se paralelisht mungojnë artistët, që krijojnë në atmosferën e traditës klasike, ose të paktën të vaditur, të frymëzuar nga fetë e saja të shëndosha, pa u- bërë skllëvër të dobësive të një personaliteti.

Këto do të thoshim për ndryshimin e artit ndërkombëtar.....  
Artisti i sotëm i afrohet njeriut dhe arti i tij i drejtohet atij.

Me sfaqjen e futurizmit lindi pa dashje dyshimi i përhapjes së tij të madhe. Shumë e çuditshme edhe kjo: të lindi në vendin shekullor të klasicizmit, në Itali, kundërshtari i tij futurizmi!

Nuk duam të themi me këtë se është gjë e pashpjegueshme, po shumë dëshirojnë të mësojnë gjendjen e tij të tanishme në Itali. Me një interesim të ‘tillë nisemi edhe për të vizituar piktorin e njohur italian XHINO ALBIERIN. I shfaqim dëshirën tonë dhe, më pas, jemi të thirrur në studion e tij për një bisedim të gjerë artistik.

\* \* \*

Më parë nga të gjitha, studioja e Albierit është vetë art, një çudi. Është një nga ato shtëpitë që gjenden brenda ledhit, që rrethon një pjesë të Vila Borgezes. Një portë e vogël na lejon të ngjitemi në shkallët e shtëpisë. A jemi në Romë? Rrethanat na gënjejnë dhe na shpien në epokën romake. Gjendemi në katin e parë që nuk ka asnjë ndryshim nga ermitazhi i një filozofi. Një bibliotekë përpara dhe reth murit një seri harpash të vjetra, për të cilat piktori ka aq dashuri. Ngjitemi edhe një tjetër shkallë edhe hyjmë në follenë e artistit. Kudo kuadro, disa të mbaruara dhe disa që kërkojnë akoma dorën e artistit që të marrin formën e tyre të fundit.

Albieri është shumë pjellor, sa edhe poliedrik: portrete, “nature morte”, pamje deti, dhe të gjitha këto eleografira. Dhe temat e tija kurrë të kufizuara. Frymëzohet prej historisë dhe më tepër prej jetës së sotme. Një burim i madh frymëzimesh është jeta dramatike e Krishtit, mbi të cilin ka dhënë më të vërtetë krijimet e tija më të përsosura. Është akoma piktor i “Botës së varfër”, të cilën e paraqit me një gjallëri të veçantë. Toger në Luftën e Përbotshme, nuk e ka lënë të pa shfrytëzuar edhe këtë faqe të jetës së tij, duke i falur artit skena të pavdekshme luftarake. Po ajo që lartëson më tepër dhe që do të bëjë të mbetet i paharruar emri i tij në historinë e artit, është fakti se Albieri është krijuesi i “Aeropikturës”. Kjo na tingëlloi pak si çudi dhe pyesim:

- Ç’domethënë kjo, mjeshtër?

– Ecco!

Dhe na tregoi kuadrot e tija, që i ka bërë nga aeroplani. Besonim se kjo do të kishte të bënte me futurizmin, se edhe titulli i kësaj lloj pikturë është pak si guximtar në mos futurist.

– Dhe ç’lidhje ka kjo me futurizmin?

– Asnjë lidhje. Aeropiktura është art i vërtetë, që respekton të gjitha traditat e klasicizmit, po vetëm që objektet i vizaton prej së larti, “sul serio”.

– Si e pranoi futurizmi këtë mjet?

– Me entuziazëm; bile shumë kohë thoshte se ai e ka krijuar.

– Dhe ku qëndrojnë karakteristikat e futurizmit?

– Në kapjen dhe përshkrimin e zhurmës, në vizatimin e lëvizjes.

– Dhe është gjë që realizohet?

– Sa për kapjen e zhurmës, kjo më tepër i përket muzikës, mund të themi edhe poezisë akoma. Për vizatimin e lëvizjes, kërkon ekstremet, çasti më nevrík i njeriut. Një gjë është e ditur, se fillon të prapset në “Credo”-t e tij dhe pranon rregullat më kryesore të artit të vërtetë.

– Atëherë ç’dobi solli futurizmi në art? A i zgjeroi vallë kufijtë e tij apo i turbulloj atmosferën?

– Kurrëgjë nga këto. Solli vetëm kryengritjen e tij kundër traditës së pathyer akademike. I dha artistit liri të plotë për krijim.

– Kur filloi Aeropiktura?

– Më 1926. Dhe këtë lloj e pranuan me entuziazëm të vërtetë në Nju-Jork, në një nga ekspozitat e mia aeropikturore.

I kërkua artistit të na tregojë gazetën dhe revistat që kanë shkruar për artin e tij. Përveç shumë gazetave italiane, italo-amerikane dhe amerikane, shënojmë këtu revistat më serioze të artit që janë marrë me Albierin: “Augustea” e Romës, “L’Eroica” e Milanos, “L’artista Moderno” e Torinos etj.

Albieri, pra, është një personalitet artistik i gjerë dhe poliedrik,

që s'ka arritur akoma përsosmëni klasike, që nuk ësh gjeni, po edhe vetë nuk dëshiron komplimente të tepërta. Është artist i vërtetë, poet, dhe në periodën e tij krijuese më të mirë.

– Jam i ri! - thotë.

Dhe me këtë lë të kuptojmë se ka për të dhënë dhe më shumë akoma, se nuk ka treguar gjithë fuqinë e tij artistike, dhe se edhe ai vetë nuk dëshiron të qëndrojë në shkallën e sotme, e cila, sa do mirë, nuk e kënaq artistin e shqetësuar.

Një talent i tillë, një personalitet i tillë artistik italian ka vizituar edhe vendin tonë, duke shpënë Shqipërinë e vërtetë në Romë me 28 kuadro.

\* \* \*

Le të hedhim një sy të shpejtë në kuadrot e tij shqiptare më karakteristike, që ekspozoi në sallën e posaçme të Ekspozitave në Romë (Via delle Terme, 101) nga 26 shkurti gjer 15 mars.

Kuadri nr. 12- “Familje Dukagjinase”. Me pak vija piktori mundi të ngjalli rrethet shqiptare. Malet saqë duken, dhe midis qetësisë, midis natyrës primitive, udhëton një familje. Krenaria e burrit që çan rrugën, ëmbëlsia e tij duke përkëdhelur kokën e trashëgimtarit. Shikoni edhe pozën e të voglit. Dhe nëna po ndjek fatin e saj që varet nga burri. Dhe sa gjë e madhe fytyra e vetvet!

Kuadri nr. 19- “Malësori i Tomorit“. Ja edhe një nga skenat më tipike malësore. Në fytyrën e tij zgjidhet problemi i madh filozofik.....

Këtu mbaron biseda, intervista jonë e parë me një nga artistët italianë. Shumë shpejt do të kemi fatin të dëgjojmë edhe artistë italianë të tjerë në të gjitha llojet e artit.

## “SHKËNDIJA”

*E përkohshme letrare dhe artistike*

*Viti I- nr. 3, 1940, faqe 37-40*

### KRITIKU DHE SOCIOLOGU VANGJEL KOÇA

E madhe ose e vogël, e pasur ose e vobektë është një letërsi, kërkon udhëheqësin e saj. E pjell, pra, ajo vetë, dhe personaliteti i tij duhet të jetë i lidhur ngushtësisht me vlerën e artit që merrte. Duhet, pra, të ekzistojë një letërsi-mbi këtë më tepër e kemi fjalën- duhet të rrojë që të mundet udhëheqësi i saj ta drejtojë, sipas zotësisë së tij ndriçuese. Dhe kur kjo letërsi është e varfër në prodhim, e vetmuar nga tradita, personaliteti i saj duhet të jetë pa tjetër formimi i kulturës së huaj, një personalitet i themeluar dhe zotërues i shkallës së jetës shoqërore dhe kulturore të vendit të vet. Kështu mundet, besnikërisht dhe asnjësisht, t'i japë udhëzimin e duhur, me besimin e një lartësimi të ardhshëm.

Për një letërsi që edhe belbëzon, që të shkëputim këtu një frazeologji karakteristike të Gideit, është i domosdoshëm një personalitet i fortë, që t'i japë formën e saj të drejtë dhe të përsosur. Por letërsia e jonë gjendet në hapet e saj të parë, dhe nuk duhet të jemi kërkues për sa u përket përpjekjeve të saja.

Kur fillon, pra, prodhimi i saj serioz, që t'i caktojme një moshë? Shumë- dhe jo pa të drejtë fare- duan të besojnë se fillon me Rilindjen tonë Kombëtare, d.m.th. fillon që nga 1878-a. Por do të thosha se kjo letërsi është thjeshtësisht patriotike dhe natyrisht, si art me qëllim që është, nuk mundet sot të mbahet në këmbë. Nuk mund të qëndrojë kryeshembull, për një imitim prej djalërisë së sotshme të zhvilluar. Nuk është e thënë që

një letërsi të ngjallet pa qëllim; d.m.th pa i munguar përsosmëria artistike.

Por edhe çdo vepër arti, së drejti ose tërthorazi, ka qëllimin e saj, misionin edukativ, shpirtëror, lartësimin artistik. Dhe në këtë periudhë shqiptare ekziston pasioni, një pasion që nuk mund të kristalizohet në art. Kështu që, me gjithë që frymëzimi dhe paradispozita poetike nuk mungojnë nga poezitë e Naim Frashërit, nuk arriti atë përsosmëni e domosdoshme që do t'i mbante të gjalla nga pikëpamja artistike. Kujton kush se gjithë ky brez letrar, ngutej të krijojë sa për arritjen e qëllimit, sa për lartësimin e turmës në kuptimin e lirisë kombëtare. Me ç'të drejtë, pra, që krijimet e kësaj periudhe të parë të jenë të pasuruar me gjithë pasionin e duhur, kurse paralelisht çalojnë pa shërim nga pikëpamja e artit të vërtetë.

Këtu, pra, duhet ta kërkojmë fillimin e letërsisë sonë? Do të akuzoheshim për padijení të plotë, në qoftë se nuk merrnim parasysh një letërsí tjetër, atë letërsí kryeshkrimtarësh që janë fryte të kulturës italiane.

Këtë letërsi e gjejmë në fillim të shekullit XIX, atëherë që lulëzuan de Rada dhe Skiroi. Dhe është për t'u çuditur mjaft, sesi në atmosferën romantike të këtij shekulli, letrarët tanë italo-shqiptarë mbetën të pangacmuar nga epiko-romantizmi i asaj kohe....

\*

\* \*

Me ikjen e epokës epiko-romantike të Naimit, do të priste kush nga brezi i ardhshëm vepra më të përsosura. Gjatë kësaj periudhe të re është e vërtetë se dallohen talente të fortë. Shquhet përnjëherë At Gjergj Fishta, personalitet poetik i fortë që qëndron mi karakteristika neo-romantike. Poet sintetik, mendje e lartë është' ai që në këtë periudhë na fali një poezi kaq të fortë. Një poezi e formuar përsosmërisht, e brumosur me virtytet e tij të mëdha poetike-lirike, protagon, me një paradispozitë

homerike, një poezi që përmbledh nëpër vargjet e veta, karakteristikat më kryesore të romantizmit. Është shumë epik, por arti i tij nuk largohet prej klasicizmit.

Si bashkëkohës të kësaj periudhe shfaqen Asdreni dhe Çajupi. Këta, më të përlulur në frymëzimet e tyre, më të matur në shprehjen e tyre, ndjejnë frikë të hipin nëpër majat e lirizmit. Më klasikë, pa qenë më të lartë se i pari, janë më tepër vjershëtarë dhe në këtë lloj, do të mbeten introductorë të këngës lirike. Një tjetër, që për kohën e tij jo aq të zhvilluar, mbetet si një fenomen poetik, është Mjeda. I thellë në thjeshtësinë e tij është i pajisur me një përsosmëri dhe harmoni muzikale të çuditshme në përmbajtjen e saj, fenomen për letrat shqiptare.

Njëkohësisht, proza gjendet në periudhën e saj të parë, porse dhe në një lulëzim të plotë. Faik Konica, Mithat Frashëri, Fan Noli.

Faik Konica, plazmuesi i parë dhe më i madh i toskërishtes, paraqitet prozator krijonjës.

Mid'hat Frashëri: dijetar, bëhet i pari novelist shqiptar.

Fan Noli, përkthyes dhe historiograf, rikrijoi disa nga kryeveprat letrare ndërkombëtare me përkthimet e tij të shumë çmuara, Shekspir e Servantes, Omer Khajami, Ibsen etj. Përkthimi shqip i Khajamit , i cili është më i miri nga sa janë bërë në gjuhët e tjera, - si dhe përkthimet e tjera të tij janë kryevepra të vërteta për letërsinë e varfër shqiptare.

Kur po ekziston lëvizja letrare, kritika është lloji i panjohur. Dhe me dukjen e brezit të Ernest Koliqit dhe të Lasgush Poradecit, del në dritë një talent me pseudonimin Vangjo Nirrvana. Opinioni ndiqte me kureshtje prodhimet e tij. Bota nuk ishte mësuar me “saggion” dhe me kritikën. Por nuk u vonua të kuptojë rëndësinë dhe kuptimin e tyre. Herë në shtypin e përditshëm, herë në të përkohshmet, kritiku, saggjografi i shumanshëm, estetik, nuk mungonte të thoshte fjalën e tij për çdo çështje kulturore. Dhe arriti dita që ta respektojnë dhe ta dashurojnë,

kurse në krye e armiqësonin dhe i trembeshin për rreptësinë e tij. Është ai, pra, krijuesi i kritikës shqiptare? Po! Puna ime më ka sjellë kurdoherë në bashkëbisedime dhe duke respektuar mendimin e tij të ndritur, asnjansinë e tij, më së fundi vendosa ta vizitoj për një bisedim letrar të zgjeruar sistematik. Bisedim i shumanshëm rreth letërsisë sonë që përfundoi me intervistën e sotshme letrare lakonike.

Ky bisedim ynë është çështje kohe dhe jo diçka e shpejtuar. Është mendimi i tij i pastër, i ngadalshëm, i vetvetishëm. Dhe që në krye, përveç hyrjes sonë të varfër dhe të shpejtuar për letërsinë tonë, i kërkojmë mendimin e tij:

– Cilët nga shkrimtarët e vjetër ai kujton më të mirë, d.m.th. ata që do të rrojnë në historinë e artit të vendit tonë.

Është' e ditur se janë pak, të varfër në prodhim dhe jo të mëdhenj në vlerë letrare. Përveç De Radës dhe Skiroit, Naim Frashëri si poet kombëtar mund të qëndrojë dhe si artist përmes vjershave e tij të pakta buklike. At Gjergj Fishta, më i pastajmë nga i pari, është epik-popullor me një vlerë të veçantë në letërsinë tonë. Një tjetër seri, është Andon Zako Çajupi, Asdreni dhe Prendushi, Një kapitull tjetër për letërsinë shqiptare përfshin Mjeda.

– Si e shihni ju zhvillimin kronologjik të intelektualizmit shqiptar?  
 – Shtytjen e parë ia dha letërsisë shqiptare periudha kryengritëse e Rilindjes Kombëtare, etja për liri, dhe përgjithësisht ndjenja e porsangjallur kombëtare. Pikërisht prej kësaj periudhe numërohet dhe lindja e saj. Pasi u formua Shteti Shqiptar me shporrjen për jetë të sunduesit, letërsia shqiptare vazhdon të ndjekë rrugën e saj të nisur për formimin e një ndërgjegjeje kombëtare. Pra, vlera e përgjithshme e artit shqiptar gjatë kësaj periudhe, konsiderohet si atdhetare, përveç Gjergj Fishtës, Prendushit dhe Mjedës, që me fuqi e tyre poetike kapërcyen kufijtë e ngushtë të letërsisë atdhetare, duke u përgjithësuar aq sa që sot



qëndrojnë nëpërmes dy brezave, brezi patriotik dhe atij që dita-ditës ecën brenda kësaj periudhe të transformimit të vetë.

– Cilat janë talentet e sotshme që dalloni?

– Periudha e brezit të tretë nuk i fsheh fare vlerat e saj. S’ka përsëri pret kritikën e së nesërme që do ta vendosë me paanësinë e saj në një vend të merituar të historisë së artit shqiptar. Dallim preferues shkrimesh ka bërë që kur vetë populli, është munduar të gjejë veten e tij te filan poet ose filan shkrimtar. Ky dallimi im i sotshëm as vlera ka për të rrëzuar as të përbuzurit ka për t’i lartësuar. Poet lirik, poet i harmonisë dhe i muzikës, është Lasgush Poradeci. Përkundrejt Ernest Koliqi si poet lirik qëndron me karakteristika të veçanta prej të parit: paganizmin dhe mendimin e plotë, idenë e përmbytur në filozofi, Koliqi i jep rëndësinë dhe kuptimin e duhur përmbajtjes; d.m.th. arti i tij, ndjenja e tij, prapsen përpara mendimit dhe shfryrjeve të veta lirike, teksta Lasgushi paraqitet më i disiplinuar, adhures i verbër i formës, i harmonisë. Koliqi gjithashtu nuk mbeti i njëanshëm; u dashurua dhe këndohet si prozator, sepse si i tillë është krijuesi i novelës shqiptare, transformuesi i saj i parë. Rreth të dy këtyrëve zë të brumoset brezi i tretë, i pasluftës, brezi i letërsisë paspatriotike. Në krah të këtyre të dyve qëndron edhe Ethem Haxhiademi si poet dramatik. Haxhiademi mund të quhet me të drejtë krijuesi i tragjedisë klasike shqiptare. Prirja e tij mendore e shpirtërore e shtyn për nga vjetëria greko-latine dhe përpiqet të mbari në shqipen frymën dhe teknikën e tragjedisë klasike.

Kemi, edhe ne fenomene në letërsinë tonë të varfër. E kam fjalën për poetin Migjeni, që me origjinalitetin e tij ndriçon si një mrekulli në kronikat e letërsisë sonë. Por Migjeni vdiq në lulen e djalërisë së tij, kështu që s’mundemi t’a profetizojmë zhvillimin e fenomenit migjenian të paharruar. Po atë fat, mortjen e pakohshme, patën edhe dy poetë të tjerë, të shquar: Platonius dhe Helenau. Prej të rinjve shquhet një seri

poetësh dhe prozatorësh tepër interesantë: Nexhat Hakiu, Dhimitër Shuteriqi, Vedat Kokona, Aleks Çaçi dhe Sotir Caci. Është një e vërtetë se poezia shqiptare ndjek rrugën më të mirë të saj, sepse ka një farë të shkuare; por nga ana tjetër edhe proza paraqit një interesim të madh. Koliqi, natyrisht, do përkujtohet si krijues novelist, që gjer sot s'e pati shokun. Novela shqiptare gjendet akoma në një epokë transformimi, sepse një përjashtim i mirëpjekur nuk mjafton t'i japë karakterizimin e përgjithshëm. Prej novelistëve më të rinj me talent të fortë janë Ndoc Logoreci dhe Vedat Kokona. Por se edhe Helenau dhe Platonicus na falën novela shumë të mira; letërsia jonë mbështet shpresa të mëdha dhe te Sterjo Spasse, prodhimi i gjertanishëm i të cilit premtion shumë.

– A ka midis publikut shqiptar ndonjë pjesë që interesohet për lëvizjen intelektuale, që vë re me vëmendje përparimin intelektual?

– Po, ka midis publikut shqiptar një pjesë të tillë, që dita-ditës zgjerohet. Një shtyllë e fortë mbi këtë pikë është shkolla jonë e mesme, atje ku mësohet me seriozitet, me dashuri greqishtja e vjetër, latinishtja, dhe në një shkallë të gjerë letërsia moderne evropiane. Porse dhe të rinjtë që ndjekin Universitetet e jashtme, sollën një influencë të madhe në transformimin e publikut tonë intelektual.

– Cili është qëndrimi i shtetit përkundrejt letërsisë? Dua të them si e pret këtë lëvizje? Nëse kohët e fundit interesohet, nëse e përkrah?

– Shumë me vend pyetja. Shteti me ose pa interesimin e tij, luan rol të art. Jashtëzakonisht në Ballkan dhe më shumë në Shqipëri shkrimtarët rojnë me një mjeshtri tjetër, në mos daçin të pranojmë zemërgjerësinë e një ministri apo deputeti. Gjer dje akoma asnjë përkrahje nuk dukej

fare.....

– Ç’ lloj influence të jashtme pranoi dhe vazhdon të pranojë letërsia shqiptare?

– Mungesa e një tradite të pasur të vendit, e shtrëngon artistin shqiptar, jo vetëm ta pranojë influencën e jashtme – një gjë që ngjan në çdo letërsi akoma edhe kur s’i mungon tradita - por dhe ta përqafojë letërsinë oksidentale si një traditë të vet. Pranon, pra, influencë nga çdo shkollë e Perëndimit, bile në një pikë, paka-shumë imituese me masën e fuqisë së artistit.

– A ka kritikë shqiptare që mundet të udhëheqë një lëvizje, që mundet të lartësojë një talent?

Të paktë janë kritikët e mirë shqiptarë dhe këta, mjerisht, nuk çajnë akoma drejtimin për një formim gjendjeje intelektuale të stabilizuar. Kritikë me vlerë sqaruese si Kristo Maloki dhe Mitrush Kuteli, këtu, merret me mend se bashkëbiseduesi im nuk mund të përmendë dhe veten , nuk na dhuruan vepra sintetike, nuk i sollën dobinë e duhur letërsisë së vendit të vetë. Janë në një gjendje mendore të tillë, që letërsia e jonë priste diçka më tepër nga kritikët.

\*

\*       \*

Këtu i dhamë fund bashkëbisedimit tonë dhe duke mbaruar do të shtojmë pa e tepruar se në ka një kritik që me kaq përulësi kontribuon në lëmin e kritikës udhëheqëse, në lëvizjen letrare shqiptare, është padyshim po ai që nënshkruan Vangjo Nirrvana.

## ARTI DHE KRISTIANIZMI

Dihet se arti klasik, arti i përsosur i helenëve dhe i latinëve e ndali rrugën e vet, rrugën e zhvillimit, qysh prej ardhjes në botë të Jezu Krishtit.

Këtu gjendet një vërtetësi që edhe fanatiku i madh s'mundet ta mohojë.

Ja një pyetje, sinqeritetin e së cilës nuk mundemi ta kundërshtojmë:

Cilat janë veprat letrare e, përgjithësisht, artistike që prej kohës kur u shfaq Krishti?

Duke diskutuar rreth kësaj pyetjeje, lehtësisht dhe jo në mënyrë sofistike, arrijmë në këtë përfundim:

Kristianizmi qëndroi varri i klasicizmit, por edhe epoka e drejtimeve të reja në letërsi dhe në pikturë.

\* \* \*

\*

Ja rrethanat, atmosfera morale e ideologjike në errësirën e të cilave shkëlqeu personaliteti qiellor i foshnjës së Nazaretit.

Perandoria Romake pas një rrugëtimi gllorizoz humbi drejtimin e saj që i dhuroi një Jul Çezar, drejtësinë e famshme që i dha personaliteti i një Ciceroni dhe i një Virgjili. Pas diellit vjen furtuna dhe, pas atyre erdhën Neroni e Kaligula. Padrejtësia dhe fariseizmi arritën në shkallën më të lartë. Një epokë e tërë kryeveprash u pasua nga një epokë e tërë shkatërrimesh. Erdhi epoka e imoralitetit. Njeriu nuk ndiente më qëllimin e tij të vërtetë, e harroi misionin e tij. Bota, e mbytur në frymën e injorancës, bëhet shërbëtoresh, skllave e njerëzve që nuk kishin në brendësinë e tyre asnjë cilësi njerëzore.

E kush do të ishte i zoti të kishte guximin e një kundërshtimi të madh dhe të një rrëzimi prej bazave të këtij sistemi. Asnjë tjetër, përveç të Birit të Perëndisë, përveç atij që është vet Zot.

\* \*  
\*

Njerëzia e atëhershme me një shpresë ringjallëse i drejtoi sytë e saj te Krishti që pa frikë shpërndante nënqeshjen e tij metafizike, jepte kurajën e jetës së vet. Dhe atëherë sytë e të gjithëve u ndalën në sytë e tij qiellorë dhe dhuruan jetën e tyre në vullnetin e tij, në dëshirën e Perëndisë.

Edhe vetë njerëzit e mendimit, duke vënë re drejtësinë dhe sinqeritetin e pavdekshëm të fjalëve të tij, lanë të gjithë krijimet e tyre artistike, mblodhën gjithë dinamizmin e tyre në teorinë e tij, që dukej atëherë në horizontet e errëta.

Poeti dhe skulptori lanë sallonet e princit mikpritës dhe ndoqën rrugën e vetësakrificës që inauguroi Krishti. Penda dhe kavaleta u harruan në ndonjë cep dhe i zoti i tyre mori një kurriz kryqin e martirizimit.

A nuk ishte ky një shërbim më i madh nga ai i krijimit të pa ndonjë qëllim të caktuar? Ja, pra, ku qëndron arsyeja e ndaljes së klasicizmit. Mënjahohet tashmë *arti për art* dhe vihet në veprim *arti në shërbim të popullit*.

\* \*  
\*

Edhe kur fanatizmi i madh ndalet në besimin e patundshëm, atëherë njeriu kthehet për atje ku është dedikuar. Apostull Joani, i frymëzuar nga besimi i tij, merr pendën dhe shkruan në mënyrë madhështore poetike

zbulimin e vet të famshëm. Nga ana tjetër, apostull Pavli, i ndriçuar prej frymës hyjnore, shkruan letrat e tij të shquara, që nga pikëpamja filozofike e moralit nuk kanë të krahasuar. A nuk gjejmë poezi në Gojarti, në Shën Vasili i madh, në Grigor Teologu e në shumë të tjerë.

Gjithashtu edhe mesjeta ka për të dëftyer shkrimtarët e saj, gjenitë e saj, nga të cilët më vonë do të shijojmë edhe vlerën e tyre.

\*            \*  
\*  
\*  
\*

Pra, edhe kristianizmi i dhuroi letërsisë kryeveprat e tij të pavdekshme dhe i dha drejtime të reja artit. Nëse gëzojmë sot një Dante, këtë ia detyrojmë mesjetës. Dhe Rilindja është fryt i kristianizmit. Mishel Anzhelon dhe Da Vinçin i lartësoi kultura kristiane, nërsa Teotokopulosi (Greko) gjeti rrugën e tij në ngjyrat e pikturës bizantine.

24 dhjetor 1939

## A N T O L O G J I

### DHJETË POETË

Po të besojmë se poezia është ajka e mendimit njerëzor, lule mendore e pavdekshme dhe, sipas Valerit, krijimi më i bukur i shekujve, nga kjo pikëpamje nuk mbetemi aspak të kënaqur nga leximi i poetëve tanë të rinj. Në qoftë se poezia nuk ka ndonjë lidhje me epokat, me rrethanat, me atdheun e poetit, atëherë rreptësia është masa më e duhur për kritikën e saj.

Por kjo nuk u intereson... poetëve tanë.

Zhvillimi i poezisë lirike, për këtë e vetëm për këtë e kemi fjalën, ka pësuar një ndryshim të veçantë, të cilit duhet t'i japin rëndësinë e duhur. Është e nevojshme një hyrje e vogël se mjerisht poetët tanë të rinj, meqë na mungon tradita letrare, janë të detyruar të ndjekin gjurmët e poezisë evropiane.

Naim Frashëri nuk është ai që mund të japë me vlerën e tij poetike shembullin për të rinjtë. Poezia patriotike nuk është ajo që ne sot e karakterizojmë klasike. Retorizmi, romantizmi dhe mospunimi i frazës është poezia e qëllimit.

Është ndryshe mendimi që kemi, kur merremi me Fishtë. Tek ai poezia fiton kuptimin e saj të vërtetë. Ndërsa shokët e tij si Çajupi, Asdreni, meqë iu mungon fryma e madhe poetike, punojnë nën atmosferën e pastër të klasicizmit.

Por brezi që përqafton me më gjerësi artin e vërtetë është brezi i Lasgushit, i Koliqit. Këta janë poetët që përbëjnë rrethin e parë të poezisë

së pastër, të poezisë lirike.

Më pas vjen brezi i tretë, i mbështetur në brezin e mëparshëm dhe i ndihmuar nga poezia evropiane, sidomos nga poezia e shek. XVIII-XIX.

Pra, kemi traditë letrare që duhet të respektohet prej poetëve tanë të rinj? A mund të formojë traditë një brez i varfër dhe i vogël?

Absolutisht është provuar, pra, se poetët tanë influencohen prej poezisë evropiane, në pasurinë e së cilës çdo njëri gjen apo jo veten e tij. Nëse tani poetët tanë e çlirojnë veten nga influenca e rrezikshme që verbon personalitetin e artistit, këtë do ta shohim më poshtë.

Është e pranueshme se rrethanat tona të varfra, jeta e varfër shpirtërore, mungesa e dramave njerëzore me ndikimin e një qëllim të madh, nuk e lejojnë artistin të frymëzohet. Kështu që ai është i shtrënguar të mbyllet në vete dhe un-i i tij nuk zgjohet, në qoftë se nuk e shtynjë rrethanat.

Mosqenia e kësaj lënde të parë dhe të domosdoshme, mosekzistenca e jetës kolektive, shkëmbimi i fryteve mendore midis tyre, e detyrojnë poezinë të mbetet personale.

\*            \*  
\*  
\*

Po nisim me *Helenaun*, poetin e parë të *Antologjisë*. Ky poet përfaqësohet me dy vjersha: *Kur mendoj* dhe *Hanës*. Mjerisht për sot do të kufizohemi me kaq, meqë nuk mund të formojmë një ide të plotë për vlerën e tij poetike. Ai karakterizohet nga paradispozita e sinqertë dhe mendimet e tij jo të shtrënguara. Vargu i rrjedh shpenguar. Fryma e tij është pesimiste me një ëmbëlsi të varfër dhe të përciptë. Familja, fshati e atdheu janë në qendër të poezive të tij. Frymëzimet e para të një poeti, por që mbeten, që kufizohen në thjeshtësi duken edhe në këto vargje:



*Në prehën të nanës, në shtëpi tu votra,  
aq i lumun me vlla e motra.*

Nuk vihet re asnjë përpjekje lartësimi, por mendime të ngadalta, të nxjerra pa asnjë luftë të brendshme. I mungon organizimi artistik. Veç melankolisë që nuk bëhet art, na mallëngjen skena, pozita e tij e gjorë dhe mospërsosmëria, harmonia poetike

Dhe në vjershën e dytë poeti qëndron po në atë atmosferë dhe monotoni. Kështu romantizmi përshkon trupin e tij, një romantizëm djaloshtar që më shumë na shtyn në gjumë. Ku është poeti rapsod me frymën e tij madhështore? Këto janë vjershat e tij më të bukura që zgjedhi hartuesi i *Antologjisë*.

Duke filluar me *Migjenin*, bota jonë shpirtërore ndryshon, bile përnjëherë me vargun e tij të parë:

*Thellë në veten t'eme flejnë kangët  
e pakëndueme.*

Autori dramën e tij e bën poezi. Një dramë e gjerë njerëzore që mund të ketë si fillim vobektësinë, por që më poshtë e lartëson në dramë të vërtetë shpirtërore. Dhembja vadit gjithë trupin e tij, që përpiqet ta derdhë në kallëpet e artit.

*Por kur t'i vijë dita të gjitha ka me i qitun  
në një mijë ngjyra të bukura, që nuk vdesin.*

Poeti e di vlerën e tij, që sot nuk i njihet, por shumë shpejt do të fitojë famën që e meriton. Gërmon zemrën e tij me kënaqësinë e një të plagosuri, që prehet me fërkimin e plagëve të tij.

Dhe vjersha e dytë, *Kanga e të burgosurit*, qëndron në atë ton. Këtu poeti frymëzohet nga realiteti. Fjalët e tij nuk luajnë me kuptimin, por këto i shfaqin skenat në të gjithë tragjedinë e tyre. Realiteti lartësohet në art dhe nuk mbetet në thatësinë e tij të tmerrshme.

Por atje, ku *Migjeni* lartësohet më shumë në atmosferën qiellore të lirizmit është në masat e lira.

*Ballada qytetse*. Në këtë poezi ritmi madhështor, i shpejtuar atje ku duhet, arrin në horizontet e harmonisë së klasicizmit.

*Dikur,  
kur gjit e saj me kreni  
shpërtheshin n'aromë,  
kur ish e njomë-  
atëherë e dashunojshin shumë zotni.  
E sot?*

Drama njerëzore jepet me gjithë trishtimin e saj. Dhe fjalët, ato fjalë janë aq të harmonizuara, aq të zgjedhura për poezinë e tij.

*Migjeni* nuk ngjason me asnjë dhe ngjason me të gjithë poetët që janë nisur të bëhen të mëdhenj. Por, mjerisht, për ne vdiq aq shpejt, sa që s' na mbeten veç zërave të tij, që e përcaktonin për poezinë e madhe.

Vendi nuk na lejon të zgjatemi, të ndjekim frymën e tij të madhe që i përngjan aq shumë frymës të një *Poe* dhe të një *Uitmani* të dhembjes dhe jo të gëzimit.

*Platonikus* për burime poetike shfrytëzon melankolinë dhe një pesimizëm vdekjeje. Nuk i mungon frymë e vërtetë, por, me gjithë pjekurinë e vargut, nuk na prek. Duket më shumë poet i mendimit. Dhe fjalët e tij janë antipoetike, me gjithë gjallërinë e tyre. Poezi lirike me një ton të mërzitshëm. Nuk i afrohet ëmbëlsisë së lirizmit të thjeshtë. Aty-

këtu gjenden vargje të bukura si këto:

*N' thithje andrimtare sa kot shijova.*

Shumë herë të tilla vargje e shpëtojnë vjershën nga *vdekja*, por që mjerisht u mungon harmonia e duhur e lirizmit. *Platonikus* është poet i fisëm me mendime të larta, por që s'kanë arritur atin. Është poet i vjeshtës, i ditëve të mërzitura. Me vdekjen e tij të parakohshme poezia shqiptare humbi një talent të singertë, zhvillimi i të cilit do të na jepte frytë të bukura poetike.

\*       \*  
\*  
\*  
\*

Me ata që jetojnë, nuk do të merremi gjerë sot, pasi ata kanë përpara vitet më të bukura të krijimit; bile shumë ende s'e kanë gjetur personalitetin e tyre.

*Dh. Shuteriqi* është e ditur që rrjedh nga shkolla bodleriane. Edhe imitimi i vetëm një poeti të madh na bën të shpresojmë por edhe të dyshojmë. Një personalitet i madh e humbet talentin, sa dhe e lartëson atë. Me gjithë rreziqet e një imitimi, *Shuteriqi* nuk e ndien veten rob të bukurisë së *Bodlerit*. Pranon influencën e “maitre” –it, por rrëshqet në rrezikun e verbimit, duke nxjerrë zërin e tij të vërtetë. Jeton në dritën e yllit bodlerian, por rrëshqet në rrezikun e verbimit të dritës së madhe. Deri më sot na ka dhënë shembull të një zhvillimi me frymën bodleriane, por do ta gjejë veten. Është shpresa më e madhe e poezisë së sotme shqiptare.

*M. Peshkëpia* nuk kërkon poetin e referimit të tij jashtë kufijve tona. E gjeti veten kollaj në poezinë lasgushiane. Poezia e tij është ë matur, pa asnjë kërkim të lartë. Përkufizohet me veten, duke marrë hua

shumë herë ritmin, masat e shesh dhe fjalët e Lasgushit:

*Vashëzë prëndvera vetë,  
ja se ç' thotë zemr' e shkretë.*

*Peshkëpia* respekton kallëpet e vjetra dhe fryma e tij e matur mjaftohet me to.

*V. Kokona* është nxënës i poezisë erotike frënge. Më shumë artificial, që nuk pret të frymëzohet për të marrë pendën, por duket se është i zoti të krijojë vjersha çdo çast. Janë vjersha të mira ku pothuaj i mungojnë krejt gabimet metrike. Është poet që qetësohet me lumturinë e varfër dhe ndien frikë në fluturime të larta. Është poet aristokrat që kënaqet me narcizmin e ëmbël të vetëkënaqësisë. Shkurt, një poet artificial, që nuk është aspak i keq.

*Th. Konomi* dallohet për vërtetësi absolute. Vargu i tij i kulluar na kënaq, se poeti nuk e gënjen veten dhe nuk kërkon dafina të rrezikshme. Rrjedh më tepër prej poezisë greke të brezit të kaluar. *Porfiras* dhe më shumë *Polemis* janë poetët që i dashuron me thjeshtësinë e tyre klasike.

*A. Çaçi* është më i ëmbël e më mjeshtër me vargun. I sinqertë në frymëzimet, me vargje të bukura e të kujdesshme:

*Të prita në burim, por ti nuk erdhe...*

Anagliffe të vërteta. Sa njerëzor në ndjenja! Një ankim i ëmbël poetik. Aq i qetë sa, si asnjë tjetër apostull i artit, kënaqet me thërrimet, me ato ndjenja që janë gjithësia e njeriut, do të thoshin poetët me idenë e madhe. Është poet i vërtetë, me ndjenja të thjeshta, është poet njerëzor.

*N. Haku*, poet erotik, që e gjen veten më shumë kur merret me temat e fshatit, por, siç e kemi thënë dhe herë tjetër, është monoton. Ku

janë ato skena të bukura në ara, bujku me qetë që kthehet në shtëpi kur perëndon dielli dhe sa e sa të tjera.

Është mëkat që talenti i tij të përkufizohet me erotizmin e thjeshtë. Le të jetë i sigurt se poezia e tij do të sjellë një ton origjinal, bukolizmin, ndër ne, se nuk i mungon asgjë për të krijuar. Poezia shqiptare pret shumë nga talenti i *Hakiut*.

*Duke përfunduar me* Sh. Musaranë, poet që rrjedh nga Lasgushi, duhet thënë se ka karakteristika të të parëve me shumë pak ndryshime.

Përgjithësisht, poezia e të rinjve të *Antologjisë* na jep shpresa të vërteta për të ardhmen.

*Cikël artikujsh botuar në gazetën "TOMORI", korrik 1940*

## LETËRSIA E RE ITALIANE

### POEZIA

- 1 -

Letërsinë klasike italiane, letërsinë profashiste që, me përmbajtjen e saj psikologjike, përfundon me vdekjen e *D. Anuncios*, e kemi njohur shumë a pak. Këtej e tutje mund të kemi dëgjuar disa emra të rinj shkrimtarësh, por esencën e artit të tyre nuk e kemi shikuar.

Ka disa të huaj që besojnë në një dekadencë letrare italiane, por kurrë nuk flasin për arsyet e këtij besimi. Për letrarin, lënda që përdor nuk ndryshon aspak nga brumi i skalitësit (skulptorit), nga mermeri i tij i paformuar, do të thoshim, duke përdorur një simbolizëm të thjeshtë. Këtij mermeri ai do t'i japë frymën e vet me të gjithë fuqinë e tij (çdo vepër artistike ka frymën e saj). Vepra do të jetë e njëjlojtë në brendësinë e saj, veçse skalitësi dhe piktori e kanë gati lëndën e parë, d.m.th. lënda e tyre është diçka e dhënë. Ajo nuk pret asgjë tjetër veçse frymën që do t'i japë smili ose peneli.

Letrari nuk është në të njëjtat kushte krijimi. Nëse piktori dhe skulptori mund të frymëzohen nga një ngjarje, nga një person, nuk ndodh kështu me letrarin, tek i cili frymëzimi është fryma e popullit. Kjo frymë duhet të jetë e formuar që ta përvetësojë e shfrytëzojë poeti. Fjala është gjithmonë për atë letrar që jeton jetën tonë, që nuk qëndron i fshehur prapa perdesh fantazmagorike. Fantazia e tij është e vërtetë se dhe tani do t'luajë rolin e saj protagonist, por edhe nuk duhet të largohet prej logjikës.

Me një sërë mendimesh njëra pas tjetrës arrijmë në bazën e arsyeve të çalimit të një letërsie.

Ja, pra, përse letërsia e sotme italiane nuk ka nxjerrë *D'Anuncion* dhe *Paskolin* e saj. Pra, me të drejtë duhet të vonohet përshkrimi i jetës italiane prej letrarëve të saj, sepse edhe jeta e re gjendet në formim e sipër. Nuk mungojnë talentet, por jeta e re kërkon njerëz të rinj dhe, më të vërtetë, njerëzit e rinj italianë, intelektualë, gjenden në moshën e tyre të parë prodhuese. Jeta e re ende s'ka marrë formën e saj të caktuar, d. m. th. gjendet në zhvillim e sipër. Është një teori, e cila s'ka më tepër se 18 vjet që zbatohet. Ajo gjendet në organizimin krijues më të madh, kështu që zhvillimi dhe lëvizja e tij e madhe e frikëson artistin ta kuptojë plotësisht.

Nga ana tjetër, pranojmë se një letërsi gjendet drejt qëllimit të vërtetë, kur lëndën dhe frymëzimet e saj i merr prej personit, individit, dhe i lartëson me kolektivitetin. Me fjalë të tjera, ajo përqafton njeriun në tërësinë e tij. Kjo është letërsia e psikologjisë kolektive. Mund të thuhet se ky është faktori kryesor, pa përjashtuar edhe arsyet e tjera të një rëndësie të dytë, të cilat rrjedhin kryesisht prej personalitetit të artistit. Shfaqen edhe çudira në botë, por epoka jonë s'na ka mësuar me të tilla në lëmin artistik.

Na mbetet ende edhe një dyshim i rëndësishëm që duhet ta shtjellojmë me vëmendje: Si e pranon traditën e saj letrare letërsia e re italiane? Ruan, vallë, ndonjë njohuri të asaj tradite? Sigurisht që po. Hem i shtrohet asaj tradite, hem ligjeve të përgjithshme të zhvillimit, qoftë i mirë ose jo. Prandaj, para se të hymë në kryepikat e letërsisë së sotme, është e udhës të hedhim një sy të shpejtë në letërsinë e porsa kaluar.

Periudhën e fundit të traditës letrare klasike italiane e përbëjnë tri personalitete të mëdha, që mbretërojnë në të gjithë epokën e paraluftës si dhe në vitet e para të shekullit tonë. Është *Karduçi*, *Paskoli* dhe ajo fytyra e çuditshme e *D'Anuncios*. Tri fytyra, tri personalitete të ndryshme.

*Paskoli* në poezinë e tij derdh të gjithë mirësinë e shpirtit të munduar në një poezi të brendshme, të ëmbël, plot dashuri. Mjeshtëria e tij zotëron artin e vizatimit të ikonave, të aspekteve të natyrës e të jetës dhe u jep një rëndësi të veçantë zërave dhe ritmit të botës së palëvizshme. Herë-herë fuqia dhe fryma e tij gjenden në kuptime të përgjithshëm dhe të larta. *Paskoli* është liriku i ëmbël, këngëtari i dashurisë dhe, natyrisht, shprehës i shfaqjes së gjallë të ritmit sekret të brendshëm. Fryma e tij është e qetë dhe mendimet e tij të larta, sikurse shpesh herë dhe guximtare.

*Karduçi*, përkundrazi, është stërnipi i idealistëve të Rilindjes Kombëtare. Dashuria e tij e flaktë për lirinë dhe atdheun e tij, si dhe kultura e madhe klasike e lartësojnë në shkallën e poetit kombëtar. Italinë e lidh me Romën dhe, këtë të fundit, e shikon si trashëgimtare e famshme të qytetërimit mesdhetar, i cili e gjeti kurdoherë si vatër të vet. Është, pra, profeti i të sotmes? Nuk e di, por këtë do ta tregojë e ardhmja më e afërt.



# LETËRSIA E RE ITALIANE

## POEZIA

- II -

Fytyra e tretë e periudhës së fundit të traditës letrare klasike italiane është D' Anuncio, një personalitet krejtësisht i ndryshëm. Kryevetja e shpirtit të tij është sensualizmi që e zotëron dhe fryma e tij heroike. Dy pikëpamje të ndryshme të së njëjtës lëndë, që shprehen në një formë jashtëzakonisht të kujdesshme dhe të stërholluar. Këtu poeti paraqitet zotërues i vërtetë i esencës poetike, me lehtësi të çuditshme në formimin e vargut dhe në kërkimet metaforike të poezisë; me një mjeshtëri të lartë gjuhësore dhe poetike.

*Karduçi me Odi Barbare; Paskoli me Poemi Con Viviali dhe Myricae; D' Anuncio me Laudi* dhe disa vargje shumë muzikale të disa dramave të tij, konsiderohen, sigurisht, më të mëdhenjtë, më të mirët e poetëve të letërsisë moderne italiane. Është e vërtetë se i pari vdiq më 1907, i dyti më 1913 dhe i treti më 1938, por, megjithëse konsiderohen si letrarë të epokës që sapo kaloi, duhet t'i përmendim në shënimet tona të sotme.

Përbri poezisë që përmendëm më sipër, lulëzoi dhe prodhimi i pasur i poetëve të quajtur poetë të *hijeditës*. Brenda e këtij prodhimi kundërshton çdo lartësim heroik, si për përmbajtjen ashtu dhe për vargun. Mund të themi pa frikë se interesimi i tyre për gjera më të thjeshta, më të vogla të jetës, preferimi i tyre për fytyrat e rrethanave popullore, i afrohen më tepër poezisë së *Paskolit*.

Një nga të njohurit e tyre me mësuesin është mallëngjimi romantik

që vadit kompozimet e tyre idilike bashkë me një nënqeshje plot hidhërim melankolik. Lexuesi i vëmendshëm do të shquajë në këtë poezi edhe një influencë të poezisë frënge më tepër, duke filluar nga *Verleni* dhe deri te *Berlioz* i sotëm. Lënda e tyre përbëhet prej ikonave dhe ngjarjeve më të thjeshta; me anën e vargut shprehen ngjarje në “prozë”; dashurinë e paraqesin pa shtjellime romantike, gruan pa mbështjelljen e një bukurie heroike ose të një tipi fatal. Paraqesin, pa dyshim, shërbëtore dhe vajza, burgje dhe spitale, gra të rrugës dhe, me fjalë të tjera, poezia e hijedritës kundërshton D’ Anuncianizmin.

Kronologjikisht, poeti i parë i hijedritës njihet *Serxhio Koraxini*, i cili vdiq më 1907, jo më i madh se 20 vjeç. Një poet tjetër, i cili me ironinë e tij tragjike dhe me ndjenjën e tij të hollë merret si më i miri, është *Guido Goxano*. Edhe ky u nda jeta shumë i ri, në vitin 1916. Përveç disa pjesëve shumë të bukura, ai la edhe ca xhevahire të vërteta.

Një ngjarje e rëndësishme në historinë e letërsisë së re italiane është manifesti i parë futurist, i botuar nga *F. Marineti* në vitin 1909. Lëvizja futuriste që atëherë kaloi në luftën më rrëpine<sup>11</sup>, duke bërë armiq të mëdhenj dhe duke tërhequr miq fanatikë.

Marinetti dhe pasuesit e tij luftuan të gjithë traditën letrare italiane, duke kërkuar ndryshimin e frazës nga bazat e saj, si dhe pasqyrën natyrale të mentalitetit të ri që përqipeshin të krijonin. Urdhrat e manifestit futurist shpallnin suprimimin e sintaksës, mbiemrit, theksit, gjuanin triumfin e ikonave poetike që të nënshtrohen prej instinktit dhe të shprehen lirisht, pa u interesuar poeti për logjikën ose për justifikimin e tyre artistik.

Kredoja dhe aksioni i tyre qëndronte në këtë frazë: ***Le të formojmë me guxim të shëmtuarën në letërsi***. Këto pretendime guximtare, pa logjikë, ata i mbështetnin në konferenca, në bisedime, në artikuj dhe në libra kritikë. Këto lëvizje nuk do të kishin veç se një përfundim: të

---

<sup>11</sup> Të ashpër.

shkundnin gjendjen e letërsisë italiane. Dhe, me të vërtetë, zërat dhe zhurma e tyre ndihmoi në ringjalljen e letërsisë. Rreth këtyre artistëve të rinj dhe, sidomos, rreth iniciatorit të tyre luftarak dhe entuziast, u ndez një interesim shumë i madh në Itali dhe gati në të gjithë botën.

Nga pikëpamja artistike nuk ishte e mundur veç se përfundimet të ishin të varfra dhe mesatare. Nëse sot dikush do të dëshironte që të bënte zgjedhje të veprave futuriste, kjo *Antologji* do të ishte shumë e përcaktuar. Natyrisht prapa flamurit futurist, që shpallte lirinë absolute, qysh në fillim vrapuan një shumicë *ratés*<sup>12</sup> që synonin të formonin një personalitet artistik. Ata besuan se do të mund të realizonin ëndrrën e famës së tyre me artin e lirë, por mbetën, siç ishte e natyrshme, njerëz të dështuar në jetë.

---

<sup>12</sup> Të pazotë.

# LETËRSIA E RE ITALIANE

## POEZIA

- III -

Poetët më të mirë, që ndoqën rrymën futuriste, ruajtën ende cilësitë e tyre të vërteta që i karakterizonin edhe më përpara si krijues të sinqertë. Ata, bile, dolën të fituar prej kësaj shkolle. Pas shkëputjes nga futurizmi, u ndie rritja e nivelit të shkrimeve të tyre. Për ta kjo shkollë ishte një eksperiment, nga i cili u mënjantuan shpejt për të ndjekur çdonjëri rrugën e tij të pavarur, duke iu shtruar talentit natyral.

Janë mjaft antologji futuriste që kanë parë dritën e botimit deri më sot. Në një prej tyre, ë cila qarkulloi më 1912, midis poetëve të tjerë përmendet edhe *Aldo Palaxeki*, i cili dhe si futurist ende mban të gjitha virtytet që e lartësuan si poet të thjeshtë. Por futuristë më “të kulluar”, më besnikë në ideologjinë e tyre qëndrojnë *Buxi*, *Folxhore* dhe, natyrisht, krijuesi i tij, *Marinetti*.

Historikisht, futurizmi arriti kulmin e tij më të madh në periudhën e luftës italiane në Libi. Në këtë kohë nuk duhet harruar roli i tij kombëtar. Ai u bë nxitës i madh te rinia për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare, duke nderur shpirtin e tyre luftarak. Nga ana tjetër, dukej haptazi se këtë e bënte për qëllimin e tij.

Një nga revistat më të rëndësishme ishte *La Voce* e Firences, që u botua nga viti 1909 deri më 1916. Në materialet e saj të pasura kritikoletrare përfshihet edhe bashkëpunimi i *Papinit*, i *Prexolinit*, i *De Robertit*, i *Sofiçit* dhe i i *Onofrit*. Futurizmi në këtë periudhë lidhte fatet e tij me ato të kombit. Në faqet e tij historike përmbliidhen zërat luftarakë kombëtarë, që

gjejnë përkrahjen e tyre në poezinë futuriste. Sa i takon letërsisë luftarake jemi të interesuar, sidomos, për disa personalitete që ranë në fushën e luftës.

Midis atyre që dhanë jetën heroikisht për idealin e kombit është edhe *Vitorio Loki*, i cili me vjershën *La sacra di Santa Goricia* u bë me të vërtetë një poet shumë i dashur në popull. Një poet tjetër, që pati fatin e të arit, është *Xhozua Borsi*, që natyra e tij e ka shtyrë në disa drejtime, derisa në fund pati një vdekje të famshme mes heronjve kombëtare. E tërë eta e tij vaditet nga një besim i thjeshtë njerëzor, që merr kuptimin e fesë.

Me largimin e frymës luftarake në poezinë e kësaj periudhe, më tej ajo ndryshon përmbajtjen e saj dhe shpesh herë zëvendësohet nga proza. Një revistë që sjell karakteristikat e kësaj periudhe është *La Ronda*. Botimi i saj nisi më 1919 dhe u ndërpre në vitin 1923. Në faqet e saj dallon një lloj zgjimi në prozë, ndërsa për bri dukej që poezia kish pësuar një rënie.

Një personalitet përfytyruar i i periudhës së pasluftës është *Xhuzepe Ungareti*, një poet i vështirë në përmbajtje dhe në idetë etij filozofike, por mjaft fisnik dhe me një delikatesë të ëmbël lirike. Poezia e tij rrjedh nga përpjekjet e simbolizmit francez, i cili kërkon magjinë e fjalëve dhe të vargut dhe që përpiket gjithmonë të krijojë një atmosferë lirike me muzikalitetin dhe harmoninë e fjalës.

Poezia e *Ungaretit* është një poezi plot harmoni dhe muzikë metafizike; ajo buron nga një shqetësim i brendshëm artistik. Mund të themi se ajo është diçka si tërheqje në burimet e vërteta të lirizmit të thjeshtë. Çuditshmëria e tij fenomenale, prototipia e gjithë veprës së tij u kritikua me rreptësi të madhe. Por, megjithëqë vepra e tij ka një lloj normaliteti dhe aty-këtu disa të meta, autokritika e poetit dhe intuita e tij poetike e lartësojnë atë dhe e bëjnë autorin e saj një nga personalitetet me rëndësi të periudhës së tij. Nga ana tjetër, idioritmia<sup>13</sup> e tij nuk largohet krejtësisht prej traditës. Lidhur me këtë është e drejtë ideja e disa kritikëve se tek *Ungareti* kanë

---

<sup>13</sup> Ritmika.

influencuar Leopardi dhe Petrarka. Pra, figura e tij përmendet si një nga personalitetet më interesante të kësaj periudhe. Por, paralelisht me të, në Itali nuk mungojnë edhe poetë të tjerë me një vlerë të konsiderueshme.

Midis tyre është *Euxhenio Montale*, i cili dallohet për frymën e tij dramatike.

*Salvatore Kuasimondo* shquhet për poezinë e përsosur dhe të bukur. Ky krijues poliedrik në muajt e fundit na dhuroi disa përkthime të goditura nga poezia klasike greke.

Umberto Saba është një nga poetët e hijedritës që kohët e fundit arriti kulmin e një përvoje poetike të thjeshtë.

*Ugo Beti* sjell ende disa nga njohuritë e poezisë të hijedritës, si për shembull ëndërrimin dhe mitiken e esencës së tij.

Duhet përmendur edhe disa poetë të tjerë të këtij grupi siç janë: *Diego Valeri*, *Karlo Betoki* dhe *Aldo Kapaso*.

Duke përfunduar shënimet për pjesën poetike të letërsisë së re italiane, duhet të kujtojmë edhe poeteshën e vjetër, *Ada Negrin*. Megjithëqë gjendet në një moshë të thyer, krijimi i saj poetik paraqet një ndryshim të konsiderueshëm. Nga realizimi i thjeshtë në vëllimin e saj të fundit *Il Dono* (1936), që është një përmbledhje vjershash, bën një kthesë, duke përqafuar lirizmin e thjeshtë dhe duke arritur përsosmërinë metrike.

Janë edhe shumë poetë të tjerë që nuk i përmendëm në shënimet tona, pasi ata nuk kanë gjetur ende rrugën tyre që do t'i udhëheqë për një krijimtari të qëndrueshme.

# LETËRSIA E RE ITALIANE

## PROZA

### - IV -

Shkrimtari *Xhovani Papini*, në një nga studimet e tij analitike, ka shfaqur mendimin se proza rrëfenjëse (tregimi i shkurtër) dhe, sidomos, romani nuk janë një lloj letërsie që pajtohet me karakterin italian. Natyra jonë artistike, vazhdonte ai, anon më tepër nga poezia lirike, nga oratoria, historiografia, nga vepra përgjithësisht me ngjyrë intelektuale dhe nga satira. Duke mbrojtur mendimin e tij, Papini sillte si shembull mungesën e veprave rrëfenjëse në të gjitha periudhat letrare italiane. Duke vazhduar më tej, ai tregonte se te veprat letrare në gjininë e prozës të krijuara nga italianët mungon thellësia psikologjike dhe dallohen ato elemente që radhitëm më sipër.

Këto mendime të përgjithshme u bë shkak për shumë shkëmbime mendimesh dhe polemikash. Kështu që jo pak shkrimtarë italianë ofruan mendimin e tyre mbi akuzën e Papinit.

Po deri ku mund të jetë e vërtetë një ide e tillë?

Ne s'do të shpërndahemi në hollësitë analitike të mendimit të shfaqur prej Papinit, por do të shprehim shkurtimisht vetëm idenë tonë mbi këtë problem me peshë. Qysh në fillim mund të themi se shumë nga veprat e vjetra të reja dëshmojnë haptazi se shpirtit italian nuk i mungon zotësia e rrëfimit, thellësia psikologjike, megjithëse kjo letërsi në përgjithësinë e saj nuk mund të barazohet me prozën letrare të disa kombeve të tjera. Por, edhe numri i kufizuar i këtyre veprave nuk na lejon të përjashtojmë krejtësisht shkrimtarët italianë prej novelës dhe romanit.

Dhe tekefundit, letërsia e sotme italiane tregon se ato shqetësime që i kemi takuar edhe më përpara, ekzistojnë edhe sot, më të gjalla e më të dukshme dhe krijimi i shkrimtarëve të rinj paraqitet me shpresa të mëdha, ndonëse epoka e re ende s'ka dhënë kryeveprën e saj.

\* \*

\*

Periudha e mëparshme ka treguar me krenarikryeveprat e saj. Ndaj e shoh me vend se një studim për këtë periudhë nuk do të kishte vend në këtë artikull. Kujtoj kryeveprën *Piccolo mondo antico* të Antonio Figaxaros (1824-1911) dhe *Mastro Don Gesualdo e Malavoglia* të Xhovani Vergës (1840- 1922).

Në këto shënime sigurisht që duhen përfshirë edhe *D'Anuncio*, *Pirandelo* dhe *Pancini*, të cilët do të mbeten për herë si personalitete të mëdha e si mësues, veprat e të cilëve kanë hyrë në historinë e letërsisë ndërkombëtare.

Vepra që nderohet sot më tepër e *Gabriele D'Anuncios*, me të drejtë, është prodhim i tij lirik. Paralelisht nga proza e tij si vepra më të mira kujtohen; *Faviglie del Maglio* dhe *Notturmo*. Kjo e fundit është vepër autobiografike me një bukuri të shquar. Të gjitha faqet e saj gjallërohen nga një sensibilitet i hollë dhe ndërshtypjet rrjedhin më një mënyrë të drejtpërdrejtë në një stil të harmonizuar që karakterizon stilin italian. Në të gjithë krijimin e tij të pasur ai shquhet për një frymëzim të lartë, plot sensibilitet dhe pasion të flaktë. Fytyrat letrare të prozës së tij bëjnë një jetë fantastike në një atmosferë mistike. Në krijimtarinë e *D'Anuncios* shëmbëllet Italia e paraluftës, një Itali artistike, poetike ashtu si e ka imagjinuar ai. Shkrimi i tij retorik, mbiemrat (epitetet) e tij të pasura, përshkrimet e shumëzgjatura, hollësia shumë e saktë, ritmi i tij prototip i dhuruan letërsisë së përbotshme, ndoshta, faqe pak të mërzitshme, por



plot “succo”, një të lartë, dobësitë e së cilës falen vetëm kur vijnë nga shpirti i një shkrimtari me zotësi të D’Anuncios.

Në këto shënime të prozës nuk do të shpërndahe mi shumë për *Luixhi Pirandelon* (1867- 1936), pasi do të bëjmë fjalë për të në pjesët teatrale (dramat), meqënëse shkrimtari në këtë fushë tregoi zotësinë e tij më të madhe letrare. Vetëm kujtojmë lexuesit se Pirandelo shkroi mjaft romane, nga të cilët më i miri është *Il fu Mattia Pascal*. Ai ka shkruar edhe shumë novela, më tepër se 300, që karakterizohen e dallohen nga idioritmia e tij e çuditshme. Shumë nga kritikët letrarë, prodhimtarinë e Pirandelos në prozë e konsiderojnë si pjesën më të mirë letrare të tij. Zaten vlerën më të madhe novelave të tij ia japin sensi realist, satirik, lirik ose tragjik, sipas frymës së tyre. Duhet thënë se shumë nga momentet e përshkruara në novelat e tij ai i ka ripunuar edhe një herë me mjeshtëri në veprat teatrale. Me idioritmin e tij, me imtësinë e tij psikologjike e me masat e reja krijoi në artin e teatrit letrar, me të drejtë duhet të konsiderohet një nga shpirtrat më të mëdhenj të periudhës së kaluar.

# LETËRSIA E RE ITALIANE

## PROZA

- V -

*Pancini* (1863 -1939) është një shkrimtar tjetër që nuk duhet të përjashtohet prej prozës së zgjedhur italiane të periudhës së kaluar. Ky letrar së bashku me *D'Anuncion* dhe *Pirandelon* përbëjnë trininë letrare të epokës së tyre. Lirizmi i tij i hollë i jep novelave të tij një shije të këndshme dhe të ëmbël. *Pancini* është një poet që në vend të vargut metrik preferoi kufijtë e gjerë të prozës. Virtytet e tij duhet t'i kërkojmë më tepër në stilin modest dhe të përkulshëm, që nuk është as i pagabueshëm, por as i pakujdesshëm. Megjithëkëtë është një stil i lartë dhe i këndshëm: këtu i shpejtuar dhe nervoz e atje i shtrirë si një bisedë e këndshme.

Gjithashtu shkrimi i tij karakterizohet nga një lartësim shpirtëror që buron prej kundërshtimit të jetës dhe të ëndrrës, një kundërshtim që nuk lartësohet kurrë në elementin dramatik, por, përkundrazi, shpesh herë merr një ton ironik me një nostalgji të mallëngjyer.

Qëndrimi i shkrimtarit kundrejt shoqërisë së sotme pajtohet me dëshirën e një jete të qetë, që gjendet gjithmonë në kontakt të drejtpërdrejtë me natyrën e kënduar shumë.

Jo pak nga kritikët e sotëm e kujtojnë *Pancinin* si një mbeturinë e periudhës së kaluar letrare. Brezi i ri i kapërcen veprat e tij. Megjithëkëtë *Pancini* do të mbetet një personalitet në letrat italiane. Vepra e dhuruar prej tij është një vepër plot eksperiencë e estetikë, me elemente të pajisura me kulturën e tij të madhe klasike. Gramatologjia italiane nuk mund të harrojë disa nga veprat e tij si *Lanterna di Diogene* etj.

Midis prodhimtarisë letrare të viteve të para të shekullit tonë, shek. XX, tri vepra na duken me shumë vlerë nga çdo pikëpamje, përveç tre letrarëve që i përmendëm më sipër. E para nga këto është *Rube*, vepër e G. A. Borgezes. Kjo është cilësuar si vepra më e madhe e këtij shkrimtari, por edhe më e mira nga krijimtaria e tij letrare. Ajo është një vepër me një kompozim të përsosur, që me vlerën e saj përbën një fillim dhe një stacion të veprave me përmbajtje sociologjike të jetës së re italiane që prej vitit 1918 e tëhu. *Borgeze* është një intelektual dhe një kritik i radhës së parë që shfaqet edhe si dramaturg, si novelist dhe poet me një zotësi të madhe. *Rube*, vepra e tij më sintetike, i qëndroi kritikës dhe shumë nga intelektualët e rinj i dhanë vlerën e një *Fausti* të sotëm. Por ka edhe të tjerë që e kritikojnë atë si një histori të çuditshme me një hero anormal. Megjithëkëtë, asgjë nuk na pengon ta karakterizojmë si një simbol të një brezi të gjerë dhe të vërtetë. Stili i tij nuk mund të thuhet se është ai që kërkojmë nga ky shkrimtar; ai shpesh herë bie në banalitet dhe shumë rrallë takojmë frymën poetike. Por realizmi dhe psikologjia e tij së bashku janë ato që i japin një vlerë të padyshimtë.

Vepra e dytë nga ato që përmendëm më sipër është romani *Ilia ed Alberto*, me autor gjeneralin *Anxhelo Gatti*, pjesëtar i Akademisë Italiane. Gjeneral Gati si letrar u shfaq për herë të parë në vitin 1931, mbas disa studimeve historike dhe ushtarake.

Si çështje më me rëndësi, por edhe në qendër të këtij romani, është vdekja e Ilias. Ajo ishte gruaja e një burri të qetë, por që pas vdekjes së saj shkaktoi në shpirtin e të shoqit një kryengritje, një turbullim të thellë kundër fatit dhe kundër Perëndisë. Por më vonë, dalëngadalë, shpirti i të njeruarit qetësohet dhe, përmes zhvillimit psikologjik, gruaja e vdekur i paraqitet përmes kujtimeve dhe drejton jetën e tij. Ai shumë shpejt gjen ngushëllim në rinjohjen e Perëndisë.

*Ilia ed Alberto* është një vepër e fortë dhe e hollë. Romani i

shkruar me një stil të shtruar dhe natyral, pa fraza bombastike, gjallërohet nga një lirizëm i thjeshtë, i sinqertë. Me përmbajtjen e lartë dhe me stilin e tij delikat, ky roman gjendet në radhën e parë të traditës së prozës italiane. Libri i Gatit, që u admirua nga të gjithë, menjëherë pas botimit u përkthye në shumë gjuhë dhe u konsiderua si një nga veprat më të mira ndërkombëtare të periudhës sonë.

Shkrimtari i tretë i kësaj trinie, që shënuam më lart, është *Alberto Moravia* me romanin e tij më të bukur *Gli Indifferenti*. Në faqet e tij shkrimtari vizaton gjera dhe persona me sinqeritetin më të madh, me asnjësinë e një pasqyre. *Moravia* ishte ende shumë i ri kur botoi romanin e tij me qëllim ironizimin e disa tipave të shoqërisë sonë, duke dashur të zhveshë imoralitetin, ose më mirë mungesën e ndërgjegjes morale të disa tipave njerëzish, sikundër edhe mungesën e vullnetit të indiferentëve.

Stili i librit duket pak si pa ngjyrë, i dobët, por që nuk i mungojnë çastet përshkuese të forta. Zotësia psikologjike e shkrimtarit, arkitektura e tij e përsosur tregojnë për një letrar të shëndoshë, që iu premtoi shumë letrave italiane.

# LETËRSIA E RE ITALIANE

## PROZA

-VI-

Bazuar në karakteristika të njëllojta që , relativisht, mund të kenë shkrimtarët e sotëm me ata të mëparshëm, në këtë artikull do të përfshijmë edhe prozatorë të tjerë në grupe jo dhe fort të dalluar.

Autorë të kësaj periudhe me një vepër të pasur janë: *Gracia Deledda, Luço D'Ambra* dhe *Salvator Gota*.

*Gracia Deledda*, i cili vdiq në vitin 1936, pas një jete të palodhur prodhuese dhe të pasur letrare, u kurorëzua me çmimin Nobel. Burimin e frymëzimit të veprës së tij e gjen në jetën e njerëzve të përlulur e të thjeshtë të Sardenjës, të njerëzve që i tronditin pasionet e forta protogone<sup>14</sup>, të një vendi të rrethuar me idiotipin origjinal të ishullit. Në shkrimet e saj shkrimtarja tregon për një grua sentimentale, por me ndjenja të shëndosha, që i kanë dhuruar rrethanat e vendit të saj. *Gracia* do të mbetet në Itali përfaqësuese e seksit të bukur, një grua me mendime të larta dhe ndjenja të holla femërore.

*Luço D'Ambra*, akademik që vdiq kohët e fundit, ka shkruar një numër të madh romanësh. Është e njohur se shkrimtari në fjalë pranoi disa imitime nga letrarë të ndryshëm, por, megjithëkëtë, nuk mundi t'i asimilojë këto imitime dhe t'i lartësojë në një shkallë të përsosur artistike. E meriton të përmendim disa nga romanet e tij më me rëndësi, në faqet e të cilave dallohet përpjekja e goditur për analizimin e shoqërisë dhe të psikotropisë së sotme. I këtij lloji është romani *Professione di moglie* dhe

---

<sup>14</sup> Vetjake.

romani tjetër i hollë *Fantazia di mandorli in fiore*.

*Salvator Gota* është një shkrimtar poligraf<sup>15</sup> dhe jo i madh nga pikëpamja e vlerës letrare. Vlerën më me rëndësi e përbën romani i tij sintetik me titullin *Ciclo di Vela*. Gjithashtu vlen të përmendet edhe romani tjetër *Il figlio inquieto*.

Arrijmë kështu në një talent të fortë, akademikun *Masimo Bontempeli*, i cili është një nga shkrimtarët më të mirë të letërsisë së re italiane. Karakteristikat e tij më kryesore janë: frymëzimi prototip, stili i përkulshëm dhe i zgjuar, në të cilën pasohet fuqia përshkruese me një humor të shëndoshë dhe të hollë, krejtësisht personal. Një gjë tjetër që e karakterizon autorin në fjalë është poliedrizmi dhe goditja e tij e përsosur në çdo gjini letrare, novelë, roman apo pjesë teatrale (dramë).

*Aldo Palaxeki*, mund të themi se ka merituar një pozitë të konsiderueshme midis letrarëve më të mirë. Faqet e tin më të bukura gjenden sidomos në *Stanope dell'Ottocento* dhe në romanin *Sorelle Materassi*.

Po në grup duhet të përmendet edhe *Antonio Baldini*. Ky autor si akademik, por edhe si kryeredaktor i *Nuova Anthologia* ka treguar një zotësi të madhe në lëmin letrar, duke përkrahur dhe duke udhëzuar talentet e reja. Shkruan rrallë dhe këtu duket arti i tij i shumë punuar. Humori i tij i hollë, çuditshmëria e tij në novelat dhe vesa e tij lirike e tregojnë një letrar të fortë plot “succo”. Një nga virtytet e tij më të mëdha është stili i hollë, gjuha e stërholluar dhe shumë estetike. Kështu ai na paraqitet gjithmonë e më i ri, më origjinal.

Po me këtë vlerë duhet përmendet edhe letrari *Rikardo Bakeli*. Por, ky i fundit dalohet nga i pari për frymëzimet dhe për përmbajtjen e ndryshme të veprave të tij. Në shkrimin e *Bakelit* shquhet një frymë

---

<sup>15</sup> Prodhimtar.

e fortë sintetike, një eksperiencë e thellë psikologjike që e tregojnë një shkrimtar të zgjuar dhe plot shqetësime shpirtërore.

Me sensibilitet shumë të hollë dhe eksperiencë të pjekur në art paraqitet letrari i shquar *Umberto Frakia*, i cili vdiq tragjikisht disa vjet më parë. Nga veprat e tij më të mira shënojmë *Angelica*-n dhe *Stella del Nord*. Hollësia psikologjike, sinqeriteti në frymëzime dhe stili i tij fisnik, japin karakteristikat më kryesore të *Umberto Frakias*, i cili zë një vend të merituar në historinë e letërsisë italiane.

Nuk duhet harruar edhe novelisti *Marino Moreti*, i cili edhe si romancier ka treguar një zotësi të madhe në teknikën dhe në fushën psikologjike e shoqërore. *La casa del Santo Sangue* shquhet ndër veprat e tij më kryesore.

Nuk mund të përjashtojmë nga këto shënime akademikun *Gelfo Çivinini* dhe *F. M. Martini*, të cilët sjellin në prozën e tyre njohuritë e shkollës poetike të hijedritës..



*Një foto e vonë, pak para vdekjes*



# PJESA E TRETË

*Dhjetë skica dhe tregime të shkurtra*



## NJË HEROINË

Lajmin sot na e jep “Fletorja zyrtare” që si kurdoherë dhe si duhet përkufizohet në pak fjalë të thata , të shkruara nga kryetari i një gjyqi. Shkenca nuk përhapet kurrë në fjalë të kota, por me dy reshta përmban një dramë të tërë.

“Thërritën zonjat X. dhe K., që të prezantohen para gjyqit për shkak se zonja X, duke qenë bashkëshortja legale e ankusit M., ka shkëlur kurorën e këtij duke u turpëruar me të pandehurin tjetër K. me të cilin është duke jetuar si burrë e grua”.

Jam i sigurt se i dashur kënduesi ka etjen të mësojë se ç’lloj grua është kjo, ç’moshë ka, në qoftë se është e bukur dhe hollësira të tjera të kësaj natyre. Do ta urrejmë, do ta shajmë, një tjetër mundet dhe ta simpatizojë, por përgjithësisht të gjithë do ta dënojnë, cilido që të jetë justifikimi i ikjes së saj prej vatrës familjare. Feja, nga ana e saj, do ta dënojë pse shkeli kurorën e shenjtë, plaka llafazane e fqinjës do ta dënojë duke përfunduar me të famshmen “u prish bota” edhe ai mashkull, akoma me një mendim të fshehtë dhe të dyshimtë, nuk do t’i japë vend në tokë. Dhe si ngushëllim i veçantë i kësaj gruaje në këtë botë mbeti gjiri i të dashurit të saj...

Në këtë rast zonja në fjalë i mohoi të gjitha këto, harroi jetën e kaluar, shuhen kollai kujtimet për gruan, dhe me një guxim djaloshar u hodh në një jetë të re. Nuk e penguan rrethanat, nuk e mbajtën të qarat e fëmijës së saj që do ta kërkojë ditën, që nuk do ta harojë kurrë në netët e gjata të dimrit. U bë heroina e ditëve tona. Besojmë se nuk e shtyti romantizmi, besojmë se nuk u bë heroinë prej imponimit të një vepre, pse nuk ka zënë kurrë një libër me dorë, pse nuk ka vajtur kurrë në kinema. Etja e një jetë të re e tërhoqi në të panjohurën. Do ta dënojmë pa shkak

lehtësor.

- E tilla... shkatërroi shtëpinë e saj...

Dhe ne, nga ana jonë, do të themi:

- Na prishi traditën besnike, an turpëroi.

Nuk mund ta dimë vendimin e gjyqit; por populli, nga ana e tij, kur është çështja për shkelje kurore, e ka dhënë vendimin...

**JANKRILI**

## SHPALLJE

Mbasi për sipërmarrjen e furnizimit të bukës së vobektëve nuk duhet ofertues, adjukata shtyhet më datë 26. 1. 1940-XVIII, ditën e premte, prej orës 8.30 -11.30 p.d.

Kryetar'i Bashkis Kryeqytetit  
(Qizim Mulleti)

## DIMRI

Thoshte një poet satirik: “Shtëpia ime u bë shtëpi dashurie, u bë harem”. Dhe u shpjegua: ”Në dhomat e poshtme shërbëtoret me... kushërinjtë e tyre. Këtu poetët me poeteshat, duket se ishin poetë materialistë, në katin e sipërm, zonjat e mëdha me zotërinjtë e qajores dhe në qiramidhet...

- Dhe në qiramidhet? - e pyeti oratori i tij pa durim.
- Dhe në qiramidhet, macet!

Kaloi janari, muaj i hymeneut i maces edhe për pak e harrova që shtylla ime nuk ka të drejtë ta përjashtojë këtë shtazë shtëpiake, meqenëse konsiderohet pjesëtar i familjes.

E shikoj maçokun tim të shtruar afër sobës dhe çuditëm se sa e madhe duhet të jetë fuqia e tij erotike që këto netë të ftohta mund ta transferojë në lartësitë e çatisë, d.m.th. në Alpet Veriore, i pa interesuar nga të ftohtit, ndjek rrugën në të cilën e shpie instikti i tij. Në këtë orë ka takimin e dashurisë. Sportist i vjetër i dashurisë, trim i vjetër i çatisë me plot dekorata në fytyrën e tij, dekorata-plagë, që ia dhuroi e dashura me

inatin e saj femëror.

Plot narcisëm fërkon kokën e tij, duke u larë me lagështinë e gjuhës. Pra, gjuha shtazëvet iu dha jo për qëllimin që iu dha njeriut, por për diçka... tjetër. Maçoku im në këtë çast është dhëndri dhe njih shumë mirë ligjet e dashurisë, të zaptimit. Çuditërisht ndonjë herë dhe kam frikë se mos imitojë të zotin e tij, që e shikon përpara pasqyrës duke rregulluar kokërugjen e tij filozofike.

Nuk rinte i qetë. Kuptova shqetësimet e tij dhe i hapa dritaren për ta ndihmuar në detyrën e natyrës së tij. Nuk kishte orë në dorë që ta shikonte në erdhi ora e takimit. Është më i thjeshtë nga ne dhe punët e tij i rregullon sipas instiktit dhe pa asnjë ligj njerëzor.

Por s'është në një mendje me mua edhe zonja e shtëpisë fqinje. Nuk e tret dot dashurinë e lehtë dhe e mundon macen e saj.

Maçoku im e takoi dje të dashurën në rrugë. Por pa asnjë përfundim. Duket se ajo kishte shumë pretendime. Dhe kur ai e dëftu veten pak si të paturpshëm, ajo ngriti dorën e saj të vogël dhe e rrahu imoralin. Por kot, nuk mund t'i bënj kurrjë. Shtazët nuk an pyesin për punët e tyre.

E shikoja të mërziut. U morëm vesh shumë shpejt, pasi i mungonte fjala që njeriut i ish dhënë për të fshehur mendimet e tij.

Por sonte puna ka mbaruar. Hip në çati dhe kot zonja e maces fqinje bërtiste:

– Pis-pis-pis! Fifi, Fifi!...

Ishte vonë. Maçoku im u kthye shumë vonë. Nuk e qortova pse nuk respektoi ligjet familjare. I lodhur u shtri afër sobës dhe vazhdoi ëndrrën e natës dimërore.

**JANKRILI**

## MËNGJESI

U zgjova edhe sot si dje, si kurdoherë, edhe si do të zgjohem gjithnjë gjersa një mëngjes do të harroj të hap sytë. Shtriva këmbët i kënaqur, por akoma sytë s'i kisha hapur. Ku isha? Nuk e mbaj mend, por e di vetëm që çdo mëngjes më kap një nostalgji e çuditshme. Lëkundem midis realitetit dhe ëndrravet dhe dëshira ime është që të mos hap sytë, të gjendem gjithmonë në këtë gjendje ëndërruese. Dëshiroja të vazhdoja një ëndër plot magji që më dërgoi në botë të panjohur, që më solli në një parajsë femëror që as që kam imagjinuar kurrë, që më mbushi portofolin, që më largoi nga hallet e ditës.

Sa do dëshironim në këto çaste të ishim në një vend të paditur, që nuk ekziston. Por do të hapim prapë sytë dhe atëherë do të kuptojmë se ky shtrati ynë është i shtëpisë sonë, se shtëpia jonë është e kësaj fqinje, se fqinja është e këtij qyteti. Gjëra të ditura, gjëra të ngopura, të mërzitura. Dhe kur ti, o i dashur shok, do të dëshirosh të mbyllësh prapë sytë për të vazhduar lumturinë e humbur do vijë vetë jeta të të zgjojë.

Pemëshitësi me karrocën e dorës do të reklamojë tregtin e tij si dje, si kurdoherë:

– Portokalle të ëmbëla!...

Nuk respekton gjumin tënd të ëmbël, i cili në këtë rast është më i ëmbël dhe nga një qind portokalle. Fundi-fundit zëri i tij ka edhe pak ëmbëlsi që e japin fjalët portokalle të ëmbëla, por bashkë me këtë do të vijë edhe llustraxhiu që zëri i tij është i mbushur me bojë dhe vernik:

– Llustra, llustra!...

– Është muzika e mëngjesit, përralla e përditshme, që vjen dhe na zgjon nga ëndrrat e mëngjesit.

Nxënësi do të kujtojë se ka lënë mësimin pa mësuar dhe përnjëherë

përpara tij do të vijë fytyra e rreptë e profesorit. Punëtori do të kujtojë kazmën dhe sekretari llogaritë e pambaruara. Do të kujtojmë shamatanë me zonjën e shtëpisë që s'i kemi paguar muajin e kaluar dhe do të shohim prapë fytyrën e saj të tmerrshme.

- Zotëri ç' do të bëhet për atë llogari?

Do të kujtojmë restorantin, që i kemi mbetur diçka nga muaji i kaluar. Mirë shpëtuam nga borxhlliu dje, por në qoftë se na del në rrugë sot?

Hallet tona janë të pambaruara, edhe sikur të dëshionim të gjendeshim një mëngjes në një vënd të paditur, të shpëtonim nga këto halle. Nuk e kërkojmë për dëfrim, për qejf, shëtitije.

Dhe ja që, erdhi radha ime:

- “Fashizmi”. Marrëveshja Ballkanike, “Fashizmi”.

S'ka mënyrë të shpëtojmë. Do të fillojmë prapë sot atë që kemi bërë dje, atë që do të bëjmë gjithmonë gjersa një ditë do të harrojmë të marrim frymë...

**JANKRILI**



## DHURATË E VDEKJES

Iku ngadalë e përlur, si kalon fryma gjysmë e vdekur e erës së një pasdreke të qetë. Kuajt e hiqnin plot mallëngjim karrocën e vdekjes, thuaj se e ndienin ngarkesën e çmuar që ishte e mbyllur në arkën e zezë dhe të pashpirt. Plot dhembje përçante korteu funebër rrugën më kryesore të qytetit, atë rrugë që aq herë e kish përçarë me gëzim bashkë me shoqet e saj. Dhe atje ku shpërndante ëmbëlsisht buzëqeshjen e saj të lulëzuar, tashti litanja e vdekjes përhap përçark mallëngjimit mbi jetën e tej varrit. Dhe pas saj të veshur me të zeza, shoqet e ndjekin plot dhembje dhe me trishtim.

Po!... Atë rrugë që përçanin dje akoma me gëzimin e rinisë, tashti e kalojnë duke bërë të qajnë edhe gurët.

Dhe udhëtari i mallëngjyer nxori kapelën e tij dhe përpara urdhrit të çuditshëm të vdekjes, ndaloi çdo energji, mbërthyer nga pamja e hidhur.

Iku ngadalë, e përlur, iku pazhurmë, duke shpërndarë rreth saj hidhërimin, dhembjen. Pak lule në sundukun e saj, pak libra, simboli i shenjtë, që shpërndan gëzimin e së ardhmes.

Sa desha ta pasoja këtë litani të vdekjes... Të derdhja dy lot bashkë me prindërit e saj, dy lot për lulen e rinisë që shuhet.

Iku ngadalë, e përlur dhe e vdekur ajo mori me vete frymën e gëzimit të shtëpisë së saj...

Dhe kjo litani do të arrijë në qëllimin e saj makabër, në fundin e saj të tmerrshëm, prindërit e saj të pangushëlluar do të marrin prapë rrugën e shtëpisë së tyre. U çduk zëri i saj, shtrati i saj bosh, dhe vëndi në bankë e prët. Librat do të mbajnë gjurmët e saj dhe në bankon e shkollës vëndi i saj do të mbetet bosh. Do të shuhet emri i saj nga regjistri i shkollës dhe shoqet e saj do ta kërkojnë pa shpresë:

– Ku është Artemisia?

Ato vetë e përcollën në banesën e fundit, por nuk duanëtë besojnë që ajo nuk rron më.

Shkova në zyrë i mallëngjyer; nuk e njihja, nuk e kisha parë kurrë, por megjithëatë hyra i nxehur tepër në tryezën e punës për të shkruar këto pak radhë për kujtimin e saj. Për t’u dhënë ngushëllimin njerëzvet të saj? S’ka asnjë vlerë. Le të qajnë që t’u lehtësohet dhembja...

**JANKRILI**

## TË DY DHE I ... TRETË

Treshi si numër u bë i shenjtë. Tre janë këndet e çdo trigoni. Në tri gjendje shfaqet perëndia.

Kristiani tri herë ka për zakon të bëjë kryqin e tij, tri ditë mban Bajrami.

Edhe ajo foshnja kur do të hidhet nga një hendek numëron:

- Një, dy, dhe treshi e gjen në ajër.

Është e lidhur aq me jetën tonë sa që edhe mëiI qytetëruari nuk e përjashton kollaj nga jeta e tij.

Lozin edhe shifrat një rol në jetën tonë.

- Tri ditë mos i kalofsh, - thotë llafazania fqinjë.
- T'i pritja tri orë, - thotë i dashuruari për të preferuarën e zemrës së tij.

– Ditën e parë mori nusen, të tretën vdiq, - thotë populli kur do të karakterizojë mendimet tona dhe ashpërsinë e mortjes.

Dhe me mënyrën e tij fataliste populli përsërit:

- Të tri të këqiat e fatit tonë.

Është treshi, pra. E preferojmë kudo dhe atje ku humbet vlerën e tij është çështje dashurije.

Këtu nuk futet i treti. I treti vetëm dëgjon.

Të dy mundohen, përpiqen, dashurojnë; por i treti dëgjon dhe bëhet tellali i tyre. Ç'thuhet midis të dyve nuk i mëson kurrë tjetri, por kur dëgjon i treti e mëson gjithë bota.

- Të ta them në vesh. Është sekret, shiko mirë!

Dhe të nesërmen e mësoi gjithë bota. Pse? Se zotëria nuk dinte rolin që lot i treti. Është karakteristika e jonë, por njëkohësisht dhe dobësia.

- Do të të them diçka. Të mos dëgjojë tjetri.  
Përkulet pastaj në veshin e të afërmit:
- Jei! vetmi që e di këtë. Dhe më poshtë në një tjetër:
- Është sekret.  
Por ka qejf kur zotëria ia thotë edhe një tjetri.
- Mos ia thuaj kurrkujt. Kështu, kështu...
- Hu, hu, nga e mësove? Tashti e mëson ti?

I ra damllaja zotërisë. Sekret personal dhe e mësuat të gjithë.  
Dhe kush e ka fajin? Sigurisht jo muret por, i ...treti.

**JANKRILI**

## KUR KËRKON FAJIN TE GRUAJA

U zure me gruan tende, e vrave fëmijën, e zëmërove mëmën. Kjo, sipas jurisprudencës, varet nga e drejta familjare dhe si e këtillë nuk më përket. Të shikoj të kuqur nga inati, si pulë deti të pjekur. I hape qitapet e vjetra dhe fillove... meshën. Nuk të emëroj Thoma, Hasan ose Luigj. Nuk e kam vënë me ndonjë nga ju, po me të gjithë ata që kanë me vete emrin burrë.

– Fajin e kanë gratë! -the.

Jo zotëri. Lé të marrë edhe kjo frymë një herë.

Hape dritaren dhe do të shikosh se s'ke të drejtë. Babai i fqinjës i gëzuar mori fëmijën dhe Evën e tij dhe kryelartë doli për të gëzuar veprat e duarve të tij. Drejtohet për në pazar. E la sot xholin dhe si njeri i mirë do të bëjë shëtitjen e tij. Do të kalojë nga reklamata e kinemasë. Në qoftë se ujdiset me gruan dhe me ... xhepin e tij, do të bëjë sot një shëtitje të vogël gjer në Romë; do të hidhet pastaj në Amerikë dhe prej andej atje ku do të qëndrojë vapori i filmit.

Bota është e ndarë. Disa i shtrijnë ëndrrat e tyre në mes të bulevardit midis një shëtitje të bukur; një dërsin në bankën e lojës pse akoma nuk i erdhi asnjë maç të bëjë romë; beqari ëndërron ëmbëlsinë e asaj që ka përpara dhe ai, më guximtari, merr aeroplanin prej lozhës për në Berlin.

Nuk e dimë se kush nga të gjithë doli më i fituar. Miku i xhollit nëse nuk fitoi, rrallë, 10 lekë, sigurisht humbi 5. Beqariti i iku.... engjëlli dhe, çudi, mbeti vetë. Dhe kinemaja mbaroi shfaqjen e saj.

Shëtitësit kthehen prej udhëtimit dhe si inondata derdhen në rrugët. Zgjohen prej një ëndrre dhe përpiqen të gjejnë ritmin e tyre të parë. Sytë e tyre janë bërë të kuq prej lotësh.

E qanë fundin tragjik të heroinës sentimentale, megjithëkëtë , një kënaqësi e thellë përhapet në fytyrën e tyre. Një admiron mjeshtërinë e Bon Karlofit, tjetri përpiqet të imitojë pakujdesinë e Çarl Bozerit, dhe vasha romantike provon zërin e saj për të arritur Marta Ezhelin. Dhe rinia romantike përpiqet gjithnjë të përmbajë të gjallë në fantazinë e saj trupin lakuriq që i ka turbulluar.

Babai i lumtur kthehet në shtëpi.

I vogli ngatërrohet në këmbët e mëmës dhe ajo e kënaqur falënderon burrin me shikimet e saj të ëmbla.

– Dhe ti, dhe ti, zotëri, akoma s’e mbarove shamatarë me gruan tënde

**JANKRILILI**

## MBETURINAT

Kaluan mjaft nga ditët e para të muajit të parë të Vitit të Ri. Por na mbeti si sëmundje zakoni i vjetër i lojës. Në atë ditë luajti gjithë bota. Kafeneja u bë Monte Karlo dhe prej shtëpisë mungon zëri burrëror i kryetarit të familjes. Luajti i madhi me palën e letrave, por edhe i vogli nuk mungonte te banka me kartelën e tombolës përpara tij. Luajti i pasuri, por edhe i vobekti nuk harroi zakonin. Mori me vete pak të holla dhe u drejtua në kafenë me shqetësimin e ëmbël të atij që kërkon fatin e vet. Humbi dhe atëherë kujtoi se ka harruar dhe diçka në arkën e vjetër.

Nuk është pokeri tashti, zaret a 31-shi, por këto u përmbloodhën në xholin. Heronjtë e lojës janë po ata që ishin në Shën Vasil; rrethanat gjithashtu nuk janë ndryshuar dhe vetëm i vogli mungon që të japë përgjithësisht mystagogjinë e rrethanave.

Me të mbaruar punën do të shkojë në kafenë me mendimin e mirë të pijë një kafe. Por lojtari i djeshëm e shikon viktimën e tij.

- Bejmë një...
- Lëre, mor derëzi, s’kemi kohë.  
Por lojtari nuk përkulet kollaj.
- Shtatë është ora, gjer më 12, kemi 5 orë.
- Jam i lodhur; do të shkoj në shtëpi.

Kujton sigurisht shamatanë me gruan e tij dhe nuk dëshiron ta hidhërojë prapë. E di ç’i pret tashti, por.... për një vetëm, jo më shumë.

Dhe xholi u formua. Kaluan një orë, dy, tri.

Bëri vaki që siguresa e elektrikut u-prish. Dritat shuhen dhe atëhere rrojmë edhe një herë çastet mystagogjike të Shën Vasilit.

- Për shumë vjet!... - dikush uron me halle.

Ora është 12. Garsoni me një frazë simbolike e lajmëron se duhet

të... ndahen:

- Durrës...Durrës zotëri.

Dhe nesër skena përsëritet.

Sa të lumtur do të ishim sikur të kishim një zell të tillë për punë konstruktive!...

**JANKRILILI**



## LOTARIA

Është shpresa e përgjithshme e fitimit. Është një ndjenjë krejt e ré që u shfaq ndër né me krijimin e lotarisë. Dhe mund të themi akoma se është një ndjenjë fisnike: hiç gjë tjetër përveç mendimit të fitimit, të një fitimi jo me djersë, por as me ndonjë vepër të keqe. Nuk do të vjedhësh tjetrin; nuk do të derdhësh gjak. Do të hapësh gazetën dhe në qoftë se ka dashur fati, do të bësh një shëtitje gjer në Romë për të marrë disa të holla, pak a shumë 9 milion lireta! E ç'ka!... Por gjersa të ... arrijmë atje, le të shohim nga sa gjendje shpirtërore do të kalosh.

Lotaria është vet fati; Këtë fjalë të pacaktuar, njeriu e ka mish e kocka, me daljen e lotarisë.

Ke në xhep 25 lekë dhe ke për të mbaruar me këto aq punë; ke për të ndrequr aq halle. Por... le ta provojmë edhe një herë këtë drej fatin. Dhe fillon nga djali që shet bileta:

- Dale mor ti! Pa hajde ta provojmë edhe një herë drejtin...
- Mere, për Zotin bej! Ke për me fitue numrin e parë vallahi!...

A e besove? Nuk e dimë. Por siç e shoh bisedimi me djalin e vogël është i butë, i ëmbël sikurse të ish vetë djali fati, a sikurse të paktën të kish një mundësi ndërmjetësimi!

Pagove, e mbështolte biletën në portofol dhe tani pret ditën e shenjtë të heqjes së lotarisë.

- Hë! Të më binte drejti!
- Oi mua, - thotë tjetri! - Dhe kam sa e sa halle për të ndrequr. Shtëpi s'kam; një punë të sigurt, jo; ime shoqe ësh e sëmurë dhe unë vet duhet të bëj një operacion...

Dhe zotëria e thotë me zë të lartë, pse kështu beson se e dëgjon Zoti dhe kështu do të përkulet ashpërsia e Fatit.

I pamartuari, në qoftë se fiton do të martohet. Dhe vajza? Kjo, ëndrrat i ka më të guximshme. Më përpara do të marrë atë që do ajo. Martesën e ka në instinktin e saj, por nuk e shfaq kollaj. Dhe kështu ëndrrat e saj janë të ndryshme, por të singerta. Do të mbarojë, thotë, shkollën dhe pastaj universitetin. Nejsë! Po të duam e besojmë.

Përgjithësisht në këto ditë nuk na zë gjumi. Natyrisht dhe, pa tjetër, dikush do të fitojë, por né i japim nënës së tij, ose gruas së tij një këshillë: do të bëjnë mirë të marrin menjëherë doktorin mos... pëson gjë njeriu. Ka ngjarë, sepse shumë herë së bashku me lotarinë njeriu, kur sidomos nuk është dhe i mësuar me paranë, mund të fitojë edhe ndonjë... kusur që e bën dertment në shejtanët e vegjël të mëhallës....

**JANKRILI**

## KUNADHJA

E kishte në thes të lidhur me një zinxhir të trashë dhe kështu fshatari me kunadhen u bë teatër i qytetit tonë. E hapte në mes të rrugës dhe populli plót etje për skena të këtilla, plot kuriozitet e rrethonte për të shikuar çudinë. Dhe ai plot krenari e tregonte kunadhen sikur ai e krijoi, sikur ai vet ishte kunadhja.

U afrova dhe pashë shtazën e vogël. E shkurtër, e bukur, i lindte njeriut dëshira për ta përqaftuar, për ta përkëdhelur. Leshi i pastër e i nxehtë, një lesh që vetëm natyra e krijoi. Sa gra dhe vajza nuk e dëshiruan këtë ngjyrë të ëmbël që nuk goditet kurrë me barnat e shkencës. Por edhe sytë e saj ishin aq të bukur, aq të ëmbël me gjithë shqetësimet e tyre. A e ka kuptuar valë përse e kanë sjellë në pazar? A e ka kuptuar vlerën e leshit të saj?

Shikon botën e habitur dhe çuditet me thjeshtësinë e saj natyrale. Pse nuk e lënë në çerdhen e saj? Ç'faj ka bërë? Mos është ajo fajto e një krimi?

U martua dhe krijoi familje si çdo banues i dheut. E dashuroi shoqen e saj dhe djemtë nuk i la kurrë në rrugë dhe lakuriq. Ç'faj ka? Në qoftë se bota është si e shqetësuar nga lajmet e radios, ajo është fajto e?

E shikoja të varfrën. Në rrethanat që rronte në ato minuta nuk shikonte kurrgjë të njohur. Thes, zinxhir dhe njerëz që e tallin. Dhe fshihte këmbën e saj të plagosur që ia dhuroi i zoti. Pse nuk e vrau më mirë që të mos ndiente, të mos kuptonte mëshirën e popullit?

Dhe bota e rrethonte më shumë dhe shumica natyrisht ishte gruaja. Profesori e shikonte me kuriozitetin e tij shkencor: ka katër këmbë, një bisht të gjatë dhe një kokë rrumbullake. Dhe tregtari me zanatin e tij: ka lesh mrekulli; dhe e trazoi qetësinë:

– Sa e shet o shok....

Dhe gruaja e ëndërronte për qafën e saj të bukur. Djali i saj s'është nevoja të dëgjojë profesorin e fizikës. Zoologjinë e ka në shtëpi, në supet e nënës.

– Sa bën o shok?

– Tre napolona e gjysmë.

Dhe në këtë çast pashë shtazën e vogël të mbyllë sytë e saj të buta. Mos e kuptoi pazarllëkun?

Mbylli sytë në një vërejtje të thellë.

Ishte sharja më e madhe që hëngra deri tashti.....

**JANKRILI**

## LECKA NJERËZORE

Miq besnikë të kësaj kishe të çuditshme, që quhet kafene, udhëtonin përmes ëndrrave, në Himalaje ndofta, ose ishim të humbur në ringjalljen e një kujtimi të lumtur. Nuk na pëlqen dhe aq bulevardi, dhe një skenë e tanishme nuk na tërheq. Një kafe e nxehtë dhe një cigare, që midis tymit të tij gjarpërues dhe të qetë, ushqejmë ëndrrat tona guximtare. Sa jemi të gënjyer të insistojmë se romantizmi u zhduk prej epokës sonë! U bë vetëm një transferim i thjeshtë. Qarkullonte më përpara i paçmueshëm në rrugët kurse tashti u mbyll krejt në brendësinë tonë. Gjendet në fazën e tij më hipokrite. Përpiqemi ta fshehim, kurse në të vërtetën na ka sunduar.

Kështu në një bankë, një grup prej të dy sekseve, shikon me vëmendjen e pelegrinit ditët e verës së kaluar nëpërmes pllakës magjike të fotografisë. Disa të tjerë më tej bisedojnë me dorë lëvizje të gjera duke dhënë kështu përgjithësisht pamjen e njerëzve të lumtur. Dhe kur zotëria fisnik u rrëfente dëgjuesve të tij historinë e rrëmbimit të Elenës së bukur, ose peripecitë e Don Zhuanit, papritur në derë u duk një fytyrë që me paraqitjen e saj e ktheu në qeshje gjithë seriozitetin e atmosferës. Ishte krijesa e njerëzimit. Një palë rroba mizore ishte veshja e tij dimërore. Mungonte këmisha, dhe xhaketa mundohesh të mbulonte lakuriqësinë e trupit të plakur. Këpucët e tij e kanë humbur krejt formën e zakonshme. Zuri të qeshë, dhe grimasat e fytyrës së plakur merrnin pamjen e një tragjedie të tmerrshme. Nuk ishte qeshja e një njeriu që shikon diçka qesharake, ishte qeshja simbolike e njerëzimit kundrejt padrejtësisë shoqërore.

Nuk ishte nevojë të zgjaste dorën për lëmosh; njeriu xhentil e kuptoi vetë këtë dhe me kënaqësi të thellë e thirri në bankën për t'i dhënë cerekun e tepërt, që s'i hyn në punë.

Këtë bujari të tepruar e pasoi dhe një tjetër por duke mos i shtuar gjë çerekut. Dhe në këtë ceremoni nuk mungoi edhe mëshira e vajzës së bukur. Zgjati dorën e saj të hollë dhe i dha çerekun e caktuar duke shoqëruar veprën e saj me një buzëqeshje hipokrite. Dhe kur lypësi i çuditshëm iku, shoqëria u kthye në veten e kënaqur nga vepra filantropike!

E bënë detyrën e tyre njerëzore...

**JANKRILI**



*Nga një veprimtari për J. Lilin në Universitetin e RMIT Australi, 1998*

# PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	15
SHËNIM BIOGRAFIK.....	35

## PJESA E PARE

NË UDHËTIM.....	41
TOKA E SHQIPONJAVE.....	49
TIRANA - KRYEQYTET MBRET / MBRETI DHE KOPEJA E TIJ.....	83
PRANVERË 1938.....	95
LUFTA.....	99
VJEN ITALIA.....	107
DASHURI E HERSHME FASHISTE.....	119
NJË DIELL PRANVEROR NË NETËT DIMËRORE EVROPIANE.....	135
FUND TETORI.....	141
ZMERT FASHIZMA.....	145
DROPULL.....	161
ATHINË.....	167

## PJESA E DYTË

ARTI DHE SHKENCA.....	173
MENDIME MBI LETËRSINË.....	177
TË DY RRYMAT.....	180
POEZIA DHE PROZA.....	183
KOSTIS PALLAMAS NJË IDOLOLATËR I MADH.....	188
RRETH NJË POETI E NJË KRITIKE.....	199
KNUT KAMSUN.....	204



PIKTORI ITALIAN XHINO ALBIERI.....	209
SHKËNDIJA.....	213
ARTI DHE KRISTIANIZMI.....	220
ANTOLOGJI.....	223
LETËRSIA E RE ITALIANE ( POEZIA I ).....	230
LETËRSIA E RE ITALIANE ( POEZIA II ).....	233
LETËRSIA E RE ITALIANE ( POEZIA III ).....	236
LETËRSIA E RE ITALIANE ( PROZA IV ).....	239
LETËRSIA E RE ITALIANE ( PROZA V ).....	242
LETËRSIA E RE ITALIANE ( PROZA VI ).....	245

## PJESA E TRETË

NJË HEROINË.....	251
SHPALLJE / DIMRI.....	253
MËNGJESI.....	255
DHURATË E VDEKJES.....	257
TË DY DHE I.. TRETË.....	259
KUR KËRKON FAJIN TE GRUAJA.....	261
MBETURINAT.....	263
LOTARIA.....	265
KUNADHJA.....	267
LECKA NJERËZORE.....	269

